

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

NDRE MJEDJA 150 VJETORI I LINDJES

KONFERENCË SHKENCORE
15 SHTATOR 2016

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE
ALBANIAN ACADEMY OF SCIENCES

150th BIRTH
ANNIVERSARY OF
NDRE MJEDJA

SCHOLARLY CONFERENCE
SEPTEMBER 15, 2016

Editor
Academician Eqrem Basha



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

NDRE MJEDJA 150 VJETORI I LINDJES

KONFERENCË SHKENCORE
15 SHTATOR 2016

Redaktor
Akademik Eqrem Basha

Këshilli organizues i konferencës:

Sabri Hamiti,

Rexhep Ismajli

Kolec Topalli

Floresha Dado

Shaban Sinani

Eqrem Basha

Copyright © ASHAK

Sabri HAMITI

NDRE MJEDJA: LIRIKU KLASIK

I. POEZIA

Vepra poetike e Ndre Mjedjes është një strukturë letrare e botëkuptimore e lidhur fort. Brenda saj është Poeti (Krijuesi) në vështrimin e atij që krijon, e jo Autori, në vështrimin e atij që shton. Përqendrimi në cilindo nga këto tri elemente, sado të jetë i thellë, bën thjeshtëzimin e kësaj vepre. Ndalja te përshkrimi i teknikave poetike, sado i motivueshëm nga mahnitja e një harmonie formale, mund të harrojë qenësinë e mendimit. Ndalja te mendimi e botëkuptimi, edhe me aparaturën e shkrimit racional, mund të mënjanojë ndjeshmërinë poetike. Shpalimi i Krijesës pa Krijuesin bëhet i pamundur, mbasi në letërsi krijuesi është domosdoshmërisht i përmbajtur në Krijesën; ata e lindin dhe e rrisin njëri-tjetrin. Vështrimi biografik apo bibliografik, sado i bërë me pedanteri, në fund provon vetëdijen që bëhet ose biografi e jetës ose biografi e shkrimit, duke mos arritur t'i bashkojë.

Një shkrim për poezinë, që mund të trajtojë lidhur tingëllimën e fjalës e thellësinë e mendimit, mund të jetë udhë e preferuar, kur kemi para veprën e Ndre Mjedjes. Natyrisht, duke takuar individualitetin të komunikueshëm me universalitetin, siç është natyra e poezisë së tij, si çdo poezi e madhe. Të kapet tërësia, duke shënjuar edhe shkëlqimin e grimcave të saj, do të dukej zgjidhje që kënaq kërkuesin. Pjesa tjetër nuk është dialog poetik, por literaturë, qoftë e vjetër, qoftë e re. Vetë Mjedja pat thënë që lënda e shprehur bukur është poezia. Duke brendashkruar veten në këtë mendim, apo duke teoretizuar universalitetin poetik, edhe ai sikur ka shfaqur shenjat e dëshirueshme të një leximi të shkrueshëm për poezinë e tij. Mund të jetë kjo edhe vetëdije e krijuesit që tanimë e ka njohur vetveten në veprën e vet për të thënë: kjo është kjo, që mund të interpretohet si rebelim: unë jam unë.

II. VETJA

Vetja në poezi nënkupton personin e krijuesin në procesin e krijimit të vlerës estetike, duke theksuar origjinalitetin. Që përmban vetën e të thënit, mënyrën e të thënit, strukturën e të thënës, për të prodhuar një Unë në trajtën e identitetit e të origjinalitetit që singularitetin e vë në lojë me universalitetin e artit poetik. Kjo dramatikë estetike merr trajta dalluese në poemat e fillimit të Ndre Mjedjes.

1. Bylbyli e unë

Te poema fillestare *Vaji i Bylbylit* poeti nis monologun poetik, duke shpikur veten e dytë për adresim, nëse kjo vetje nuk përgjigjet për të realizuar komunikimin; krijon personazhin si esencë të përngjasimit, duke e derivuar simbolin tradicional *që këndon* në personazh *që vajton*, madje jo vetëm që vajton po që *bën gjâmë*; për të vajtuar vetminë e robërinë, me shenja të dhembjes personale, që do të bëhen universale. Harmonizimi i vetjeve në strukturën estetike të poezisë rastin e ngreh në nivel të dukurisë, duke e shpëtuar shprehjen të mos bëhet *klithmë*, qoftë me kërkesën në trajtë të domosdosë, për lirinë e individit si domosdo të realizimit njerëzor: *gjâma* për lirinë e për jetën. Vetja e shqiptimit (Unë) nis me tregim neutral të adresimit (Ai), por shpejt kthehet në vetje të komunikimit të afërt (Ti), e cila në komunikimin poetik kthehet në unë.

Ky lloj i bashkimit zhvillohet nëpër faza në katër këngët e poemës, duke krijuar akte të dramatikës që rrokin e njësojnë dhembjen e jetës e bukurinë e artit. Ky kompozicion nis portretimin e kufizimit dhe të robnimit të qenies. *Kafaz ké qiellin/Epshin pengim* vijon me lakminë e zjarminë për bukurinë si qenësi që kthehet në kob: *Vet bukurija, o i shkreti, Kënka për jû një kob*. Vijon me paralelizmat e jetës e të artit, të cilat njësohen duke afruar dy qeniet (të njeriut e të poetit) nëpërmjet *zisë* e *gjâmës*: *Kurr s mbarojn t'zezat e mija/Gjama e jote kurr s'mbaron*. Përfundon me një thirrje, e thënë si lutje në mënyrën urdhërore, duke andrrue një dalje të shpëtimit: nga *gjâma* në *gëzim*: *Fillò me gëzue/Kam per t'u gëzue*.

Këndimi i dhimbjes për lirimin bëhet në variacione ndërmjet Bylbylit e Njeriut duke i përngjasuar gjendjet nëpërmjet pamjeve të natyrës e rrëfimeve të njeriut, në situata kontrastive apo të pajtuara; po

kjo dramatikë ikën nga konkretja tokësore e ngrihet në dimensione kozmike, po dhimbja mbetet një, e shqiptuar si vetmi me dimension njerëzor, që mund të zgjidhet në prehrin familjar të munguar, në të cilin mund të qetësohet shpirti, duke u shpaluar i plotë, si kthim e si shpëtim.

2. Unë

Te poema *I tretuni* (titulli ka vështirimin edhe i larguari edhe i humburi) nuk ka më personazh a simbol letrar përngjasues, është vetëm *Unë-i*, që është poeti që rrëfëhet. Rrëfimi i tij, i kënduar në variacione, është përpjekje për të shpëtuar shpirtin, për të mos mbaruar i tretur. Prandaj, gjithë ai dramacitet i shpënë në teh me një emocionalitet në skaj, kur këndohet *Lamtumira*, si këngë e vdekjes së ngadalshme, dhe *Mirupafshim* si ëndërr e kthimit dhe e shpëtimit. Shpëtimi kërkohet nëpërmjet kujtesës vetanake, të një jete të shkuar. Prandaj, gjëmimi i motit, acarja, rrufeja nuk është peizazh i natyrës poetike, po është portretim i gjendjes shpirtërore, dhe këtë poeti nuk ngurron ta pranojë kaq shkoqur:

*Por këjo gjamë qi bân natyra,
Këjo duhië qi s ká pushim,
E kësaj zëmres â pasqyra,
Â pasqyra e vâjit t'im.*

Tashmë pasqyra e zemrës është pasqyrë e vajit, i cili zhvillohet në variante nëpër këngët e poemës, si vaj i shpëtimit nga gjendja e tjetërsimit. Së pari duke kujtuar vendet, si topika të kujtesës: Shkodra e Cukali, Drini e Buna. Mandej shkretërimi shpirtëror, që mbulohet me ëndrrat e një parajse që pushon vetëm në gjuhën e identitetit të shqiptarit, si botë e kulturës që nuk shprishet. Pastaj kërkohet shpëtimi në këngën e djalit: *Po këndon një djalë te bregu/Permállshem si tui kjaë*. Një zë i humbur në shkretëtirë. *Vox clamantis in deserto*. Por jo: tash është një mjerim shpirtëror, që do të bëhet art. Dhe këtu lind poeti i vetëdijshëm për vlerën e *lotit* që, në kullimin e vet shpirtëror, kalon të përditshmen e ngushticave për të kaluar në sferat metafizike: si shpirt a si fat, që ngjall shpresën. Dhe poeti vetëportretohet:

*Janë xhevahira, o i mjeri,
Lott qi t'kullojnë per dhé;
E per mbî mjaltë â vëneri
Qi t'turbullon n'at fë;
Jan' âr e gur t'paçmueshem
Per nji kunorë n'krye t'at.*

Shpëtimi i shpirtit në krijim tani e arnon shpresën e kthimit, qoftë nëpërmjet lejlekut që lidh hapësirat e stinës, për të arritur te dheu i vet, te djepi që përkund më i pari, te nana. Vendi, kënga, nëna, tashmë janë ruajtur si shenja themeltare të identitetit. Në *andërr* a në *zhgjandërr*, kthimi është i detyrueshëm, i domosdoshëm.

*Nuk kalon nji nat' e nd'ândërr,
Porsi zhgjândërr,
E shof nanen këtû per brîë*

Nana është aty, e shoqëron shpirtërisht, duke ia shpalosur në variante kthimin e tij, jo më si ajo që e lindi, po si ajo që e bëri *njeri*, për ta kaluar në sfera morale-identitare: *Nana e jote â Shqyptarija*. Dhe ky tashmë e ka përgjigjen të pjekur në labirintet e lakimeve të veta shpirtërore: *Shqyptariën nuk e korita*. Kjo gjendje shpirtërore tash e rrit mallin, përtej kujtesës fëmijërore, përtej dashurisë për peizazhin identitar, përtej asaj që e bëri, e bën mall për atdhë.

3. Prapë Unë

Te poema *Malli për atdhë* poeti bëhet përfundimisht Unë si qenie që rrëfëhet, si personalitet, si vetje që flet e si krijues i realizuar, për të kënduar himnin e atdheut nëpërmjet figurave tani të lakuara në këngët pararendëse, nëpër situatat personale e ngushticat shpirtërore. Është e habitshme sesi pa u diktuar një këngë intime kthehet në një këngë himnizuese atdhetare. Janë pesë shkallë të gjendjeve shpirtërore, që lakojnë dashurinë për vendin në jetë e në vdekje. Në shkallën e parë shfaqet mjerimi në trajtë dertimi me figurën përngjasuese:

*Mue, o i mjerë bylbyli, po m'pergiân mue
Me kto dertime.*

Në shkallën e dytë përmallimi për fisin që e fali e përhumbe shikimin,
duke e kthyer trishtimin në pika loti

*Por prej trishtimit me lot syt m'mbushen
E s mund t'i ndali*

Në shkallën e tretë artikullohet përvoja vetanake për jetën e mërguar në
hapësira të huaja:

*Nder dhëna t'hueja, kû mbrapa u solla,
Veç trishtim gjeta.*

Shkalla e katërt, dëshirën për kthim e forcon me formulë të mallkimit
përrjashtues për ata që nuk e kuptojnë, për ata që nuk kthehen:

*Lerg teje, o Shqype, kush lypë gjallimin
Po do mallkue.*

Shkalla përmbyllëse kthimin e dashninë e mat me jetë e me vdekje, i
qetësuar përgjithmonë:

*Sá do n'giuhë t'ême kan me m'urue:
"Dritë pastë n'lumnië".*

Cikli i poemave të Ndre Mjedjes për veten krijon portretin e
artistit në rini bashkë me sprovimet për krijimin e personalitetit e
tundimet e personit. Shtegtimet në hapësira e në kohë për të marrë
dije, të fëmijës që u bë burrë larg, të nxënësit që u bë prift, të
vjershëtarit që u bë poet, duke kënduar vetëm këngën e vet në vetmi si
gjuhë, formë e domethënie. Tanimë kjo poezi ka shenjë e fortë
personale sa të quhet edhe letërsi autobiografike dhe shenjë formale
sa të quhet poezi e idiolektit në gjuhë e në trajtë. *Vaji i Bylbylit* ka
katër këngë me strofa katërshe me varg të matur, ku variacionet e
rimës e gjatësia e vargut krijojnë orkestrimin poetik. Te *I tretuni* e
strukturuar në pesë këngë: e para me strofa katrena, të tjerat me
sestina. Sestinat me rimë e sintaksë të veçantë, në të cilën strofat
ndahen në dy tërësi ritmike: vargjet një e dy dhe katër e pesë kanë
rimë të puthur, ndërsa vargu i tretë rimon me vargun e gjashtë. Loja
poetike krijohet me gjatësinë e vargjeve. Te poema *Malli për atdhë*
është përdorur strofa safike si katrenë. Kjo është pjekuria poetike e
Mjedjes, që do të kalojë poetikisht te andrra e jetës shqiptare, te kthimi.

III. ANDRRA E JETËS

Nga malli e ëndrra e kthimit poetik te letërsia e tij juveniliane, por personale, Ndre Mjedja lirik, tashmë është në zemër të jetës te *Andrra e jetës* e te stinët e saj, duke e lakuar jetën me vdekjen. Ky projektim poetik del në dy nivele. Në poemën *Andrra e jetës* me strukturimin e tri moshave e të relacioneve të tyre botëkuptimore e poetike, duke artikuluar një metafizikë neutrale nëpërmjet pamjeve reale. Në ciklin për stinët, duke u nisur nga pamjet e reales për të arritur në metafizikën e personalizuar. Është këtu i shfaqur si i figuruar ballafaqimi i jetës e i vdekjes, duke e lakuar lehtësisht çështjen e ripërtëritjes e trashëgimit, si pamje ideale apo iluzion të shpëtimit përpara tiranisë së kohës në udhëtim kah përjetësia e mbijetesës. Në këtë strukturim e thurje poetike, në të cilën shtrohen çështje të rënda filozofike e jetësore, shenja e autorit herë shfaqet më hapur, herë ikën anash si vajtues e shqiptues i *asaj që është*, porse më fort se kudo në veprën poetike zien e mbuluar dhembja njerëzore. Prandaj, motivimi i kuptuar si frymëzim në shkallë të përqendrimit poetik më fort sesa si shpërthim emocional, arrin shkallën sipërore, shkallë që arrihet edhe me krijesën poetike.

1. Andrra e jetës

Poema *Andrra e jetës*, e klasifikuar si kryevepër poetike e Mjedjes, kërkon një nuancim të vlerave të saj, qoftë të kërkuara në sistemin e tij poetik, qoftë në mendimin filozofik, qoftë në artikulimin figurues. Kalimi i personales në subjektiven, si fazë përgjithësimi; pamja e botës së qenë, e kaluar nëpër tronditje, jo për përmbysje, por për provimin e të përhershmes; figura elementare e kthyer në metaforë, për të mbaruar në emërtim (nominim) të idesë në funksion të formës klasike. Përfundimisht: prania e plotë e botës femërore, në mungesë të botës mashkullore, e kurorëzuar në trajtën poetike të elegjisë, si mbretëreshë e lirikës.

Poema përbëhet nga tri këngë: *Trina* (me tri pjesë thurur në katrena), *Zoga* (me katër pjesë thurur në katrena e sestina), *Lokja* (me dy këngë, thurur në katrena); gjithsej *nëntë* pjesë. Titulli *Andrra e jetës*, një metaforë e bukur mbretërore, me emërtimet e pjesëve me emrat e personazheve, që në fillim vë në raport artin me jetën duke shënjuar procedurën artistike që kalon nga emërtimet në metaforë e në

motivim: *Molla t'kputuna një deget/Rrijnë dy çika me një nanë*. Kjo tregon dhe një gjendje e një raport njerëzor, familjar. Vajzat kanë emra, kurse *nana* për raport e dashuri emërtohet Lokja. Këtë gjendje e jep pjesa e parë e *Trinës*, me një orkestrim të bukolikes, që shënjohe në varg të fundit me ndryshimin: *Se â tui çue një tjetër ërë*. Në pjesën e dytë tregohet ndodhia, si mbrëmje baritore, me ambient e personazhe në veprim: Trina, Zoga e Lokja. Atëherë parandjenja e Lokes se ajo tirrte fatin, ashtu si turrshin *drangojt* e *shtojzovallët*. Kurse fëmijët flenë si dy *qiellorë*. Pjesa e tretë është një mbyllje dramatike: Trina vdes. Atëherë hyn tema e vdekjes si njohje e parë për Zogën që bën pyetje e Loken që jep përgjigje: *Tash â tui folë me Zojen/Po shkon me bûjtë te Zoja*. Një formulim maestral poetik, mbështetur në moralitet familjar e doktrinar për përballimin e humbjes, vdekjes.

Në katër këngët e *Zogës* lakohet poetikisht tema e dashurisë, prapë e shfaqur në ëndërr:

*Herë n'at gjumë tui qeshun dukej,
Si m'u falë herë doren çote;
Herë permallshëm n'védi strukej
E n'fëtyrë gjaku t'tân'i vëlote.*

Kjo pamje e ëndrrës së dashurisë merr një shpjegim poetik në parantezë. Porse variacionet e shfaqjes së pamjes së djalit zhvillohen në pjesën e dytë, duke u përngjasuar me ndodhje e pamje të natyrës në gjëllim. Ky lulëzim i natyrës është artikulum i ndjenjës në pjesën e tretë: *Bashkë me lule lén dashtnija*; porse këtu shfaqet autori që u prin veprimeve me dëftimet në trajtë të urdhërores:

*Del, o bij' prej shpijes s'ate
Del prei t'vorfenit katund;
Njajò flakë qi n'zëmrë pate
Do t'percjellin tjetër-kund.*

Kjo dalje, apo kjo shkuarje, propozon një kurorë dashurie që bashkon flakë e zemra, besë e nderë, që do të zgjasë përherë; sepse *Â dorëxan' i Lumi Krisht*.

Pjesa e katërt është kurorë poetike e dashurisë, që nisat të lakoje lumturinë njerëzore, të shfaqur në një harmoni, në tokë e në qiell, porse asgjë, as toka as qielli, as yjet as prilli nuk i ngjet

*Foshnjes qi i qeshet
Nanës, kúr mbî të perkulet.*

Një krahasim i pa krahasuar i natyrës me dashurinë njerëzore, veçanërisht me dashurinë e nënës për fëmijën. Në këtë trajtë *Zoga* është përmbyllje e himnit të bukurisë e të dashurisë në lindje të njeriut.

Mirëpo kënga për *Loken* rikthen temën e vdekjes e të vetmisë. Në pjesën e parë këndohen variantet e vetmisë, në pjesën e dytë variantet e vdekjes. Vargjet lapidare nistore të njërës: *E n'balkue mbaruene lulet*; e të tjetrës: *U shty vjeshta e krisantemi/Vetun vorreve lulzon*; filozofikisht e metaforikisht paraqesin përmbysjen e stinës së jetës e vdekjen e Lokes. Kjo dinamikë gjendjesh e ndodhish shtrihet në katrena. E ajo nga fundi vetëportretohet:

*E shikjon një dritë t'venitun,
Vron pasqyren e jetës s'vet:
E lerg Mórden tui kositun
E kujton e pran' e thret.*

Mbarimi i këngës, vdekja, me vargun përfundimtar: *U ndal drita e ajó mbaroj*, duket që shënjon qetësi të përhershme, si shpëtim. Por, dramatika është aty para me një përshkrim të tmerrshëm të aktit të vdekjes. Këtu është dhembja madhore e mbarimit të jetës njerëzore. Nuk ka këtu asfare shenje të ngushëllimit. Sepse vdekjen e fëmijës, Trinës, e pajton Zoja (Maria), ndërsa kurorën e dashunisë së vashës, Zogës, e merr në dorëzaní i Lumi Krisht; kurse Lokja që mundet nga dhimbja e vet, edhe nëse i ngjet, nuk është Maria, por një grua e nënë malcore shqiptare. Poeti Ndre Mjedja këtu nuk është më predikues, as moralizator, është njeri që shqipton fuqishëm dhembjen njerëzore. Prandaj, poema e tij *Andrra e jetës* është vërtet andërr e jetës, dhe lirika e tij më e fuqishme.

2. Stinët e jetës

Vetë poeti shfaqet i pangushëlluar si qenie në poezitë intime për jetën e vdekjen te cikli i vjershave për stinët: *Pëndvera, Vera, Vjeshta e Dimni*, që në thurjen e tij poetike nuk janë stinë të natyrës, por stinë të jetës së njeriut, të mbytura në metafizikë. Këtu ai nuk e poetizon dhembjen në mosha të njerëzve, po në moshën e vetvetes. Në të katër stinët është uni i tij që lakohet poetikisht duke përvetësuar në intimitet

figurat e mëparme të poezisë së vet, natyrën e njeriun, gjendjet shpirtërore e përngjasimet e jashtme. Lexojmë te *Prëndvera*:

*Fllad i lét me vapë dashtnijet
Puthi pémen gëmb per gëmb;
U zgjue pëma, e qe prei shijet
Buloj mbarë neper kopshtë t'ëm.*

Te *Vera*, pas fushës së zverdhur e diellit që djeg, lexojmë fatin e individit, vetminë:

*Veç n'at arë, porsi një e tretun,
Zi nder petka e n'fytërë terr,
Korrë një cucë pá shoqe, vetun
Me hie t'vet qi mbrapa e merr.*

Nga një neutralitet i thënies, tani te *Vjeshta* shfaqet subjekti thënës krejt i dëftuar si unë i vetmuar, që është një paradhomë e varrit:

*Deken mëndova
Se m'vjen kúr do;
Se m'lëni vetun
S mëndova, jo.*

Jo, por, po! Vjen *Dimni* me metaforat e shkuarjes, vdekjes: Murlani, Stuhia, Akulli, Ngrica, Pika e gjakut. *Po del dimni me kosë ndorë*, po ashtu, *Qet balkoni pjalm e bórë*. Atëherë lutja e fundit, e shqiptuar nga dimri si stinë e natyrës, apo e shqiptuar nga njeriu (poeti) si stinë e jetës: *Struku, struku, i shkreti plak*, është hyrje në elegjinë e përbotshme e personale. Si poet i madh e lirik klasik, Ndre Mjedja, te lirikat personale i këndon në mënyrë të barabartë *andrrën e jetës e përshkrimin e vdekjes*, që, nëse nuk janë e njëjta gjë, atëherë duke qenë afër i japin shumë njëra-tjetrës.

IV. IKONA POETIKE

Në rrjetin poetik e në sistemin botëkuptimor të Ndre Mjedjes: *Nana*, *Skanderbegu*, *Shqypja arbnore*, *Shqyptarija* duken shenja identitare. Shfaqen si figura e zhvillohen në tema për të shkuar më tej. Duken si shenja të karakterit, të gjuhës e të ligjëritimit të jetës e të

vdekjes. Simbole të një morali dallues, që shtrihet përtej historisë së një kohe. Dëshifrohen të lidhura “në një rrfanë” dhe marrin kuptim së bashku kur dalin në poezi konceptualisht e poetikisht në vepra të veçanta intime e personale; edhe kur dalin në vjersha thirrëse e kushtrimore; edhe kur marrin ngjyrën e madhështisë me këndimin elegjiak. Si figura të ideve lidhen e kushtëzohen me njëra-tjetrën ose derivohen njëra në tjetrën. Mund të quhen *albanizma poetike* të Ndre Mjedjes, mirëpo këtu vetëpërkufizohen *ikona poetike të tij*.

1. Nana

Një dhe e pakrahasueshme, krijuese e jetës dhe e andrrës së jetës, shqiptuese e dhimbjes dhe dashurisë në gjirin e familjes e në botën përreth. Kënga për të merr përmasa të madhështisë e të adhurimit dhe trajtë të himnit e të elegjisë, po asnjëherë të ironizimit; si ndjenjë intime apo si raport universal. Ngushëllimi i parë e i fundit në lindje e në vdekje. Largimi prej saj bëhet i përballueshëm, si mërgim shpirtëror apo si largim fizik. Te libri *Juvenilia* idhnimi e helmi i të mërguarit artikullohet *Porsi dnesë me futë në krye/Nana e shkretë qi mbet pá djelm (Vaji i Bylbylit)*. Largimi artikulon dhembjen e mungesës, *Lamtumirë, o ti nanë shkreta/N'kohë mâ t'mirë per tý un treta (I tretuni)*. *Kû ké nanen me dérdhë lot?* është thirrje e mungesës, që ka pasojën *Afër nanës u shtrve me fjetun (I mbetuni)*, për të gjetur paqtimin e përjetshëm. Lidhja e nanës me fëmijën kap majat e shprehjes emocionale si në dhimbje, *E disprohet ke i ve mëndja/ Ór' e ças te Trina, e shkreta!* për vdekjen (*Lokja*); si në dashuri apo ëndrrën e dashurisë, *E nanë-bardha tui shikjue/”Flëj me egjuj, thotë, o bië” (Zoga)*. Prandaj as harmonia e natyrës, as harmonia hyjnore nuk i ngjet *Foshnjes qi i qeshet/Nanës, kûr mbî të perkulet (Zoga)*. Vetmia e nanës pa fëmijë është një situatë e pangushëllueshme, *Jo, me loken nji e dytë/Neper shpië mâ nuk u gjet (Lokja)*. Lakimin e raportit me nanën në jetë e në vdekje, pra në poezi, Mjedja e ngjyros me situata konkrete e rrethana, prandaj figura *nanë-shkreta* e zotëron këtë ndjesi, me një përjashtim të vetëm, *nanë-bardha*. Atëherë, ku të gjendet kundërpesha? Në përkushtim e në moralitet, në udhëzim, atëherë kur *Nana* bëhet *Loke*, drejtuese morale, përtej lidhjes emocionale, përtej vetes e mbi veten, kur atë që e lind edhe e rrit, dhe i drejtohet: *Nana e jote â Shqýptarija* dhe merr përgjigjen e pëlqyeshme të birit *Shqýptarinë nuk e korita (I tretuni)*. Po, sepse tradita e njëmendët e

nanës është në rritë të fëmijës, në pjekurinë e tij, që del si absolut i përkushtimit identitar:

*Qe nder djepa rrisin
Nanat e Hotit djelmenin ushtore
E idhnim n'anmikun neper gjí ju qisin
(Lirija)*

Nana qandër dashurie, morali e ideali. Po çka kur vdes Nana e Lokja, çka mbetet për jetimin? Këtë poeti Mjedja e kthen në problem jetësor e filozofik në një vjershë të hershme (1889) *Uzdaja pa dobi*. Dhe qenia poetike i përgjigjet qenies jetësore, reale:

*Me shkrime vet' fisin
Nderova e n'ushtri:
As nam, as lumni
S'm'dha fisi per hak*

Përkushtimi ideal nuk ka kurrë shpërblim real, i flet realisti idealistit, porse mësimi e sprovimi vazhdojnë. Dhe shembujt lindin teoritë e zbërthimin e tyre.

2. Skanderbegu

Për Ndre Mjedjen poet, *heroi* është veprues i pashembullt; por *heroikja* është potencë (fuqi) e pashtershme. Prandaj, Skënderbeun nuk e pa vetëm hero nacional të një epoke, po më thellë, simbol e ikonë të përjetshme të shqiptarëve, frymëzim për veprim. Kudo në poezitë e tij që shprehin identitet historik e kulturor del kjo figurë, mirëpo provën e vet poetike e bëri herët pikërisht me vjershën *Vorri i Skanderbegut*. Pra, heroi fizik ka vdekur e poezia është për vorrin e tij. Atëherë çka ka mbetur nga fuqia e tij? Poezia ka dhjetë strofa shtatëvargëshe me skemë rime të alternuar në katër vargjet e para, me rimë të puthur në dy vargje dhe me rimë të puthur të vargut të fundit të strofës pasrendëse. Kjo rimë nuk i bie vetëm rrokjes së fundit, por i bie theksit të kuptimit, prandaj ka më shumë efekt në domethënie se një tingëllim:

*Diq i Madhi: askund n 'ushtrië
 S e shef mâ jo kurr mizori;
 Rrebtë si para s shndritë, Shypnië,
 Njajò shpatë qi sá herë xori.
 Frig'e mnerë kerkund s na mbeti
 Qýsh se né na u rrxue gjyteti
 E gjith fisin e rrënoj.*

*Diq: vorfnisht n'njat vorr â mbëlue
 Pá lumnië mâ i madh luftari:
 Fisi i jonë me tē u rrenue,
 Me tē diq per luftë shqyptari.
 Bashkë n'at vorr â mbëlue Shqypnija
 Deri sá t'a thrasin mnija
 Me e thaë doren qi e turpnoj.*

Strofa e parë nis me *Diq i Madhi* ; strofa e dytë fillon me: *Diq*. Është artikuluar shkurt e dhëna tragjike e historike. Mirëpo, në interpretimin kulturor shqiptar, *diq i madhi* shënjon tragjedinë duke ruajtur madhësinë, kurse trajta e vetme, *diq*, ruan interpretimin (vdik krejt) për të shënuar një tragjedi të përhershme. Vjersha është shkruar në variacione: si të shpëtohet i vdekuri nga vdekja, si të prodhohet heroikja nga heroi, si të komunikojnë kohët. Në këtë kërkim vorri bëhet simbol i ndodhisë, po dhe i ngjalljes: *Shqyptarija rri tui shfrye; Lott e shëndin e Shqyptarit/ Njiky vorr i dite s'parit; Jo, t'bâj bé, s â kjo Shqypnija*. Poeti kërkon shteg për të rindërtuar heroikën nëpërmjet retorikës së kushtrimit.

Ky prosede i poetikës kushtrimore zhvillohet nëpërmjet ballafaqimit të gjendjes: *Kot Dukagjini e Skanderbeg fatosi/Shpupurishin nder vorre eshtna të harrue*, dhe shpresës se shkëndijën e liritimit e jep “hija e Skanderbegut”, që shëtit i padukshëm me frymën e vet. Kështu vijohet te *Lirija*. Prosedeun e ikonizimit të heroit Mjedja e kalon nëpër shkallë të tjera në luftën e tingëllimave *Lissus*. Leshi (Lissus) është i shënuar *E ti vorrin do të mbájshe të Skanderbegut*, shenjë e gjallnimit heroik; aty ky vorr do të bëhet kishë e faltore, si sublimim shpirtëror; kurse shpirti i tij kalon përtej hyznizimit të fisit në duar e krah të qiellorëve, si “dishmues” që shkrin jetën për jetën për shqiptari e shenjten fe. Variante të shenjtërimit poetik mjedjan, që rrokin bashkë fizikën e metafizikën heroike për të cilën lotojnë fatosat e të gjitha kohnave.

3. Shqypja arbnore

Por është një ikonë poetike e Mjedjes, që zë fill përpara Skënderbeut e shqyptarit, është *shqypja arbnore*, që është e kohëve të kaluara e kohëve të pritshme. Shqypja arbnore që përballon me moshë e kundërshtim Shqypen e Romës, tanimë është në qiell. Thirrja poetike e Mjedjes është të zbresë në tokë për të parë gjendjen e zogjve të vet. Pra, zbritje nga qielli në tokë, nga simboli në vepër, e cila vepër gjen një shëmbëllim konkret në gjestin skënderbejan, që me potencën (fuqinë) frymëzuese do të komunikojë me një të tashme. Vjersha përkushtuese *Shqypes arbnore* është strukturuar në dhjetë strofa gjashtëvargëshe dhe ka dy tërësi me nga pesë strofa. Të dy tërësitë ndahen me strofën e pestë e të dhjetë që janë në trajtë të refrenit të madh, që del në variante në dy vargjet e tij:

*Oh zbrit nder né, mbretnore
Shqype, edhe'j herë, si zbrite
Kur permby ball, madhnore
Të Madhit Kastriot' i shndrite,
E u trand gjithë bota unji
Prej vringllit të shpates së tij.*

Në mbarim të poezisë dy vargjet e fundit të refrenit dalin në formë të shtjelluar me referencë të kohës:

*Të binden barbarët e ri,
Per djelm qi ke Shqypni.*

Mjedja, duke lakuar ikonën e shqypes nëpër kohë, e sheh dhe e identifikon në antikitet, e gjen të realizuar në Mesjetë dhe pret ta ruajë në aktualitet. Mirëpo, ky cilësim poetik vetëm se nis të artikulojë një koncept shumë më të gjerë, që nuk lidhet me kohë as me vend, por me veçori të përqendruara të një populli.

Si figurë e përsëritur apo metaforë, *shqypja arbnore* gjen shtratin për t'u bërë koncept, por ende jo sepse ruan të fuqishëm motivimin letrar. Në këtë dysi ajo bëhet figurë mbretërore, si masë e vlerësimit kulturor të veprës së Bogdanit;

*Më thotë mendja se edhë me kaq mundet m'u njoftë dija gjûha e zotsija e njeri shkrimtarit, qi, deri sod, çohet në **shqype madhshtore** në qiell të letraturës së sanë.*

Njeri pernimënd i pàharrueshem, e per t'u nderue te jet, deri sà nji zëmrrë Shqyptari të rrahin për atëdhë të vet.

si dhe e vlerësimit ekzistencial të identitetit të kosovarëve për mbijetesë, në një fjalim:

...Asht fati i nji popullit qi dishmon dashnín për Atdheun e vet, Shqipnín, jo tue djegë e tue vra, por tue derdhun gjakun e tue dekë për te. Thaçë: "fati i nji popullit!" Jo, zotnij, gabova. Ishte dikur nji popull n'ato krahina: sot nuk ka ndoshta atje veç kocka, kocka të shpulpueme, qi çokasin orlat e maleve e brejnë ulkojat e unshme. Janë vorre, ku nuk bin lule dashtuni-jet e lagun prej lotve të ndokuj... Jo, nder ato vende nuk ka kush flet, kush vepron për to. Por përmbi ato eshtna, mbi ato vorre të shkretnuem, mbretnon me krahë haptë Shqypja arbnore: janë edhe ata të bijt e Shqipnís. Ani mâ, mos na prekshin zemrën ahti i nji popullit të pafaj, hukata e nanave shqiptare... mos na prekshin salvimet e vllazënve tonë, t'na shtyjë me pasë mëshirë për ta shembulli i shejtë i Atdheut tonë: Shqipja mbretnore e Shqipnija e lirë t'u diftohet dishmuesvet vetë nanë e jo njerjë.

Kështu shqypja arbnore e sprovon shqypen mbretnore në aktualitet, a do të mbetet Nanë apo do të bëhet Njerjë. Në këtë mënyrë shqypja arbnore e zotëron ligjërimin poetik e ligjërimin ekzistencial të Ndre Mjedjes.

4. Shqyptarija

Shqyptarija është më e gjerë se Shqipëria, se atdheu, se gjeografia; është përfitim historik, por nuk përkufizohet në një kohë. Është identiteti dhe malli për identitetin, që është gjakim i individit, ashtu dhe i kolektivitetit, që shpalohe si vetëvetije, pikërisht në komunikim me të tjerët në dhunë e në paqe. Është cilësim individual dhe strukturim moral kolektiv, përqendrim normash humane që nuk treten, por rimerren, si nder, si qëndrim. Shqiptaria për Ndre Mjedjen

është *âma*, është (nana), është amëza, që lakohet në lindje e në vdekje, në hapësira e në kohë. Në një sprovim të vetin me të ai vetërrëfhet: *Shqiptariën nuk e korita* duke theksuar individualitetin. Po ashtu e thekson si cilësim kolektiv të qëndrueshmërisë përballë sprovave të ekzistencës: *Por nuk u shuejti edhë, jo, Shqyptarija*. Duket si një shenjë ikonike, që e prodhon liriku klasik si ëndërr epike. Këtë e kërkoi dhe e krijoi më në fund, në tufat e tingëllimeve. Madje së pari në tingëllimin *Andërr* (1909) duke e shëmbëllyer me lëvizjen metafizike tokë-qiell të njeriut, si sublimim të shpirtësisë, madje të cilësuar si *bukurija*, veti e bukur, e adhuruar dhe e përkufizuar nëpërmjet të ndjesisë e dashurisë të ambientit familjar dhe të figurës familjare.

Në kërkimet poetike, ditunore e antropologjike, në rrafshin arkishqiptar, Shqyptaria është qenësi: është Lëndë e Frymë, Ekzistencë e Përhershmeri. Është mit.

V. PËRJETËSIA

Nëse Shqyptarija është variant i përjetësisë së shqiptarëve, atëherë Ndre Mjedja është vënë në këtë aventurë poetike me tufat (tubëzat) e tingëllimeve *Lirija*, *Lissus* e *Scodra*. Këto tri poema, që janë të lidhura, provojnë mjeshtërinë e tij poetike klasike, si figurë e si formë dhe më tepër e më thellë, botëvështrimin e tij metafizik e antropologjik të gjenit të vet, në retrospektivë e në prospektivë, duke u nisur nga *Unë* e nga *Këtu*, duke e kaluar këtë aventurë krijuese nëpër përrallë, mit, nëpër histori e nëpër aktualitet. Këto poema mund të lexohen veç e veç, por mund të lexohen dhe të lidhura, madje në dy mënyra: si shëmbëllime të kohëve njerëzore apo si faza të strukturi-meve poetike. Do t'ishte mirë të kapeshin në të dy mënyrat. Formalisht tufat e tingëllimeve duken ligjërime poetike për kohët deri në pafundësi, duke u nyjtuar në formën e përsosur e të ndërliqshme të tingëllimit, duke marrë karakterin e tekstit neutral klasik që është i vetëgjetur, thjeshtë është i tillë. Substancialisht shtrojnë shtratin arkishqiptar si njohje, vetënjohje e ndodhje. Subjektivisht hetohet një zjarrmi e madhe autoriale, që me lakimin e mënyrës së thënies e bëjnë autorin personazh. Nuk duhet harruar këtu hijen apo shenjat e trashëguara poetike të klasikëve, nga Homeri te Virgjili, nga Dante te Karduçi.

1. Scodra

Tingëllimi i fjalës i bashkuar me thellësinë e mendimit krijon modelin poetik të tingëllimit, që me procedim përrallor e mitologjik synon të mbërrijë te gjeneza. Aty ku ngjizet një botë njerëzore në mesin e një bote hyjnore. Poeti e bën këtë ndërmarrje nëpërmjet invokacionit fantastik të Taraboshit, si dëshmitar e si alter ego të krijuesit, një invokacion që të kujton hyrjet e tipit homerik.

I.

*O Tarabosh i mnért', ndëja hyjnore.
Kû e rrebt' rrufënat Frômboja farkote,
E e perzêmruem', gjyteteve mizore
Pshjtjell' me shtergata e bumbullim' i l'shote.*

*Andej mbí breshtat e mbí land't pjellore,
Qi rreze diellit per dishír s' pershkote,
Ti soditshe gjarpnues neper fushore
Kulmin e Drînit me qetí kah shkote.*

*E kuvêndshe me tê madhnin e Ilirit,
Kû t' lir, si shqypet neper bjeshk', banoshin
Nipat e hyjvet ilirjak' e t' robít.*

*E n'at' zêmer u knaqshe pá fê kobít,
E u knaqshin hyjzit qi tinzisht veshtoshin
Nper heshtime t' pámatuna t' ethirit.*

Teksti poetik mitologjik artikulohet si komunikim i dy qenieve për një ndodhje, po që është në të njëjtën kohë tregim i përbashkët. Pra, Ndre Mjedja tashmë është në majë, në Tarabosh, shikon botën nga lartësitë dhe muzgu i kohës. Fantastika krijuese mbërrin te ndeja hyjnore, dhe teksti poetik i dalë nga aty merr pamje njerëzore: komunikim miqësor deri në identifikim. Tregimi bëhet *dëftim*, shfaqje për ndodhi hyjnore. Thelbi i ligjërit, që në tingëllimin e parë, shqiptohet si dëshmi e Taraboshit për botën: *O Tarabosh i mnért; Ti soditshe Drinin; E kuvêndshe me Ilirin; E n'at' zêmer u knaqshe*. Në anën tjetër zhvillohet mrekullia poetike e formës që shënjon botën e plotë të rrethinës. Dëshmitari i shekujve të panjohun (kohës mitike) figuron një harmoni hyjnore e njerëzore deri në origjinë të Ilirit. Pamjet fantastike të botës

së gjallë i vëren me shije gjarpri helmues. Po Taraboshi dëfton smirën e hyjve të Heladës, që donë të rrënojnë ilirët, nipat e Poseidonit, nëpërmjet flakës së Kulshedrës. Shkrumbohet natyra: *E dnesshin nuset per kunor' t'vorfnueme/E vjerr' gjinit amtuer, disshin ferishtat*. Tashmë ka luftë në mes hyjnive greke e hyjnive ilire. I hidhëruar Polifemi hidhet me fuqinë e tij që si furtunë lidh Pashtrik e Adriatik, për të dëshmuar themelin e Ilirisë. Dhe shfaqet Kodri, me thirrjet bashkuese për themelimin e selisë, Shkodrës qytet mbretnor, duke e stërpikur me gjak kulshedre. Thirrja i bashkon krahinat ilire për të ndërtuar ditën atë që natën rrënohej. Leximi i shenjave dëfton pajtimin e hyjnive, porse *Afërdita për flí Rozafën lypë*. Këputet miti, këndimi mitologjik-poetik, duke kaluar në legjendë: Shkodra ndërtohet si seli mbretnore ilirike. Tashmë kërkohet të kalohet në histori. Prandaj, në vështrim konceptual poetik të Mjedjes, poema *Scodra* është e përfunduar. Një vijim i këndimit poetik-historik bëhet te poema tjetër, kështu që këtu do të ishte vetëm përsëritje. Kjo jep shenja që poemat duhet të lexohen të lidhura.

2. *Lissus*

Nëse te *Scodra* këndohet legjenda për qytetin, te *Lissus* këndohet kënga himnizuese për jetën, për natyrën e për njeriun, me trimat e me vashat ilire dhe me komunikim të këngës së zanave të malit e të rrjedhës së Drinit.

III

*Të falemi, o Lesh, i lum për sá Madhnija
Shperdau rreth téje miradina e hire.
E perdorj me cenë kujdesi e dija
Të sá mjeshtrove lulzuen në ket tok' Ilire*

*Me rruga të ndrejta hijeshue, me shpija
Të nëlta si sukat qi të shikjojnë me smirë;
Me ndertesa t'ushtrimeve kû fëmija
Vujshin, fatosat e një kohës má të vshtirë.*

*E kqyrshë sqelen qi Sirakuzani
Ndertoj, e në dritë të venituna ti njëfshe
Fytyren tande me stoli të një mbreti.*

*E lundra të hueja mbushë me rob qi bâni
Fitues Ilirsi, e, porsi fjetun, shifshe
Andrra fatosash, tui të perkundun deti.*

Porse nga natyra kalohet në kulturë, në qytetërim. Artikulohet poeti *Të falem, O Lesh* për të lavdëruar qytetërimin e qytetin ilir, të ndërtuar me dije e mjeshtëri, për ëndrra fatosash, për fitore e begati *e në dritë të venituna ti njëfshe/Fytyren tande me stoli të një mbreti*. Ky është qyteti që lidh malin e detin ilirik: i lumë për kështjellën *Ku hovi i të huejvet porsí qelqe thehej*, i mbrojtur fort nga djelmnia *Kû shqypja ilire neper ajr dëfrehej*. Një harmoni qytetare e njerëzore. Në pesë tingëllime në vijim shkallëzohet kënga e trimërisë dhe e madhështisë për organizimin e mbrojtjen e qytetit e të qytetërimit ilir, për përballjen me armiqtë, Greqinë e Romën, ku dalin personalitetet Bardhyli e Agroni e Teuta mbretnore, po më theksueshëm organizimi i fatosave, që kanë detyrë: *Me dekë* për atdheun, për kohët e përtardhme. Kjo është ndeshja përfundimtare e shqypes arbnore (ilirike) me shqypen romake, si shenja qytetërimesh të ndryshme.

Në tri tingëllimet e fundit të *Lissus*, vijon një portretim i ri i qytetërimit të Lezhës, që lidhet me figurën e Skënderbeut, fitoret, salvimin, bekimin nacional e universal. Është kjo dhe hyrje e Mjedjes poet në zemrën e krishterimit. Autori shfaqet prapë me përkushtim: *Por se fatmadhe, o Lesh, një ditë do të mbërrite*, dhe do të mbyllë përkushtimin: *E ti vorrin do të mbájshe të Skanderbegut*. Poeti e Lezha sërish kuvendojnë në një miqësi poetiko-historike për figurën identitare e kombëtare, duke kaluar nëpër heroizëm e nëpër dëshmim të krishterimit. Luani i luftave, kreshniku, në fund me një lot në faqe, mbështeti ballin në kryq e shkoi. Njeri a hero. Poezia e Mjedjes e shpie nëpër sprovime të tjera të bekimit e shejtnimit poetik, brenda shqiptarëve e përtej shqiptarëve, duke e parë në duar të qiellorëve. Dëshmia që për Fé e Shqiptarí jetën e shkrin. Dhe mbarimi është një lutje t'i ruhet atdheu i tij, të mbetet mbrojtës qiellor i tij. Kërkimi poetik historik, në arkishqiptarizëm, mbaron këtu, i lakuar me temën e vetësisë e të heroikës. Po mbetet një temë e përtashme apo e përhershme, si realitet apo si mit, liria e njeriut, liria e shqiptarit, të cilën Mjedja e kurorëzoi te tufa e tingëllimeve *Lirija*.

3. Lirija

I.

*O shqype, o zogjët e malevet, kallxoni
A shndritë rreze lirije mb'atò maje?
Mbi bjeshkë të thepisuna e nd'ograje
Kû del gurra e gjimon permállshem kroni?*

*A keni ndîe, kah fluturoni
Neper shkrepa, me ushtue kângen e sajë,
A keni ndîe një kângë të pá travajë?
O shqype, o zogjët e malevet, kallxoni.*

*Lirim, lirim bertet gjithëkah Malcija,
A ká lirim ky dhé qi na shklet kâmba,
A veç të mjerin e mblon ânë mb'ânë robnija?*

*Flutrò, shqype, flutrò kah çilet lâma,
Siellju malevet per rreth qi ká Shqipnija,
E veshtroje kû i del lirim it âma.*

Në gjashtë tingëllime të lidhura, ndoshta më të bukurat që ka shkruar Mjedja si organizim ritmik, kapacitet figurues, shpërthim domethënës, trajtohet *liria* si domosdo jetësore e njeriut, saktësisht duke e ballafaquar me robninë si përmbysje të njeriut. Duke e kërkuar *âmën* e lirim it si *âmë* të mbrodhsimit, poeti lakon ide e teza që shtrohen për botën shqiptare dhe njerëzimin. Liria amerikane është si shembull dhe duket e vënë në parantezë, në dy tingëllime. Mjedja këtë herë është mendimtar por edhe krejtësisht i rebeluar; kërkimin e lirisë shqiptare e zhvillon në tri pika. Në tingëllimin I duke shtruar pyetje; në tingëllimin V duke paraqitur gjendje, në tingëllimin VI duke thirrur shpresën. Një tezë fundamentale humane e nacionale e kthyer në ligjëratë poetike. *O shqype, o zogjët e malevet, kallxoni/A shndritë rreze lirije mb'atò maje?* pyet poeti në fillim. *Lirin e keni ju; na hekra kemi* i përgjigjet vetvetes poeti. *Por nuk u shuejti edhë, jo Shqyptarija*, ëndërron poeti. Një kërkesë, një gjendje e një shpresë, shkojnë duke u nuancuar ideisht e në figurë në tingëllimet përkatëse, me një gradacion dramatik. Kështu që tingëllimet V e VI marrin pamjet e dy gjendjeve shpirtërore në kundërshtim ekstrem: si dëshpërim e si shpresë. Pyetje

të rënda jetësore, gjendje tragjike njerëzore, ëndrra e pasosur identitare, një dramë rrëqethëse e krijuesit dhe e krijesës.

Ne kemi parë lakimin e gjuhës në emocion, lakimin e gjuhës në mendim, porse këtë herë kemi nivelin superior të lakimit të gjuhës në veprim. Kjo nuk na trimëron tepër ta quajmë krijuesin militant, jo se jo militar, porse kryengritës gjithsesi. Madje, këtu është shprehur karakteri i tij i papajtueshëm me rrethin, ambientin, shoqërinë, në faza të ndryshme të jetës, që në ligjërimet poetike artikullohet: si mospëlqim, si ankim, si vaj, si idhnim. Të gjitha këto gjendje, shpirtërore e poetike, mund të jenë episode jete të njeriut, po janë edhe trashëgimi e përjetësisë. Ashtu që arti të jetojë më gjatë se njeriu që e krijon. Më në fund, ky është malli i pangushëlluar që e ka shoqëruar Mjedjen për të gjallë e për jetë të jetëve.

VI. BUKURIJA

Ndre Mjedja kishte formim kulturor klasik dhe disiplinë klasike në teori e praktikë poetike. Shkrimet e tij, jo të shpeshta – për teori estetike e të artit, për poezinë dhe natyrën e saj, për përkthimin, për natyrën e ligjërimet – i ka shkruar kryesisht në vitet '30, kur po ligjëronte në Gjimnazin Saverian në Shkodër. Prandaj, shkrimet e tij teorike kanë dy cilësi: janë tekste të dala nga ligjëratat, duke pasur një lloj skolariteti, e për pasojë të kësaj, një formulim të qartë të çështjeve të ndërlikshme, të cilat tëhollohen edhe me shembuj.

1. Përmbi poezi pergjithësisht

Në artikullin *Përmbi poezi pergjithësisht* (Shkëndija, 1941) me tri pjesë: *Natyra e poezis, Të shprehurit poetik të bukuris, e Shëllimi i poezis*, shqyrton përkufizimin e artit poetik me argumentime klasike, duke e zhvilluar si diskutim me teza e antiteza.

1. Poezia është të shprehurit e ndjesive të zemrës e të përfytyrimit (fantazisë), mirëpo “këna e poezis nuk pështetet mbë të shprehun e në stil, por mâ fort në sënd”.
2. Poezia është përgjasim me natyrë, mirëpo “Giasimi me natyrë âsht një mjet i poezis, por jo edhe këna e saj”. Në poezi dramatike e epike duket përngjasimi me natyrë, mirëpo shtrohet pyetja “Por në poezi lirike ku gjindet ky giasim?”.

3. Poezia është një hartim apo një sendërgjim, porse hartimi e sendërgjimi, herë kuptohet si përrallë, si diçka e trilluar, e herë shënjon trajtimin, formësimin e poemës.
4. Masa, metri, është një gjë e domosdoshme për poezinë, mirëpo masa e plotëson poezinë por nuk është e domosdoshme për natyrën e saj. Proza filozofike e historike, edhe e vjershëruar, nuk është poezi sepse i mungon përftimi poetik. Masa të bën vjershëtar, por jo poet. Të parët kanë qëllim të shfaqin të vërtetën e sendeve, kurse poeti e ka qëllim të shëmbëllejë bukurinë.
5. “Per bukuri këtu merret vesht çdo sënd qi, sa të kuptohet, sjell kënaqje”, mirëpo bukuri nuk do të thotë vetëm sende të ëmbla, të hijshme e të shndritshme, por edhe të naltueshme e të rëndësishme që bindin.
6. Mjedja përfundon diskutimin me përkufizimin e vet: “Poezija është shfaqunit e bukurisë me një të shprehun të përfëtyrimit (fantazisë), më të shumën e herës me masë”. Për ta vazhduar argumentimin që bukuria gjendet edhe te artet e tjera, mirëpo poezia e shfaq me shprehje që del prej “tûgës së zëmërës e prej fuqís së përfytyrimit”

Nëse diskutimin e natyrës së poezisë Mjedja e mbështet kryesisht në teorinë e Aristotelit, diskutimin e shprehjes poetike të bukurisë e mbështet te Horaci, Virgjili, Ciceroni, Lukreci. Poeti mund të shprehë bukurinë duke përshkruar gjëra të bukura ose duke krijuar gjëra të bukura. *Ut pictura poiesis* (Poezia është si piktura) thotë Horaci; Mjedja e diskuton këtë mendim. Piktori shfaq pamjen e sendit, poeti krijon pamje e raporte të sendit, i përgjason sendet por nuk i përshkruan. “Giasimi lyp qi sendja t’përgiajnë sendes, por jo të jetë njinji me të”. Argumentimi vijon me Virgjilin (për thelbin e shprehjes), me Horacin (për fantazinë në poezi), Me Ciceronin (për frymëzimin në poezi). Po me Horacin e Lukrecin zhvillon diskutim për krahasimin e bletës e të poetit; ajo kalon lule më lule e jo në pleh e në baltë; ky nëpër sende të bukura, të ndershme e të shijshme.

Shëllimin (qëllimin) e poezisë e Mjedja e merr prapë si teori të lidhur klasike (Horaci, Lukreci) ndërmjet të *dobishmes* e të *këndshmes*; duke hyrë në një diskutim të raportit të tyre për mënyrën e funksionimit të poezisë në shoqëri. Bëhet i rreptë e fatal: “Poezija nuk është një knaqje që ta poshtnojë nieren. Kënaqja që nuk është e nierit, është murtaja më e rrebtë e helmi ma rrënues i shpirtit”. Autori bën një

përmbyllje të prerë, gati në nivel të censurës e të përjashtimit. Tashmë nuk flet teoriku klasik, por flet prifti jezuit. Kjo aventurë e ripërkufizimit e kthen atë në një moralizator të madh. Argumentimin e vijon duke cituar ligjëratën e At Famian Stradas, të shoqërisë jezuite. Ndoshta këtu mund të sqarojë diçka skatologjia poetike, në qëndrim e në figurë e poezisë *Mustafa Pasha në Babunë*, të cilën Mjedja vetë e propozon si shkallën më të lartë të ligjërimit poetik.

2. Përmbi përkthimin përgjithësisht

Ky formulim analogjik ka të bëjë me recensionin e Ndre Mjedjes për librin e përkthimeve poetike: Ernest Koliqi, *Poetët e mdhej t'Italis*, I (Leka, 1932). Në këtë shkrim autori paraqet një teori të përkthimit duke u mbështetur në shembuj të praktikave të përkthimit. Prova është e zgjedhur me autorë të mëdhenj të njërës nga letërsitë më të mëdha. Modestia e autorit – të mos flasë për autorët e mëdhenj sepse shpjegimi i tij mund të jetë sa një ndihmë e një shkrepëse për të ndezur diellin – bie menjëherë posa nis diskutimin e nivelit të lartë për përkthimin, pikërisht duke u nisur nga autorët latinë e filolatinë. Mjedja thekson që përkthimi është ndër artet më të vështira letrare, sepse *përkthyesi* mund të bëhet *përgënjyes* (italisht: traduttore, traditore). Vështirësia më e madhe e përkthimit është natyra e ndryshme e gjuhëve. Është gati e pamundur të barazohen fjalët me fjalë, e përkthyesi kërkohet të ketë të njëjtën frymë e të njëjtën shkallë me autorin, në anën tjetër gjuhët e ndryshme kanë ndjesi të ndryshme, doke, mendime, rodi e klime. Prandaj ka mendime të ndryshme për mënyrën e përkthimit. Madam de Sevinje i krahason përkthyesit me shërbëtorë që i çojnë dikujt fjalën e zotërisë së vet duke e thënë të kundërtën e porosisë. Një përkthim fjalë për fjalë duket përkthim besnik, por është vështirë të përkthehen ndjesitë e autorit. Mjedja vazhdon me shembuj e dëshmi për variante e suksese të përkthyesve. Vinçenc Monti e ka përkthyer *Iliadën* e Homerit, pa gramatikë greqishte, do të thotë pa ditur greqisht, por duke qenë vetë poet, e duke njohur përkthime të tjera ka arritur të krijojë tekstin e ri kaq të bukur, duke kaluar përkthimet e tjera italiane. Në anën tjetër rri mendimi: të përkthehet në stilin më të lartë në gjuhë të vet. Shembull Anibal Caro, i konsideruar përkthyesi më i madh italisht i Virgjilit, si njohës i madh i gjuhës poetike, mirëpo që nuk ia ka dalë ta rikrijojë shpirtin e Virgjilit, prandaj poeti i madh romak duket i zbehtë. Përmendet Volteri, si njohës përkthimesh, duke mënjanuar Rivanolin prej

përkthimit të Dantes, qoftë si mjeshtëri qoftë si stil. Mjedja përfundon me kërkesën e tij ideale që përkthimi të rrijë afër fjalës në origjinal, por edhe të kënaqë shijen e lexuesit, duke marrë si shembuj përkthyesish të mëdhenj, pikërisht ata që janë edhe poetë të mëdhenj: Pope, Laconte De Lisne, Victor Hugo.

Vetëm pas diskutimit teorik të përkthimit poetik e pas varianteve të përkthimeve të njohura, Mjedja i kthehet shembullit shqip, përkthimeve të Ernest Koliqit. Përkthimin e tij të Dantes e quan fort të bukur, (duke dhënë një fragment), ndërsa e cilëson edhe më të bukur, madje si ambëlzim gjuhe përkthimin e Koliqit të poezisë *Shtëpia e gjumit* të Ariostos. Shqyrtimin teorik të përkthimit dhe kritikën e tij autori e mbyll duke u ankuar që nuk ka hapësirë për t'i krahasuar copat e origjinalit me copat e përkthyer, porse e pranon Koliqin poet e përkthyes (ndërmjetshëm), duke pohuar që i ka përkthyer mirë dy poetët e mëdhenj, Danten e Arioston.

3. Përmbi artin e ligjërimit përgjithësisht

Në ligjërimet e tij në Gjimnazin Saverian, Mjedja mban mësimet për parime estetike, teori të letërsisë, rregulla të vargnimit, dallime të poezisë me prozën, e për artin e ligjërimit përgjithësisht.

Artin e ligjërimit e analizon dhe e klasifikon duke u nisur nga qëllimi i tij. Sipas tij ekziston ligjërimi historik, që ka për qëllim *me mësim*; ekziston ligjërimi retorik (gojëtaria), që ka qëllim *me bindje*, dhe ekziston ligjërimi poetik që ka qëllim *me kënaqje*. Duke shtruar çështjen e stilit të artit të ligjërimit, ai nëpërmjet përshkrimit të strukturave e të figurave bën diferencimin e arteve të ligjërimit si poetikë e si retorikë. Sipas metodës dhe natyrës së tij të punës, Mjedja diskutimin teorik përherë e forcon me zgjedhjen e shembujve konkretë e praktikë. Këtë e konkretizon në mënyrë të veçantë nëpërmes shembujsh të tri niveleve apo shkallëve të ligjërimit poetik, të diferencuar në prozë e në poezi.

Shkalla e ulët e ligjërimit në prozë tregohet me *Jobi, Historia e Shenjtë* (Mjedja); shkalla e ulët e ligjërimit në poezi shënjohe me *Lokja I, Juvenilia* (Mjedja).

Shkalla e mesme e ligjërimit në prozë tregohet me *Gosta e Baltasarit, Historia e Shenjtë* (Mjedja); shkalla e mesme e ligjërimit në poezi ofrohet me *Mbreti i Tules, Juvenilia* (Mjedja). Këtu shihet që Mjedja përkthimin e poezisë e ngre në nivel arti që kur e jep shembull poezinë e Gëtes në përkthimin e tij në shqip.

Për shkallën e naltë të ligjërimit në prozë propozohet *Sh'Luigi Gonzaga, Historija e Shenjtë* (Mjedja); për shkallën e naltë të ligjërimit në poezi shënjohej *Mustafa Pasha në Babunë, Juvenilia* (Mjedja).

Venerime themelore rreth këtij diskutimi: 1. Këto vështrime e klasifikime teorike janë nxjerrë nga ligjëratat që poeti Mjedja i ka përgatitur me shkrim dhe i ka diktuar, sepse janë të nxjerra nga fletoret e nxënësve të tij. Prandaj janë të pjesshme derisa të mos gjenden shqyrtimet integrale; 2. Me qenë se janë të dhëna në formë të skemës (shenjë kjo e metodës së mësimdhënies) mund të kenë zhvillime më të përimtuara në tekstet integrale; 3. Bie në sy që të gjitha nivelet e ligjërimeve poetike jepen me tekste të vetë Mjedjes në prozë nga shkrimet e tij kanonike, kurse në poezi nga shkrimet e tij poetike, për t'i konsideruar si të barasvlershme në shkrimtarinë e tij.

Venerimi përfundimtar del vetvetiu: Ndre Mjedja mbetet konsekuent deri në pikën e fundit në projektimin dhe sistematizimin e shqyrtimeve të veta teorike të mbështetura në kulturën antike klasike e të krishterë dhe kjo teori është ose pretendon të jetë komplementare me shkrimin e tij letrar qoftë në prozë, qoftë në poezi. Klasiciteti i tij tanimë bëhet normë e krijimtarisë personale, kur gjurmon e argumenton struktura (forma), dhe kur artikulon Frymë e Lëndë poetike. Kjo është *Këna* e veprës së tij.

VII. LIRIKU KLASIK

1. Klasiku

Ç'është klasiku? Pyetje përherë e shtruar, pa një përgjigje që kënaq. Klasiku, një krijues në veprën e të cilit përqendrohet poezia, gjuha, mendimi, qytetërimi. Sent-Bevi e gjeti në shembullin e Homerit, duke e kërkuar në variante në kohë e në letërsi të tjera. Tomas Elioti e pa në shembullin e Virgjilit, si kurorë të latinitetit europian, e diku më vonë, në latinitetin kristian te Dante Aligieri. Harold Blum e gjeti te Uilliem Shekspiri, për ta bërë bosht të kanonit të tij perëndimor. Ernest Koliqi e zbriti në nivel nacional dhe e përktheu në shumë, Poetët e mdhej, duke e parë në variantet: Jeronim de Rada, Naim Frashëri e Gjergj Fishta. Po Koliqi në nivel të shkollave letrare diskutimin e mbaroi me diferenca, duke madhëruar e adhuruar Gjergj Fishtën e duke cilësuar e lakmuar Ndre Mjedjen.

E ne tash për Mjedjen: *liriku klasik*, në trajtën e shquar. Para abstragimit teorik, është më mirë të hyjmë në tekstin poetik.

2. Andrra

ANDERR

*Pezull prei qiellit fluturonte e shkreta
E si dielli n'mjesditë rreze shpërdake:
Engjëll nder cucat o një çikë giake
Qi veç qielli numron nder valle t'veta.*

*Arit i kishte flokët, e kish si zgjeta
Driten e syve e mollzat rrumbullake
E buzët e vocrra me të ngjyeme gjake,
Qi kur i pash krejt i mahnitun mbeta.*

*Mandej si njeri, qi prej gjumit ngrihet,
Mora zemër e e pyeta me trimni:
“Engjëll a vajzë je ti, o bukurija?”*

*Qeshi goca një herë, si vashë që pîhet,
Uli kryetin teposhtë e me dashtni
“Motër e nanë, tha m'ke – jam Shqyptarija”*

Ndre Mjedja e shkroi tingëllimin *Anderr* më 20 nëntor 1908, ditën e vendimit të Kongresit të Manastirit që është edhe ditëlindja e tij. Poezia u botua një vit më vonë, më 1909 në Selanik me pseudonimin Shqiptari. Do të pritej një poezi okazionale, por jo, këtu rasti është vetëm një shkrepje drite për të parë përgjithësimin apo përjetësinë si kurorë poetike të tingëllimit, një vezullim që krijon *andrrën* tejkohore me pikënisje në një çast. Andrra në fillim vezullon si dielli në Qiell. Një qenie, që ndriçon si diell e i ngjan një çike në vallet qiellore, një pamje metafizike. Pastaj në trajtë figure të vajzës zbret në Tokë. Atëherë zbulohet tokësore, me flokë ari, sy shigjetë, me mollëza rrumbullake e buzë gjake e i ngjan një vajze që mahnit në valle tokësore. Zgjohej si trajtë e Bukurisë për të krijuar habinë e mrekullimin, në të cilin krijuesi nis dialogun me vetveten për të gjetur identifikimin. Zgjimi nga ëndrra është zbulimi, duke biseduar me vetveten njeriu, autori: “Engjëll a vajzë je ti, o Bukurija?”. Identifikimi si kurorë e vjershës është Shqyptarija, e gjetur si personale e krijimit, në një ambient figurues familjar, për t'u bërë botë shpirtërore, si esencë e artit. E artit të poezisë së përjetshme. E fisit dhe e polisit,

do të thoshte Eqrem Çabej. Dhe zgjidhja vjen si përgjigje përfundimtare për vetveten: “Motër e nanë, tha, m’ke – jam Shqiptarja”. Është ky zbulimi apo përkufizimi i shqiptarisë, që njësohet me bukurinë, në vallen qiellore e në vallen jetësore (tokësore) të poezisë së Mjedjes.

Pastaj vazhdojnë *andrrat* poetike të Ndre Mjedjes. Andrra e kthimit të shpirtit të mërguar në djepin fillestar, te *Vaji i Bylbylit*. Andrra e jetës, e zbritur dhe e ngritur në truallin konkret, ku jeta matet me vdekjen në familjaritetin figurativ të Trinës, Zogës e Lokes, për të riprovuar fiziken e metafiziken e njeriut në përballje me kohën. Andrra e lirisë dhe e çlirimit, te *Lirija*. Andrra e rebelimit te: *Varri i Skanderbeut*, *Shqypes Arbnore* e *Bashkonju*. Andrra e identifikimit mitologjik e historik, te *Scodra* e *Lissus*. Dhe rrethi mbyllet si kohë, por hapet si krijim poetik.

3. Ikona

Ndre Mjedja lirik personal apo poet i kohëve, ndien në zemër e vështroi nga lart, nga *Taraboshi i mnershëm*, mërzitë e kalueshmërisë së stinëve të njeriut dhe bubullimat e vetëtimat e përhershëmërisë së njerëzimit, etnosit e nacionit. Kjo dramatikë orkestrohet me tone të ulëta e me bërtima që kthehen në jehona. Kështu farkohet stili i tij poetik, që kërkon jo vetëm fjalor elementariteti, por mbi të gjitha një gjuhë poetike të tij me morfologji e me sintaksë personale, kaq të afërt e kaq të ndryshme nga artikulimet e rapsodive shqiptare. Topoit personalë të mërzisë, idhnimit e të zemërimit alternohen me topikën e vendit, Taraboshin e Pashtrikun, Shkodrën e Lezhën, Drinin e Bunën, Vardarin e Prishtinën. Kjo dramatikë krijuese me shenja letrare mjediane, sa duket personale, rishfaqet natyrale, impersonale, e ndodhur kudo e përherë, si vepër pa autor. Kjo arrihet me proces krijues me rimë e ritëm të disiplinës klasike, që shpërthen barbarisht konvencat e kufirit ritmik të vargut, duke u shtrirë në strofë e në tërësinë e poezisë, me sintaksën poetike që frazën e poezisë e bart përtej vargut, përtej strofës, përtej tingëllimit. Figurën e ngre nëpër shkallore, nga epiteti te metafora e në fund te ikona. Ikonat e tij poetike gjenden edhe në topikë, mirëpo përqendrohen përfundimisht në *Skënderbeun* e në *Shqypen Arbnore*, për të bërë identitetin. Shqypen Arbnore e sprovon në mënyrë antitetike me *hanën drapnore*, për të vendosur përhershëmërinë identitare të Shqiptarisë, si frymë, si shpirt, si moralitet e si identitet.

4. Mendimi

Mjedja e shpreh kulturën poetike klasike duke shkruar për poezinë përgjithësisht, apo për strukturën e saj, edhe pse këtë e bën tepër rrallë. Te *Përmbi poezi përgjithsisht*, diskuton lëndën, bukurinë, formën e qëllimin e poezisë, duke u mbështetur te autorët klasikë të parakrishterë e të krishterë. Te diskutimi për përkthimin e poezisë, duke tërhequr vëmendjen e kalimit të poezisë nga një gjuhë në një gjuhë tjetër, thekson qenësinë e gjuhës si substancë elementare të saj, që duket gati e pamundshme të kalohet në shprehje e në gjuhë tjetër, duke ruajtur trajtën e frymën e origjinalit. Si ligjërues i retorikës e i metafizikës në rini e si ligjërues i poetikës në pleqëri, Mjedja në fakt bëhet më personal duke zbërthyer formalisht artin letrar me shembuj nga letërsia e vet, poezia e vet. Në këtë mënyrë zbulohet pahetueshëm Mjedja si kanonizues dhe dekanonizues, më mirë vetëkanonizues, që në fund të fundit është vetëdije e klasikut, lirikut klasik pa pararendës e pa trashëgimtar. Kjo vetëdije e lartë letrare parashkruan apo pas-shkruan klasikun, që nuk njeh kohët, nuk pranon të jetë i klasifikueshëm në kohë e në formacione stilistike. Qoftë kjo e vërtetë apo vetëm provë e një të vërtete, është një iluzion i bukur i un-it poetik.

5. Uliksi

Mjedja është një udhëtar i madh fizik e metafizik, në hapësira e në kohë. Një herë, në rini, me aventurat e marrjes së dijeve e të njohjeve; mandej përjetë në ëndrrat krijuese poetike. Mirëpo filozofikisht ai është një shëtitës i palëvizshëm. Ka një dramatikë njerëzore e krijuese në këtë cilësim paradoksal. Kur kaloi në hapësira fizike diturore e filozofike, ishte vetëm dhe veten e kishte marrë me vete. Kur u kthye në Itakë (Shkodër), u bë i palëvizshëm, por hapësirat i kishte marrë me vete, si provë personale e si kulturë. Dhe vijoi udhëtimet poetike si ëndrra në kohë. Kishte këtu një konflikt të personalitetit që mendohej të drejtpeshohej në harmoni. Universaliteti i tij kulturor dhe i fortë doktrinar: katolik jezuit, po ndeshet me personalitetin që në formë të kryengritjes po kthehej poetikisht te vetja e përhershme, te Shqyptaria si vetëdije letrare e si identitet. Ai u ishullua me decenie në Kukël (katund), mirëpo në fund pushoi në Shkodër, pikërisht në gjimnazin jezuit, në mesin e nxënësve të tij. U kthye aty prej nga ishte nisur. Dhe bota e tij në këtë mënyrë

përmbillet në rreth. Duhet të theksohet që këto çështje janë shumë më të ndërliqshme se sa një grindje apo hatërmбетje njerëzish në rrethana të veçanta e në kohë konkrete; për të rimarrë mendimin që shtegtimi i Ndre Mjedjes në hapësira e në qytetërime, në fakt është një shtegtim me dimensione krijuesi, i cili nuk ka punë të tjera pos të përpiqet t'i neutralizojë të gjithë kufijtë, të gjitha kufizimet. Prandaj poezia e tij është një thesar dijeje e bukurie për brezat, por jo poezi për asnjë përdorim.

6. Fusnota

Ndre Mjedja e nisi botimin e poezisë më 1888, në të njëjtën kohë me botimet e para të Naim Frashërit në shqip. Vepra e tij e fundit, *Scodra*, u botua mbas librave lirikë të Lasgush Poradecit. Kjo dëshmon që ky jetoi e mbijetoi tri formacione stilistike të poezisë shqipe: romantik, paramodern e modern. Kjo logjikë e caktimit të përkatësisë poetike dhe e periodizimit, u ku marrë një shekull kohë sistematizantëve të letërsisë shqipe: ta vendosin në njërin nga këto formacione, apo në të tretë, që i bie në asnjërin. Mjedja lirik klasik vetë e ka synuar dhe e ka arritur këtë status në letërsinë shqipe, për t'u cilësuar sot klasik modern. Më duket që këtë e pati hetuar, qoftë me një shenjë, Zef Skiroi i Riu, te *Historia e letërsisë shqiptare* e tij, pa e shtjelluar e argumentuar më thellë. Ndoshta bashkë me të edhe Ernest Koliqi te diferencimet e stileve te shkollat letrare.

7. Personale

Tani pak personale, mbasi secili lexim i letërsisë e secili ligjërim për letërsinë, sado që kalon nëpër konvenca të dijeve, përfundon në lexim personal, si triumf i un-it.

1. Ka më se një gjysmë shekulli si nxënës shkolle, mësuesit e vëmendshëm, nuk na i shpjegonin poetët e mëdhenj, po na thoshin t'i mësonim poezitë e tyre përmendësh. Duke e mësuar përmendësh me zë, e pëlqenim Mjedjen sa unë edhe prindërit e mi.
2. Si shkrimtar e botues para më shumë se tri deceniesh, kur po bëja gati botimin e poezisë së Mjedjes te Rilindja e Prishtinës, më ra ta takoja në Gjermani, Mark Traboinin, një ish nxënës i Mjedjes në Shkodër. Si njeri që e adhuronte Ndre Mjedjen u pa i lumturuar që

do të botohej poezia e plotë në Prishtinë, po, shtoi Traboini me një hije droje, të cilën ma shtroi si pyetje në trajtë të urimit “Dhashtë zoti, e e botoni pa ndryshime e pa shkurtime”! Po, i thashë e në vitin tjetër ia dhurova botimet e Mjedjes. Se vepra letrare duhet të shihet e të lexohet vetëm në origjinal, në formën dhe trajtën origjinare.

3. Tani, që edhe sot vazhdoj ta lexoj poezinë e Ndre Mjedjes, po me dashuri e pasion si të tjerët, e di me siguri që është nga poetët e mi të preferuar, ata që lexohen përherë. Edhe në 99-vjetorin e botimit të parë *Juvenilia*.
4. *Ars longa, vita brevis*, thoshin latinët.

SHËNIME

1. Ernest Koliqi, “Dy shkollat letrare shkodrane”, *Kritikë dhe estetikë*, 1999.
2. Ernest Koliqi, “Tre poetët ma t’mdhej shqiptarë”, *Kritikë dhe estetikë*, 1999.
3. Giuseppe Schirò Junior, *Storia della letteratura albanese*, 1959.
4. Harold Bloom, *The Western Canon*, 1995.
5. I. Rugova, S. Hamiti, *Kritika letrare*, 1979.
6. Mentor Quku, *Mjeda*, 5 (2010), 6 (libri i parë), 2012.
7. Ndre Mjedja, *Vepra* 1, 2, 3 1982.
8. Sent-Bev (Sainte-Beuve), “Ç’është klasiku?”, *Historia e teorive letrare*, 1979.
9. T. S. Eliot, “Ç’është klasiku?”, *Ese të zgjedhura*, 1982.

Kolec TOPALLI

NDRE MJEDA SI GJUHËTAR

Abstrakt

- Mjedja si historian i gjuhës shqipe;
- Mjedja si leksikograf;
- Kontributi i Mjedës në Kongresin e Manastirit dhe në Komisinë Letrare Shqipe;
- Fjala e rrallë shqipe në veprën poetike të Mjedës;
- Forma gramatikore të larmishme në veprën e Mjedës;
- Ndihmesa e Mjedës për pastrimin e gjuhës shqipe prej fjalëve të huaja të panevojshme.

Shumëkush prej shqiptarëve e njohin Ndre Mjedën si poet; por të paktë janë ata që e njohin si gjuhëtar. E pra, ai që njëri prej gjuhëtarëve shqiptarë më të përgatitur të brezit të tij, që e dëshmoi me studime të mirëfillta për historinë e shqipes, si një ndër aktivistët më të zellshëm në ngjarjet e rëndësishme me vlera kombëtare, studiues e transkriptues i autorëve të vjetër, mjeshtër i fjalës në krijimet e tij në poezi e në prozë, gjurmues e përdorues i fjalës së rrallë shqipe, punëtor i zellshëm për pastrimin e saj prej bykut të fjalëve të huaja të panevojshme, së fundi mësues i apasionuar i gjuhës shqipe në gjimnazin e jezuitëve të qytetit të Shkodrës.

Prirjet e tij si gjuhëtar duken që herët, kur më 1902 mori pjesë në Kongresin XIII të Orientalistëve në Hamburg të Gjermanisë, ku si përfaqësues i Shqipërisë mbajti latinisht kumtesën “*Mbi shqiptimin e qiellzoreve në dialektet e ndryshme të gjuhës shqipe*”, duke qenë kështu i pari gjuhëtar shqiptar që përfaqëson vendin tonë në një

konferencë ndërkombëtare. Si historian i gjuhës, Mjeda shfaqet sidomos me studimin “*Vrejtje mbi artikuj e prëmnë pronës të giuhës shqipe*”, i botuar në Shkodër më 1934. Në këtë studim prej 31 faqesh, i pajisur me kulturë të gjerë gjuhësore dhe me njohjen e thellë të gjuhëve klasike e moderne dhe të veprave të autorëve të vjetër, Mjeda merr në shqyrtim nyjat dhe përemrat pronorë, që përbëjnë aspektin më problematik por edhe më origjinal të sistemit emëror të gjuhës shqipe duke arritur në përfundimin e njohur se shqipja nuk ka pasur në këtë pikë ndikime prej gjuhëve të tjera. Është vepra e parë, e shkruar nga një gjuhëtar shqiptar për një problem kaq të rëndësishëm e po kaq të vështirë. Në mbyllje të studimit Mjeda shkruan: “*Asht një detyrë shëjte me vû në krye të çdo mësimi tjetër mësimin e giuhës kombtare. Ajo asht stolia mâ e shkëlqyeshme, kunora mâ e çmueshme në ballë të nanës sonë, së mjerës Shqipni*”.

Në fushën e onomastikës, Mjeda botoi dy artikuj, ku spikasin aftësitë e tij prej etimologu: njëri me titull “*Prend e Prendë*”, botuar në revistën “Leka” më 1932, ku shpjegon shkencërisht prejardhjen e emrave të ditëve të javës në gjuhën shqipe; ditën e enjte e të premte prej burimi vendës, të tjerat huazime ose kalke prej latinishtes. Artikulli tjetër, “*Dromca toponomastike: Zeta*” është një përgjigje që i jep studiuesit kroat Josip Gelčić, që kishte botuar një artikull për Zetën dhe dinastinë e Balshajve. Dihet gjithashtu se Mjeda ka hartuar një gramatikë të shqipes prej 34 faqesh në gjuhën italiane, punim i daktilogruar, që ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit. Në fushën e filologjisë, ka botuar studimin “*Nji dorëshkrim i moçem e nji kritikë e re*”, ku analizon njërin prej dokumenteve më të lashta të gjuhës shqipe, Perikopenë e Ungjillit të Shën Mateut. Ai gjithashtu ka botuar në revistën “Leka” disa fragmente të veprës “*Pasqyra e të rrëfyemit*” të Pjetër Budit, duke qenë ndër transkriptuesit e parë të veprave të letërsisë së vjetër shqipe.

Një kontribut tjetër si gjuhëtar ka dhënë Mjeda si leksikograf, me fjalorin botanik, që ka mbetur në dorëshkrim. Në këtë fjalor prej 12 faqesh, që e bëri të njohur studiuesi Mentor Quku, Mjeda shfaqet si një mbledhës i zellshëm dhe i kujdesshëm i thesarit popullor. Fjalori është fryt i punëve të tij të para, atëherë kur ai punonte si famullitar në Mirditë, Pukë e Zadrimë, vende që citohen herë pas here në fjalor duke qenë ndër mbledhjet e para të florës shqiptare.

Këto punime shkencore të Mjedës, ku spikat historiani i gjuhës, gramatikani dhe etimologu, kanë hyrë tashmë në fondin bibliografik të

studimeve gjuhësore, duke u rimarrë prej historianëve të shqipes, si Eqrem Çabej, Vladimir Orel, Shaban Demiraj, Besim Bokshi etj.

A ka punuar Mjedja për “Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe” dhe për një “Gramatikë historike” të saj? Letërkëmbimet me albano-logë të kohës dëshmojnë se ai punonte për këto dy vepra, që i kishte shumë për zemër. Por a janë përfunduar dhe ku mund të ndodhen ato? Kjo është enigmë. Mund të kenë pasur të njëjtin fat me vepra të tilla të hartuara prej Joklit, që janë zhdukur njëherë e përgjithmonë bashkë me autorin e saj.

Por punën më të madhe Mjedja e bëri si themelues dhe aktivist i shoqnisë “Agimi” dhe në institucionet me rëndësi kombëtare, si Kongresi i Manastirit dhe Komisia Letrare Shqipe, që u krijuan në fillim të shek. XX.

Si njohës i mirë i veçorive të tingujve të shqipes, Mjedja kishte krijuar një alfabet sipas parimit të Gustav Meyerit, ku çdo tingull përfaqësohej me një grafemë të veçantë. Me këtë alfabet botoi disa libra, kryesisht shkollore.

Si përfaqësues i shoqnisë “Agimi”, Mjedja mori pjesë në Kongresin e Manastirit, ku dha kontributin e tij duke u zgjedhur anëtar i komisionit për hartimin e alfabetit. Më vonë dha kontribute të vlefshme në *Komisinë Letrare Shqipe*, në Shkodër, ku, ndërmjet të tjerash, së bashku me Gjergj Pekmezin e Rajko Nahtigalin, profesor i Universitetit të Gracit, mori pjesë në një ekspeditë gjuhësore prej tri javësh në Elbasan, për t’u njohur me veçoritë e kësaj së folmeje, që mendohej të vihej si bazë e gjuhës së përbashkët letrare.

Por kontributin më të madh si gjuhëtar Mjedja e ka dhënë me veprën e tij poetike, ku tregohet një mjeshtër i rrallë i përdorimit të shqipes. Në pendën e tij shqipja gjallërohet, rinohet e zhdërvjelltësohet. Ai e përdori fjalën e shqipes me një zotësi të rrallë poetike duke hulumtuar me kujdes e durim thesarin e popullit, fjalë e shprehje të rralla, që në artin e tij këndellen e marrin jetë. Në veprën e tij janë bashkuar e gërshetuar cilësitë e tij të lindura prej poeti me punën e palodhur e të vullnetshme prej lëvruesi të gjuhës. Ja disa prej fjalëve të rralla, të qëmtuara në veprën e tij poetike.

- **Cirlik** “bëjnë zhurmë”; te “Ândrra e jetës”: *cirlikne rrotllat posht’e perpjetë*. Krijim i brendshëm nga një onomatope, imitim i zhurmës që bëjnë rrotat kur rrotullohen.

- **Degame** “grindje”; në poezinë “Mahmud Pasha”: *Herë permállshem tui kqyrë, si degame / Vetë me vedi me ngrehun fillon*. Formim i

brendshëm prej *degë* me prapashtesën *-ame*, prej kuptimit “përçarje, ndarje”, siç janë *degët* që ndahen dysh.

- **Dêhet** “shkrin, zhduket”; në poezinë “Mustaf Pasha”: *Nder festa e t'kreme n' fush' e n' malci / burrnimi u dêjti*. Është forma joveprore e një rrënje **ten-*, që lidhet me foljen *ndêj* “hap, shtrij”.

- **Denik** “erë e fortë që sjell shi”; në poezinë “I tretuni”: *O djalë, e n'frymë t'denikut, / N'furi të kësaj érës vajton*. Fjalë e gegërishtes veriore, me kuptimin e parë “erë deti”; formim i brendshëm prej emrit *det* me prapashtesën *-nik*, me rënien e *-t-së* në një grup bashkëtingëllor.

- **Diret** “humb”; në poezinë “Të vorruemit e Sir John Moore”: *Krizma e jonë me 'j tjetrë diret*. Është trajta joveprore e foljes *vdjerr* “humb”, formim i brendshëm nga *bjerr*, që ka marrë prapashtesën *dë-* dhe ka ndjekur evolucionin e fjalëve me grupin bashkëtingëllor *-db-*: *dëbjerr* > *dbjerr* > *bdjerr* (me metatezë) > *vdjerr* (me hapjen e njëres mbylltore) > *djerr* (me rënien e *-v-së* në një grup bashkëtingëllor). Të gjitha këto forma gjenden në të folme të ndryshme e tek autorët e vjetër sipas prirjeve dialektore; Buzuku: *mos bdirectë, por të ketë gjellënë e amëshuome*; Budi: *desh qenë vdjerrë frike e tmërje* (SC); Bardhi: *Me dierrë arësnyë*; Bogdani: *po ende dyjerrënë shpirtinë*; Kuvendi i Arbënit (si Buzuku): *A asht për t'u bdjerrë moti*; Kazazi (si Bogdani): *nieri nuk e dvier hîrnë e Tinëzot*.

- **dnes** “qaj me ngashërim”; te “Váji i bylbylit”: *Tui dnes' i vorfni se e mbluene t' kijat*. Formim i brendshëm prej emrit *dënesë*, e formuar me prapashtesën *dë-*, rrënjën *ne-* dhe prapashtesën *-së*. Rrënja *ne* mund të jetë emri *nye*, që në trajtën e shquar e në shumës del me zanoren *-e* (*neu, neje*). Ky emër në një fjalë të tillë përligjet prej shprehjeve: *nuk më shkon buka, m'asht lidhë nye; iu lidh një nyjë në grykë (nga ngashërimi), m'u mblodh një lamsh (një nye) në grykë*. Dënesa është një vaj me ndërprerje, sikur ndesh në një pengesë, në një nyjë (khs. edhe *nyja e fytit*).

- **Dudûm** “halldup, turkoshak”; në poezinë “Mustaf Pasha”: *Nder valle jevkash, n'lodré dudûmash*. Fjalë me origjinë onomatopeike, imitim i zhurmës së lodrës.

- **Galdoj** “gëzoj”, në poezinë “I tretuni”: *Ju njeti galdoni: / Kû â flladi i pelqyeshem*. Fjalë e gegërishtes veriperëndimore, e përdorur në shkrime poetike. Nuk ka karakter popullor; prandaj është krijim intelektualësh, që ka si bazë lat. *gaudium* “gëzim”.

- **I errmaktë** “i majtë”; në poezinë “I tretuni”: *Nji pecë t’kuqe i pata qepë / N’kambë t’errmaktë qi kishte repë*. Lidhet brenda gjuhës me *i majtë* dhe *i mëngjër*, të gjitha këto prej lat. *mancus* “dorëcung, sakat, i metë”. Sipas besëtytnive të lashta, ana e majtë lidhej me të keqen, kurse e djathta me të mirën. Mbiemri *i rrëmakët*, që është trajtë dialektore e gegërishtes veriperëndimore, ka marrë parashtesën *rrë-*, ndërsa zanorja *e-* është një shtesë fonetike për lehtësi shqiptimi, që e marrin në gegërishte fjalët që nisin me grupin *sonante + bashkëtingëllore*, një veçori që e ka edhe gegërishtja verilindore dhe ndër autorët e vjetër Buzuku me rastet *ermonj*, *errshajë* etj.

- **Jes** “mbes, mbetem”; në poezinë “Vllávrasi”: *Dy mâ t’mdhajt nder luftina mbeten / E këtû i treti qe po jet*. Është forma e vetës II shumës të rrënjës ie. të foljes *es-* “me qenë” në një paradigëm të hershme: *jemë ~ *jetë ~ jenë*, ku forma e vetës II shumës është zëvendësuar nga forma më e re *jeni* me mbaresën e foljeve me *-nŌō*: *jeni si bani / bëni*. Kësisoj, folja *jet* krahasohet në plan indoeuropian me format e vetës II shumës me mbaresën *-t*: gr. *εστὲ*, sll. vj. *jeste*, got. *sijub*. Kjo mbaresë, që në gjuhën shqipe del në të pakryerën *ishit*, në të kryerën e thjeshtë *qetë* e në mënyrën dëshirore *qofshit*, ka qenë edhe në të tashmen dhe gjurmët e saj kanë mbetur te folja *jet*, që ka zhvilluar një zgjedhim të plotë sipas shembullit të foljes *qes ~ qet*. Sot është fjalë dialektore, por ka qenë e mbarë shqipes, sikurse e dëshmojnë të folmet arbëreshe të Greqisë e të Italisë, që kanë foljen *vjetem* “mbetem”, të formuar me parashtesën *vë-*. E ka edhe Buzuku.

- **Kacatore** “një lloj pushke”, te “Ândrra e jetës”: *Me rryp rreth brëzit, me një gjashore / E’ j kacatore*. Formim i brendshëm prej *gacatore* “pushkë e vjetër me strall” prej emrit *gacë* me kuptimin “pushkë që nxjerr zjarr”.

- **Kaliboç** “kaliqafë, në shpinë”, në poezinë “Vllávrasi”: *Neper terr qi lëshote nata, / Ngarkue teshat kaliboç*. Formim i brendshëm me prefiksin *kali-* prej emrit *kalë* dhe emrin *bohçe* “plaçka të mbështjella në një shami të madhe”.

- **kerzha** “vend i mbushur me gurë e shkëmbinj”; në poezinë “Mahmud Pasha”: *N’ fusha bâsa e nder kerzha t’ bungajes*. Lidhet brenda gjuhës me *karsh / kërs*; huazim nga sll. (skr.) *krš* “shkëmb, shkrep”.

- **Kokot** “gjel, këndes”; te “Ândrra e jetës”: *Veç prej plehit gjel kokoti, / Me njat zâ qi s ndrron kurr-herë*. Formim i brendshëm nga një onomatope: *ko-ko*, imitim i këngës së gjelit.

- **Kollovrade** ”pështjelluemas, rrokoll më rrokoll”; në poezinë “Vllávrási”: *Tu u sjellë bora kollovráde*. Fishta e ka për “njerëz pa vlerë, që sillen kot rrugash, halabakë”, te Lahuta: *do shqyptarë do kallavrade*. Fjalë krahinore e geg. VP, e formuar me emrin *kollovar* me kuptim përbuzës, që ka marrë prapashtesën *-ade*, si në *forcade* për “fuqi, forcë”.

- **Kore** “turp”, në poezinë “Giûha shqype”: *Per lumni veç kore t’mbeti*. Formim prapashkues prej foljes *koris* nga sll. *koriti*.

- **Lashtë** “vesë”, te “Ândrra e jetës”: *E permbi kashta / Shndritë pika lashta*. Formim i brendshëm me foljen *lag* dhe prapashtesën *-shtë*.

- **Lavruer** “kau i parmendës”; te “Ândrra e jetës”: *Pau se n’at náde poshtë një lavruer / Kish bá një shpuer*. Formim i brendshëm me prapashtesën *-or* prej *lavër*, formë prapashkuese e foljes *lëvroj* prej it. *lavorare* “punoj”.

- **Lmuç** “shuk, top, njëri mbi tjetrin”, në poezinë “Shtegtari”: *N’ rrugë mbet grueja brí një lisit, / Edhë fëmija ráne lmuç*. Ndajfolje e formuar me prapashtesën *-lë* nga emri *muq*, që e shënon Gazulli për “grumbull i vogël” me burim prej it. *mucchio* “grumbull”. Forma *lëmuç*, me kthimin dialektor *-q- > -ç-*.

- **Loke** “emër personazhi te “Ândrra e jetës”, antroponim për gjininë femërore. Lidhet brenda gjuhës me **lok* në *bablok*, që ka marrë fundoren *-e* si formant të gjinisë femërore. Elementi **lok* nuk gjendet si fjalë më vete, por del si fundore e emrave, prandaj ka qenë prapashtesë, që mund të afrohet me prapashtesën *-llëk* të turqishtes me ndërrim të lëngëzoreve (khs. *baballëk* e *bablok*).

- **Luron** “ulurin”, në poezinë “Vllávrási”: *Landët e pýllës si’j ujë ju dukshin, / qi prej újet n’mal luron*. Lidhet brenda shqipes me *uluron* e jashtë saj me lat. *ululāre* “ulërij”, *ulula* “kukuvajkë”, lit. *ulula baņgos* “ulërijnë valët”.

Llastore “e përkëdhelur”; në poezinë “Mahmud Pasha”: *Kqyri Pashen tui qesh’, e llastore / E muer ngryk*. Formim i brendshëm me prapashtesën *-tore* prej *llasë* “përkëdhelje”, vetë kjo prej foljes *llāj* “fryhem, ngopem”, me burim të trashëguar, prej rrënjës **elan-* “përkul”.

- **Mjet** “midis, ndërmjet”; te “Ândrra e jetës”: *Tui rá bórë, tui frye murlani, / mjet dy vorreve si ’j lis*. Fjalë me burim indoeuropian, që lidhet me lat. *medius*, gr. μέσ(σ)ος “i mesëm”, gjerm. *mit* “me”, *Mitte* “mes”. Me këtë fjalë lidhet emri i një fshati në Zadrinë, prej të cilit rrjedh edhe mbiemri i poetit.

- **Mungullon** “mbin, nxjerr syth”; te “Ândrra e jetës”: *Edhë shtâza po gazmohet, / Edhë bari mungullon*. Formim i brendshëm prej emrit *mug* “gjysmerrësira pak përpara lindjes së diellit”, që ka zhvilluar kuptimin “gjendja kur fillon të çelë (drita)”. Ka marrë prapashtesën -o të foljeve dhe epentezën e një -n-je.

- **Murgjinë** “emër lope”; te “Ândrra e jetës”: *del se erdh murgjina*. Formim i brendshëm me prapashtesën -inë prej shumësit *murgj*, duke u emërtuar kafsha prej ngjyrës së errët të rrobës së murgut.

- **Nget** “afër, pranë”, në poezinë “Vorri i Skanderbegut”: *E nget vorrit t’Skanderbegut / Rrite ‘j zojë me futë në krye*. Formim dialektor që lidhet me *ngjat* e të dyja këto me mbiemrin *i gjatë*, me ndërrimin e qiellzores në grykore në të folme geqe.

- **Njome** “fëmijë, vogëlushe”; te “Ândrra e jetës”: - *Bij’, mos e prek, se njomja / Tash â tui folë me Zojen*. Lidhet me foljen *njom*, që ka burim të trashëguar duke u lidhur me mbiemrin “i ri” të gjuhëve indoeuropiane nga rrënja *neJos*,-*Ōos*, ku bëjnë pjesë ind. vj. *návya*-, gr. (jon.) *veîos*, gal. *Nevio*-, got. *niujis*, të gjitha me kuptimin “i ri” (shq. **nŌë-m*).

- **Pronjet** “pronat”; në poezinë “Mahmúd Pasha”: *Sá t’kujtojn’ se nder pronjet e t’parit / Nji kind t’vetun perdhuni na shklet*. Është trajta më e vjetër e së sotmes *pronë*, huazim prej gr. mes. *πρόνια*, që me këtë trajtë dëshmohet te Budi në emrin *proniarëtë* dhe në patronimin *Pronjari* në anët e Korçës.

- **Rranje** “punët e përditshme të shtëpisë”; te “Ândrra e jetës”: *Lodhë prei vëgësh, prei rranjesh shpijet*. Është shumësi i emrit *rrangë*, me burim prej it. vj. *rangola*, duke u lidhur brenda gjuhës me *rrangulla*, *rrangalle*, *rrangallinë* e *rrangla*.

- **Rreshket**, te Mjeda me kuptimin figurativ “dëshiron, ke dëshirë”; në poezinë “Váji i bylbylit”: *E gjith kú t’rreshket / shkon fluturim*. Është folja *rreshk* “thaj, skuq”, me burim të trashëguar, që lidhet brenda gjuhës me *ndryshk*, duke u lidhur në shkallë indoeuropiane me rrënjën *reud^h*- “i kuq”, ku bëjnë pjesë sll. vj. kisht. *rudъ* “i kuq”, *rusъ* “i kuqërremtë”, *ръзда* “ndryshk”, lat. *russus* e gjerm. *rot* “i kuq”.

- **Rrfanë** “bishti ku lidhet kokrra e qershisë”; te “Ândrra e jetës”: *Molla t’kputuna nji deget / Dý qershija lidhë n’nji rrfanë*. Formim i brendshëm me parashtesën *rrë*- dhe emrin *vanë* “ulluk i ngushtë, që i bëhet për së gjati një dërrase që të puthitet mirë me një dërrasë tjetër”, shumësi i emrit *va* “shteg kalimi”. Lidhet brenda gjuhës me *rruvan* e *rrufane* “veshi i rrushit pa kokrra”.

- **Rrmyeshëm** “me vrull, furishëm”; në poezinë “I tretuni”: *Kû qetas del kroni, / Kû gurra del rrmyeshëm*. Formim i brendshëm me prapashtesën -shëm prej emrit *rrymë*.

- **Qetë** “shkëmb me majë të mprehtë”, te “Ândrra e jetës”: *Sogjetarë, porsi furija / E një rrfës qi qetat shpon*. Formim i brendshëm nga *qye* “majë mali”, që në trajtën e shquar bën *qeu* e në shumës *qetë*. Është një shumës i singularizuar, rrënja e të cilit në shkallë indoeuropiane lidhet me ind. vj. *kanda-* “top, gungë”, gr. *κόνδυλος* “shkop, grusht”, gjerm. l. vj. *hnel* “majë, kulm”.

- **E salikueme** “që i janë bërë ceremonitë fetare gjatë varrimit”; në poezinë “*Të vorruemit e Sir John Moore*”: *Dhimshem burrin tui ankue / Neper buzë, e salikueme*. Lidhet me *psalmet* “këngë fetare” me burim prej gr. *ψάλλω* “këndoj”. Në gjuhën shqipe ka hyrë prej italishtes. Budi e ka me formën *psalikoj* ~ *psalikime*. Trajta e sotme mund të jetë ndikuar prej it. *salmo*, ose buzorja *p-* mund të ketë rënë në një grup bashkëtingëllor. Trajta e thjeshtuar del së pari te Junku e te Bashkimi. Brenda shqipes fjala ka pësuar zhvendosje kuptimore duke shprehur ceremoninë e varrimit, në vend të këngëve e lutjeve fetare.

- **I shpjetë** “i shpejtë”, te “Ândrra e jetës”: *Cirlikne rrotllat posht’ e perpjetë / Nen kâmbë të shpjetë*. E shënon Gazulli për Zadrinë dhe Marko Boçari për toskërishten; një nga trajtat që dëshmojnë lidhjen me foljen *shpie* ~ *shpjerë*, duke u lidhur me *shpjert* të Buzukut e me *i çpjertë* të Bardhit.

- **Shqimit** “krejt”; në poezinë “I tretuni”: *I falem, se shqimit / Ju m’hiqni trishtimit*. Është emër i rasës rrjedhore njëjës me vlerë ndajfoljore, i formuar me formantin -m të pjesores prej foljes *shqyej*, duke u lidhur brenda gjuhës me *shkimëz* “një pjesë e prerë a e shkëputur; copë e vogël: një shqimëz letre”, ku del kuptimi i parë i foljes.

- **I shuem** “i shkretë”; në poezinë “Vllávrasi”: *Ah! nanë shkreta! i shuemi briti*. Mbiemër i nyjshëm i formuar me formantin -m të pjesores prej foljes *shuej* “fik” me kuptimin “i fikur, i mbaruar”. Me kuptimin “i vdekur” në Shkodër *Dita e të Shumëve* “dita e të vdekurve, e atyre që janë shuar”, interpretuar gabim prej Tagliavinit si *dita e të shumtëve* “giorno dei molti”.

- **Travajë** “mundime, shqetësime”, te “Ândrra e jetës”: *Shndritte at fëtyr’ të pa travajë*. Huazim prej it. *travaglio*, që e ka edhe Bogdani.

- **Tramë** “frikë”; në poezinë “Mahmud Pasha”: *T’rrgjanten shpatë qi kje trama e gjithkujit*. E ka edhe Kuvendi i Arbënit dhe lidhet me foljen *tremb* me një shkallë tjetër vokalike me marrëdhënie apofonike.

- **Truç** “bashkë, grumbull”, në poezinë “Shtegtari”: *anì prei fisit / Me i dalë para u nisne truç*. Formim i brendshëm prej *trumë* “grumbull, bashkë, tufë” me prapashtesën -ç, që ka shkaktuar rënien e sonantes -m.
- **Tytë** “bosh” te “Ândrra e jetës”: *Shurdh’ â vendi e shpija tytë*. Fjalë e trashëguar me burim indoeuropian, që lidhet brenda shqipes me *tytën e pushkës* e përjashta saj me rrënjën ie. *tġō(ū)*- “tub”.
- **Vení** “vetmi”; në poezinë “Váji i dallëndyshës”: *Lerg gjithkújit e n’vení*. Formim i brendshëm me prapashtesën -i prej trajtës dialektore *vetun* të gegërishtes veriore me rënie tingujsh. Mund të jetë krijim i autorit.
- **Zgaq** “fundërri, pleh”, “njeri i poshtër, pa cipë e pa nder”, në poezinë “Mustaf Pasha”: *zgaq i perbuzshem, Shqypnija t’vulli*. Lidhet me *zgaqem* “zhvishem, zbulohem” e me *mgaqem* “vishem”, e formuar prej *gagë* “shallvare prej cohe të kaltër deri në gju”.
- **Zis** “ngacmoj”, në poezinë “Váji i bylbylit”: *E kur t’zitë edi / Nder prroje pi*. Është trajta pa parashtesë e foljes *nxis*, me burim indoeuropian.
- **Ziti** “vrull, shpejtësi, nxitim”; në poezinë “Váji i bylbylit”: *Neper fush’ e neper shpija, / Me ziti qi s nep afat*. Formim i brendshëm me prapashtesën -i nga një rrënjë *zit-*, që lidhet brenda gjuhës me foljen *nxis* e jashtë saj me rrënjën ie. *g^li-t* “jetoj”, ku bëjnë pjesë let. *dzît* “shëroj”, sll. vj. *žiti* “jetoj”, ind. vj. *jīrá-* “i gjallë”. Formën më të hershme *zit* e shënojnë Weigandi e Gazulli.

Në veprën poetike të Mjedës gjejmë jo vetëm fjalë të rralla të shqipes, të përdorura me mjeshtri e elegancë, por edhe forma gramatikore me vlera të veçanta, sintagma e frazeologji, që i japin gjuhës së këtij artisti thellësi mendimi, të shprehur me fjalë të pakta. Në to gjendet shkurtësia e shprehjes dhe ekonomia gjuhësore, që poeti i mori në të folmen e vendlindjes dhe i përpunoi më tej. Vëmë në dukje rrjedhoren pa parafjalë, në raste si: *Flutrojnë kû çerdhen motit e ngule*; *Ju m’hiqni trishtimit*; *U lodhne gjûmit fëmija*; pjesoret e shkurtra që shprehin një gjendje, si: *Vesh’ e njeshë me stoli t’vet*; *Lodhë prei vëgësh*; ndajfoljet me burim mbiemëror, si: *këndon permállshem*, *hangri shieshem*, *kuvendte me nanen pergjumshem*; mbiemrat pa nyjë, që marrin vlera të veçanta shprehëse, si: *Zi nder petka*, *Shurdh’ a vëndi*, *E tamli*, *bardh si bórë*; emrat me vlerë ndajfoljore, si: *Shkon fluturim*, *Rrkaj’ i ulen lott per rrudha*; sintagmat emërore të formuara nga një emër e një mbiemër pa nyjë, si: *nan-zeza*, *nan-shkreta*, *nan-locja*; formën e pashtjelluar foljore me një emër të rasës kallëzore, si: *T’ardhmen Trina mbrámje n’shpi*,

T'cilmen lotve syt e mi; trajtën e pashtjelluar me pjesëzën pa me vlerë ndajfoljore, si Bylbyl, pá prâ gjimò, pá dá zêmrën m'a ngushllon, tui luejtë pá-mêjun gishtat; mbiemrat në trajtë të shquar për të shprehur shkallën sipërore, si: Krajlnit mâ t'moçmet ndrrohen me t'reja. Ka edhe mjaft fjalë të reja, sidomos mbiemra, pjesa më e madhe e të cilëve janë krijime të autorit, si: rrjedha qetore, ograia bleroshe, diell i valtë, rrufë bumbullore, udhtim i rrmueshem, dallëndyshë shtegtoe, giuhë vajtoe, rrjedhë damtoe, flakë shkrumuese, sukë mrekuore, borë amshore, hanë drapnore, kohna qytetnore, djelmëni ushtore etj.

E gjithë kjo pasuri gjuhësore e veprës së këtij poeti të talentuar, që nuk është përfshirë në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, mund të rigjallërohet duke pasuruar më tej gjuhën.

Mjeda ka qenë gjithashtu një punëtor i palodhur për pastrimin e shqipes prej fjalëve të huaja të panevojshme. Ai i përpunonte gjithnjë poezitë e tij jo vetëm për figurat e stilin, por edhe për gjuhën duke u prirur drejt një pastërtie sa më të madhe. Për këtë mjafton të krahasojmë poezitë e tij të para, që i botoi Jungu më 1887 në shtojcën e librit "Shahiri elierz" me ato që botoi poeti më vonë në Vjenë e në Shkodër.

Të gjitha këto dëshmojnë se shembulli i Mjedës, që përpiket ta lëvrojë dhe ta pasurojë shqipen me brumin e mjetet e saj, është fryt i dashurisë së tij për gjuhën amtare, për të cilën, duke e parë si shenjë bashkimi të të gjithë kombit shqiptar, shkruan:

*Nji giuhë shqipe t'gjith kuvesim
Nji Istori, nji atdhe na kemi
Geg' e Toskë nji zemre jemi
me ndjek shqype hovin tand.*

BIBLIOGRAFI

Mjedja Ndre

- Juvenilia, Shkodrë, 1928.
- Lissus. Shkodrë, 1928.
- *Prënd e Prëndë*. Leka IV 1932, 351.
- Vrejtje mbi artikuj e premna pronës të gjuhës shqipe. Shkodrë, 1934.
- Scodra. Shkodrë, 1939.

Mjedlogji 1. Aktet e konferencave shkencore; Shkodër, 8 dhjetor 2007 dhe Bushat, 1 gusht 2012. Lezhë, 2014.

Osmani Tomor

- Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918). Camaj-Pipa, Shkodër, 2004.

Quku Mentor

- Një fjalorth botanik i Ndre Mjedës. “Studime filologjike” 3, 1984, 155-172.
- Mjeda 3, 4, 5, 6. Shtëpia botuese Ilar.

Topalli Kolec

- *Ndre Mjeda dhe pasurimi i gjuhës shqipe*; “Kumtari i Muzeut historik”, Shkodër, 2007; “Gjuha Jonë”, Tiranë, 2007.
- Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe (i pabotuar).

Floresha DADO

MJEDJA – TRI POETIKA NË NJË!

Pyetja që shtroj që në fillim është: interpretimi ka të bëjë thjesht dhe vetëm me individualitetin krijues të Mjedës, me përcaktimin e poetikave që pleksen në veprën e tij?

Në një kuptim Po, por jo vetëm kaq. Sepse një poet i përmasave të Mjedës, me një kombinim interesant të drejtimeve letrare, që shfaqen dhe largohen prej krijimeve të tij, që nxisin por edhe i zënë vendin njëra tjetrës, mund të na çojë në një vështrim më të gjerë. Nëse themi: *tri poetika në një*, kjo ka të bëjë edhe me studimin e specifikave të zhvillimit të letërsisë së fundit të shek. XIX dhe fillimet e shekullit XX, periudhë kur, në disa raste, ajo shfaqet provokuese në strukturat poetike.

Është folur, por jo gjerësisht, për romantizmin e poetit, për realizmin në krijime të veçanta, për elemente të neoklasicizmit lidhur vetëm me mjeshtërinë e hartimit të poezive. Por problemet që trashëgojmë në interpretimin e këtij poeti janë: *Së pari*, përcaktime të ndryshme nga studiues të ndryshëm; *së dyti* jo koherencë edhe brenda interpretimit të të njëjtit studiues; *së treti*, përcaktim i llojit të poetikës kryesisht vetëm sipas *frymës* së poezisë dhe jo e lidhur, sa duhet, me strukturat e brendshme, të cilat i përkasin herë poetikës romantike, herë realiste, ndonjëherë edhe neoklasiciste; *së katërti* trajtimi i thjeshtëzuar i poetikave të Mjedjes, si një fenomen jo i lidhur sa duhet me proceset e zhvillimit të letërsisë shqiptare.

Si e kanë përcaktuar studiuesit poetikën e poezive të Mjedjes ?

Justin Rrota te libri “Letratyra shqipe për shkolla të mjesme” (Shkodër, 1925): “...ky auktuer asht për t’u çëmue për *ndërtim klasik* të vjershës, hartue e lëmue me cenë të posaçme.”

Çabej shkruan për “përsosjen teknike të versit” (“Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe”, Tiranë, 1936).

Jup Kastrati, në shkrimin “Mbi disa forma klasike të Mjedjes” (Gjuha shqype, f.21,v.1) përcaktonte: “Vepra poetike e *romantikut* përparimtar dhe *neoklasikut* Ndre Mjedja...”.

Jolanda Kodra, në Parathënien që do përfshihej në botimin e saj “Ndre Mjedja, Poesie e Poemi”, (Tiranë 1966, që mbeti dorëshkrim), shkruante: “Drita e artit të tij merr ngjyrim nga më të ndryshmet, *romantizëm, realizëm, neoklasicizëm*, por të gjitha këto shkrihen...” (Cituar sipas botimit: Mentor Quku, MJEDJA 3, Libri i dytë, ILAR, f.707). Po kjo studiuese dhe përkthye e talentuar, humbet koherencën në përcaktimet e ndryshme për të njëjtën poemë. Ndërsa e quan “Andrra e jetës” poemth të mbështjellë me një *vello romantike*, më poshtë vazhdon “Andrra e jetës është *poema e parë realiste* e letërsisë shqipe, e para poemë që pasqyron realitetin shqiptar ashtu siç është, jo në dritën e idealeve, as të kontrasteve romantike.”

Vehbi Bala, shkruante: “Në këto tufa tingllimesh, Mjedja kaloi nga *romantizmi e realizmi* i periudhës së parë tridhjetëvjeçare në periudhën e dytë: në *klasicizëm*. Vërtetë kjo rrymë mund t’i përshtatej epokës s’evokueme, por, mbas rrymave ma të reja që i përdori në periudhën e parë, ishte një kthesë së prapthi.” (Ndre Mjedja – Me rastin e 20 vjetorit të vdekjes, Revista “Nëntori”, nr. 8, 1957, f.175). Kështu ai e sheh poezinë e Mjedës në kalimet nga romantizmi te realizmi dhe tek neoklasicizmi i vonë, prej të cilit, sipas tij, dolën dy tufat e tingëllimeve “Lissus” dhe “Scodra”. “Nga poemthet lirikë romantikë *Vaji i bylbylit* e *I tretuni*, tek poemi shoqëror kryesisht realist *Andrra e jetës*, nga tufat e tingllimevet *Lirija*, *Lissus* e *Scodra* tek motivet e ndryshme lirike patriotike ...” (Po aty, fq. 182)

Në Kapitullin “Ndre Mjedja” tek Vëllimi i dytë i “Historisë së letërsisë shqipe”, (Tiranë, 1959, f.394-430) shkruhet: “*Romantik* n’esencë, Mjeda eci kryesisht në vazhdën e romantizmit përparimtar; ai e pasuroi metodën e vet me *realizëm plot elemente kritike*, duke prekur anë të ndryshme të problematikës shoqërore. Në këtë drejtim, ai mund të vështrohet si shkrimtar i *kapërcimit nga romantizmi i fundit të shekullit të kaluar, në realizmin e fillimit të shekullit tonë*, duke qëndruar kështu afër Çajupit”.

Dh. S. Shuteriqi: “Juvenilja është një përmbledhje lirikash *romantike*, po ku depërton shpesh *theksi realist*. ...” (Po aty, fq. 203). Ndërsa “Andrrën e jetës” e përcakton si “një tjetër poemth më shumë

realist se romantik” (Histori e letërsisë shqipe” për shkollat e mesme, botimi i dytë, Tiranë 1958).

M. Gurakuqi, për “Andrra e jetës”: “Mjedja me *realizëm* vë në dukje se çdo dhembje njerëzore...”. Po më poshtë pohon: “ Poemë *romantike*, kjo.”. (Mark Gurakuqi, *Mbi veprën poetike të Mjedës*, në Ndre Mjedja, *Vepra* 3, Rilindja, Prishtinë 1982, fq. 119). Ose më poshtë: “ Një poemë....që, për rëndësinë e saj, për vlerën e saj ideoartistike, mbetet një ndër veprat themelore poetike të letërsisë sonë para realizmit”. (fq. 132)

Në “Historia e letërsisë shqiptare”, (Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1983, fq. 360) është shkruar: “Në themel, ai është *romantik*. Madje mund të themi se Mjeda është ndër të parët poetë të letërsisë sonë (përfshihen arbëreshët), që nxori në pah ndonjë veçori të romantizmit, e cila nuk ishte dukur dhe aq deri atëherë.”

R. Qosja e quan: “njërin prej poetëve të *romantizmit* shqiptar”, por, gjithashtu përcakton: “Ndre Mjedja, megjithatë, shumë më tepër se paraardhësit e tij i kushton kujdes kallëzimit objektiv. Dëshmi e kësaj veçorie të procedimit të tij krijues janë hollësitë e shtuara *realiste*, me anën e të cilave thellohen dhe zgjerohen pamjet e botës së paraqitur”. (Po aty, fq. 470, apo “ ... Megjithëse të ngrira me hollësi *realiste*, visoret e vjershave dhe të poemave të fillimeve të tij krijuese, sikundër janë *Vaji i bylbylit*, *Shtegtari*, *Malli për atdhe*, apo, madje edhe *I tretuni* dhe *Andrra e jetës*, nuk mbesin visore të thjeshta *realiste*, çfarë janë visoret në poezinë e parnasizmit apo, më në fund, në poezinë e realizmit. (fq. 475)). “Veta e tretë në poezinë e Ndre Mjedjes nuk mund të njehsohet me veten e tretë në poezinë e *klasicizmit* apo *realizmit*. (fq. 469)

S. Hamiti, flet për një “...përshkrim *simbolizues*...” (Parathënia në: “*Mjedja*” – *Vepra* 1, “Rilindja”, Prishtinë 1982.fq. VII). Duke iu referuar tekstit poetik, e karakterizon si “...tendencë nga simbolizimi i saj, nga fundi... (Po aty, fq. XXXV). “Në këtë kërkim - shkruan ai-teksti i tij merr trajtën klasike të ligjëratës poetike dhe rri diku në mes të historisë e poezisë klasike antike me ngjyrimet e theksuara mitologjike, që manifestohet në formën më të përsosur poetike të tingëllimit.” (fq. XXXVI)

J. Bullo, flet për “metodën e *romantizmit*”, por edhe shton: “në poezitë e Mjedjes, ... mbresat *realiste* janë më të forta, ato përcaktojnë idenë *realiste* të veprës, subjektin *realist*.” Dhe më poshtë, për “Andrra e jetës” shkruan: “është një *vepër realiste*”... “Figura e Lokes është

thellësisht realiste” “Zgjidhja e veprës, që lidhet me fundin e Lokes, është realiste”, etj. (“Realiteti shqiptar të “Andrra e jetës”, Gazeta “Drita”, 20 nëntor 1966)

Pak më i ndryshëm është këndvështrimi i Milazim Krasniqit: “E nisi *si romantik* dhe e mbylli *si romantik*”, sepse, sipas tij “elemente të krijimeve sonetike të Ndre Mjedës, si tematika, glorifikimi i së kaluarës, figuracioni, janë në fundamentin e poetikës romantike”. Por, më pas ai pohon: “...në krijimet sonetike të Ndre Mjedës kemi një gërshetim interesant të prirjeve *romantike* me ato *neoklasiciste*.” (Milazim Krasniqi, Soneti në poezinë shqipe”, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë 2005 fq.107, f.110)

Studimet tona për autorë të shquar tashmë kërkojnë krahas vëzhgimeve të specializuara për individualitete të papërsëritshëm, si rasti i Mjedës, edhe një vështrim më të gjerë, çka ndriçon një përmasë tjetër dhe vlerë më të gjerë historiko-letrare të tyre. Në këtë shtrat teoriko-historiko-letrar mendoj se studimi i specifikës së drejtimit letrar, të cilit i përket poezia mjedjane, do të na çonte në vëzhgimin e disa çështjeve themelore:

I A mundet që brenda krijimtarisë së një autori të pleksen poetika të dy, ose dhe tre drejtimeve letrare? Po brenda së njëjtës vepër?

Këto pyetje i provokon krijimtaria e Mjedës. Janë sidomos poemat, të cilat, siç e vumë në dukje më sipër, janë përcaktuar në mënyra të ndryshme. I vlerësuar njëherazi ‘romantik’ dhe ‘neoklasik’, krijimtari ‘me romantizëm, realizëm, neoklasicizëm’, ‘autor që kalon nga romantizmi e realizmi në klasicizëm’, “shkrimtar i kapërcimit nga romantizmi i fundit të shekullit të kaluar, në realizmin e fillimit të shekullit tonë”; poet që ‘theu rregullat klasike të vjershërimit, etj. ky poet ngjall kërkesën, që, sipas Jorgo Bulos: “Ajo që të shtyn të mendosh më tepër mbi këtë poemë lidhet me metodën artistike, ... Nga forma, nga përdorimi i figurave e mjeteve të tjera artistike, të ngjan se në vepër zotërojnë ngjyrat e romantizmit; nga përmbajtja ndodh ndryshe. ...vepra, në analizën e fundit, është realiste, por balancimi i këtyre dy tipave, që rivelejnë njëri-tjetrin, i jep veprës në pamjen e parë, një ngjyrë romantike.” (Shkrim i cituar). Në këtë mënyrë çështja e metodës së krijimit, kur pohohet gërshetimi i realizmit me romantizmin, apo kalimit nga romantizmi veprues i fazës së parë në një realizëm të goditur nxit diskutimin mbi parimet estetike që ndërtojnë poezinë e tij.

Më provokues vjen interpretimi që sheh gërshetimin e **dy poetikave brenda të njëjtit krijim**. Sipas M. Gurakuqit: “Në dhënien e Lokes, Mjedja ka ndjekur një vijë të përcaktuar *realiste* zhvillimi, të drejtë e bindëse...Me Zogën poeti ndjek një rrugë tjetër zhvillimi, kryesisht *romantike*. (Ndre Mjedja, *Vepra* 3, Rilindja, Prishtinë 1982, f.143 dhe f.145), ose kur pohon për të njëjtën poemë se “Mjedja na jep një tablo *realiste*, të gërshetuar me *elemente romantike*” (po aty, f.136)).

Nga Shuteriqi poema “Andrra e jetës” është përcaktuar si ‘romantike, por edhe si poemth ‘më shumë realist se romantik’.

I veçantë është përcaktimi i Qosjes për personazhet e “Andrra e jetës”, kur shkruan: “Personazhet e poemës, Trina, Zoga dhe Lokja, nuk mund të quhen personazhe *realiste*, përmes të cilave do të shihej, në plotësinë e saj, gjendja sociale e shtresës së varfër shoqërore dhe shfrytëzimi i saj prej shtresave të larta, çka, rëndom, është qëllim i veprave letrare *realiste*. Më parë, ato janë *personazhe - simbole*, që përfaqësojnë tri prirje të jetës njerëzore” (fq. 459)

Këto pohime, dhe interpretime të tjera nga autorë shqiptarë, na çojnë në diskutimin teorik të konceptit mbi poetikën e një drejtimi letrar. Dihet se në letërsitë evropiane një drejtim letrar lindi në një kontekst kulturor dhe social-shpirtëror-psikologjik, si kundërvënie ndaj një poetike paraardhëse. Si pasojë e këtij kushtëzimi ideo-estetik ky drejtim nuk rishfaqet më në të njëjtin vend, ku jeta shpirtërore-social-ideore ka ndryshuar, por bëhet zotërues në letërsi të vendeve të tjera. Kjo është arsyeja që në letërsinë shqipe poetikat e romantizmit, realizmit, neoklasicizmit..., erdhën në periudha më të vonshme në krahasim me letërsitë e vendeve të tjera. Prandaj edhe krijimtaria e Mjedës, pavarësisht formimit teorik të autorit, ndikimeve që solli çdo letërsi tjetër në shijet e tij, dëshmon lidhjen shpirtërore me realitetin shqiptar, me problematikat që mbante ai. Ajo erdhi si një vërshim, sa i kontrolluar aq dhe i papërmbajtur, sa shpirtëror aq edhe historiko-kulturor, sa e vendosur në momente historike, aq edhe në kapërcyell të këtyre momenteve, sa nën ndikimin estetik të veprave të një drejtimi të caktuar, aq edhe vetjake në mënyrën e përjetimit emocional. Prandaj herë shfaqet si romantike në frymën dhe përfytyrimin e saj, herë vëzhguese dhe kritike ndaj realitetit, herë e përpunuar me adhurimin e teknikave dhe koncepteve të teorisë klasiciste. Ato bëhen bashkë, shpesh të padallueshme në kapërcimin mbi njëra tjetrën, duke mos cenuar individualitetin krijues, por përkundrazi, duke i dhënë një origjinalitet të përsëritshëm.

II Raporti i frymës me teknikën poetike është raport i vetëdijshëm apo intuitiv ?

Një pjesë e mirë e përcaktimeve mbi drejtimin letrar, të cilit i përkasin krijimet e Mjedës, mbështeten në *frymën* që i përshkon. Domethënë, një krijim është romantik sipas frymës që përcjell poezia romantike, shfaqet realist për marrëdhënien që ndërton me realitetin e kohës dhe mjedisit. Në këtë lloj qasjeje hetimi i parimeve estetike, që realizojnë këtë frymë (romantike, apo realiste, apo të konceptit neoklasik) është aspekti që kërkon më shumë vëmendje në studimet shqiptare. Ndonëse studiues të ndryshëm (në mënyrë të veçantë R. Qosja) janë përpjekur të prekin sistemin e poetikës së brendshme, apo raportet e elementeve që realizojnë strukturën e vargut, ritmit, muzikalitetit, etj. ky interpretim mbetet, gjithsesi, i hapur.

Kur është vlerësuar si romantik, kuptohet se tek ai mbizotëron shpërthimi i lirë, frymëzimi spontan. Por në studimin e V. Balës lexojmë: “Në këto dy tufa tingëllimesh duket ma fort dora e mjeshtrit se sa spontaniteti i poetit,...”. (fq. 181). S. Hamiti, duke synuar të hetojë marrëdhënien midis aspekteve tekniko-poetike të Mjedës dhe spontanitetit figurativ, konstaton se “... kërkimi i stilizimit me çdo kusht, qoftë edhe me bartje të tepërta, sjell panatyrësi në vargjet e tij. Stilizimet e rëndojnë veçmas sintaksën poetike të Ndre Mjedjes. ... Nuk është e vështirë të vërehet se në të gjitha vjershat dhe poemat e shkruara me stil të lartë, shprehja bëhet më e rëndë se sa mendimi që e bart. Për këtë arsye vjershat dhe poemat e shkruara me një stil të tillë, të lartë, vuajnë prej shqiptimit patetik, prej tonit të lartë, prej foljezimit dhe, në përgjithësi, prej patosit e retorizmit që cenon natyrësinë aq të çmuar në poemat sikundër janë *Vaji i bylbylit*, *I tretuni* dhe *Andrra e jetës*. Ndërsa Justin Rrota çmonte Mjedën për ndërtim klasik të vjershës, hartue e lëmue me cenë të posaçme, Gurakuqi vlerëson thyerjen e rregullit *klasik*, sipas të cilit mendimi duhet të përfundojë *brenda një strofe* e të mos të kalojë në strofën tjetër. (vepër e cituar, fq. 214), Petrota e vlerëson për “teknikën e vjershërimit”, Çabej për “përsosjen teknike të versit”, Shuteriqi për “vargun e përsosun” dhe si “mjeshtër i rrallë i strofës”, J. Kastrati flet për “format klasike të Mjedës” etj. Të gjitha këto vëzhgime i referohen **vetëdijes krijuese** të Mjedës, procesit të zgjedhjes e përpunimit të kujdesshëm të vargëzimit poetik.

Përcaktime të tilla, ndonëse në dukje kanë të bëjnë me drejtimet letrare, mpleksjen e të cilave e gjejmë në disa poema, në rastin e

Mjedës reflektojnë një marrëdhënie specifike midis kërkimit të vetëdijshëm dhe shpërthimit të brendshëm. Karakterizimet e ndryshme mbi këtë poet reflektojnë, në të vërtetë, specifikën e procesit të tij krijues, gjatë së cilit lëvizin në mënyrë të paparashikuar *vetëdija* e kërkimit të formës dhe shpërthimi *intuitiv* i figuracionit. Në këtë mënyrë mund t'i japim përgjigje edhe çështjes se **a mund të jetë kanonike një poemë në raport me një drejtim letrar të caktuar** ? Kështu, a është, tek Mjedja, lloji i strofës, i vargjeve dëshmi e vetme rigoroze e përkatësisë në një drejtim letrar? A ka liri formale ? E marrë në tërësinë e saj e gjithë krijimtaria e tij mund të shihet si gërshetim parimesh estetike. M. Krasniqi shkruan: "Strukturë e konservuar e formës poetike dhe të metrit dhe rimës si elemente kyç të kësaj forme." Ideja që: "...të hetohen shkallët e formimit të një vetëdijeje krijuese duke u lexuar pikërisht teksti i tij, brenda këtij sistemi të varësive artistike po edhe me referime të jashtme. Pra, transformimi i vetëdijes krijuese të hetohet nëpërmjet transformimit të vetë teksteve poetike" (vepër e cituar, f.109) rivlerëson, gjithashtu, rolin e vetëdijes krijuese të poetit.

Kur M. Gurakuqit kish pohuar se "Mjedja theu rregullat klasike të vjershërimit", lidhja me një drejtim letrar është më e qartë. Por, nga ana tjetër, nëse brenda së njëjtës poemë (Andrra e jetës), kemi konceptim *romantik* dhe *realist* të dy personazheve, atëherë është e qartë se liria shpirtërore thyen lirinë formale dhe shkëput vargonjtë e parimeve kanonike.

Kapërcimet, pleksjet e parimeve estetike, si rezultat i përjetimeve të fuqishme emocionale, konfirmojnë forcën e **intuitës krijuese**. Sado të kontrolluar të jenë nga respektimi i rregullit të poetikës klasike, frymëzimi dhe mënyra e shprehjes së ndjenjës së brendshme bëhen të fuqishme dhe shpesh mbizotëruese në frymën poetike. Kështu, duke iu përgjigjur pyetjes që shtruan në fillim, mund të themi se raporti i **frymës me teknikën poetike** te Mjedja shfaqet i veçantë: niset për të qenë i vetëdijshëm, por intuita e frymëzimit dhe sistemit figurativ ndërhyjnë fuqishëm, duke e çuar poetin nga respektimi i disiplinës klasiciste në patosin romantik, dhe herë-herë në frymën e vëzhgimit realist.

III A është tema faktor themelor në poetikën letrare ?

Kjo është një çështje që nuk ka të bëjë vetëm me Mjedën, por që bëhet e diskutueshme veçanërisht përballë pikëpamjes që mohon rolin

e përmbajtjes, temës në analizën e një teksti letrar, që përcaktimet e veçorive të poetikës i sheh vetëm në aspektet teknike-artistike. A mund të themi, p.sh., se tek Mjedja ishte tema patriotike që kërkoi parimet estetike të romantizmit, ndërsa tematika sociale kërkonte realizmin? Sipas Gurakuqit: “Për problemet e plagët shoqërore që preku, realizmi ishte i përshtatshëm, ashtu siç ishte më i përshtatshëm romantizmi përparimtar për t’u kënduar luftës për liri, bashkimit kombëtar etj.” (Vepër e cituar, fq. 230-231). Në “Historia e Letërsisë Shqipe”, (1983, fq. 360) prirjet realiste të Mjedja lidhen pikërisht me “trajtimin e motiveve shoqërore.” Studiues të tjerë kanë shpjeguar se trajtimi i temës shoqërore solli lindjen e letërsisë me prirje realiste, krahas interpretimit tjetër se lëvizja patriotike e Rilindjes solli romantizmin në letërsinë tonë. “Romantik n’esencë, shkruan V. Bala, Mjedja eci kryesisht në vazhden e romantizmit përparimtar; ai e pasuroi metodën e vet me realizëm plot elemente kritike, duke prekur anë të ndryshme të problematikës shoqërore”.

Sigurisht kjo lidhje e brendshme midis problematikës dhe parimeve estetike është e pamohueshme, madje e rëndësishme. Por rasti i Mjedës, krijimtaria e të cilit në planin ideor-politik i përket një faze të caktuar historike, me momente zhvillimi dhe kapërcimi politik e estetik, ndërsa në planin shpirtëror e filozofik reflekton një situatë vetjake, të komplikuar në planin emocional dhe artistik, dëshmon se vërtetë problematika e kohës është nxitëse, është aty brenda, por ajo nuk skematizon, nuk skllavëron intuitën e lirë krijuese, ajo e le të lirë poetin të shpërthejë në përjetimet e tij, herë me frymën e një romantizmi mahnitës, herë me detajin therës realist, herë me respektimin e vetëdijshëm të parimeve estetike klasike në përpunimin e strofës dhe vargut. Rasti i krijimtarisë së Mjedjes është dëshmia më e qartë se tematika (në kuptimin e filozofisë që mbart) sigurisht ndikon në parimet estetike, por ato nuk janë ekstremisht të kanonizuar dhe të ngurtë. Këtë fenomen poetik e hasim edhe tek disa krijues të tjerë, që, për sa i përket drejtimit letrar, shpesh janë interpretuar në mënyra të ndryshme.

IV Pse poetika e një poeti të shquar duhet parë si pjesë e procesit të evolucionit poetik të letërsisë? Raporti e përgjithshme/ individuale.

Në “Historia e letërsisë shqipe”, 1983 lexojmë: “Ai është ndër ata shkrimtarë, që hodhën urën e kalimit nga letërsia romantike e lëvizjes së çlirimit kombëtar në letërsinë me prirje realiste të periudhës

që pasoi... Është kjo tematikë, që zhvilluan më tej Mjedja me të tjerë në letërsinë e kohës dhe që, duke i dhënë patriotizmit një kuptim më të thellë popullor, theksuan elementet realiste të letërsisë së Rilindjes. (fq. 359). Dhe më poshtë: “Madje mund të themi se Mjedja është ndër të parët poetë të letërsisë sonë (përrjashtohen arbëreshët), që nxori në pah ndonjë veçori të romantizmit, e cila nuk ishte dukur dhe aq deri atëherë... mund të themi se Mjedja, duke qenë kryesisht një romantik, po duke u prirur nga tema shoqërore, është ndër të parët që në poezi i çel rrugën realizmit në letërsinë shqiptare”. (fq. 360)

“Historia e letërsisë shqipe”, 1959: “shkrimtar i kapërcimit nga romantizmi i fundit të shekullit të kaluar, në realizmin e fillimit të shekullit tonë,” (f.426). Diskutimi mbi drejtimin letrar është pleksur edhe me konceptin e metodës krijuese, kur shtrohet çështja: “Mbetet për të diskutuar se deri ku e deri në ç’shcallë kjo *prirje* u kristalizua në një *metodë* realiste. Sipas nesh, jo deri në fund. As te Mjedja, as te bashkëkohësi i tij *Çajupi*. Për *metodë* realiste mund të flitet për *Migjenin* e ndonjë tjetër. Por, sidoqoftë, ka rëndësinë e vet fakti që Mjedja, - e me të *Çajupi* e të tjerë, - bënë një hap me rëndësi përpara në zhvillimin e një poezie realiste shqipe, të mbrujtur me idetë e përparuara të kohës”. (Ndre Mjedja, *Vepra* 3, Rilindja, Prishtinë 1982, Mark Gurakuqi, *Mbi veprën poetike të Mjedës*, fq. 230-231)

R. Qosja e sheh krijimtarinë e Mjedës në një rrokje më të gjerë historiko-letrare: “Ndre Mjedja do të bëhet paralajmëtar i periudhës së re të letërsisë shqipe. Por, vetëm paralajmëtar. Duke e filluar krijimtarinë në vitet e fundit të shekullit XIX, kur ndjeshmëria dhe shprehja romantike, sado pak, ishin harxhuar, atij sikur i bëhet e mundshme të parathotë prirjet ideostilistike, që do të përbëjnë periudhën e ardhshme letrare: prirjet realiste, parnasiane-simboliste dhe neoklasiciste...” (fq. 508).

Gjithashtu S. Hamiti: “Stili klasik i Mjedjes, si dhe mënyra e komunikimit të tij me një kohë të larguar shumë në të shkuarën, është vijuar në mënyra të ndryshme në letërsinë bashkëkohore shqipe dhe ndikimi i tij gjithsesi është i fortë dhe i dukshëm, herë-herë jo vetëm për apostrofimin e tematikës po dhe për vetë mënyrën e ndërtimit të tekstit poetik e artistik ... (fq. XXIX):

Këto dhe përcaktime të tjera, ndonëse, në një farë mënyre, e shohin Mjedën në sfondin e zhvillimit historik të letërsisë shqiptare, mbeten të karakterit të përgjithshëm. Sipas meje, nëse ky poet vendoset në kapërcyell të dy epokave historike dhe të dy apo tre drejtimeve letrare, ky fakt i kapërcen kufijtë individualë, duke hapur

një qasje më të gjerë historiko-letrare. Rasti i Mjedës dhe i Çajupit, por dhe i ndonjë autori tjetër, duhen për të shpjeguar veçantitë e zhvillimit të letërsisë sonë në aspektin pak të studiuar, siç është raporti midis drejtimeve të ndryshme letrare, zëvendësimi apo kapërthimi i tyre, si dukuri e rëndësishme e procesit të zhvillimit letrar-historik. Kjo qasje nga njëra anë ndihmon historianët e letërsisë të ndërtojnë skemën e rrugëtimit historik të letërsisë, nga ana tjetër i jep autorit një status të veçantë të individualitetit të tij artistik.

V Poetikat mjedjane në plan krahasimtar: me veten dhe me romantikë të tjerë.

Ky vështrim në dy plane lidhet gjithashtu me çështjet që prekëm më sipër. Në raport me vetveten Mjedja është ‘i paqëndrueshëm’, në raport me romantikë të tjerë, qoftë të letërsive evropiane, qoftë shqiptarë, është sa i ngjashëm, aq edhe i veçantë.

Është interesant dallimi që studiuesi R. Qosja sheh midis romantizmit mjedjan dhe atij tipik kur shkruan se “Poemat e Ndre Mjedjes ndryshojnë shumë prej poemave të tjera të romantizmit tonë si për nga përmbajtja, ashtu edhe për nga ndërtimi kompozicional... Në qoftë se Jeronim de Rada dhe Naim Frashëri janë poetët më përfaqësues të dy tipave të poemës sonë romantike: i poemës dramë – i pari, kurse i poemës epike – i dyti, Ndre Mjedja është përfaqësuesi më i dalluar i poemës së shquar lirike, çfarë janë *Vaji i bylbylit*, *I tretuni* dhe *Andrra e jetës* dhe i poemës tingëllimore, çfarë janë *Lirija*, *Lissus* dhe *Scodra*.” ((*Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III*, “Rilindja”, Prishtinë 1990. Ndre Mjedja (1866-1937), fq. 441-442) “Qëndrimin e tij romantik ndaj botës, prandaj, gjithnjë e më pak do ta mbështesë mbi kulturën patriarkale popullore, posaçërisht mbi letërsinë popullore e gjithnjë e më shumë mbi kulturën e lashtë ilire. Pikënisja e këtillë, në saje të së cilës aq shumë do të largohet prej pikënisjes së romantikëve tanë të tjerë, ...” (po aty, f. 468). Dhe përsëri: “Në qoftë se trajtimi i të kaluarës historike, sidomos, i kohës së Skënderbeut, në poezinë e romantikëve të tjerë vihet në shërbim të bashkëkohësisë, të luftës për pavarësinë kombëtare, trajtimi i të kaluarës në poemat e Ndre Mjedjes *Lissus* dhe *Scodra* shndërrohet në një nostalgji për të. Kjo, ndërkaq, nuk është e vetmja arsye pse poemat e tij tingëllimore shquajnë si krijime konservatore. Romantike për nga tema e zgjedhur dhe për nga qëndrimi emocional ndaj saj, ato duken konservatore për nga fryma e përgjithshme që i përshkon dhe,

posaçërisht, për nga vargjet me të cilat krijohen”. Sipas tij “Me ndryshim prej romantikëve tanë të tjerë, ...nënteksti i poezisë së romantikëve të tjerë, shpesh, u detyrohet copëzimeve dhe simboleve tradicionale; nënteksti i poezisë së Ndre Mjedjes, ndërkaq, shpesh, u detyrohet situatave simbolike dhe ngjeshurisë. (po aty, fq. 473). “ Roli stilizues i figurës në poezinë e Ndre Mjedjes do të jetë aq më i dukshëm edhe për shkak se, shpesh, në krahasim me figurën në poezinë e romantikëve të tjerë, do të jetë e re dhe e papritur.” (po aty fq. 474). Për studiuesin R. Qosja “... poezia e tij, ndërkaq, tregon edhe disa cilësi të tjera, që e veçojnë në gjirin e poezisë (po aty, fq. 469).

Nëse do duhej të përcaktonim se çfarë ka të veçante poetika e Mjedës në raport me autorë të tjerë shqiptarë, do ndaleshim në diskutimin në ç’raport qëndrojnë poetikat me tematikën e trajtuar, porë kjo në plan krahasimtar për të provuar se poemat e Ndre Mjedës ndryshojnë shumë prej poemave të tjera të romantizmit tonë si për nga përmbajtja, ashtu edhe për nga ndërtimi kompozicional... Ky është aspekti themelor që do ta orientonte studiuesin në qasje më të thelluar në poetikën romantike të poezive të Mjedës. Nuk mjafton të karakterizojmë një autor si ‘romantik’ apo ‘realist’, sepse veç parimeve të përgjithshme estetike që karakterizojnë çdo drejtim letrar, çdo autor është *i papërsëritshëm* në individualitetin e tij krijues, çka, sigurisht, e diferencon nga autorë të tjerë të të njëjtit drejtim letrar.

VI Përkatësia në një drejtim letrar e një vepre, sidomos e një poeme, a duhet parë vetëm si parime estetike dhe frymë/ide, apo edhe si konceptim i natyrës së letërsisë prej vetë poetit ?

Poetët nuk janë teoricienë, por, në forma të ndryshme, herë përmes shprehjes së drejtpërdrejtë të pikëpamjeve të tyre mbi poezinë, herë praktikisht në realizimet e poetikës së veprës, ata zbulojnë, më shumë intuitivisht, kuptimin teorik mbi letërsinë. Mjedja nuk ishte teoricien i letërsisë, por në trajtesën e shkurtër “Përmbi poezi përgjithësisht” trashëgojmë një mini-traktat të shkurtër lidhur me “Natyra e poezisë”, “Të shprehurit poetik të bukurisë” dhe “Shëllimin” (qëllimin) e poezisë. Është e qartë se në formimin teorik Mjedja ka qenë nën ndikimin, ose më mirë në njohjen e teorisë së Aristotelit, Horacit, Bualoit, filozofëve dhe teoricienëve modernë... Nga një anë pohon se: “ma mirë përcaktohet poezia tue thanë se asht të shfaqurit e bukurisë me një të shprehurit të përfytyrimit (fantazisë) ma të shumtën e herës me masë.”, por duke shkuar më tej e krahason

me arte të tjera, për të qëndruar në thelbin e mjetit që përdor letërsia, “me njatë të shprehun qi i del prej tugës së zemrës e prej fuqisë së përfytyrimit”, çka reflekton frymën themelore të teorisë romantike. Por, përcaktimi i poezisë si arti që duhet të synojë “kah e mira”, “qi nuk asht ta poshtnojë njerin, por qi ta naltojë”, i afrohet konceptit të klasicizmit mbi pasqyrimin e së bukurës, e modeleve të virtytshme...

Ndonëse kjo trajtesë është tepër e shkurtër për të njohur *sistemin e të menduarit teorik* të Mjedës, ajo vlen për të kuptuar *sistemin e krijimit artistik* të tij, për t'i dhënë një përgjigje të përafërt çështjes, që tek studiuesit ka krijuar shpesh një konfuzion, se si ndodh që herë e gjejmë të përcaktuar si romantik, herë si realist, e herë si neoklasicist.

Lidhur me problematikat që shtrova në hyrje të këtij referimi, mund të arrij në disa konkluzione.

1. Poezia e Mjedës, në **qasje analitike**, përfaqëson *takime të tri poetikave*; romantike, neoklasiciste dhe realiste, të cilat qasen, largohen në mënyrat më të papritura dhe të çuditshme.

2. Në **plan sintetik** ajo është *një poetikë e vetme*, origjinale, e dallueshme nga çdo romantik tjetër.

3. Kjo dukuri, mjaft interesante, është shprehje e një individualiteti të spikatur, tek i cili liria e krijimit, **shpërthimi emocional sa është në mirëkuptim me vetëdijen e kërkimit të metrikës klasike, aq edhe i rrëshqet kësaj harmonie**, për t'ju nënshtruar vetëm vrulleve të shpirtit, ndjenjës së fuqishme, të situatave personale dhe të realiteteve shpirtërore të kohës.

Me këto tre tipare thelbësore, vetjake, Mjeda mbetet poet i veçantë, gjithnjë provokues për studiuesin e letërsisë.

Rexhep ISMAJLI

MJEDJA PËR ALFABETIN NË RAPORT ME JEZUITËT E TË TJERËT

Në historinë e kulturës sonë këndeje Adriatikut më kanë tërhequr vëmendjen tre poetë gjuhëtarë: Ndré Mjedja, Martin Camaj dhe Besim Bokshi. Mjedja kishte marrë formim fetar dhe filozofik në kolegjet e jezuitëve dhe kishte qenë e anëtar i rendit, më vonë jashtë tij. Camaj i kishte marrë mësimet në Kolegjin saverian, ku më herët kishte mbajtur mësimet dhe Mjedja, ndërsa më vonë kishte ndjekur shkollim universitar filologjik e lingvistik. Bokshi kishte marrë formim fillim e mbarim laik për filologji dhe lingvistikë. Mjedja ishte me frymëzim lirik refleksiv i butë dhe i thellë, me tendenca të theksuara të modelimit të vargut e të gjuhës së zgjedhur, por edhe shpërthyes në momente, që më shpesh i lë pa botuar gjatë jetës. Gjithsesi me frymëzime të thella atdhetare, shpesh i përmbajtur ndaj eksponimit pragmatik politik. Me njohje dhe ndjesi të hollë gjuhësore, studiues për brezin e tij i shquar i strukturës dhe i zhvillimit të gjuhës, filolog dhe interpretues i teksteve të vjetra, e mbi të gjitha i aspekteve pragmatike të jetës së gjuhës në bashkësinë kombëtare. Camaj po ashtu poet theksimisht refleksiv, në fillimet me frymëzime gjithësi joheroike, më vonë me zhvillime drejt shprehjes moderne të kursyer, romancier. Refleksioni dhe, do të thosha, refuzimi i heroizmit shquajnë Camajn, i cili në poezinë *Mjedjes*, të cilën patëm mundësinë ta botonim për herë të parë pas vdekjes së autorit, mtonte të kishte parë si thelbësore tek ai

“vetmitar mes njerëzve tu
shujtoheshe me frytet e heshtjes
e na solle shpinën ftoftas
mue me shokë, pa kend tonin
në një literature”,
“drojen e zbërthimit të bulzave
para ngrijes dimnore,... dhe para diellit të fortë”.

Camaj njëkohësisht merrej me historinë e gjuhës, madje me depërtime të thella në aspektet krahasimtare, studionte tekstet e vjetra shqipe, të folmet arbëreshe, gramatologjinë, mund të themi bëri një jetë të dyfishtë. Por cili ishte vokacioni i tij? Me gjithë vlerësimin e lartë për studimet e tij, pa fije dyshimi do të thosha poezia. Dilemat nuk i ushqente as ai vetë. E kam dëgjuar tek thoshte: studimet për gjuhën i kam për bukë, letërsinë e kam për shpirt. Në vrojtimet e mia, malli për vendlindjen, për atdhenë ishte buka e tij.

Poet po kështu i mendimit dhe i refleksit, madje në kohët kur ajo mungonte fare, por më vonë pa ngurrime për refleksin politik në poezi, ndryshe nga Camaj e pjesërisht nga Mjedja, linguist me aporte të dorës së parë në studimet diakronike të shqipes, me origjinalitet dhe avancim të dukshëm modernizues në studimet historike të shqipes, që ndonjëherë të kujton refleksin e përmendur të Camajt ndaj Mjedjes për “drojën e zbërthimit të bulzave para ngrijës dimnore... dhe para diellit të forte”, por tani në një aspekt më tejindividual, më të përgjithshëm, më gjerësisht politik, tek

“unë due pikën kur gurin shpon
edhe borën kur ruen tokën nga acarimi...
Ndoshta due veç hanën, që sheh gjithçka e s’flet”.

jo pa ndjenjën e dhimbjes, në dekadën e fundit të jetës, kur ishte i tëri i zhytur në hetimin e zhvillimit të shqipes në kohë kur nuk shkruhej, më kishte thënë: sikur ta ktheja kohën kur qeshë zhytur aq thellë në poezinë dhe të isha marrë gjithnjë vetëm me gjuhën.

Po Mjedja ku ishte? Nuk kam arritur ta pyesja.

Veprat si *Andrra e jetës* na thonë qartë se vokacioni i tij ishte poezia. Shija për gjuhën po ashtu. Por Mjedja nuk mbeti aty. Kureshtjen e tij e kishin zgjuar studimet e albanistëve të botës dhe qysh herët kishte marrë kontakte me Gustav Meyerin, më të shquarin ndër ta në atë kohë. Letërkëmbimi me të na tregon për një komunikim intensiv me dijetarin austriak dhe të tjerë pastaj. Disa madje nuk kanë nguruar ta quanin nxënës të Meyerit. Botimet e para i bëri, si të gjithë shkodranët e tjerë, në alfabetin e trashëguar shqip nga autorët e vjetër, por me plotësime dhe ndryshime rrugës. *Shahiri Elierz* na dëshmon për këtë. Por Mjedja e dinte se përhapja e atij alfabeti ishte e kufizuar, se shtronte dhe vështirësi leximi në raport me gjuhën e folur, etj. Ai e dinte po ashtu se në botimet shqip përdorëshin dhe alfabetet e tjerë, kishte njohuri për K. Kristoforidhin, për alfabetin e Stambollit, për

alfabetet e përdorura nga arbëreshët, për alfabetet e përdorura nga albanologët. Studiues të specializuar të çështjes, ndër ta Kastrati, Osmani, Quku e të tjerë, kanë sjellë mori argumentimesh dhe diskutimesh në këtë pikë. Me këtë rast dua të veçoj faktin se Mjedja ngulte këmbë te nevoja për krijimin e një alfabeti që do të përshtatej më shumë për gjuhën shqipe. Për këtë arsye ai vinte në përdorim dijet e tij jo të pakta në fushën e gjuhësisë. Në hullinë e praktikave që po propozonte K. Kristoforidhi me shkrimet e tij, që po sugjeronin albanologët, Mjedja shquhet me këmbënguljen për të gjetur një alfabet që do të pasqyronte strukturën e shqipes së folur në këtë kohë dhe një alfabet që do të vinte në përdorim një shenjë të vetme për çdo tingull. Atëherë nuk operohej me konceptet e fonemës dhe as të njësive funksionale në analizën tingullore, por nga arsyetimet e tij të shpërndara në letra, në diskutime apo në vetë praktikën e shkrimit, duket qartë shqetësimi i tij që çdo shenjë grafike e alfabetit të ri t'i përgjigjet një njësie tingullore pavarësisht nga kontekstet. Analizat e tij të gjuhës së folur mbështeten në të folmen e Shkodrës me rrethina, por njohjet e tij shtriheshin në hapësira më të gjera të gegnishtes, ashtu si në arealin tosk. Analizat e qiellzoreve të shqipes, që ai kishte paraqitur dhe në kongresin e linguistëve në Hamburg, ku shqyrtonte realitetet e ndryshme në këtë segment brenda hapësirave të ndryshme shqipfolëse: qiellzore përballë afrikateve, në një anë, dhe qiellzore në gegnishten qendrore dhe në toskërishten, jashtë çamërishtes, përballë grupit *kj*, *gj* apo *k*, *g* në gegnishten veriore. Për ta marrë parasysh këtë kompleks realiesh brenda shqipes ai kërkonte një zgjidhje unike: përshtatjen e shenjave *k*, *g* me një theks mbi *k̆*, *ğ* për variantet e ndryshme (në për hundoret), duke supozuar që gjithkush ta lexonte atë sipas realitetit shqiptimor që zotëron. E tërë analiza e tij mbështetet në vrojtimet në terren dhe njohjet e studimeve më të avancuara të kohës për shqipen, por edhe në sugjerimet e zgjidhjeve që mund të kishte vërejtur në traditat e gjuhëve dhe të popujve të tjerë. Kjo zgjidhje për një pjesë të kujton zgjidhjen që kishin adoptuar sllavët e jugut me *ѣ* për realitet tingullore *e*, *je*, *i*je – një shenjë, por secili mund ta lexonte sipas përdorimit të tij.

Pikë tjetër me rëndësi në diskutimet e tij kishte qenë çështja e grupeve bashkëtingëllore *mb*, *nd*, *ng*, të cilat ruheshin në shkrim tek autorët e traditës së vjetër, ashtu si te Kristoforidhi dhe stambollasit. Këtu diskutimet e tij nuk mund të mos e shtronin çështjen e realizimit të veçantë të këtyre grupeve si *m^b*, *n^d*, *n^g* (*n*) në arealin që ai njihte, e ku funksiononte si njësi e veçantë. Kemi të bëjmë pra me një analizë që aty shihte fonema të veçanta /mb, nd, ng/, çështje të cilën analizat

dhe vendimmarrjet e mëvona nuk e kanë marrë parasysh, po e kanë trajtuar thjesht si përndarje me shtrirje rajonale.

Mjedja, në shqetësimet e tij themelore për të gjetur për çdo tingull një shenjë përkatëse brenda alfabetit latin të pamjaftueshëm për realitetet tingullore të shqipes, mendonte se duhej të futeshin në përdorim, siç kishin bërë dhe të tjerë në hapësirat romane, sllave e të tjera të Europës Qendrore, mjetet diakritike: dy pikët, makroni mbi dhe në mes, theksat dhe tilda. Mjetet diakritike për shënimin e zanoreve i kishte vënë në përdorim dhe Kristoforidhi. Realitetin e vrojtueshëm të shqipes së veriut – zanoret hundore i kishin vërejtur qysh autorët e hershëm: Buzuku, i pari, për të shënuar foljen *jam* në vetën e tretë njëjës përdorte pas zanores *a* një *n* – pra *an/te* [ãʃtə] ndryshe nga *aft*, por pa qenë sistematik më tej; Bogdani kishte qenë pak më i plotë në indikacionet për hundorësinë e zanoreve, sadoqë as ai nuk ishte konsekuent, Budi nuk i shënonte fare; në transkriptimet e tij të teksteve të Bogdanit Mjedja ndiqte shënimin e hundoreve sipas shqiptimit modern që ai njihte. Kuptohet që tejshkrimit të tillë mund t'i bëhet vërejtja se nuk mbështetet në realitetet e shkruara. Por edhe këtu, Mjedja, si Kristoforidhi, kishte hetuar çështjen e gjatësisë së zanores. Ndryshe nga Kristoforidhi, që për këto qëllime përdorte sistemin e tejshkrimit fonetik të Lipsiusit, për shënimin e zanoreve të gjata përdorte makron mbi zanoren përkatëse, ndërsa për të shkurtat ~, Mjedja sugjeronte përdorimin e theksave të mprehtë për zanore të gjata, të randë për të shkurtat dhe hundor për hundoret, te të cilat sugjeronte përdorimin e tildës (*theks hundor me bisht*) për të gjatat. Kjo traditë, më vonë, ishte bërë e zakonshme në botimet geqe. Kuptohet që kjo po sillte një mundësi konfuzioni: theksat përdoren për të shënuar theksat tonikë, pra rrokjet ku bie theksi, ndërsa çështja e gjatësive të zanoreve ndërlihet vetëm me zanore të theksuara. Shpesh është menduar që mjaftonte të shënohej gjatësia dhe kuptohej se zanorja ishte e theksuar dhe e kundërta. Por këtu krijohet një ngatërrim, të cilin e kishte vërejtur S. Riza qysh te *Tri monografinat* 1944, e që ka të bëjë me çështje të fonetikës sintaksore: tjetër është theksi i fjalës, e pra edhe realizimi i gjatësisë në rrokje të theksuar brenda fjalës, tjetër është theksi i fjalisë apo sintagmës e me këtë edhe realizimi i gjatësisë apo hundorësisë. Shembuj te Riza, i cili pyeste: “ëmënat: *farë* e *zotni*, numërorin: *shtatë* dhe formën verbale: *pasë*, a do t'i shkruejmë po n'atë mënyrë në daç të jenë tonikë në daç atonë?” Ishim *shtatë* vetë. Sa? *Shtatë*. [‘ĩʃĩm ʃtāt ‘vət. ‘Sā? ‘ʃtāt. ~ ‘ĩʃĩm ʃtāt ‘vətə. ‘Sā? ‘ʃtātə.]

Zotni Gaspri është burr *zotni*. [zotni ‘gāspri āšt ‘būR zot’ nī.]

ai *farë* djali – misër për *farë*. [ai fār ‘djāli – ‘misər pər ‘fār, ose ‘fārə]
me e *pasë pasë* ndër thonj - [me pās ‘pās ndər ‘θōj, ose me pās ‘pās
nder ‘θōj].¹

I mbështetur dhe nga albanologët, si Meyer, Pedersen apo të tjerë që s’kishin si të mos e mbështesnin në parim idenë e shënimit të një tingulli me një shenjë të vetme, qoftë dhe me ndihmë shenjash diakritike, por që nuk e vlerësonin sa duhet traditën tashmë ekzistuese të kombinimit të shenjave themelore të alfabetit latin, atë që përdorte dhe shenja të veçanta, por më pak diakritike, etj. Po të hetohet mirë tradita, do të shihet qartë se mjetet diakritike, theksi që përdorej te Bogdani, ta zëmë, në tejshkrimin e vetë Mjedjes sillte paqartësi. Mjedja shënonte gjithandej zanoret hundore sipas gjendjes së kohës së tij, edhe kur Bogdani nuk kishte dhënë indikacion, ndërsa nuk e shënonte ë-në fundore të indikuar rregullisht nga Bogdani. Për më tepër, sistemin tradicional brezi i Mjedjes së *Shahirit* e kishte begatuar me theksin hundor.

Tradita e shkrimit të gegnishtes që sanksionoi Komisija Letrare e Shkodrës, e ku merrte pjesë dhe Mjedja, e që përdorte gjerësisht theksat, çka nuk ishte parashikuar te vendimi i Kongresit të Manastirit, me kohë po bëhej e larmishme, pikërisht për shkak të referimeve të ndryshme rajonale si idiomë natyrore, në një anë, po edhe për shkak të asimilimit të një elementi me një tjetër – të gjatësisë, që në vete ngërthen gjatësinë, shkallën e hapjes, intensitetin, elemente që në raste të caktuara bëhen të mjaftueshme për ta eksponuar njësinë bazë fonematike. Kështu shpjegohen variacionet dhe inkonsekuencat e mëdha që mund të vërehen në praktikën e shënimit të theksave në shkrimet letrare dhe të tjera të autorëve të shquar si Koliqi, Camaj, po edhe vetë Mjedja.

Në ndjekjen e idesë së shkrimit në vetvete të drejtë dhe shkencërisht të saktë të një njësie me një shenjë të veçantë Mjedja me Shoqërinë *Agimi* kishte përballë të tjerët me Shoqërinë *Bashkimi* brenda Shkodrës, ndërsa në Kongresin e Manastirit që pikërisht ai që ndërmori hapin e kompromisit vendimtar: të idesë së përdorimit të dyshkronjëshave, ide që merrte parasysh kapërcimin e hendekut midis dy shoqërive nga Shkodra dhe njëherësh afrimin me ata që mendonin se kjo ishte më praktike dhe që afrohej me stambollasit. Edhe përtej vendimit që kishte formuluar vetë në Konferencën e ipeshkvijve më herët.

¹ Riza (1944), S.: *Tri monografia albanologjike*, Tiranë, rimarrë te Riza (1996), S.: *Vepra* 1, ASHAK, Prishtinë, f. 50-51.

E gjithë lufta për shenjat diakritike, që përdorëshin për njësitë themelore, e që u sanksionuan për rastin e dypikëshit dhe të sedijës, nuk ishte krejt e rastit. Gjuhëtarë si Mjedja nuk mund të mos e hetonin peshën e realieve që kërkonin të ekspononin ato shenja: fjala ishte për sistemin e gjatësive natyrshëm të ndërlidhur me çështjen e theksit dhe me sistemin e hundorësisë, po ashtu të ndërlidhur me gjatësinë. Gjatësia e zanoreve dhe hundorësia e kishin ndjekur si probleme edhe traditën e shkrimit shqip qysh nga autorët e parë. Hundorësia vetëm sa kishte arritur të jetë e indikuar te Buzuku, pak më shumë te Bogdani, ndërsa theksohej tek vazhduesit në sh. XIX, nuk mund të ishte problem për shkrimin toskërisht. Gjatësia, siç pamë, ndërliqej dhe me çështje të theksit, theksit të fjalës dhe theksit të rrjedhës së folur, dhe kështu më vete sillte një qerthull ndërlikues, jo lehtë të zgjidhshëm për përdoruesit e zakonshëm, shpesh edhe për të diturit. Jo rastësisht ato nuk u theksuan në vendimin e Kongresit të Manastirit, ndërsa u zhvilluan gjerësisht në traditën shkrimore midis dy Luftërave Botërore. Në fakt edhe vetë brenda gegnishtes po hetoheshin tendenca drejt lëkundjes së sistemit të gjatësisë dhe të hundorësisë – kishte zona, sidomos në qytete, që po e birnin hundorësinë, ndërsa gjatësia nuk ishte më vendimtare. Te P. Budi, në vargje metrikë gjatësia luante rol me rëndësi, natyra dymorëshe e zanores së gjatë interpretohej si dy rrokje, çka nuk ngjante më tek autorët e sh. XIX. Komunikimi me hapësirat e tjera sillte dhe realitetin e mungesës së gjatësisë dhe të hundorësisë në arealin jugor. Të gjitha këto, me ose pa vetëdije, ndikuan që përparësi t'i jepej një sistemit maksimalisht të përbashkët, çka do të thoshte gjithësesi të reduktuar në raport me realitetin e gegnishtes, sa u përket zanoreve. Nga ana tjetër, në fushën e bashkëtingëlloreve u krijua hapësira e plotë për optimumin e njësisë që ndesheshin në gjuhën e gjallë. Shprehja e tyre me dyshkronjësja qe kompromisi i Mjedjes.

Po të krahasojmë mënyrën e shënimit të Mjedjes të proverbave që sjell Quku me shënimin e tyre nga Meyeri, do të hetohen ndryshime po ashtu.

Në këtë vorbull tendencash të përgjithshme, Mjedja nuk mund të mos luante një rol me rëndësi përmes praktikës së shkrimeve të tij – më pak poetike, më shumë të teksteve për shkolla, laike e fetare, sidomos përmes botimeve të shumta të jezuitëve. Pas Komisionit Letrar, vendimet e së cilës qenë bërë zyrtare në Kongresin e Lushnjës, e për të cilat vetë Mjedja kishte dhënë ndihmesë me vlerë, në jetën praktike u shtrua nevoja e zbërthimit të mëtejshëm të atyre vendimeve të përgjithshme, e plotësimit me rregulla të reja. Kështu në Ortografinë e parë në

vijim, atë të Adon Aldeghierit, që ishte prodhim i konsultimeve në grup, lindën disa probleme. Aldeghieri bënte eksplicite ndonjë prej tyre. Po përmendim rastin e ë-së, sa për të ilustruar shkallën e konfuzionit që sundonte. Rregulla e përgjithshme e Komisisë “gjuha do të shkruhet ashtu si flitet sot prej popullit” dhe “si themel i orthografisë do të mirret djalekti i Elbasanit me disa përmirsime”, që do të thotë “disa ndryshime typike, qi u përkasin formavet etymologjike të fjalëve të ruejtuna mâ mirë në djalektin tosknisht e në disa nendjalekte gegnishte”, nuk i mjaftonte. Kështu përdorimi i ë-së “në rrâjë të fjalëve”, në & 7 “të shkruhet aty ku e lypë etymologjia e ku shqypothet në tosknishte” i dukej rregull e papërshtatshme për gjithkënd dhe për nxanësa. Si zgjidhje ai shihte fjalorin, por meqenëse të tillë nuk kishte, “kishte me këne nevoja me kndue librat e Toskve, per me dijtë, sado pak, kû eja pazane shqypthohet në tosknishte”. Pakënaqësinë ai e shprehte përmes një citimi të F. Konicës: “gegët kan marrín mos me e perdorue aspak ë; Toskët kan marrín me e perdorue edhë atý kû s’âsht nevoja”. Prandaj ai e shihte nevojën të sillte shpjegime sipas kategorive gramatikore për lakimet e zgjedhimet.

Në pika të tilla Mjedja nuk kishte të njëjtin mendim dhe ndiqte një drejtshkrim të tij, që nuk është sanksionuar askund, por që mund të nxirret nga praktika, prandaj, kur ai erdhi mësues gjuhe në Kolegjin Saverian, pushoi së përdoruri Orthografija e Aldeghierit.

Në fakt Mjedja kishte qenë aktiv dhe më i ndërlikur në proceset e formimit të mendimit për shkrimin, drejtshkrimin dhe gjuhën e shkruar seç mund të shihet vetëm nga vendimet. Janë dy nyja që më duket se duan diskutuar ende.

Nga korrespondenca e Mjedjes me G. Meyerin dhe nga shkrimet gjuhësore që ka botuar Mjedja, është avancuar përfundimi se ai kishte bërë një fjalor etimologjik dhe një gramatikë historike të shqipes. Nuk ka dyshim se Mjedja kishte interesa për etimologjinë, çka shihet qartë jo vetëm nga letërkëmbimi me Meyerin, po edhe nga disa botime me interes nëpër faqet e shtypit të specializuar të kohës. Studimi për nyjat dhe për përemrat, po ashtu flet bollshëm në të mirë të këtij interesi. Studiues këmbëngulës të Mjedës, si Quku, kanë avancuar idenë që Mjedja mund të kishte hartuar një fjalor etimologjik dhe një gramatikë historike-krahasuese, të cilat, madje, duan kërkuar eventualisht nëpër dorëshkrimet e lëna pas vdekjes së Meyerit. Nuk kemi mundësi të spekulojmë më tej, por avancimi tjetër që mbi supozime të këtij lloji e shpall Mjedjen autor të Promemories për një gjuhë të përbashkët letrare mbi bazë të elbasanishtes, të botuar nga R. Nahtigali më 1917 nuk më

duket se qëndron. Argumenti se Nahtigali nuk dinte shqip nuk është kaq lehtë i pranueshëm. Nahtigali, siç ka shkruar gjerësisht Jokli me të gjallë të Pekmezit, mbahej si bashkëndihmues themelor në hartimin e Gramatikës së këtij të fundit qysh më 1908 dhe kishte vazhduar të merrej me këto çështje. Kishte bërë studime të thelluara për alfabetet e përdorura në Elbasan dhe kishte njohuri për shqipen. Mbi të gjitha ishte gjuhëtar i kalibrit. Ishte kundërshtar i kërkesës për të vënë në bazë të gjuhës së përbashkët shkodranishten, të mbrojtur nga M. Lambertzi, dhe gati fanatik i idesë për elbasanishten si bazë. Megjithë formimin dhe njohjet e mëdha të Mjedjes për çështje të gjuhës, megjithë bindjet e tij rilindëse për afrimin sa më të madh me toskërishten, nuk mund të thuhet se ai ishte bërë partizan i bindur i elbasanishtes, sidomos jo nëse hetojmë nga pak gjuhën që përdorte ai vetë, ku shkodranizmat janë gjithandej. Në botimin e Nahtigalit të vitit 1917, *Promemoria* paraqitet si e tij, ndërsa sqarohet si ishte firmosur dhe nga Mjedja e Pekmezi. Mjedja në Komisinë Letrare të atij viti kishte paraqitur përkthimin shqip të tekstit gjermanisht të Nahtigalit. Për më tepër, të gjitha këto kishin ndodhur me të gjallë të Mjedjes dhe po të kishte qenë ai hartues, do ta gjente rastin të reagoonte ndaj një përvetësimi të atillë. Nga ana tjetër, Nahtigal mbahet dijetar me integritet të lartë shkencor e etik, aq të lartë sa të mos i lejonte vetit në asnjë mënyrë eventualitete të atilla. Nuk ka dyshim se Mjedja dhe Pekmezi do të kenë biseduar me të për të gjitha çështjet, do të kenë shprehur dhe ide që mund të kenë ndikuar te formësimi përfundimtar i ideve të Nahtigalit, por kjo është diçka tjetër.

Në raport me jezuitët do rikujtuar se ai kishte hartuar tekstin për vendimet e Konferencës së ipeshkvijve, që avanconte përdorimin e alfabetit pa dyshkronjësha. Më vonë në Kongresin e Manastirit kishte bërë kompromis me këtë pikë. Në Komisinë letrare ishte pajtuar me vendosjen e bazës tek elbasanishtja, por në shkrimet e tij nuk i kishte rrafshuar shkodranizmat tingullorë dhe leksikorë. Mund të jetë që sa i përket përdorimit të *ë*-së të kishte ruajtur dallime ndaj jezuitëve dhe *Ortografisë* së Aldeghierit. Mjedja mbronte idetë afruese midis krahinave e dialekteve, por edhe ruante individualitetin që vështirë se e zhvendos nga baseni i Shkodrës. E ruante dhe ndaj jezuitëve. Gjuha e përdorur në poezi, po edhe në prozat e natyrës fetare apo gjuhësore këtë dëshmon.

A ishte Mjedja në radhë të parë poet dhe pastaj të tjerat? Përfundimisht mendoj se po. Mjedja u mor me shumë gjëra, me hartimin e teksteve mësimore, me meshtari, me studime gjuhësore e folklorike e shumë gjëra të tjera. Formimi që kishte ia bënë të mundur të arrinte një nivel dhe cilësi. Linguist ai ishte vetëm pjesërisht.

Dhurata SHEHRI

STINËT E MJEDJES

Ndre Mjedja në vitin 1904 nis botimin e një cikli librash për shkollat e të gjitha diogjezave katolike shqiptare, një projekt i financuar nga qeveria Austro-Hungareze, shtypur në Vjenë me alfabetin e Mjedjes (Agimit) të aprovuar më 1902 në Konferencën e Ipeshkëve. Në Librin e *Këndime per Shkollë të para të Shqypëniësë*, pjesa e parë, në kapitullin *Këndime* shfaqen mes të tjerave edhe katër poezi për stinët. Poezitë në të katër rastet vijnë pas një shpjegimi në prozë për secilën stinë, si për shembull:

“Dimnit toka është thatë, pa bar e pa gjeth. Vjen prëndvera e me j’herë mungullon bari e dalin lulet. Pëmët veshen me gjeth e mbushen me lule edhe ato.”¹:

Prëndvera dhe *Vera* titullohen dy poezitë përgjegjëse për secilën stinë, ndërsa poezia pas përshkrimit të Vjeshtës titullohet *Dallëndyshes* e ajo pas përshkrimit të Dimnit titullohet *Dimni e plaku*.

Në vitin 1917 kur boton për herë të parë *Juveniljen*, Mjedja përsëri boton katër poezi për stinët: *Prëndvéra*, *Véra*, *Vjeshta* e *Dimni*. Tre nga katër poezitë për stinët në botimin e *Juveniljes* ndryshojnë nga botimi i *Këndimeve* dhe e katërta, *Dimni dhe plaku* ndryshon titullin.

Në botimet e mëpasme të veprës së Mjedjes², sidomos në përmbledhjet e botuara pas vitit 1944, variantet “për të vegjël” të këtyre poezive zhduken. Në ndarjen “Vjerrsha për të vegjël” nga Mjedja, në të gjitha botimet e realizmit socialist mbijeton *Prëndvéra* e *Juveniljes*, zhduket *Prëndvera* e *Këndimeve*. *Vera* e *Këndimeve* botohet pa strofën e fundit, përfaqësuesja e Vjeshtës të *Këndimet*

¹ *Këndime për Shkolla të para të Shqypëniësë*, f. 111, botimi 3, Vjenë

² Po citoj vetëm dy, Ndre Mjedja, *Juvenilja dhe vepra të tjera*, Tiranë 1964; Ndre Mjedja, *Vjerrsha për të vegjël*, Tiranë 1967.

(poezia *Dallëndyshes*) zëvendësohet me *Vjeshtën e Juveniljes*, por edhe kur shfaqet poezia me këtë titull i hiqet strofa e fundit. Poezia *Dimni e plakut* botohet me të drejtë me titullin *Dimni*, vullneti i fundit i autorit (1917).

Diferencat mes poezive të stinëve “për fëmijë” dhe ciklit të stinëve të *Juveniljes* janë të mëdha dhe të thella. Thelbi mbetet diferenca mes të dobishmes në natyrë dhe të bukurës si artefakt, mes përshkrimit të natyrës si e dhënë e vlerës së saj të përdorimit dhe emocionit njerëzor mbi natyrën si kontemplim, si bashkëpërkim me stinët e jetës njerëzore.

Poezia *Prëndvera*, tek *Këndimet* është më shumë fotografim i llojit “vëre atë që është”, i gjendjes së natyrës dhe e njeriut që shfaqet në harmoni me të, fillimisht në figurën e plakut që del me u nxeh e pastaj të bujkut që punon me zell. Pjesa e dytë e poezisë nga vërejtëse, si e mirë e dhënë, shndërrohet në urdhëruese për të njëjtat subjekte të përfshira: bylbylat, bletët, tëneglat, bujkun e plakun ku urdhërorja lidhet funksionalisht me “muzën bonare”, me pedagogjinë siç e quante Croce.

- “këndoju bylbylat ndër ograja”³ (pjesa 1)
- “këndo bylbyl m’b at gjuhën t’ânde - (pjesa 2)
- “dalin tëneglat për mel” (1) - “mos u lodhni tënegla aspak”(2)
- “del prej zgojsh e censhmja bletë”(1) - “flutro blet’gjith kah të kânde” (2)

Duket sikur gjithçka varet nga vullneti i zërit urdhërues, që në strofën e fundit të poezisë e mbyll didaskalinë me një vullnet sipëror të versionit: po u binde për urdhrin që po merr do të shpërblehesh:

“Puno, bulk, puno; hitija
Ka me t’dhân’ jet’ e pështim;
Vet’ prej qielle Perëndia
T’çon ma t’dashtunin bekim”.

Ndërsa në poezinë *Prëndvéra* të *Juveniljes* nuk i flet natyra poetit po poeti natyrës.

“Jeni lodhë, dallëndysa t’shkreta”
Jé molis’ i ziu bylbyl”⁴

³ Të gjitha citimet e poezivë të ciklit të stinëve për fëmijë janë marrë nga *Këndime për Shkolla të para të Shqipërisë*, f. 111-116, botimi 3, Vjenë.

Natyra është e bukur se subjekti kontemplues e sheh si të tillë: Mjafton të vërehet dallimi mes përshkrimit të tokës te:

Prëndvera e Këndimeve:

“Mal e fush â gjith blerim”

dhe përqendrimit të poezisë tek subjekti i thënies në poezinë *Prëndvera e Juveniljes*:

“E **nen borë** po shpërthejn’ lulet

Porsi fëmië qi zblohen n’djep

Fllad i lét me **vapë dashtnijet**

Puthi pëmen gëmb per gëmb

U zgjue pëma, e qe prei **shijet**

Buloj mbarë neper kopshtë t’em.”

Shenjat e subjektit duken tek ndërtimi i figurës: *nen borë po shpërthejn’ lulet* (poeti i sheh ende pa shpërthyer); te metaforat *vapë dashtnijet*, *puthi pëmën*, *u zgjue pëma* deri te krahasimi *porsi fëmië qi zblohen n’djep*. Ky krahasim tek *Andrra e jetës* do të bëhet shenjë e fortë e ndërtimit total të botës prej subjektit poetik, e natyra do të mbetet thjeshtë dekor⁵:

“Por s i giet qielli

Nuk i giet prilli

As fllad qi shetitë lulet

E me érna veshet

Foshnjes qi i qeshet

Nanës, kur mbi te përkulet.”⁶

Edhe këndi nga konteplohet natyra në poezinë e Juveniljes ndërron kah, nga tokë- qiell tek *Prëndvera e Këndimeve* në qiell- tokë (nga dallëndyshet e bylbylat deri tek *kau që bërlyket*). Vetëm strofa e fundit *Prëndvërës së Juveniljes* mbart shenjat e urdhërores që i gjejmë të forta e në funksion të të dobishmes te *Prëndvera e Këndimeve*:

⁴ Ndre Mjedja, *Juvenilia*, f. 64, Vjenë 1917

⁵ Sabri Hamiti, në *Mjedja*, vepra 1, f. XIX, Rilindja, Prishtinë

⁶ Ndre Miedia, *Juvenilia*, f. 40, Vienë 1917

“Vrapo bulk, ku puna t’thurret”.

Dallimi në dy variantet e *Verës* është më esencial. Të njëjtë, të dyja poezitë kanë fatin e botimit: të dyjave u është hequr strofa e fundit: “me të drejtë” *Verës* së *Juveniljes*, po krejt çuditshëm *Vërës* së *Këndimeve* pasi duket se vlera moralizuese e kësaj strofe ka pak gjasa të bjerë ndesh me “moralin socialist” të kohës së censurimit. Po e citoj:

“Nji ky mund qi shkon sa ndora
Ka m’u ndërrue shpejt n’pushim:
Kur t’vijë akulli e t’bjen bora
Prej këtij mund do t’keni pështim.

Ndoshta edhe vetëm përmendja e “pushimit” është e papranueshme për moralin socialist të punës?

Përveç fatit të përbashkët të cungimit, në pamje të parë duket sikur edhe personazhet e ambienti janë të njëjta në të dy variantet e poezive, madje edhe fjalori e ngjyrat. Tek të dyja kemi diell, ara, drithë, korrës, vapë dhe një vajzë. Ngjashëm me *Prëndverën* e *Këndimeve*, shkrimi është përshtues e moralizues edhe tek *Vera* e *Këndimeve*, ndjehet edhe urdhërorja “pedagogjike”, por shenjat e subjektit janë më të forta se te *Prëndvera* e *Këndimeve*:

“Mbrini vera tuj **flakrue**”
“Arët u banë t’gjitha **n’shend**” –

ku metaforat antropomorfike e përfshijnë dhe theksojnë këndin e subjektit; por edhe si prani gramatikore

“dorca, dorca **m’a** vendo”.

Në *Vërën* e *Juveniljes*, duket sikur pamja është po ajo: një arë, njerëz që korrin grurin nën vapën e diellit, por ka ndërruar gjithçka: vera nuk është më stina e mundimshme ku të mirat e tokës janë edhe fryt i mundit të njeriut e shpërblim i punës së tij:

“Ndën vap’ t’diellit me hiti
Shko ti, o vajz, o grue shko:
Tuj korr grunin me çallti
Dorca dorca m’a vendo.”

Vëra e Juveniljes bëhet stina e vdekjes si maturim, si të qenët gati (“e ka goditë”), si pjekje, që të kujton mitologjinë e perëndeshës së vdekjes përfaqësuar me kallëza gruri apo me kosë në dorë (do të shfaqet në trajtë mashkullore tek poezia *Dimni*: “Po del dimni me kosë ndorë”).

Vëra, vëpa, e verdha, vetmia, vdekja janë fjalët çelës të kësaj poetike të “pjekjes” a maturimit. Topika e vdekjes bëhet vatra kuptimore e jetës në harmoni me natyrën e me Zotin në poetikën e Mjedës dhe përvijohet si thelb i pashmangshëm i të vërtetës hyjnore e njerëzore që me vdekjen nuk përjeton fundin për përtëritjen e jetës. Ngjyra e verdhë e natyrës përfaqësohet si përmes përmendjes së drejtpërdrejtë

“A zvérdhë fusha”

ashtu edhe përmes metonimisë

“Pa u kujtue si dielli i dogj”

duke kujtuar se komponenti njerëzor i kësaj pamjeje që na shfaqet në strofën e parë është i bërë njësh me natyrën:

“vëlojnë korrcat porsi zogj”.

Kur vështrimi zbret nga lart poshtë, por edhe kur njerëzorja nuk është më kolektivitet por individ,

“Veç n’at arë, porsi një e tretun”

ndryshojnë edhe ngjyrat. E verdha dominuese e strofës së parë kontraston me të zezën e strofës së dytë.

“Zi ndër petka e n’fityrë terr”

Kontrastin e ngjyrave e përforcon kundërvënja e zërit kolektiv me heshtjen individuale:

“vëlojnë”, “këndojnë” – në strofën e parë

“Korrë një cucë pá shoqe, vetun

Me hije t’vet qi mbrapa e merr” – në strofën e dytë.

Strofa e fundit e poezisë që mungon në botimet e poezive të Mjedjes gjatë periudhës së realizmit socialist në Shqipëri e shfaq pastërtisht thelbin e vdekjes si maturim i individit, si kondicion i domosdoshëm afrimi me Perëndinë:

“Kjenë një arë qi muell një ditë
 Perëndia, e i dha shëndet;
 U poq para: e ka goditë
 E e⁷ ka bajtë te shpija e vet.”

Tek *Andrra e jetës* ndryshon figura, por jo thelbi:

“Rri, bij se sunte Trinka
 Po shkon me bujt te Zoja”

Tema e vdekjes rikthehet edhe tek vjersha *Dallëndyshës* e cila radhitet në librin e *Këndimeve* pas një pjese në prozë që përshkruan vjeshtën, si në të katër poezitë e stinëve. Pjesa prozaike mbyllet kështu:

“Në vjeshtë zogjt, qi janë t’ardhun, nisen e shkojnë për dhena tjera, ku është dimni më i butë, me këthye përsëri në prendverë.”⁸

Pas këtyre rreshtave teksti i *Këndimeve* vijon me poezinë *Dallëndyshës* e cila në botimet e mëpasme të shkrimeve të Mjedjes për të vegjëll del si poezi më vete dhe në vend të saj tek cikli i poezive të stinëve vendoset poezia *Vjeshta* marrë nga *Juvenilja*. Por edhe vetë poezia *Dallëndyshës* në të gjitha botimet pas vitit 1945 del pa strofën e fundit të saj:

“Ndoshta ‘j kryq, kur t’vinë prëndvera,
 Ke me gjetun mbi këtë truall;
 Përmbi të, dallëndysh’ e mjera,
 Ndalë ‘j herë, se fati t’ suell.
 M’lut pushim, mb’at gjuh’qi ke
 Mojt dallëndysh’ shtegtare e re.”⁹

Pikërisht kjo strofë që mungon shpjegon edhe arsyet e zëvendësimit të kësaj poezie (*Dallëndyshës*) me variantin *Vjeshta* që shfaqet tek *Juvenilja* në botimet gjatë realizmit socialist. Po t’i analizojmë të plotat, siç shfaqen në botimet origjinale, poezitë janë të ngjashme me njëra-tjetrën, aq sa mund t’i konsiderojmë variacione të së njëjtës temë. Në të dyja ideja e shtegtit, largimit të përkohshëm të shpendëve lidhet me largimin nga jeta të njeriut. Ndryshon forma metrike: 3

⁷ “E i ka bajtë te shpija e vet” – këtë formë ka vargu në botimin e 1917. Duhet të jetë gabim shtypi.

⁸ *Këndime...*, f. 114

⁹ Po aty, f. 115

sestina tetërrokëshe tek *Dallëndyshës* dhe katër katrena pesërrokëshe tek *Vjeshta*; ndryshon ritmi, ndryshon toni, ndryshon veta.

“Qe Shtatori tash mâ mbrini
E pa **m**’lanun nuk po ndale” – *Dallëndyshës*

“Dhe **ju** po shkoni
Bylbyla kshtu!
Po tretni këndenaj
Dallëndysha, **ju**! – *Vjeshta*

Dhimbja e përqendruar tek subjekti, shprehur përmes trajtës së shkurtër *m*’, tregon një ndodhi të kryer, të cilën poeti thjesht e vajton por nuk habitet. E njëjta trajtë përsëritet në të tri strofat e poezisë *Dallëndyshës*, në të gjithë udhëtimin imagjinar të dallëndyshes përshkruar nga subjekti lirik (nisja-strofa e parë; shtegtimi- strofa e dytë, rikthimi- strofa e tretë): “E pa **m**’lanun nuk po ndale”; “Me **m**’ankue, dallëndyshë shtegtare”; “**M**’lut pushimin, mb’at gjuh qi ke”. Poeti vajton udhëtimin, largimin, vetminë si fatalitet që pritet të ndodhë, si kthim që nuk do të jetë më nisje për të.

Vjeshta nis me një habi të transferuar përmes përemrit vetor *ju* i cili përsëritet dy herë e forcohet deri në paralajmërim në strofën e dytë:

“Dekën mendova
Se m’vjen kur do;
Se m’leni vetun
S’mendova jo”

Nëse në poezinë *Vera* vdekja është thelb maturimi, kusht e kryerje për një udhëtimi a nisje, te *Dallëndyshës* ajo fillimisht është frikë nga vetmia, dhimbje për vetminë, më pas e për pasojë, pushim e prehje. Udhëtimi është pa kthim, si në një pjesë të madhe të poezive të Mjedjes.

“Ndoshta j’kryq, kur t’vijë prëndvera,
Ke me gjetun mbi ket truell” – *Dallëndyshës*

Te poezia *Vjeshta*, botuar 13 vjet më vonë, kur Mjedja i ka kryer të gjitha shtegtimet, ideja e vdekjes dhe kthimit përmbushet me simbolin e çerdhes, rinisjes së jetës, që mungon te poezia *Dallëndyshës*:

“Ndoshta, kur t’ktheni
Mue vorri m’ba”
E ju kërkoni
Çerdhen qi s â – *Vjeshta*

Pastaj vjen Dimni... *me kosë ndore.*

Bardhyl DEMIRAJ

Ilir. *Bassania*

Titulli i kumtesës sonë është në thelb edhe objekti i saj e të dy së bashku përkujtojnë Jubilarin tonë këtu e 80 vjet më parë në një vëzhgim të tij të thukët e me të njëjtin titull në revistën „Leka“ (VII, nr. 6 [1935] 242-3). Aty Mjeda fokusohet në shpjegimin gjuhësor-historik të disa varianteve që dëshmon toponimi, më saktë oikonimi sot zyrtar *Pllana* krahas *B(ë)dhana*, *P(ë)dhana* e *Pedana*, si emërtime (dikur) popullore të atij fshati kodrinor më të djathtë të rrjedhës së poshtme të Matit, thuajse përballë me *Milotin* më të majtë të tij (sh. Shtojcë: I). Duke qëmtuar variantin *Bëdhana* si formë anase dhe parësore e këtij oikonimi, Mjeda përsiat si të mirëqenë një vijimesi të pandërmjetme në traditën gojore brezpasbrezi të oikonimit pas gjase me burim ilir *Bassania*, i regjistruar si i tillë në analet e historisë së antikitetit: (lat.) <Bassania>, me banorët e vet: (lat.) <Bassanitae> (Liv. XLIV 30 7, 8, 13-15).

Asgjëmangut, kemi të bëjmë me një temë në dukje krejt anësore në aktivitetin intelektual poliedrik të Ndre Mjedës,¹ por që ka interes të mirëfilltë shkencor, sepse parakupton si e tillë një hulumtim albanologjik të natyrës ndërdisiplinore, ku ndërliiden në boshtin kronologjik vëzhgime të mirëfillta në fushat e dialektologjisë e të gjuhësisë historike-krahasuese, sikurse edhe në ato të arkeologjisë e të historisë të antikitetit në përgjithësi. Gjithashtu nuk gabojmë aspak, po të mëtojmë paraprakisht që kjo temë a tematikë edhe pse anësore, nuk është aspak rastësi në personin e Mjedës, sepse vërejmë të ketë shoqëruar në vazhdimësi angazhimin social dhe krijimtarinë e tij letrare,

¹ Përpos këtij botimi, mund të citojmë edhe një punim të dytë po aq të shkurtër të tij po në revistën „Leka“ VIII, nr. 9 [1936] 419-420: „Dromca toponomastike: Zeta (Zedda, Zenta, Centa, Cetta, Genta, Senta).“

duke u shfaqur herë pas here e rast pas rasti si në atë letërkëmbim e tij (të gjymtë) të viteve '90 të shek. XIX me albanologun e njohur Gustav Meyer² ashtu edhe në poezitë e tij, ndër të tjera: “Giuha shqype”, “Lissus” apo “Scodra”, ku vihet gjithnjë theksi në lashtësinë e etnosit shqiptar, përkatësisht vazhdimësinë etnike-gjuhësore iliro-shqiptare.



Harta 1: <Bassania> dhe Pëdhana (Burimi: Stadtmüller 1966: Römische Spuren in Albanien)

² Shih së fundi Quku 2006 206vv., 427vv., 493vv.

I përfundojmë këtu këto fjalë hyrëse, duke i përcjellë tash lexuesit edhe synimin tonë modest, që ka të bëjë në radhë të parë me verifikimin e atyre zgjidhjeve që ofron Mjeda në këtë vëzhgim historik-toponomastik, duke i përqasur ato edhe me sosh në debatin shkencor bashkëkohor, pra pa u anashkaluar aspak qoftë shkallës së sotme të njohjes në shkencat historike, ashtu edhe parametrave shkencorë-metodologjikë që parakupton ndryshimi i paradigmës përgjithësisht në shkencat historike-albanologjike në kohën tonë.

2. Larmia e varianteve në fokusin e dialektologjisë dhe të kujtesës historike-popullore

Në këtë shkrim, Mjeda i përcjell lexuesit në një paragraf të vetëm larminë e varianteve të këtij oikonimi, së bashku me kumtin përkatës lidhur me vendndodhjen e ngulimit shqipfolës me këtë emër në bregun e djathtë të rrjedhës poshtme të Matit (Shtojcë: I), si edhe me do copëza të jetës materiale së dikurshme e marrëdhënieve sociale në të, të fiksuara si të tilla në kujtesën historike-popullore të kohës, si vijon:

“[...] N’atë vënd kû Kiepert-i [shih më poshtë – B.D.] ká vû “Bassania”, shtrihet mbí një kodrë në breg të lumit të Matës, shi kû áisht bálli veruer i urës së Zogut, një katund qí vëndi vetë e katundet e aferta i thonë *Bdhanë* (Bëdhanë); e vëndet mã të largëta: *Pdhanë*, *Pllanë*. Misionarët e huej e kjujejshin *Pedana*; e, kúr flitshim me ta, edhë na Shqiptarët i thoshim ashtû, me jau bâ *qéfin* të shkretvet, e qí ta merrshin vesht mã mirë. Populli kallxote punë të mëdhá për ketë katund; e sod 36 vjet D. Ndue Melgushi (D. Ndue Cubi) qí kishte kalue 70 vjett, thote se aj njihte shtatqind troje mb’atë kodrë; ishin mullîj, rrenime shpijashsë mëdhá, rreshta shpijash si me pasë kênë *pazarë*; e se të moçmit kallxoshin se ató, si në sá vënde tjera, mica prei një skâji së kodrës kalote kulm mbë kulm në skâjin tjetër. Gurët e rrënimevet kanë hi ndër ndertesa shpijash të réja, por mã fort në godí të rrugës së madhe qí pat çilë Austrija.” (f. 242)

Në rast se fokusohemi tash në larminë e varianteve popullore që renditen në pjesën e parë të këtij paragrafi, nuk do ta kemi assesit të vështirë të kuptojmë që Mjeda anon të veçojë variantin anas *Bdhanë* < (*)*Bëdhanë* si formën më të hershme të këtij oikonimi, përkatësisht – siç do t’i rikthehemi më poshtë – si atë fjalëformë që qartëson një lidhje të pandërmjetme me gjegjësin antik *Bassania*, të regjistruar si të

tillë për herë të parë e të vetme prej historianit romak Titus Livius (shek. I e.j.).

Parë nga perspektiva e sotme e gjuhësisë dhe e dialektologjisë historike të shqipes, sigurisht që duhet t'i bashkohemi përsiatjes së Mjedës në përzgjedhjen e një varianti parësor popullor ^(*)*Bëdhanë* (= [bə.'ða.nə] – si formë në fakt e padokumentuar me shkrim, por e rindërtuar bindshëm me forcë argumenti), që i paraprin variantit ndërkohë anas *Bdhanë*, i cili në “vëndet mâ të largëta” tingëlloka, sipas tij: *Pëdhanë*, *Pdhanë* e *Pllanë*. Lejohemi të sqarojmë me këtë rast, se të dyja variantet dytësore dëshmojnë në radhë të parë çzëshmim të mbylltores nistore si rrjedhojë e një procesi disimilimi krejt të natyrshëm regresiv qoftë edhe në distancë: /pð°/ ~ /pəð°/ < /bð°/ ~ ^(*)/bəð°/; ndërsa ndërndërrimi /ð/ ~ /ʎ/ në variantin e sotëm zyrtar *Pllanë* është një dukuri sporadike por e rëndomtë dialektore në gegnishten veriperëndimore. (Gjinari 1989 174) Përndryshe rrëgjimi i rrokjes së patheksuar nistore është një dukuri e përhapur gjithkund në arealin gegë, sidomos në shtresat e hershme të leksikut të shqipes, khs. lat. *camisia* > shq. *këmishë*, geg. dial. *kmishë*, *kmīsh*.

2.1. Varianti zyrtar *Pllanë*

Sa i përket variantit dytësor, por sot zyrtar *Pllanë*, jemi të detyruar të bëjmë ndërhyrje të rastit, meqë ky emërtim nuk duket të jetë krejt i huaj në toponomastikën e Shqipërisë së Veriut, ku e ndeshim të regjistruar si përbërës emërtimi gjeografik, khs. oron. *Maja e Pllanës* në Malësi e Madhe dhe Tropojë (Cikuli et al. 2002 223), ku përballemi pas gjase me një ndikim sllav në kuptimin “maja e malit”, khs. edhe oronime të kësaj natyre në Mal të Zi dhe Serbi në variantet *Plana*, *Plana Gora*, apo varianti sllavisht i *Maleve të Sharrit* si *Šar Planina* e gjetkë, ku varianti i zgjeruar *Planina* na shfaqet gjithkund në hapësirën sllavishtfolëse në Ballkan dhe në Europën Lindore me kuptimin “malësi; vargmal”.

2.2. Varianti “i pazakonshëm” *Pedana* në ligjërimin e thjeshtë popullor

Jo më pak interes në hetimin induktiv-diakronik shfaq pa dyshim varianti më i rrallë *Pedana* (= [pe.'da.na]), të cilin Mjeda ua vesh në zanafillë misionarëve apostolikë të huaj (kryesisht italianë), andaj vetëm “kúr flitshim me ta, edhë na Shqiptarët i thoshim ashtû, me jau bâ *qëfin* të shkretvet”. Kemi të bëjmë edhe në këtë rast me

përsiatje të vetë autorit që vetëm gëzojnë tumirje përkatëse për nga perspektiva e sotme gjuhësore e sociolinguistike, pasi nuk përballemi aspak me një dukuri dialektore krejt anësore të shqipes, por thjesht dhe vetëm me përshtatje automatike nyjetimi ndaj tingëllimit funksional më të afërt, sikurse edhe ndaj rregullave fonotaktike të fiksuara në kapacitetet nyjetimore të organit të të folurit, përkatësisht syresh perceptive në ndërgjegjen gjuhësore të njërit apo tjetrit folës jonativ të shqipes. E njëjta situatë edhe në hartografinë e shek. XIX, khs.:



Harta 2: <Pedana> në hartën e “Turqisë europiane” (Burimi: Kiepert 1853)

2.3. Variant tjetër regjistrimi në letërsinë shkencore të kohës: *Pezana*

Larmia e varianteve të cituara më lart dokumentohet deri diku qartë edhe në letërsinë shkencore të kohës, ku kemi mundur të fiksojmë deri sot krahas varianteve *Pedana* (Kiepert 1853; Hahn 1869 200) e *Pllana* (Ippen 1907 66) edhe variantin *Pezana*: (pas gjase) [pe.'za.na]. Këtë variant të fundit mëtojnë ta kenë përjetuar si dëshmitarë okularë, më saktë auditivë, Praschniker dhe Schober (1919 84³). Po të marrim tash në analizë edhe këtë variant të fundit, nuk bëjmë gjë tjetër, veçse përforcojmë me një argument shtesë gjykimin e

³ Praschniker & Schober *loc. cit.* shën. 132: „So hörten wir den Ort nennen“ [= kështu dëgjuam të quhej vendi – B.D.]

mprehtë të Mjedës lidhur me atë variant “të pazakonshëm” *Pedana*, sipas të cilit varianti primar *Bdhanë* < *Bëdhanë*, sidomos ndërdhëmborja frikative e zëshme <dh> = [ð] në trup të fjalës – si tingull funksional karakteristik i shqipes – ishte më se e vështirë të nyjëtohej e të perceptohej si e tillë prej folësish jonativë ose mosnjohësish të shqipes. Të njëjtën rrethanë ndeshim pas gjase edhe me studiuesit gjermanishtfolës Praschniker dhe Schober, të cilët janë detyruar ta pasqyrojnë këtë tingull karakteristik vetëm të shqipes me fishkëlloren [z].⁴

3. *Bëdhana* në fokusin e gjuhësisë historike-krahasuese, të arkeologjisë dhe të toponomastikës historike në Ballkanin Perëndimor

Një situatë të ngjashme gjuhësore ka parasysh Mjeda, kur rreket të depërtojë ende më në thellësi të trashëgimisë toponomastike të zonës, shi në periudhën e antikitetit. Në këtë trashëgimi feks, sipas tij, ngulimi antik *Bassania* së bashku me banorët e vet *Bassanitae*, të cituar vetëm prej Titus Livius, historian romak i periudhës së Augustit (shek. I e.j.), kur përshkruan luftën e fundit dhe ngadhënjyese të Romës kundër mbretit të fundit ilir, Gencit (= lat. *Gentius*, gr. *Γένθιος*) në vitin 168 p.e.s. Në këtë kontekst historik-politik-ushtarak që mbylli siparët e historisë së mbretërive ilire, Livius përmend thukët edhe ngulimin në fjalë me banorët e tij ilirë (?), i cili: a) ndodhej jo më larg se 5 milje romake (= ca. 7,5 km) prej qytetit të Lezhës (= lat. *Lissus*)⁵; e që b) Genci, edhe pse e rrethoi me ushtrinë e vet, nuk arriti ta nënshtrohte dot; meqë c) jo vetëm s’ ishte i zoti për ato punë, por iu desh të tërhiqej shpejt, me lang e me plang, drejt Shkodrës (= lat. *Scodra*), në selinë e vet mbretërore; d) ku përjetoi brenda tridhjetë ditësh edhe fundin e mbretërisë së vet, duke i dorëzuar çelësat dhe thesarin pretorit romak Lucius Anicius Gallus (Liv. XLIV 30 7, 8, 13-15). Asgjëmangut, vetë distanca e madhe në kohë me dëshminë e vetme dokumentare të antikitetit parakupton një vëzhgim ndërdisiplinor të këtij problemi. Gjithsesi le të ndalemi fillimisht në rezultatet e debatit të derisotëm shkencor.

⁴ Një dukuri e ngjashme me fërkimoren gjegjëse të pazëshme /th/ që ndërndërrohet me /s/ regjistrohët ndërkohë edhe në raporte, letra e shkrime të klerit të huaj, khs. shq. *Kthellë*, *Këthellë* kundrejt (it.) <Ksela> = [ˈkse.la].

⁵ “[...] ipse ad Bassaniam urbem quinque milia (= 7,4 km) ab Lisso ducit.” (Liv. *loc. cit.*)

3.1. Shq. *Bëdhana* ~ ilir. *Bassania* në argumentimin gjuhësor të Mjedës

Pozicionimi hartografik i këtij ngulimi antik: (lat.) *Bassania*, në letërsinë shkencore të kohës më të djathtë të rrjedhës së poshtme të lumit të Matit (Kiepert 1908, harta XVI), pak a shumë aty ku jes e gjëllin sot e gjithë ditën fshati kodrinor *B(ë)dhana* (~ *Pllana*, *P(ë)dhana*) e josh Mjedën të argumentojë sa vijon:

“Êmni *Bassania* është êmen ilir; e këtû nder né është giytet; mâ nalt, nder *Dæsetiatet* gjindet si lum, *Bassanus*, (*Bosna* e sodshme); në krahinë të Venetvet prap si giytet *Bassanum*. E është për t’u vûm oroe giasimi i Bassan’jes sanë me Bassanin e Grapës n’ Itali: të dyja këto giytete janë në breg të një lumi, e e jona permbí një kodrë, tjetra afer kodrash.

Por ndoshta ká me ju dukë dikúi e vshtirë si mund te puqet êmni shqip me êmnin latin. Për ketë do mëndue se latinët nuk e kishin në giûhë të vet kûmbimin *dh*, e prandej do ta zevëndojshin me një germë tjetrë kûr të ju vite rasa me e shkruet; me një germë due me thanë qi të shênjote kûmbimin qi latini vetë i epte asaj germës kûr detyrohei me i shqiptue, e shifet se ishte germa *s*. E këta e dishmon përshkrimi i disá fjalvet *çeltike* qi permbájne kumbimin *dh*, e qi Çeltit vetë e shkrueshin me *D*, *đ*, qýsh në kohë t’ Augustit. Prandej ndodhë qi bri fjalëvet *Epađatextorigus* e *Đirona* gjindet *Epasnactus* e *Sirona*. (Shif Mommsen. Provincjet romake , kr 3).

Ketë mëndim tēm ja pata paraqitë sod 12-13 vjet, kûr ishte Drejtuer i Muzeut shqiptár në Tiranë, të madhit njoftës të moçmimevet tona Hofrat Dr. Karl Patsch, Profesuer i rregullshem e Botuer n’ Universitet të Vjenës, i cilli e pelqeu. E mâ vonë më ká rá me pá në do fletë të shtypuna se ai vetë e kishte perdorë nder Prelekcjone të veta.” (f. 242-3)

Sqarime të rastit

Po qe se lejohemi tash të ndërmarrim ndonjë sqarim të rastit lidhur me këtë kumt të Mjedës, sigurisht që duhet t’i përmendim paraprakisht lexuesit se jubilarin ynë ka qenë gjithherë i prirë (shih më lart) me përcjellë me vëmendje, përkatësisht me pjesëmarrë në vazhdimësi e në mënyrë aktive në debatin shkencor të kohës, sa i përket qëmtimit dhe rindërtimit të historisë së antikitetit në Ballkanin Perëndimor, parë ky zakonisht si zonë etnike-kulturore, e njësuar nën

entitetin e ashtuquajtur “ilir”. Bëjmë fjalë këtu shi për një zonë që sendërtohej atëbotë – sikurse (në shumësinë e vet) edhe sot e gjithë ditën në shkencat historike-albanologjike shqiptare (!!!) – me të paktën dy ndër identifikatorët themelorë në matriksin e kulturës etnike të popullit shqiptar, siç janë a) territori anas (i sotëm/historik, por gjithmonë i rrudhur) dhe b) gjuha burimore si mjet komunikimi zanafillës i bashkësisë etnike shqiptare. Përndryshe, përqsja e bazës toponimike *Bassan*^o me gjegjëse të tjera brenda dhe jashtë këtij gadishulli (deri në zonën e Venetëve të dikurshëm, si p.sh. me *Bassano del Grappa* në Italinë së Veriut) i shkon tamam përshtat tezës së asaj kohe ndaj të ashtuquajturit ‘panilirizëm’ në shpjegimin historik të gjetjeve arkeologjike dhe materialit kulturor-gjuhësor e toponomastik që u takojnë periudhave të ndryshme të antikitetit në veriperëndim të Gadishullit Ballkanik deri në Europën Qendrore.⁶

Asgjëmangut, duke mbajtur parasysh këtë premisë metodologjike që parashtroam më sipër, nuk e kemi aspak të vështirë me kuptuar sa e siç duhet atë operacion gjuhësor me argumentin pozitiv përkatës që përcjell jubilarin ynë në debat, kur syzon një bashkëlidhje të pandërmjetme midis a) realizimit gjuhësor faktik të një toponimi anas në gjysmën e parë të shek. XX, khs. shq. ^(*)*Bëdhanë* > *Bdhanë* (krahas *P(ë)dhanë*, *Pllanë* e *Pedana*); dhe b) dokumentimit të tij shkrimor në periudhën e antikitetit, kur rezulton i tejshkruar me kodin alfabetik të një gjuhe kulture ndërkombëtare të kohës, khs.: lat. <*Bassania*> (Livius: shek. I e.j.).

Parë nga perspektiva e kontaktit gjuhësor, kemi të bëjmë – sipas Mjedës (!) – edhe në këtë rast me mënyrën se si një folës/shkrues jonativ, përkatësisht mosnjohës i një gjuhe anase percepton në ndërgjegjen e vet gjuhësore, përkatësisht hedh me shkrim në letër të bardhë njësi a shprehje leksikore, e pse jo (!) edhe toponime çfarëdo, që i përkasin si të tilla asaj gjuhe e bash në një fazë të zhvillimit gjuhësor, kur në sistemin e saj fonologjik realizoheshin do tinguj me vlerë funksiondalluese (= fonema), që nuk gëzonin aspak gjegjëse nyjetimore përkatëse në një gjuhë kulture (= latinishte) e si të tilla pasqyrohen me përafërsi në analet historike të kohës. Thënë ndryshe, Mjeda nxitet edhe në këtë rast prej relacioneve ekzistuese ndërmjet gjuhës së folur anase (shqip) dhe gjuhës së folur/shkruar të huaj (italisht), khs.: shq. *B(ë)dhanë* ~ it. <*Pedana*> (= [pe.'da.na]; po ashtu edhe (gjermanisht nga Praschniker e Schober) <*Pezana*> =

⁶ Shih së fundi Krahe 1955 3vv.

[pe.'za.na]); duke i transponuar ato edhe në periudhën e antikitetit, ku na shfaqet i dokumentuar varianti latinisht <Bassania> = [ba.'s'a.nia]. Prashtu, sipas tij, në rastin e parë kemi ndërndërrimin tingullor proporcional shq. [ð] ~ it. [d] (krahas gjerm. [z]), ndërsa në të dytin – i shtyrë ky në kohë me thujse një mijëvjeçar – kemi gjegjësin (shq. =) ilir. [ð] ~ lat. [s].

3.2. Shq. *Bëdhanë* ~ ilir. *Bassania* në diskursin shkencor të kohës

Sigurisht që do të ishim të paplotë, sikur t'u anashkalonim në këtë studim atyre ideve dhe mendimeve që hidheshin e ndër këmbeshin në debatin shkencor albanologjik në (gjysmën e parë të) shek. XX, sa i përket ndërlikës problematike që ngërthen e gjithë ajo larmi variantesh oikonimike bashkëkohore të ngulimit shqiptar, të cilin e njohim sot zyrtarisht me emërtimin *Pllanë*, dhe bashkëlidhjen e tij të mundshme me ngulimin antik ilir (?) *Bassania*.

Si nxitës për zhbirilimin në detaj të këtij debati na mjafton ngjërimi i pjesës së fundit në pasazhin e cituar më lart, ku Mjeda vë oroe se: “Ketë mëndim tëm ja pata paraqitë sod 12-13 vjet, [...] të madhit njoftës të moçmimevet tona Hofrat Dr. Karl Patsch [...], i cili e pelqeu.” Gjithashtu nuk mund të mos mbajmë parasysh edhe citimin në fillim të atij pasazhi të emrit Heinrich Kiepert, i cili rezultoi të jetë i pari studiues që të ketë fiksuar ngulimin antik *Bassania* në të djathtë të rrjedhës së poshtme të Matit (Kiepert 1908, harta XVI), pikërisht aty ku ndodhet sot e gjithë ditën *B(ë)dhana* (~ *P(ë)dhana*, *Pllana*). Në një tjetër hartë të më shumë se gjashtë dekadave më parë ky studiues rezultoi të ketë fiksuar edhe variantin <Pedana>, bash në hartën e asokohe mbi të ashtuquajturën “Turqi Europiane” (Kiepert 1853).

Pjesë e këtij debati janë e duan parë padyshim edhe do materiale ekspeditash në terren, të botuara në fillimet e shek. XX, ku ndeshim rishtas emrin e Karl Patsch-it së bashku me atë të Theodor Ippen-it (1907 66), të cilët e kërkonin motmoti ngulimin antik *Bassania* diku në rranzat kodrinore-malore, aty te 7,5 km në juglindje të Lezhës. Gjithsesi, mosndeshja në ato vise e gjurmëve të dukshme arkeologjike që i takonin periudhës së antikitetit, ngjizi mëdyshje te të dy këta studiues – sikurse më parë edhe te Wilhelm Tomaschek (1897 104) –, me fiksuar me pak a shumë siguri vendndodhjen e këtij ngulimi.⁷

⁷ Ippen 1907 66: „Nach den bis jetzt bekannten aus der vorömischen Zeit stammenden Ortslagen möchte ich die Stadt, zumal da sie eine Belagerung aushalten konnte, mit Patsch südöstlich von Leš auf der Bergumrandung der

Përndryshe, me rezultatet e Kiepert-it, përkatësisht me përputhjen e koordinatave gjeografike që syzon pas gjase ky studiues i parë, sa i përket vendndodhjes së (lat.) *Bassania-s* së dikurshme dhe (gjerm.) <Pezana-s> së sotme (= *Bdhanë*, *Pdhanë*, *Pllanë* etj. – shih më lart) bashkohen pa dorashka Camilo Praschniker dhe Arnold Schober (1919 84), të cilët mëngojnë të japin informacion shtesë edhe për gjetje të ndryshme arkeologjike, si tjegulla, qeramikë qypash (*pithoi*) etj., në këtë ngulim që, sipas tyre, mund e duhet t'i takojë pas gjase bash periudhës së antikitetit.

Parë nga perspektiva e hetimit gjuhësor-historik, debatin shkencor të kohës e pasuron, thënë më saktë e ndërlikon, në mos e “zhvlerëson”, në këtë periudhë Norbert Jokl-i (1934 196), të cilit në fakt nuk i intereson fare oikonimi antik *Bassania*, por qëmton si parësor në tufën e varianteve bashkëkohore oikonimin *Pëdhanë* që na shfaqet si i tillë në “vëndet më të largëta” (Mjeda 1935 242) dhe përsiat si zanafillë të tij një toponim historik deri sot të padokumentuar me burim latin **Pedaneus* e me kuptimin **“në këmbë, rrëzë malit/malësisë”*, i cili, sipas tij, duhet të jetë njohur dhe përdorur si i tillë prej popullsisë migratore shqipfolëse aty rreth shekullit VIII e.j. a më vonë.⁸ Këtë operacion gjuhësor-etimologjik, edhe pse pa forcë argumenti dokumentar, e tumir mote më vonë si të mirëqenë historiani i njohur gjerman Georg Stadtmüller (1941, 1966² 90, 99), për të cilin etnosi shqiptar gjëllinte si i tillë atëbotë (shek. VII-X e.j.) në dheun e vet anas, të rrudhur bash në luginën e zonës malore të Matit (= gjerm. *Mati-Gau*). Në të njëjtën hulli, por me drejtim të përkundërt ecën Anton Mayer (1955 79; 1957 22), i cili, siç do ta shqyrtojmë hollësisht më poshtë, interesohet në përqsjet gjuhësore-historike dhe qëmtimin e etimonit të oikonimit antik *Bassania*, por pa kërkuar e gjetur aty gjithashtu kurrfarë lidhje me shq. *B(ë)dhanë*. Përndryshe do lënë

Ebene suchen. Doch vermochte ich hier nur kirchliche Altertümer aufzufinden. Solche Zeugen einer besseren Zeit besitzen die durch ein Engtal getrennten Dörfer Zojmeni und Plana [= Bdhana – B.D.], die auf dem Abhange des Rückens Bokjani liegen.“ Një kumt të tillë e përcjellim edhe në ndonjë manual enciklopedik të kohës, khs. Tomaschek në: „Paulus Realencyclopädie der Classischen Altertumswissenschaft“, Bd. 5/1 104: „Bassania, illyrische Stadt, V m. p. ab Lisso, von Gentius belagert, von Anicius entsetzt, Liv. XLIV 30, 7; die Einwohner *Bassanitae*. Sie lag in der Mitte, zwischen Lissus und dem Unterlauf des Mathis; doch haben sich Bauwerke hier nicht vorgefunden.“

⁸ Ky kufizim në kohë bëhet për të motivuar mosrëgjimin e mbylltores së zëshme /-d-/ në pozicion ndërzanor që ka rrokur pa përjashtim të gjitha huazimet e mirëfillta latine në shqipe, khs. *va*, shq. *vj*. *vā* < lat. *vadum*; *pyll*, shq. *vj*. *pÿll* < lat. ballk. **padūle*- < lat. *palūs*, -*dis*, khs. rum. *pădure* “id.”.

mënjatë pa koment një përsiatje tejet e guximshme që lexojmë te Georges (I, 1913 793: *Bassania* – ndoshta nën ndikimin e Ugolini-t ?), ku vihet shenja e barazimit midis këtij oikonimi antik dhe gjegjësit të sotëm *Elbasan* (< **El* + *Bassan*^o).

Lejohemi të shtojmë së fundi që përpos pohimit dyshimndjellës të Stadtmüller-it nuk vërejmë ndonjë riaktivizim të kësaj teme në debatin shkencor albanologjik përgjatë gjysmës së dytë të shek. XX. Këtë zbrazësi debati nuk e përmirëson aspak faza aktuale amorge e tranzicionit intelektual në hapësirën shqipfolëse, ku dremkën e tejzgatur të kërkimit të mirëfilltë shkencor diakronik e thyen vetëm ribotimi i ndonjë mendimi skeptik të dikurshëm, sa i përket mungesës së gjetjeve të hershme arkeologjike në *Pllanë* (Islami 2008 132). Pa kurrfarë mbështetjeje historike-dokumentare e gjuhësore, e pas gjase edhe topografike është mendimi i Neritan Cekës (2006 36), që e sposton vendndodhjen e *Bassania-s* 25-30 km në veri të qytetit të Lezhës, duke e pikasur atë diku në qendrën së sotme urbane *Bushat* pranë Shkodrës.

4. Përsiatjet e Mjedës në fokusin e vëzhgimit ndërdisiplinor bashkëkohor

Kjo paraqitje e debatit të derisotëm shkencor që e përmblodhëm thukët në paragrafët e mësipërm (§§ 3.1; 3.2) dëshmon së qarti atë ndërlikë përsiatjesh e mëdyshjesh që ka përcjellë hulumtimi ndërdisiplinor i një teme të tillë, e cila rrok në vetvete disa të panjohura: a) vendndodhjen e ngulimit të dikurshëm *Bassania* në një largësi aty te 5 milje romake (= 7,5 km) larg qytetit të Lezhës; por edhe b) entitetin kulturor-gjuhësor të këtij ngulimi në periudhën e antikitetit (shek. II p.e.s.); sikurse së fundi c) bashkëlidhjen e mundshme në aksin kronologjik ndërmjet (lat./ilir.) *Bassania* dhe shq. *B(ë)dhanë* (krahas *P(ë)dhanë*, *Pllanë*). Shtojmë këtu, që ndër studiuesit e derisotëm Mjeda është i vetmi që rreket të përcjellë në debat një dorë argumentesh pozitive që plotësojnë në thelb njëri-tjetrin, duke sendërtuar së bashku një tezë, e cila të paktën nuk çalon në rrjedhën logjike të argumentimit shkencor, e që lejohemi ta parashetrojmë si vijon: *oikonimi antik Bassania* (Liv. XLIV 30 7, 8, 13-15) *pasqyron me shkrim emërtimin anas të një ngulimi ilir me vendndodhje më të djathtë të rrjedhës së poshtme të lumit të Matit* (Kiepert 1908, harta XVI) *e që përkon në kohën tonë me nyjëtimin e variantit anas B(ë)dhanë*.

Le të ndalemi tani më hollësisht në forcën e njërës apo tjetrit argument pozitiv që piketojnë së bashku rrugëtimin argumentativ të tezës së Mjedës. Sigurisht që këtu duan mbajtur si gjithnjë parasysh, përpos shkallës së sotme të njohjes në shkencat historike albanologjike, edhe konceptet e reja ndaj kulturës etnike-gjuhësore ilire në përgjithësi, përkatësisht të marrëdhënieve të saja të filiacionit me kulturën etnike-gjuhësore shqiptare.

4.1. *Bassania* në hartën arkeologjike të Shqipërisë

Siç vumë në dukje që në hyrje të këtij punimi, Titus Livius ishte i pari dhe i fundit historian i periudhës së antikitetit që e citon pa teklif këtë oikonim si emërtim të një ngulimi urban me banorët e vet *Bassanitae*, një ngulim ky pas gjase i fortifikuar dhe i vendosur në një largësi rreth 5 milje (romake = ca. 7,5 km) prej (lat.) *Lissus* (= shq. *Lesh*, *Lezhë*). Kërkimi i këtij ngulimi në jug ose juglindje të Lezhës, përkatësisht në rrjedhën e poshtme të Matit, motivohet bindshëm me rrethanat e shfaqjes së tij në veprën e Livius-it, përkatësisht me dendurinë e ngjarjeve politike-ushtarake në rajon në vigjilje të Luftës së Tretë dhe të fundit Ilir-Romake, kur u vendosën përballë njëri-tjetrit mbreti i fundit ilir Genci dhe pretori romak Lucius Anicius Gallus (shih § 3). Siç mësojmë më tej prej Livius, rrethimi i *Bassania-s* prej trupave të Gencit bëhej në kuadrin e aleancës së tij me mbretin e atëhershëm të Maqedonisë Perseu-n për të luftuar së bashku romakët; ndërsa tërheqja e tij e shpejtë drejt Shkodrës ishte rrjedhojë e kundërveprimit mësimës të Anicius-it me trupat e veta në Iliri, që vjen me thënë (të paktën) në territoret e Mbretërisë Ilire si një formacion shtetëror i *Illyrii Proprie Dicti* me në krye mbretin vëllavrasës, Gencin.

Meqë edhe ndër historianë dhe kronikanë të tjerë romakë të antikitetit citohen lëvizjet e Gencit me trupat e tij prej Lezhës drejt jugut, përkatësisht tërheqja e tyre prej jugut drejt Shkodrës, nuk kemi përse të vëmë tash në dyshim orientimin e thujasë të gjithë studiuesve të derisotëm që e kërkojnë këtë ngulim në një zonë të kodrinore-malore në jug ose juglindje të Lezhës.⁹ Që ky ngulim mund a duhet të përkojë me *B(ë)dhanën*, që vjen me thënë *Pllanën* e sotme, këtë mendim, siç pamë më lart (§ 3.2), u rrekën dikur ta mbështesin jo pa të drejtë studiues në terren si Praschniker e Schober, të cilët kanë vëzhguar sado kalimthi (vetëm) aty gjurmë qyterimi antik, ndërkohë që i befason topografia dhe mbrojtja natyrore e vendit në fshatin

⁹ Ndryshe Ceka 2006 36 (shih § 3.2)

<Pezana> (= *B(ë)dhanë*, *P(ë)dhanë*, *Pllanë*, *Pedana*) me gjurmë të dukshme jetës mesjetare (shek. XIV-XVIII), por që rezulton të ketë qenë tejet i përshtatshëm edhe si një vendbanim i fortifikuar i periudhës ilire, pikërisht mbi një sipërfaqe të rrafshët malore që rrethohet nga rrëpira shkëmbore, duke siguruar kështu një mbrojtje natyrore të patëmetë. Dhe është fakt që ky vend kontrollon plotësisht edhe grykën e luginës së Matit para se ai të vijojë me rrjedhën e poshtme në zonë fushore deri në derdhjen e vet në Adriatik.¹⁰ (Shtojcë: II)

4.2. *Bassanitae* si banorë të këtij ngulimi

Po banorët e këtij ngulimi? Cilët ishin këta “bukëshkalë” që nuk iu bindën Gencit tonë, por u barrikaduan në rrethim, derisa u erdhi në ndihmë pretori romak Anicius me trupat e veta? Në fakt Livius na kumton thjesht dhe vetëm se *bassanit-ët* ishin aleatë të romakëve (Liv. XLIV 30 8: “socii erant Romanorum”). E ndërsa për studiues të tjerë të kohës ky detaj tingëllon ndoshta i dorës së dytë, për Mjedën nuk duket të ketë qenë aspak i tillë, meqë ai këmbëngul që *bassanit-ët* ishin ilirë den-baba-den, çka vjen me thënë bartës të asaj kulture etnike-gjuhësore, (edhe për atë vetë) të njësuar që mbizotëronte në gjithë pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, madje shkonte deri në – në mos edhe i kapërcente – viset kufitare të Europës Qendrore, ku jo rastësisht na u shfaqka rishtas edhe te venetët antikë (me gjak të pastër ilir) i njëjti oikonim (lat.) *Bassanum*; sigurisht edhe ky – sikurse *Bassania* buzë Matit – me një tejshkrim latin me <ss> dyfishe në trup të fjalës si perceptim i mbrapshtë i atij tingulli xanxar [ð] (= <dh>) që na u shfaqka pas një mijë vjetësh i pandryshuar edhe te gjegjësi anas i shqipes së sotme *B(ë)dhanë* (krahas *Pëdhanë* e *Pllanë*).

Operacione të tilla induktive të natyrës kausale, rezultatet e të cilave në kohën tonë nuk mund t’i përcjellim ndryshe, veçse me një tubë pikëpyetjesh në varg, nuk janë aspak të rralla në studimet

¹⁰ Stadtmüller (1966 90) sheh këtu një nyjë lidhëse edhe për një rrugë të mundshme që lidhte Lezhën me Durrësin. Shih edhe Cabane 1988, 2004² 291. Ndër studiuesit shqiptarë dallojmë këtu Islamin (2008 f. 132, shën. 197) që përsërit dyshimet e shprehura dikur prej Tomashek-ut etj. (shih § 3.2.) se nuk ka qenë e mundur të qëmtohen në Pllanë gjurmë të ndonjë fortifikimi apo të kulturës materiale antike ilire. Gjithsesi, shkruesi i këtyre radhëve nuk ka informacion, që të jetë kryer deri sot ndonjë ekspeditë e veçantë arkeologjike në Pllanë e rrethina për të verifikuar këtë konstatim të fillimshkullit të XX. Shkruesi i këtyre radhëve lejohet gjithashtu të përmendë këtu bisedat konstruktive me kolegun dhe mikun e tij arkeolog Gëzim Hoxha, duke i shprehur falënderimet e rastit për këshillat e jo më pak edhe për fotot me situacionet hartografike, që i vuri në dispozicion (shih Shtojcë: I, II).

historike onomastike dhe antropologjike jo më vonë se gjysma e parë e shek. XX, madje tek-tuk edhe më pas. Mjafton të përmendim në rastin tonë përsiatjet e Stadtmüller-it (1966 90) që thellon pa një e pa dy atë hulli të hapur prej Jokl-it (1934 196), sipas të cilit oik. *Pëdhanë* vijon pandërmjetshëm – sigurisht pas shek. VII e.j. – një toponim gjithsesi të padokumentuar të burimit të mirëfilltë latin **Pedaneus* (shih § 3.2). Në vijim të këtij operacioni thjesht gjuhësor Stadtmüller mëngon të shtojë vrik e vrik, sa vijon: “Pra, në rrjedhën e poshtme të Matit duhet të ketë pasë mundur të mbijetojë [e paasimiluar – B.D.] një mbetje popullsie romane edhe pas uzurpimit sllav. Khs. Jokl, *Ortsnamenkunde* [= 1934] 136, i cili huazimin [e këtij toponimi në shqipe – B.D.] nuk do që ta fiksojë para vitit 700.”¹¹

Pa dashur të hyjmë në më shumë hollësi lidhur me mangësitë e pakapërcyeshme të këtij argumentimi e përmyllim këtë pamje të problemit, si vijon: Parë nga perspektiva e historisë politike-ushtarake të Ballkanit Perëndimor në këtë periudhë të antikitetit si edhe në bazë të materialit dokumentar që disponojmë, lejohemi të mëtojmë me siguri vetëm që *bassanit-ët* ishin aleatë të romakëve. E ky pozicion i shkon përshtat edhe pozicionit gjeostrategjik të vetë ngulimit (lat.) *Bassania*, i cili nuk ndodhej thjesht dhe vetëm nën influencën e fuqishme romake, por ishte bash pjesë e asaj hapësire në Ballkanin perëndimor që ndodhej qysh prej atij zhgënjimi të madh ilir në Luftën e Parë Iliro-Romake nën protektoratin romak, thënë ndryshe ishte pjesë e së ashtuquajturës Iliri Romake, e cila ravijëzon deri diku edhe konturet e ndarjes së mëvonshme administrative zyrtare të Epirus Nova nën perandorin romak Diocletian (shek. III e.j.)

4.3. Oik. *Bassania* dhe *Bassanit-ët* në fokusin e ilirologut

Do të ishim sigurisht të paplotë, sikur t’i anashkalojmë në këtë studim ndonjë përpjekjeje etimologjizuese të oikonimit antik *Bassania* me banorët e vet *bassanitae* që është ndërmarrë deri sot, parë sigurisht nga perspektiva e ilirologjisë, një fushë kjo që gjatë shek. XX arriti deri aty, sa të mëtonte statusin e një shkence të veçantë ndërdisiplinore e pa ndërvarësi të drejtpërdrejtë me shkencën po aq komplekse të albanologjisë.

¹¹ Varianti original: „Es muß sich also am Unterlauf des Mati ein romanischer Bevölkerungsrest auch nach der slavischen Landnahme behauptet haben. Vgl. Jokl, *Ortsnamenkunde* 196, der die Entlehnung nicht vor 700 ansetzen möchte.“

I tillë është p.sh. syzimi i ilirologut të njohur Anton Mayer, i cili i përkushtohet përpos identifikimit të këtij oikonimi dhe saktësismit të realies historike-kulturore (1957 79), në të cilin shfaqet,¹² edhe përqasjes gjuhësore-diakronike, sikurse edhe zbërthimit strukturor etimologjik të tij (1959 22v.), duke parë, kërkuar e gjetur në (lat.) <Bassania> [ba.'s'a.nia] një ndërvaresi formale me regjistrimin (për ne diturak) <Pezana> [pe.'za.na], i livruar si i tillë prej Prashniker dhe Schober (shih § 2.3.) Kjo ndërliidhni konceptohet gjithsesi prej ti si e natyrës së një trashëgimie të tërthortë kulturore-etnike, në kuptimin që ishte bash ajo popullsi migratore shqipfolëse, e cila erdhi dhe e përvetësoi këtë toponim në mesjetën e hershme (pas shek. VII), duke e shqiptuar këtë oikonim bash njëlloj siç e shqiptonte atëbotë popullsia vendase ilire-romane. Mayer-i e ka fjalën në këtë rast sidomos për atë tingull xanxar: [z]-në ndërzanore, i cili, sipas tij, përcillej natyrshëm në antikitet në kronikat latinisht me digramën <ss>. Segmentimi i strukturës fjalëformuese në *Bass-an*^o e lejon Mayer-in më tej (1959 22v.) të syzojë njëlloj si Mjeda (§ 3.1.) një përqasje formale reale me do emërtime të tjera në inventarin e toponomastikës së ashtuquajtur ilire në periudhën e antikitetit, ku feks sipas tij një bazë emërore e përbashkët ilir. **baz-* (= lat. <Bass^o>), khs. (në mesjetë) *Bosna*, *Posna* (< ilir. **Báss-an-as*, *-ā*), *Bassiana* etj. Ngërthimi në këtë qerthull problemor edhe i hidronimit *Bósut* (emër lumi në Kroaci) e josh Mayer-in të përsiasë në vazhdim burimin etimologjik të kësaj baze si një rrënjë burimore foljore ilir. **baz-* me kuptimin themelor **“rrjedh”* e që shërben njëherësh edhe si bazë emërore me kuptimin **“ujë i rrjedhshëm; përrua, lumë”*. E si e tillë, baza emërore përkon, sipas tij, kuptimisht dhe formalisht ndër të tjera me gjerm. vj. l. *bah* < *bahh*, gjerm. *Bach* “përrua” etj., duke sendërtuar kështu së bashku e po aq natyrshëm një bazë të rindërtuar indoeuropiane **b^hog-* “ujë i rrjedhshëm”.

Sa i besueshëm është ky operacion etimologjik? Për të ardhur në një përfundim bindës, vështirësi nuk paraqet aspak përqasja formale dhe kuptimore që bën Mayer-i me gjerm. *Bach* “përrua”, duke përsiatur për to një formë të përbashkët me burim ie. **b^hog-* “përrua, lumë”, edhe pse në kompendiumet e sotëm etimologjike të fazës së përbashkët të zhvillimit gjuhësor indoevropian (= indoevropianishte primitive) gjegjësen gjermanisht dhe ato të paka simotra të veta (vetëm gjuhë *kentum*) lexojmë zakonisht një paraformë pie. **b^hog-* “ujë i rrjedhshëm”, pra me një tektale velare në trup të fjalës, khs. Pokorny (1959 161: ie. **b^hog-* “ujë i rrjedhshëm; përrua”). Rindërtimi po aq i patëmetë i një baze emërore të

¹² Pra, ndryshe nga pararendësi i tij Hans Krahe (1925; 1955-64) që nuk e ngërthen fare këtë oikonim në inventarin e toponimeve ilire.

përbashkët ie. **b^hoĝ-* “ujë i rrjedhshëm; përrua, lumë”, pra me një tektale palatale në trup të fjalës, i hap udhë çdo gjuhëtari historian të ngërthejë në të gjegjëse simotra në ndonjë gjuhe *satem*.¹³ E pikërisht këtë rast e shfrytëzon dukshëm edhe Mayer-i, kur kërkon burimin etimologjik të një baze ilire **baz-* të rindërtuar gjithsesi *ad hoc* vetëm prej tij.

Por sa i besueshëm është në të vërtetë ky operacion etimologjik? Goditjen vrastare ia jep bash natyra e tingullit tonë xanxar [ð], të cilin Prashniker dhe Schober (§ 2.3.) e perceptojnë si [z] dhe e shkruajnë po ashtu: <z>, kur hedhin në letër të bardhë dhe venë shenjën e barazimit midis dëshmisë së antikitetit (lat.) *bassania* dhe asaj bashkëkohore, të dëgjuar me kujdes prej tyre si Pezana = [pe.za.na], e jo siç mëtonin kolegë të mëhershëm ase bashkëkohës të vet: shq. *Pllanë* (Ippen) ase *Pedana* (Hahn). Pra edhe në këtë rast, sikurse me Mjedën, Stadtmüller-in etj. më lart (§ 3.1.; 3.2.), vërejmë se si një studiues bie lehtë pre e regjistrimit spontan të një fjale të zakonshme apo emërtimi gjeografik bashkëkohor, i cili përmban në strukturën e vet fonetike tinguj “të pazakonshëm” por me funksion kuptimdallues (= fonema) në gjuhën e dhënë, e duke i marrë ata si të mirëqenë e të mirëruajtur edhe në faza të mëhershme të zhvillimit gjuhësor, në rastin tonë të antikitetit: (lat.) <Bassania>.

5. *Bassania* në fokusin e gjuhësisë historike-krahasuese bashkëkohore

Shtjellimet e ndërmarra më lart lidhur me realien historike, kulturore e gjuhësore që përcjell dokumentimi i ngulimit antik *Bassania* me banorët e vet *Bassanitae* jo vetëm nuk e mbështesin, por vetëm e vështirësojnë hulumtimin e mirëfilltë gjuhësor diakronik, sa i përket qoftë kërkimit dhe izolimit të etimonit të këtij oikonimi, qoftë edhe bashkëlidhjes së tij të drejtpërdrejtë ase të tërthortë me gjegjësin anas shq. *B(ë)dhanë* (~ *P(ë)dhanë* e *Pllanë*) në kohën tonë. Dozën e këtyre vështirësive paraprake e shtojnë sipas rastit do vëzhgime shtesë, të tilla si:

¹³ Sigurisht që një premisë e tillë do ta përdëllente gjuhëtarin albanolog, sepse arrin të zbërthejë variantin anas *B(ë)dhanë* pa kurrfarë mundimi, domethënë si rrallë e për mall në hetimin etimologjik të toponomastikës historike shqiptare, duke rindërtuar disa faza: shq. *Bdhanë* < *Bëdhanë* < **Bað-án°* < **b^hoĝ-* + *-án°*. Mungesa e çerdhes leksikore përkatëse, qoftë edhe e një fjale a baze foljore/emërore çfarëdo në fondin leksikor të shqipes e bën gjithsesi krejt të dyshimtë rindërtimin e baze emërore protoshq. **bað-* me kuptimin **“ujë i rrjedhshëm; përrua, lumë”* e bashkë me të zbërthimin etimologjik të këtij oikonimi me material shqip (?) **bað-+an°* **pranë, buzë lumit”*.

a) mungesa e oik. *Bassania* (krahas venet. *Bassanum*, panon. *Bassiana* etj.) në nomenklaturën e toponomastikës ilire, e regjistruar me aq skrupulozitet në veprën e studiuesit të njohur ilirolog Hans Krahe (1925); b) se varianti i dokumentuar lat. <Bassania> nuk gjen kurrfarë shpjegimi bindës kuptimor e fjalëformues me gjegjëse përkatëse në inventarin e leksikut latin të kohës; për më tepër c) ai përcjell me dyshkronjëshin <ss> në trup të fjalës një strukturë tingullore, e cila nuk mund të jetë assesi burimore në këtë gjuhë,¹⁴ e së fundi d) oikonimi i sotëm shqip në variantet popullore anase *B(ë)dhanë* ~ *P(ë)dhanë* është pas gjase unikal në nomenklaturën e makro- dhe mikrotoponimisë në hapësirën kompakte shqipfolëse, përkatësisht pa ndonjë gjegjës bindës në fondin e përgjithshëm leksikor të shqipes, çka nuk lejon të ndërmerren aspak hapa të sigurt në zbërthimin fjalëformues dhe hulumtimin retrospektiv në përgjithësi.

Pa dashur të ndalemi më gjatë në secilin vëzhgim shtesë të renditur më lart ose të kalojmë në përgjithësi sa të panevojshme aq edhe të rastit lidhur me marrëdhëniet e filiacionit iliro-shqiptar a diçka të ngjashme me to, lejohe mi të përmendim shkurt se për rastin në fjalë ajo bashkëlidhje që përsiat Mjeda ndërmjet toponimit antik – e pse jo – ilir *Bassania* dhe emërtimit popullor shqip *B(ë)dhanë*, emeton sot për sot të vetmen dritë jeshile në zhbirimin e këtij *puzzle-i* ndërdisiplinor. Veçse për këtë mjafton të mbajmë gjithherë parasysh si kriter metodologjik – pra aspak ideologjik-nacion(al)ist (!!!) – anashkalimin me vetëdije, duke i parë thjesht e vetëm si opsion alternativ marrëdhëniet e mundshme të filiacionit të pandërmjetshëm etnik-kulturor e sidomos të atij gjuhësor iliro-shqiptar, një tezë kjo dikur e, për fat të keq (!), ndërkohë tërësisht e unifikuar dhe me vlerë aksiomatike në mendimin albanologjik shqiptar.

Parë nga perspektiva e sotme e gjuhësisë historike-krahasuese, përqasja e strukturës fonologjike e formës anase shq. *Bëdhanë* me (lat. klas.) <Bassania> nuk pengon aspak, përkundrazi vetëm mundëson induktime fatlume për çdo gjuhëtar historian, kur zbret poshtë e më poshtë dhe troket në portat e antikitetit, meqë edhe atë pengesë në dukje të vetme – bash kur përqasim dyshkronjëshin lat. <-ss-> = /s^s/ me tingullin xanxar shq. <-dh-> /ð/ në trup të fjalës – jemi në gjendje ta kapërcejmë bindshëm dhe lehtas. Në këtë rast mjafton të mbajmë parasysh ndërndërrimet e ngjashme tingullore, që janë përftuar vetëm (?) gjatë hyrjeve të hershme të ashtuquajturave fjalë kulture migratore ase mesdhetare në fondin leksikor të shqipes gjatë periudhës së antikitetit, të

¹⁴ Shih së fundi Meiser 1998 125.

tilla si: shq. *thikë*: lat. *sica*; shq. *thes*: gr. vj. θάκ(κ)ος “thes (me lëkurë dhie)”, lat. *saccus* (< huazim nga semitishtja, khs. hebr. (fenik.) *śaq* “thes”); shq. *bathë*: gr. vj. φάκος “thjerrë”, φάσηλος “lloj fasuleje” (> lat. *fasēlus*) etj.¹⁵

Duke mbajtur vath në vesh proporcione të kësaj natyre që nuk i takojnë aspak burimit apo fondit indoeuropian të shqipes, edhe pse nuk jemi ende në gjendje të zbërthejmë me saktësi etimonin e këtij oikonimi, jemi të paktën të sigurt se kemi të bëjmë me trashëgiminë gojore të një mikronimi antik në një trevë kulturore-etnike pas gjase ilire, e cila në shek. II p.e.s. ishte përfshirë nën protektoratin e dikurshëm romak. Është bash ky mikronim që është njohur, përthithur e përvetësuar prej (proto)shqiptarëve, duke u lakuar shumë herët po në gojë të tyre, madje në mos shumë kohë më parë, të paktën në atë kohë – e pse jo (!!!) – kur ata pagëzuan lumin ngjitur të Matit (Vibius Sequester: <Mathis> – shek. V e.j.)¹⁶ me një fjalë të fondit të vet leksikor, khs. *matë* “breg lumi; shtrat lumi” krahas oik. *Bregu i Matës*, pranë lat. *mons*, -tis “mal” < pie. **myt*- “vend i ngritur, ledh; mal”.¹⁷ Mikronimin *B(ë)dhanë* < (prot)shq. **Badāna* (proto)shqiptarët vështirë ta kenë njohur, marrë e mësuar dikur drejtpërdrejt prej gojës latine shi në atë formë të dokumentuar (lat.) <Bassania> = [ba.'s'a.nia], e aq më pak – siç mëton shumëkush – pas shek. VII-VIII e.j., kur mjedisit etnik-kulturor të këtyre trevave e viseve erdhi e iu shtua edhe komponenti etnik-gjuhësor sllavojugor. Për t’u bindur për këtë, mjafton të orientohemi rishtas drejt veriut, duke përshkuar ato 5 milje romake që citon Livius-i, e të darsim apet bash në qendrën e madhe urbane të antikitetit iliro-romak, por edhe të mesjetës, të cilën e njohim jo rastësisht me makronimin (gr. Λισός >) lat. *Lissus*. Gjegjësi popullor shqip i këtij makronimi *Lesh* dëshmon më së miri zhvillimin, përkatësisht përshtatjen normale të huazimeve latine në (proto)shqipe, ku lat. (vulg.)/rom. lind. <s(s)> = [s^(s)] në trup të fjalës është shndërruar rregullisht në *sh* = [ʃ], khs. lat. *massa*, *cossus*, *camīsia* > shq. *mashë*, *kosh*, *k(ë)mishë* etj.

Përshtatja gjuhësore e formës latine vulgare e këtij makronimi në bashkësinë shqipfolëse të asaj zone i takon pas gjithë gjasash fazës (së fundit) të antikitetit të vonë deri në fillim të mesjetës. Këtë syzim tonin e mbështet pa kurrfarë dyshimi timbri [e] i zanores së theksuar, i përfutur me siguri në latinishten vulgare, përkatësisht në periudhën e

¹⁵ Shih së fundi Demiraj 2010 43vv.; 2012 31vv.

¹⁶ Oberlin 1778 14: (Vib. Seq.) “Mathis Dyrrachi, non longe a Lisso.”; 143: <Mathis>.

¹⁷ Shih Demiraj 2010 43vv.

romanitetit lindor: lat. klas. /i/ > lat. vulg./rom. lind. /e/, khs. shq. *fē* < lat. vulg./rom. lind. **fēde-* < lat. klas. *fidēs*. Bash në këtë periudhë pritet një zhvillim i tillë, si: lat. klas. *Lissus* > lat. vulg./rom. lind. **Lē.s^(s)o-* > shq. **Leš-* = *Lesh* (sot *Lezhë*), njëlloj si lat. klas./kisht. *missa* > lat. vulg./rom. lind. **mē.s^sa* > shq. *meshë*. Variantet e mëvonshme të fazës italiane-veneciane të këtij makronimi, khs. *Aless(i)o* nuk vijjnë fare në vështirim për periudhën në fjalë, kur në (proto)shqipe priteshin zhvillime të tjera në pozicion nistor, khs. emrin personal *Llesh* e (shq. vjet.) *Llezhder* < rom. lind. /Aleks/, /Aleksandr^o/.

Prashtu, bëjmë fjalë këtu në çdo rast për shndërrime në timbër të zanores së shkurtër e të theksuar lat. /i/ (> lat. vulg./rom. lind. /e/), të cilat i takojnë fillimeve të romanitetit lindor, përkatësisht janë perceptuar si të mirëqena ndër (proto)shqiptarë, duke u përshtatur si të tilla në sistemin fonologjik të (proto)shqipes së kohës, falë kontakteve të drejtpërdrejta e të vazhdueshme me popullsinë vendase romane ase të romanizuar në atë qytet (me statusin e hershëm të qytetarisë romake) e në trevat rreth tij. Përndryshe, të tjera proporcione përsiat, kërkon e gjen me llupen e vet një gjuhëtar sqimatar në zhvillimet sa normale aq edhe të pritshme në toponomastikën autoktone (ilire ?), ku latinishtja apo romaniteti ballkanik nuk kanë luajtur patjetër rolin e ndërmjetësit, khs. ndër të tjera formën antike të lumit të Ishmit: (lat.) <Isamnus> (Vibius Sequester: <Isanus > – shek. V e.j.)¹⁸ kundrejt (ilir. ?) *Isamn^o* > (proto)shq. **Ísamn-* > **Íšām^m* > shq. *Ish(ë)m*.

Të nxitur nga kjo perspektivë e re e studimit diakronik, lejohemi të përfundojmë tash natyrshëm e pa kurrfarë vrasamendjesh, se kush mban parasysh proporcione historike-gjuhësore të kësaj natyre si dukuri që i kanë përjetuar, përcjellë e sendërtuar së bashku në antikitet (proto)shqipja me gjuhë fqinjë, ndër to me latinishten dhe greqishten, vështirë të mos i bashkohet sot dashur-padashur atij gjykimi sado të brishtë, por tejet të mprehtë të eruditit tonë të madh, Ndre Mjedës. Veçse për të kuptuar dhe argumentuar këto proporcione pas gjase reale të antikitetit duhet parë e pranuar në kohën tonë thjesht e vetëm si opsion alternativ dhe pa interes të mirëfilltë albanologjik, një marrëdhënie e mundshme filiacioni (sidomos) gjuhësor e shqipes me një pseudogjuhë të antikitetit ballkanik perëndimor: gjuhë kjo, së cilës ende nuk ia gjejmë dot fillin; fundin jo se jo (!!!)

¹⁸ Shih Krahe 1925 28; më parë Oberlin 1778 135, 322: (Veb. Seq.) “*Icanus Dyrrachii ab Icano castello dictus | *forsan* Isanus ... Isano”.

6. Epilog: Sa e njohim Jubilarin tonë në këtë përvjetor?

Një pyetje kjo, në dukje provokuese, por që nuk vë asesi në kandar atë prurje të tij të vyer, të cilën e tumir dhe trajton me seriozitetin e duhur edhe ky tubim i organizuar me rastin e 150-vjetorit të tij të lindjes. Pyetja bëhet në fakt për një arsye të thjeshtë, thujase triviale: Ndre Mjeda me aktivitetin e tij intelektual dhe angazhimin social – ndryshe nga ai numër i panumërt sivëllezërish të vet¹⁹ – është parë e vlerësuar gjithëherë prej shkencës, letërsisë dhe përgjithësisht kulturës shqiptare si pjesë e asaj pasurie të patundshme në trashëgiminë e kulturës shqiptare, duke u mjaftuar këtu sigurisht vetëm me prurjet e tij në lëvrimin e poezisë dhe të lirikës shqipe, të gjuhësisë shqiptare e të kulturës së shkrimit shqip në përgjithësi, sikurse në rastin tonë konkret – e pse jo?! – edhe si nxitës i studimeve të mirëfillta diakronike të natyrës ndërdisiplinore.

Asgjëmangut, kjo pyetje e ruan qenësinë dhe rëndësinë e saj, në rast se u përmbahemi qoftë edhe faktikisht të dhënave statistikore. Kështu p.sh., siç vumë në dukje qysh në fjalët hyrëse të këtij punimi (§ 1), përkushtimi i Mjedës ndaj rindërtimit të marrëdhënieve etnike-gjuhësore të popullit shqiptar në atmen e vet historike në Ballkanin Perëndimor ngërthen vetëm dy (mikro)artikuj me gjithë-gjithë katër faqe reviste së asokohe. Për proporcione të tjera të sigurt e shumë më të dukshme e për rrjedhojë edhe më domethënëse e jo më pak vrasamendase në gjithë atë prodhim të tij intelektual, që e pa dikur dritën e botimit, u detyrohemi vëzhgimeve të mprehta të një studiuesi të huaj me veladon të zi, Dom Markus Peters (2007; 2016²), të cilit lejohemi t'i referohemi, sa vijon: Prej Mjedës trashëgojmë një fond aspak të brishtë të aktivitetit të tij botues me as më shumë e as më pak, por plot 2065 faqe, në të cilin krijimtaria poetike lirike, që në pamje të parë ruan karakterin e vet laik nuk e kapërcen cakun e 169 faqeve, pra aty te 8% e gjithë prodhimit të tij intelektual. Këtij fondi lejohemi t'i shtojmë edhe 65 faqe (pra 3%) botimi në fushat e gjuhësisë, kritikës letrare dhe të toponomastikës historike. Një veprim i thjeshtë matematikor lejon të konkludojmë pa gabuar aspak, që aty te 89% e gjithë trashëgimisë së tij intelektuale-shpirtërore sikurse edhe e asaj mësimore

¹⁹ Për dhunën strukturore informale, të ushtruar prej aparatit shtetëror të regjimit në fuqi në Shqipërinë e Pasluftës së Dytë Botërore lidhur me implementimin e atij projektimi afatgjatë, sa të mirëstudiuar aq edhe të neveritshëm ndaj shpëlarjes së kujtesës historike-intelektuale (= lat. *damnatio memoriae*), sikurse edhe pasojat e tij në lëvrimin e kulturës enciklopedike në Shqipërinë e periudhës e tranzicionit social dhe intelektual (1991-), shih së fundi shkruesin e këtyre radhëve (Demiraj 2016), që merr në analizë linçimin e (pa)vetëdijshëm, por në vazhdimësi që është ndërmarrë e mirëruhet edhe sot e kësaj dite ndaj prurjeve të klerit shqiptar e të huaj në trashëgiminë e kulturës shqiptare.

në shkollat fetare e laike, i është nënshtruar shumë pak, në mos aspak studimit kritik dhe debatit shkencor-kulturor albanologjik.

Këtyre përfundimeve u bashkohet sa me bindje aq edhe me dhimbje edhe shkruesi i këtyre radhëve, sepse edhe lexuesi sqimatar, edhe kritiku letrar, sikurse edhe studiuesi i mirëfilltë albanolog e kulturolog lejohet të mëtojë sot për sot të ketë njohur e përtypur as më shumë e as më pak por gjithë-gjithë aty te 11% e gjithë asaj trashëgimie që na ka lënë në letër të bardhë eruditi ynë Dom Ndre Mjeda. Mbetet pra të ndërmerret e realizohet shumë më shumë në përvjetorët e ardhshëm të këtij kolosi të kulturës shqiptare; për ata sivëllezër të tij të panumërt e të fshirë thuajse njëherë e përgjithmonë nga kujtesa jonë historike-intelektuale, po se po (!)

BIBLIOGRAFI

Livius, Titius: Ab urbe condita, shih: <<http://www.thelatinlibrary.com/liv.html>>

Cabanes, Pierre: Les Ilyriens, de Bardylis à Genthios (IVe-IIe siècle avant J.-C), Paris 1988 [Bot. i dytë: Ilirët, nga Bardhyli te Genti (Shek. IV - II para J.-K.), Tiranë 2004]

Ceka, Neritan: Udhëtim në këshqjellat ilire, Tiranë 2006.

Cikuli, Nikoleta (et al. - bot.): Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2002.

Demiraj, Bardhyl: *Probleme të lëna pezull: vendbanimet e shqiptarëve në mesjetën e hershme*, in: “Hylli i Dritës” 1 [2010] 35 – 46, Shkodër.

Demiraj, Bardhyl: *Gjurmë të substratit mesdhetar-ballkanik në shqipe dhe greqishte*, in: „Hylli i Dritës” 2 [2012] 31-49, Shkodër.

Demiraj, Bardhyl: *Fé dhe Të prëmt e fës në Kanunin e Lekë Dukagjinit*, in: “Studime” 22 [2015] 79-111, Prishtinë.

Frommer, Hansjörg: Die Illyrer, Karlsruhe 1988.

Georges, Heinrich: Ausführliches lateinisch-Deutsches Wörterbuches (Ausgearbeitet von Karl Ernst Georges), Darmstadt 1998 (bot. I: Hannover 1913)

Gjinari, Jorgji: Dialektet e gjuhës shqipe, Tiranë 1989.

Hahn, Johann Gerorg von: Reise durch die Gebiete des Drin und Vardar, Wien 1869.

Ippen, Theodor: Skutari und die nordalbanische Küstenebene. Zur Kunde der Balkanhalbinsel I. Reisen und Beobachtungen, (hrsg. von Dr. C. Patsch) Heft 5, Sarajevo 1907.

Islami, Selim et al. (bot.): Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, bl. I: “Ilirët dhe Iliria te autorët antikë”, Tiranë 1965.

Islami, Selim: Historia e ilirëve, Tiranë 2008.

Jokl, Norbert: Zur Ortsnamenskunde Albaniens, në: „Zeitschrift für Ortsnamenforschung“ 10 [1934] 181-206.

- Kiepert, Heinrich: General-Karte von der europäischen Türkei: nach allen vorhandenen Originalkarten und itinerarischen Hilfsmitteln (bearbeitet und gezeichnet von Heinrich Kiepert); Berlin 1853. <<https://www.lib.uchicago.edu/e/collections/maps/kiepert/G6800-1853-K5.html>>
- Kiepert, Heinrich: *Formae orbis antiqui*: XVI. Gracia cum Macedonia et Epiro, 1. Text Berlin 1907; 2. Karte XVI, Berlin 1908.
- Krahe, Hans: *Die alten balkanillyrischen geographischen Namen – aufgrund von Autoren und Inschriften*, Heidelberg 1925.
- Krahe, Hans: *Die Sprache der Illyrier*, Wiesbaden: bl. I 1955; bl. II 1964.
- Mayer, Anton: *Die Sprache der alten Illyrier*, Bd. I: Einleitung. Wörterbuch der illyrischen Sprachreste, Wien 1957; Bd. 2: Etymologisches Wörterbuch des Illyrischen. Grammatik der illyrischen Sprache, Wien 1959.
- Meiser, Gerhard: *Historische Laut- und Formenlehre der lateinischen Sprache*, Darmstadt 1998.
- Mjeda, Ndre: „Dromca toponomastike: Zeta (Zedda, Zenta, Centa, Cetta, Genta, Senta) „Leka“ VIII, nr. 9 [1936] 419-420.
- Oberlin, Jeremias Jacob: (botues) Vibius Sequester: *De fluminibus, fontibus, lacubus, nemoribus, paludibus, montibus, gentibus quorum pud poetas mentio fit. Lectionis varietatem et integras doctorum commentationes adjecit et suas Jer. Jac. Oberlinus [...]* Argentoratum MDCCLXXVIII.
- Peters, Markus E.: „Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur: Die "Buchdruckerei der Unbefleckten Empfängnis" zu Shkodra (1870-1945), Kovač, Hamburg 2007. [botimi i dytë: Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvisjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën: Tipografia e Zojës së Papërlyeme në Shkodër (1870 - 1945), Shkodër 2016.]
- Pokorny, Julius: *Indogermanisches etymologisches Wörterbuch*. Bern/München 1959.
- Quku, Mentor: *Mjeda 2, Albanologu (1888 – 1899)*. Tiranë 2006.
- Praschniker, Camilo & Schober, Arnold: *Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, në: „Akademie der Wissenschaften in Wien. Schriften der Balkankommission, Antiquarische Abteilung, Heft VIII“, Wien 1919.
- Sequester, Vibius: (shek. 5 e.j.) shih më lart Oberlinius, J. J.
- Stadtmüller, Georg: *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*. Zweite erweiterte Auflage, Wiesbaden 1966.
- Tomaschek, Wilhelm në: „Paulus Realencyclopædie der Classischen Altertumswissenschaft“, Bd. 5/1, Stuttgart 1897.
- Wilkes, John: *The Illyrians*, Oxford UK & Cambridge USA 1992.

Shtojcë: Situata reale dhe hartografike e ngulimit të Pllanës (Përgatiti Gëzim Hoxha)

I: Ngulimi i Pllanës i marrë nga lart (Burimi: Google earth)



1. Shpërthja e mandeshave e fortifikimit (pa gjurmë natyresh antike);
2. Vendbanim me gjurmë natyresh të shkatërruara (nëqytet apo ndodhë edhe antike ?)
3. Kisha mesjetare e Shën Barbaras (shek. XIII-XIV)
4. Maja kodre në trajtë piramide (e pa verifikuar në përpunje arkeologjike)
5. Ura e Matit e kësaj se shpesh Zog.
6. Ura e trenit dhe ura e vjetër e rrugës automobilistike.

II: Pozicioni gjeostrategjik i Pllanës në fillim të rrjedhës së poshtme të Matit (foto: Gëzim Hoxha)



(Foto dhe përpunim hartografik nga Gëzim Hoxha): 1. Fortifikim natyror; 2. Vendbanim i braktisur mesjetar, ndoshta edhe antik; 3. Kisha e Shën Barbaras; 4. Vendbanim i fortifikuar; 5. Ura mbi Mat.

Ali ALIU

LEXIMI DHE RILEXIMI I MJEDJES

A është i mundshëm leximi nga e para i veprës poetike të Mjedjes, vepër që e kemi pranuar si vlerë përfundimisht të qëndrueshme dhe si raport të përkufizuar komunikimi? Pse duhet të lexohet poema “Andrra e jetës” menjëherë pas leximit të “Vaji i Bylbylit” për të kuptuar më drejt filozofinë jetësore të Mjedjes? A mund të mos lexohet poezia e tij duke u nisur nga teza të shtruara paraprakisht, si në frymën – është Mjedja optimist apo pesimist, të lexohen të pavarura, veç e veç pjesët brenda poemave dhe pastaj bashkërisht, poema e plotë, sepse pjesët kane reflektim të brendshëm të ndërsjellë?...

Janë pyetje të kësaj natyre të shtruara në një studim të Sabri Hamitit, me titull “Ndre Mjedja poet”, vendosur parathënie kompletit të veprave të Mjedjes, botuar nga Rilindja më 1982, i cili merr në shqyrtim edhe çështje të pavërejtura deri atëherë, por, njëkohësisht sjell dhe një lexim ndryshe të poezisë së Ndre Mjedës nga studiuesit e kohës. Studimi në fjalë prek një sërë nyjash të veprës poetike të Mjedjes që nxisin shtigje të reja, por edhe qasje ndryshe nga disa mendime të përsëritura rreth veprës së Mjedjes në shkencën letrare të shqipes.

Që në krye të studimit ai shtron pyetjen: “a mund të lexohet *habitshtëm* një tekst i njohur mirë më parë”? Pra a mund të lexohet së pari, të zbulohen sfera, shtresa të reja të tekstit të njohur mirë, tekstit të pranuar si vlerë, bile i pranuar me adhurim, shton ai... Pyetja tingëllon ngasëse, sfiduese për t’u sprovuar... Anash hamendësitë e pohimeve teorike të natyrës se teksti i qëndrueshëm si vlerë, prodhon impulse të reja komunikimi me çdo kohë dhe hapësirë, rileximi i tekstit poetik të Mjedjes mund dhe duhet të lexohet edhe nga kjo perspektivë sfiduese, nisur nga çështjet që shtron për rishikim, studimi

i Hamitit, nxjerr në shesh problemin e leximit jo të plotë, jo si një univers unik i poezisë së Mjedjes, tek ne.

Hamiti përcakton qartë kornizën e vet artistike të poezisë së Mjedjes: poema “Andrra e jetës” është kryevepra e autorit që, njëkohësisht qëndron në majat e poezisë shqipe. Dy këngët e Lokes ndërsa përbëjnë kurorën artistike të poemës. Cikli i soneteve “Lissus” dhe “Scodra”, më të përsosura në këtë zhanër poetik të shqipes... Janë ledhe vlerësimi në këtë studim që, gjatë gjithë analizës që shtron autori brenda rreth tridhjetë faqeve tekst, duhet të kihet në vëmendje... Pra, çfarë konsideron ky studiues çështje të mbetura jashtë vëmendjes së deriatëhershme (deritanishme) të lexuesit dhe të studimeve të veprës poetike të Ndre Mjedjës?

Hamiti, në studimin e tij nxjerr përfundimin se Mjedja është poet i dhembjes. Jo poet i tragjikës së sforcuar, as optimist, as disfatist; është poet që, në mbështetje të filozofisë së tij, e mbase edhe në mbështetje të petkut klerik, e përballon dramën jetësore si ekzistencë e dhënë në jetën e njeriut. Ja pse poema “Andrra e jetës”, kryevepër e poezisë shqipe, për frymëzim qendror ka bërthamën e dhembjes: që në krye shfaqet fati pikëllues i familjes mbetur vetëm me një nënë me dy vajzat e njoma, që është gjendje, situatë reale, realitet jete... Vdekja rrëmben dy nga tre personazhet: Tringën dhe Loken. Burimi i dhembjes së poetit pra është konkret, i gjallë, i përherëshëm. Edhe Zoga që mbetet fillikatisht, ka dhembjen e motrës që i mungon realisht, në njërën anë dhe, në anën tjetër, ka ëndrrën në të cilën i shfaqet trimi... Do vijë vërtet ai, do arrijë Zoga të thurë folenë familjare, - ndoshta thotë Mjedja, me që është realitet ëndërror. Logjikisht, përfundon studiuesi, se burimi i dhembjes në tringun familjar të poemës është bëmë reale dhe godet si i tillë, gëzimi, optimizmi, ndërsa është frymë ëndërrore... Sfondi i frymëzimit lirik është dhembja që, si një nga më të fuqishmet ngasje në krijimtarinë artistike përgjithësisht, e vërvit majave veprën në fjalë. Argumenti se Zoga shtrihet në katër këngë të poemës, përballë tri të Tringës dhe dy të Lokes, është përjashta përmasave cilësore dhe vlerës artistike të përgjithshme të poezisë.

Por le të kthehemi edhe njëherë te dilema: është optimist apo pesimist Ndre Mjedja? Natyrisht, nga sa u tha më sipër, autori i studimit është i mendimit: as njëra as tjetra. Është filozofi jetësore që zgjedh durimin edhe përballë anës tragjike të jetës.

Në pjesën e fundit të studimit, Sabri Hamiti ka në vëmendje dy poemat sonetike “Lissus” dhe “Scodra”. Me përfundimin e këtyre dhe me shkrimin edhe të dy tjerave që ishin në projektin e studios të tij,

Mjedja ëndërronte të shkruante historinë poetike të kombit, që nga rrënjët antike të tij, ndryshe nga rilindësit që drejt thellësive ishin ndalur te epoka e Skënderbeut. Ç'ishte kjo ngasje e poetit që përfshihet nga një perspektivë, ndjesi dhe temperament fare ndryshe nga poemat “Andrra e jetës” dhe “Vaji i Bylbylit”? Pse Mjedja durimtar, i qetë dhe poet i dhembjes, rebelohet në këtë faze të jetës krijuese? Pse betejat e bashkëkombasve të vet antikë i përfshin me hov kushtrimi, me zemërim përmasash homerike? Mos vallë të ketë qenë ngacmim frymëzimi nga realiteti i kohës së vet, i përballjes së shqiptarëve të rrezikuar rrethpërreth?

Kështu pra Mjedja paqësor, i butë, lirik sqimatar i majave në mbujtjen e artit poetik, duke e mbajtur larg detyrimeve, atë, poezinë, bën kthesë të plotë duke e vënë në mision kushtrimor? Ajo që është e rëndësishme të thuhet me këtë rast vjen natyrshëm: poeti, poezia, arti i vërtetë, edhe kur përfshihet shpirtërisht edhe nga misioni, kur shpërthen në kushtrim, siç ndodh me Mjedjen, nuk zbret nga majat, që, si fenomen, lejon edhe hamendësime teorike.

Ngasja bosht e frymëzimit drejt realizimit të dy poemave të përmendura – “Lissus” dhe “Scodra”, është zemërimi, mnija ndaj armikut – atij antik apo i kohës së vet? Si duhet të lexohen ciklet sonetike, si synim i poetit për një poemë, përkatësisht për një ep lirik, për të sjellë epokën, rrënjët antike të kombit dhe kulturën shkrimore të shqipes ta begatojë me këndime homerike, apo ishte shqetësim nga rreziku i kohës së tij për etninë? Besoj se duhet të jenë të hapura si njëra si qasja tjetër: t’i sjellë bashkëkombësit në sërën e fiseve më të zgjedhur dhe, njëkohësisht, të zgjojë dhe ushqejë ndjenjën e atdhedashurisë, vigjilencën përballë rreziqeve të kohës përreth. Fryma e kushtrimit, që mbizotëron me këtë rast, e bën më të besueshëm ngasjen e dytë.

Por jo vetëm nga ky studiues del kurorë e artit poetik të Mjedjes “Andrra e Jetës” që shpreh qëndrimin dhe formimin filozofik të tij mbi botën dhe që, bashkë me “Vajin e Bylbylit” në bërthamën përmbajtësore ka dhembjen dhe durimin e njeriut dhe ku vibron butësia dhe delikatësia shpirtërore e lirikut. Fill pas këtij përfundimi, kurora tjetër e artit poetik vijnë ciklet sonetike “Lissus” dhe “Scodra” që për frymëzim kanë rrënjët antike të etnisë dhe fatin dramatik, epik dhe tragjik të saj. Në këtë degëzim zhanri, Mjedja i butë dhe paqësor, shfaqet luftarak tek sonetet, përkatësisht në tërë lirikën patriotike, dhe që përben vëllimin kryesor të poezisë së këtij autori. Lirika patriotike e tij, në këtë lloj të poezisë shqipe është e veçantë. Ajo, përballë mallit

dhe lektisjes romantike të Rilindjes dhe asaj në frymën e patosit më vonë në letërsinë tonë. Malli dhe përhumbla romantike nga larg, tek Mjedja nuk e sjellin etninë, vatrën, natyrën, gjithësinë vendlindjen dekor, në funksion të zërit të përmalluar dhe të afshit patriotik, po përkundrazi: tek Mjedja largësia, vendi i huaj janë episod, ndërsa dheu, mali, Drini, Taraboshi, Rozafa, Shkodra, janë prani përjetësie, janë dhuratë qiellore e atdheut, dhe poeti ju falet, ju këndon oda atyre..., si tek poezia e shkurtër “Ëndrra”. Kaq, nuk kërkon asgjë për vete, as dëshmi, as faktorizim të mallit, të zërit të vet, siç ndodh te lirika patriotike me shijen e patosit sidomos.

Gjithnjë lidhur me lirikën patriotike të Mjedjes, Hamiti përmend edhe çështjen e ndikimit si qëndrim të artit poetik, ndikimit në përditshmëri, në rrjedhat historike, në fatet. Tek ciklet sonetike “Lissus” dhe “Scodra”, më të realizuarat në këtë lloj të lirikës shqipe, Mjedja jo vetëm që e ngre në mision ndikues atë, poezinë, të mbajtur larg tek poemat e dhembjes, por i vë krahë kushtimi asaj, nga njëra anë, nga ana tjetër, nuk e zbret nga majat artistike... Të bërit bashkë këto dy prirje, duhet pranuar se janë fenomen i rrallë, prandaj nxisin sfida përsiatjesh... Çështje tjetër, gjithnjë lidhur me këtë lloj të lirikës është edhe rebelimi kushtimor i Mjedjes, me këtë rast, të jetë vetëm në mision të dëshmisë së rrënjëve antike të etnisë apo edhe shqetësim i kohës së poetit, i vetë poetit, nxitur nga lakmitë përreth etnisë? Mbase të dyja bashkë, por nisur nga toni, ritmi furioz i rebelimit, duket sikur nxitet nga nevoja për ta mbajtur zgjuar vigjilencën e etnisë përballë rreziqeve.

Çështje që duhet rishikuar dhe të cilën e prek në studimin e vet Sabri Hamiti, është edhe ajo e varianteve të një pjesë e poezisë së tij. Siç dihet Mjedja, gati të gjitha krijimet e veta i ka botuar me vonesë, pra i ka mbajtur dhe rishikuar gjatë në studion e vet, punë që ka prodhuar nga disa variante të poemave. Gjatë botimit të teksteve, edhe pas vdekjes së poetit, kryesisht janë preferuar variantet e fundit. Pse? A janë vënë përballë njëra-tjetrës variantet në fjalë, ato të parat frymëzime të lirikut të ri, përballë lirikut me formim shkollash filozofike dhe poetike, përkatësisht hovi rinor i lirikut përballë mjeshtrit të pjekur që i ka gdhendur vazhdimisht vargjet e veta?

Opusi poetik i Ndre Mjedjes, modest si vëllim, por i majave artistike të shqipes, për të cilën është thënë shumë, megjithatë nxit dhe hap vatra që pluskojnë si shkrepje, zbulime leximesh dhe rileximesh të reja.

Shaban SINANI

IKJA PREJ RIMËS GRAMATIKORE SI IKJE PREJ RAPSODISË

I.

Ndre Mjeda e filloi veprimtarinë e vet krijuese në *zenithin* e shekullit të romantizmit dhe e përmbylli në *perigjeun* (gr. *περίγειος*) e lulëzimit të modernitetit. Kjo ka paracaktuar vendin e tij ndërmjet fundit të njëres epokë letrare dhe fillimit të tjetrës.

Nëse në frymë dhe në frymëzim, gjithashtu dhe në rrafshin tematologjik, nga studiuesit Ndre Mjeda vendoset më lehtësisht pranë të fundmëve të romantizmit; për sa u takon modeleve të vjershërimit, zgjedhjes së poetikave, teknikave të të shkruarit, do të përafrohej më me bindje me *modernizuesit e parë* të letërsisë shqipe.

Kjo ndërthurje e ndërlikuar mund të shpjegohet me cilësinë e personalitetit të Ndre Mjedës, si një ndër *tre poetët e ditur, tre poetët filologë* të historisë së letërsisë shqipe, sipas përcaktimit të prof. Rexhep Ismajlit, i cili i bashkon emrit të tij edhe Martin Camajn dhe Besim Bokshin: tre poetë, tek të cilët ligjërimit poetik përfitoi shumë prej ligjërimit gjuhësor; figura gjuhësore dhe figura letrare ndërvepruan; vetvetishmëria e talentit dhe njohjet e thella të mjeshtrit të fjalës shqipe u ndërthuren me një fuqi të tillë shprehëse, që do të mund të merrej si manifestim i mundësive nyjetuese të shqipes.

Pikërisht padukshmëria e kufijve midis poetit e dijetarit, mjeshtrit të fjalës dhe njohësit të fjalës, dhe anasjelltas, mund të shpjegojë burimin e debateve shkencore për përkatësinë e mundshme të Ndre Mjedës në disa rrjedha të kodifikuara të letërsisë: klasicizmi a neoklasicizmi, romantizmi, realizmi dhe madje edhe simbolizmi.

Kjo pyetje mund të marrë një përgjigje duke pasur në vëmendje prirjet dhe zgjedhjet e Ndre Mjedës në modelet, teknikat dhe poetikat e

prozodisë; para së gjithash në *modelet e rimëformimit*, në prozodi dhe retorikë, si një çështje e pavarur prej regjistrimit të shqetësimeve letrare që ato veshën, romantike apo moderniste qofshin.

Me termin *rimë gramatikore* i jemi referuar *eufonisë formale* që krijon vetë *sistemi i eptimit* në gjuhën shqipe, një sistem me fuqi njësuere të pakrahasueshme me gjuhët analitike, qoftë në *fjalët quajtëse*, por sidomos në ato të *veprimit*. Mjafton të sjellim ndërmend se ç'peshë zënë në paradigmen e sistemit foljor të shqipes format që përmbyllen me diftongun *-ue*, gjegjësisht me grupin *-uar* në toskërisht; si dhe mbiemrat prejfoljorë të veprimit me vlerën aspektive të së kryerës; pa llogaritur emrat e veprimit me *-im*, për të vlerësuar *luksin bujar* që ofron gjuha shqipe për *rima të gatshme*, prej *formës* dhe jo prej *fjalës*; për të pasur të qartë dallimin midis rimës së gjuhës së popullit dhe asaj të gjuhës së mjeshtrit. Pikërisht ky term na lejon të bëjmë një dallim tipologjik midis *rimëformimit prej fjalës* dhe *rimëformimit prej trajtës*, apo prej eptimit.

Shprehur në formën e një pyetjeje, çështja që përbën interesin themelor të kësaj trajtese është: në ç'hierarki gjenden në poezinë e Mjedës rendi gjuhësor dhe rendi poetik, forma gjuhësore dhe forma poetike, theksat gjuhësorë dhe theksat prozodikë; ritmet gjuhësore dhe ritmet poetike; rimat gjuhësore dhe rimat poetike. Tentimi i trajtesës është mundësisht të provojë se në këtë vepër mbisundon *rimëformimi prej fjalës* për dallim nga *rimëformimi prej trajtës*, rendi poetik mbi rendin gjuhësor, ritmi dhe theksat poetikë mbi ritmet dhe theksat gjuhësorë.

II.

Në lidhje me termin tjetër, me përkufizimin kushtimor të *rapsodisë* dhe kuptimin e *ikjes* prej saj, do thënë se çështja në shqyrtim ka lidhje me një histori të gjatë të metrikës dhe prozodisë së vjershërimit shqip, para së gjithash *me historinë e shfaqjes dhe të ekspansionit të rimës* në traditën popullore e në letërsi, që prej fillimeve të saj, me *Ungjillin e Pashkëve sipas Shën Matteut*, që ruhet në Bibliotekën *Ambrosiana* të Milanos*, deri në kohën kur shkroi e botoi Ndre Mjeda.

Dihet mirë se vjershërimi tradicional shqip *ka qenë shpërfillës ndaj rimës*. Në themel të prozodisë klasike shqiptare ishin faktorë të

* Ekzistencën e tij e bëri të ditur për herë të parë Sofronio Gassisi, në *Contributo alia storia del rito greco in Italia*, ediz. di tip. italo-orientale S. Nilo, Grottaferrata 1917.

tjerë të poetikës. Vargu misionar i këngëve heroike, dhjetërrokëshi, që u shthur në dy shekujt e fundmë, ishte rregullatori kryesor i këngës epike. Kënga heroike legjendare e detyronte shqipen të shprehej rreptësisht në *dhjetërrokësha*. Edhe nëse vargu ishte *polimetrik/heterometrik* në tejshkrimin formal-gjuhësor, lahuta e shtendoste ose e ngërthente brenda *dhjetërrokëshit imperial-urdhërues*. Ky ishte një rend gjuhësor që nuk ekzistonte jashtë eposit. Lahuta i jepte mundësi këngëtarit të dyfishonte rrokjen, të asimilonte rrokje dhe vargu të mbërrinte në dhjetë rrokje. Çdo përpjekje për ta përkufizuar vargun e eposit jashtë pushtetit të lahutës për ta shtrirë në dhjetë rrokje, pavarësisht se tejshkruesit sot vargu mund t'i dalë polimetrik, nga 6-rrokësh deri në 16-rrokësh, do të ishte e gabuar. Gramatika e sotme dhe as ajo historike e shqipes nuk janë të mjaftueshme për botën e eposit¹.

Në këngët heroike legjendare rima ose nuk ekziston fare, ose, edhe kur ekziston, del vetëm për rastësi. Dallimet thelbësore në prozodi e metrikë ndërmjet eposit heroik dhe këngëve historike i ka sqaruar një herë e mirë Arshi Pipa para 40 vjetësh, në studimin e tij *Albanian Folk Verse: Structure and Gendre*: në bazën e prozodisë së hershme shqiptare ka qenë *vargu gnomik-topik indoeuropian*, me karakter *tonik-melodik*, gjurmë të të cilit ruhen ende në *paremiologji*² dhe përgjithësisht në ligjërimet konservative etnografike, ndërsa në këngët historike sundon një metrikë e prozodi tjetër, e mbështetur mbi 8-rrokëshin e rregullt dhe rimën, zhvillim i vonët historik-folklorik.

Jo vetëm në eposin heroik legjendar të Veriut, por dhe në këngët historike të arbëreshëve të Italisë, *rima* nuk ishte e njohur. Pikërisht në kohën kur vargu i epopesë heroike legjendare, për shkak të ndryshimeve në të kënduarit, e humbi vargun misionar dhe u bë *isometrik* dhe *isoritmik*, doli nevoja e zëvendësimit të mjeteve poetike të vjetra dhe u shfaq një dukuri e re: *rima*. Kjo gjen shpjegim me prishjen e *marrëdhënies trekëndore* që kanë përkufizuar Milman Parry e Albert Lord, *instrument-këngëtar-rapsodi*³, që ndodhi në kohën kur vendin e lahutës shkallë pas shkallë e zuri *sharkia* ose *çiftelia*. Prej kësaj dukurie

¹ SINANI, Shaban (2010), *Etnos në epos*, bot. Naimi, Tiranë, f. 70.

² PIPA, Arshi (1978), *Albanian Folk Verse: Structure and Gendre*, në *Albanische Forschungen*, Bild nr. 17, edit. Trofenik; përkthyer shqip me titullin *Vargu folklorik shqip*, bot. Princi, Tiranë 2013: *All existing metric and rhyme patterns are found, rudimentary of full-fledged, in gnomie verses. Older than ictus-syllabic verse is syllabic verse which occurs in proverbs and riddles.*

³ LORD, Albert (2000), *Performance and Training*, në *Singer of Tales*, second edition (Stephen Mitchell and Gregory Nagy editors), Harvard University Press, Cambridge-Massachusetts-London, p. 13-30.

të re, e cila në thelbin e vet shënjonte ekspansionin e mjeteve të llojeve dhe nënlojeve jashtë epikës në këngët heroike legjendare, u shkaktua shthurja përfundimtare e *vargut misionar dhjetërrokësh* të rapsodisë dhe u bë e detyrueshme zëvendësimi i mjeteve të mëhershme të vjershërimit me *rimën*.

Në dy fragmentet e mëposhtme, prej këngëve epike heroike legjendare, regjistruar në kohë të ndryshme, para dhe pas prishjes së *marrëdhënies trekëndore* (zëvendësimit të *lahutës* nga *sharkia* dhe *çiftelia*), bëhet e dukshme se çfarë ndodhi në procesin e kapërcyellit prej vargëzimit popullor *pa rimë* tek ai *me rimë*, që u dha vlerë barazimeve formale tingullore të përfuara prej eptimit dhe kalimit prej *epit* në *rapsodi*:

Martesa e Halilit, ep⁴

Faqe-bardhë, ju kjoshi, more shokë,
Se mirë hallin po m'a dik'i, burra!
Manà paret s'm'u kan dhimbët me i **dhânun**,
Manà, darsmat s'm'u kan dhimbët me i **bânun**,
Ju t'pa-vllazën, shokë, s'kini qillue:
Kuj po i dhimen darsmat për vllà t'vet?
Ky dhe s'është, or burra, cub **fligshtish**,
Mirë e njihni, se â daji **trimnish**.
Qi për n'dashtë me m'prû marren te shpija,
He, ktij Zoti i shkimët hisen e diellit!
E n'pastë menden me na koritë fisin,
Gjurma, rê, qetash me kokër rrfeje!
Zirma, tokë, përjashta n'natë të vorrit!

Kanga e Milush Kopiliqit, rapsodi*

Kqyr Milushi shka u paska thanë:
- Ndal kadal', o kral, ja ban,
Edhe un' kam me u **shtrëngue**,
Vet te mbreti un' kam me **shkue**,
N'ma dhashtë mbreti dorën mue,
Unë atij kam me ju **dorëzue**,
Se n'ma dhashtë ai kambën mue,
Me hanxhar kam me **shitue**!

Fuqia vetëruajtëse e sistemit të vjetër të vjershërimit në poezinë popullore arbëreshe mbijetoi edhe gjatë romantizmit e më vonë. Kjo nuk kishte ndodhur edhe me poezinë e ngulimit tjetër, më të

⁴ PALAJ, Bernardin; KURTI, Donat (1937), *Visaret e Kombit*, vëllimi II, Tiranë 1937, f. 23-41.

* *Këngë legjendare për Milush Kopiliqin*, kënduar në festivalin e Gjirokastrës, viti 1988 dhe Prentash Nilaj. Citohet si tek QERIQI, Ahmet (2003), *Milush Kopiliqi, serb apo shqiptar*, Prishtinë. Sipas autorit, në vitin 2006 gazetarja dhe intelektualja Anna di Lellio ka regjistruar vetë një fragment të *Këngës së Betejës së Kosovës*, kënduar nga Halim Budakova dhe Azem Tahiri.

vjetër, me vjershërimin popullor të arvanitëve. Kur Panajot Kupitori përshtati në të folmen e Hydrës kangjeljin nr. 7 të *Milosaut*, ndryshimi më i rëndësishëm pati të bënte me nënshtrimin e vargut të De Radës ndaj *isoritmisë*, *isometrisë* dhe pjesërisht edhe ndaj *isorimit*. Kangjelji i *Milosaut* në procesin e përshtatjes prej P. Kupitorit në pikëpamje të prozodisë u tjetërsua: sistemi i vjetër ndryshoi regjistër, ashtu si ndryshuan *këngët e lahutës* kur kaluan në një instrument tjetër. Më pranë toskërishtes dhe polifonisë, ashtu si në ndonjë të folme e ligjërim tradicional popullor jugor brenda hapësirës shqiptare*, arvanitikishtja e Kupitorit e përndryshoi tipologjikisht vargun e *poemës së dyfishtë lirike*, siç e quante *Milosaun* autori. Përshtatja e P. Kupitorit pajton ritmin me sasinë e zanoreve si në gjedhet inovative folklorike të shekujve të vonshëm⁵.

Siç kanë mundur të provojnë tashmë studiuesit arbëreshë Francesco Altimari e Nicola Scaldaferri, poezia arbëreshe cilësohet prej *ritmit tonal vetërregullues* sipas modeleve poetike popullore, që *qëndron mbi kuantitetin formal fonologjik*. Poezia e Jeronim de Radës, në pikëpamje të theksimit tonal-rrokjesor, *është agramatikore*; vendosja e theksave nuk i nënshtrohet të njëjtit rend shqiptimi si në përdorimin e përditshëm; masat tonale prozodike në shqiptimin e saj janë të ndryshme prej ligjëritimit të zakonshëm gjuhësor. Edhe në parimet teorike-estetike të De Radës, në *Principi di estetica*, siç vërejnë studiuesit, rima dhe ritmi në poezinë shqipe cilësoheshin të papërshtatshme: *La rima, che alla nostra lingua, è impropria, porta sempre offensione a grammatica*⁶.

* Agramatikorësinë në prozodinë popullore tradicionale, historike e lirike, përkundër rendit normal-intonativ të ligjëritimit jashtë poetikës, kemi pasur rastin ta vërejmë edhe në fshatrat e Bregut të Detit, gjatë një ekspedite të karakterit ndërdisiplinar. SINANI, Shaban (2004), *Himara, identiteti i bashkësisë dhe etnotipi*, në *Himara në shekuj*, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, f. 328-349.

⁵ SCALDAFERRI, Nicola (2014), *Strutture ritmiche nella versificazione tradizionale arbëreshe: una proposta di analisi*, në *Letërsia dhe kultura arbëreshe: Jeronim de Rada në 200-vjetorin e lindjes*, konferencë e organizuar nga Universiteti Aleksandër Xhuvani dhe mbajtur në Elbasan më 4-5 qershor 2014; gjithashtu: ALTIMARI, Francesco (2005), *Introduzione, La metrica*, p. 65 passim, në *Girolamo de Rada, Omera omnia*, vol. VI, *Skanderbeg sventurato* (a cura di Vincenzo Belmonte), Rubbettino Editore. Shih dhe MARCO, Costantino (2003), *Cenni sulla metrica del De Rada*, në *Omaggio a Girolamo De Rada* (a cura di Italo C. Fortino), Microprovincia, Napoli.

⁶ DE RADA (1884), *Girolamo, Fiamuri Arbërit*, maggio, p. IV.

Sistemi i vjetër i prozodisë së letërsisë arbëreshe dhe ai këngëve epike legjendare kanë diçka thelbësore të përbashkët⁷. Kjo duhet të lidhet edhe me veçoritë e rendit gjuhësor shqiptimor të të folmeve skajore. Dallimet midis formës së shkruar dhe formës së shqiptuar në poezinë e De Radës, gjithaq dhe në këngët heroike, duhet të lidhen sa me të quajturën *rrokje jo-sonorike, rrokjen e panumërueshme* (në rastin e eposit heroik verior më së pari zanorja ë), sipas përcaktimit të studiueses polake Irena Sawicka, aq edhe me dukurinë e përkundërt, të *bashkëtingëlloreve silabike* rrokjeformuese në shqiptim, *me një jehonë vokallike të lehtë*⁸ (kryesisht në poezinë e arbëreshëve). Falë analizës filologjike të Francesco Altimarit dhe vëzhgimeve etnomuzikologjike të Nicola Scaldaferri-t, kjo çështje e historisë së prozodisë, ose më saktë e dy epokave të prozodisë shqipe, klasike e moderne, ka marrë një zgjidhje shkencore. Për të shpjeguar të ashtuquajturat *parregullsi metrike* të De Radës, të pafrytshme kanë rezultuar analizat *klasike*, të cilat, edhe pse kanë vënë në pah kujdesin ndaj përbërësit ritmiko-formulaik të vargut dhe ndikimet nga poezia popullore, nuk kanë arritur të identifikojnë një sistem që t'i nënshtrohet një logjike procedimesh metrike, qofshin ato edhe të vargut të lirë⁹. Kështu, sipas Nicola Scaldaferri-t, për të kuptuar sistemin metrik të De Radës duhet përmbysur metoda e analizës duke vënë në qendër të vëmendjes *performancën e vargjeve të recituara, zhvillimin konkret dhe zgjatjen kohore me anë matjesh të thjeshta kronometrike*¹⁰. Me fjalë të tjera, siç ka shkruar Matteo Mandalà, zgjidhja e enigmës së vargut deradian nuk qëndron në analizën metrike të teksteve të shkruara, por në analizën e vargjeve të recituara sipas traditës së poezisë gojore arbëreshe¹¹.

⁷ PIPA, Arshi (1978), *Hieronymus de Rada*, edit. R. Trofenik, Muenchen, *Albanische Forschungen* 18.

⁸ SAWICKA, Irena (2015), *Struktura e rrokjes arbëreshe*, në Bardhyl Demiraj, Matteo Mandalà, Shaban Sinani (përg.), *Edhe njëqind! - Studime në nderim të prof. Francesco Altimarit me rastin e 60-vjetorit të lindjes / Studi in onore del prof. Francesco Altimari in occasione del 60° compleanno*, bot. Naimi, Tiranë, p. 602-603.

⁹ SCALDAFERRI, Nicola (2008), *Appunti per un'analisi della versificazione tradizionale arbëreshe*, në *Omaggio a Girolamo De Rada. Atti del V seminario internazionale di studi italo-albanesi e altri contributi albanologici*, a cura di Francesco Altimari e Emilia Conforti, Università della Calabria, ediz. Rende, p. 355.

¹⁰ Idem, *ibid.*

¹¹ MANDALÀ, Matteo (2015), *Mbi formimin rinor të Jeronim De Radës (1822-1837)*, botuar në *Hylli i Dritës*, nr. 1-2.

III.

Këtë parantezë e konsideruam të domosdoshme, sepse përmes saj kemi mundësi të njohim *kapërcyellin nga njëri sistem metrik në tjetrin*. Ky proces kapërcyelli, në vjershërimin në gegërisht, por në ndonjë rast edhe në atë të arbëreshëve, u shoqërua me *invazion e rimës*, kryesisht të *rimës prej eptimit*, të asaj rime që e krijon vetë gramatika, e njohur ndryshe si *rima e gatshme*. Këtu do të paraqesim katër shembuj të kësaj dukurie, dy prej të cilëve kanë veçori të ndryshme prej kalimit të zakonshëm nga tradita në rendin e ri. Është fjala për:

1. *Rapsoditë* e vona të Giuseppe Schirò-it (*Mino, Liriche sparse*), të modeluara sipas gjedheve të këngëve heroike të Veriut, të cilat ndoqën jo traditën e epeve klasike shqiptare, por prozodinë dhe metrikën e vargut tetërrokësh, që u shfaq kur lahuta u zëvendësua prej *sharkisë* dhe *çiftelisë*, rast i rrallë në poezinë arbëreshe deri në shekullin XX.

2. Për një dukuri tjetër, atë të *rimës së zgjeruar* (që mund të quhet dhe *rimë ekstensive*) me shtimin e një *formanti gjuhësor parazitar*, thjesht rrokjeshtues dhe rimëforcues, kemi zgjedhur disa poezi të Hilë Mosit*.

Dy rastet e tjera të përdorimit të *rimës foljore* si rregullator bazë të poezisë, janë cituar nga vepra e Gjergj Fishtës dhe nga poezia popullore.

Të katër rastet e bëjnë më të qartë dallimin midis *epit* dhe *rapsodisë*. Ndërsa nga dy rastet e fundme bëhet e mundur të krahasohet funksioni i rimës së gatshme si mjet përdallues, tërësisht funksional, për *një skemë komunikimi që bashkon autorin, rapsodinë dhe dëgjuesin*, jo me lexuesin, siç është në natyrën e letërsisë. Mund të pohohet se rimëformimi prej trajtave të eptimit krijon *rapsodinë* dhe ikja drejt rimëformimit prej eufonisë formale gjuhësore, *rima e vetë autorit*, krijon *letërsinë*:

* Ekstensionin formal të eptimit të fjalës për të dyfishuar e përforcuar rimën tek poezia e Ndre Mjedës e kemi gjetur vetëm në një rast: *himun, ndiemun* (vjersha *Nji shoqit qi kthete n' Shqypni*).

I. Giuseppe Schirò

1.

Ishe i pari ndë Mīrdit¹²
 Ìll i dhezur, Ìll me drit.
 Mēmën tēnde ti **gëzove**,
 Se nkā gjumi bijt i **zgjove**;
 Po ti vet nënk u **shpëtove**,
 Me pā-hir te i huaji **shkove**.
 Jerdhën turqit e **të zūn**,
 Te një burk i zī **të shjtūn**,
 Prān tre zet ndë mes **të vūn**,
 Tek i huaji dhē **të shprūn**.

2.

I shēn Gjergji e i shēn Mitri
luftuan¹³
 për të vërtetēn fē, ngjera çē **rruan**;
 pā u tundur mballē armiqēvet
qëndruan;
 tue derdhur gjakun, Perëndīn
lëvduan.
 Po, n'qiell tue klēnē, ata ngē na
harruan
 t'Lartit, me të dashur, na
kujtuan;
 dhe të keqeshit pa le se na
shpëtuan,
 po t'mira pā të matur na
dhuruan.
 Si t'parēt tanē te rreziku
mpuruan,
 ashtu neve të ndihnjēn edhe **duan**;

II. Hilë Mosi

1.

Ah, një dit', kur Shqypnia e **liruemun**
 E gjuha faqeza nëpër bot' t'i dalë,
 Ather' krejt e ngrata **kundendumun**
 Me gëzime ty ka për t'u përfalë,
 Se ti at' pend' si kordh' je **tue përdorumun**
 Për nder edhe për fam' të Shqipnisë...
 Hovin tand ti kurr për pa e ndalë,
 M'nji për liri t'atdheut je **tue luftuemun**.

Me at' zemër t'dhanum krejt mbas dashtnisë,
 Që t'atdheut dashtnore asht bamun valë;
 Zemrat shqypitare pesh' asht **tue çuemun**,
 Ma fort në tjetër që jem' jasht' Shqypnisë!

Un', djal' i ri, sot tye jam tuj t'u falë
 Për kang't e bukura që **ke kënduemun**,
 Porsi një bylbyl i djegun mbas dashtnisë,

Që kndon në pyll kangët palë e palë.
 Të gjith dashtnorët e mjer' **tue përvëlueun**:
 Kshtu kndon ti sot në gjuh' të Arbënisë¹⁴.

2.

Ça zemrën teme kështu sot pesh' **ka çuemun**?
 Pse sot qetsi nuk kan' kto mendt e mia?
 Çmos kurr pse ma e re po m'ngjan djelmia
 E zemra her' asht n'gzim e herë e **hutuemun**?

¹² SCHIRÒ, Giuseppe (1997), *Kryengritja shqiptare*, në *Liriche sparse*, në *Opere*, vol. VII, a cura di Matteo Mandalà, ediz. *Rubbettino*, Pianna degli Albanesi, p. 30.

¹³ SCHIRÒ, Giuseppe (1997), *Kënka të përshpyrtëshme*, në *Opere*, vol. VI, a cura di Matteo Mandalà, ediz. *Rubbettino*, Pianna degli Albanesi, p. 280.

¹⁴ MOSI, Hilë (1904), *Jasht atdheut*, 5 tetor.

e duan me të vërtetë, edhe e
dëftuan,
kūr i thirrëm me besë e na **gëzuan**.

Po e dij mjaft mirë, se jam **tue provuemun**:
Në zemër teme ndrye asht dashunia,
E n' mende teme siellet fantazia,
Tue m' lan n' dyshim e nga një her' **të gzuemun**.

Un' kaq të flakt' s' e pata kurr **kujtuemun**!
E dijshe t' vogël krejt sikur shkëndija,
Që veç një çast flakron, së shpejti prap **mu shuemun**.

Po tash po e ndiej, se po ma njeh fuqia,
qi n' trupin tem gjithnji vjen tue **u ndrruemun**,
P'e dij se ç' asht ajo: asht' bukuria¹⁵.

III. Àt Gjergj Fishta

Pasha Zotin: kjoftë **lëvdue**!
Edhë kshtu s' mûjm me **durue**.
Pushken sod un i a kam **vûe**,
Mandej dalët si kjoftë **gjikue**.
Kshtû tha Deda, e si **shtërngue**,
Veshë e mbathë kishte **qillue**¹⁶.

*

* *

Ata janë do Lekë t' Malcís,
Qi n' kushtim të Pashës s' Gucís,
Prej Vishnjevët na janë **çue**
N' at Sutjeskë n' luftë me u **flakrue**,
Për me dekë, a për me **pshtue**,
Si prej Zotit t' jetë **gjikue**,
Gjallë Shqypnin por mos m' e
lshue¹⁷.

IV. Këngë popullore

N' Përzeren haberi a **shkue**,
Se n' Goriq, more, kanë **liftue**,
Shaqën n' ven, Sherifin **varrue**.
Hanmi i pashës n' kam' na u **çue**,
Hanmi i pashës a dalë n' çarshi,
Pa tërlík edhe pa avli,
Ja ka msy-o n' saraj a hi:
Fetah pasha more zotni,
A ma gjanë ti-o ni koçi?
Ni koçi-o me ma gjetë mue,
O n' Goriq, po thonë, kanë **liftue**,
Shaqën n' ven, Sherifin **varrue**,
Shum jetima m' kanë lanë m' i **rue**.
Fetah pasha ju ka **ngërmue**:
- Merri thmin, n' Malsi m' u **martue**!

¹⁵ Po aty.

¹⁶ FISHTA, Àt Gjergj (1937), *Ded Gjo Luli*, në *Lahuta e Malcís*, Shkodër, vv. 35-40.

¹⁷ FISHTA, Àt Gjergj (1937), *Pater Gjoni*, në *Lahuta e Malcís*, Shkodër, v. 104-110.

IV.

Ndryshimi që solli Ndre Mjeda në poetikën e letërsisë shqipe që i shumanshëm. Ky ndryshim preku modelet e vjershërimit, organizimin e poezisë në strofa, tipologjinë e vjershave dhe *sistemin rimuer*, nëse do të përdornim një term të Kolë Ashtës, autor i një fjalori të gjuhës së veprave të tij, që ruhet ende në dorëshkrim në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Nga një numërtim jopërfundimtar, ky fjalor, dalë prej veprës letrare dhe një pjese të përkthimeve agjiografike e katekistike, përmban afro gjashtë mijë njësi të leksikut të gjuhës shqipe¹⁸, duke e renditur Ndre Mjedën në një prej autorëve *me leksikun më të pasur e më aktiv të kësaj gjuhe përgjatë shekujve*. Duke pasur parasysh se Mjeda shkroi vetëm poezi dhe fare pak prozë (ku po përfshijmë disa përkthime librash liturgjikë dhe studimet dhe publicistikën), që do të thotë se objektivisht mundësitë e ofruara prej llojit të lëvruar i kishte të kufizuara, mund të pranohet se gjuha shqipe me veprën e tij arriti një fuqi shprehëse të pakrahasueshme me atë të bashkëkohësve dhe të pasardhësve.

Në formën e një shtojce, fjalorit të veprës së Mjedës Kolë Ashta i ka bashkuar dhe *rimarin*¹⁹, tërësinë e rimave të poezisë së tij, vendosur në rend alfabetik, duke iu referuar sistemit zanor, që realizon pajtimin eufonik të vargjeve sipas zgjedhjes së autorit²⁰. Këtu nuk është vendi të ndalemi në tipologjinë e rimave të Mjedës, sepse këtë çështje e kanë sqaruar ata që janë marrë me të, qoftë dhe në mënyrë të pjesshme: dikush me tingëllimën²¹, dikush me poemën, dikush me vjershat për fëmijë. Kolë Ashta ka numërtuar vetëm llojet e rimave,

¹⁸ ASHTA, Kolë (pa vit, por jo më vonë se viti 1955), *Fjalori i plotë i nxjerrun nga shkrimet e Mjedës dhe rimari*, dorëshkrim, ruhet në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Dosja 54, nr. invent. 273, 430 fl. *Rimari* gjendet në fl. 383-430.

¹⁹ Ndoshta, vërtet Mina Gero, kur hartoi *Fjalorin rimor të Dritëro Agollit*, nuk ishte në dijeni të këtij termi-neologjizëm, të krijuar dekada më parë prej Kolë Ashtës. Ndryshe, më së paku, qoftë dhe për të shmangur një homoformë të padëshirueshme për një leksemë-term, me të kryerën e thjeshtë vetë e tretë njëjës të foljes *rimarr*, *rimora*, do të kishte pasuar zgjedhjen e të parit. Në parathënien dhe hyrjen e botimit, po ashtu dhe në shenjimet në libër, nuk gjejmë ndonjë të dhënë që autori i fjalorit të pohojë se ka shprehur interes për dorëshkrimin e Kolë Ashtës. Këtë e përforcon pohimi në pasthënie të botimit, që *ky është i pari fjalor i këtij lloji gjer më sot i botuar në gjuhën shqipe*. Shih GERO, Mina (2013), *Fjalori rimor i Dritëro Agollit (morfologjia e rimemave, konkordanca, fjalësi)*, bot. Toena, Tiranë.

²⁰ ASHTA, Kolë, po aty.

²¹ KRASNIQI, Milazim (2005), *Soneti në poezinë shqipe*, bot. Pen Center - Kosovë, Prishtinë, f. 95-111.

për të cilat thotë se janë mbi 400²². Duke qenë se numri i përgjithshëm i fjalëve të rimuara është 2040 (që do të thotë rima gjithsej 1020), mesatarja e përsëritjes së një modeli rime është 2.5²³.

Rimari i Mjedës, përfunduar bashkë me fjalorin nga Kolë Ashta në vitin 1955 dhe dorëzuar në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë një vit më vonë, nuk është i vetmi i mbetur deri më sot në dorëshkrim. Ka pasur një qëndrim refuzues ndaj fjalorëve autorialë gjatë një gjysmë shekulli, me sa duket edhe nga druajtja se botime të tilla mund t'i bënin autorët të krahasueshëm dhe kjo mund të çonte në prishjen e hierarkive zyrtare, qofshin për shkrimtarët bashkëkohorë, qofshin për ata të traditës apo për të dyja palët së bashku²⁴. Por, ndryshe prej dy fjalorëve të tjerë të karakterit të *rimarit*, njëri i hartuar po në vitet 1950 nga Alfons Dovana dhe i dyti disa vite më vonë nga Shefqet Karaj, dorëshkrimi i Kolë Kamsit ruhej në një institucion kërkimor, ishte pjesë e trashëgimisë së tij intelektuale dhe shërbehej për njohje e studim për kërkuesit e brendshëm dhe bashkëpunëtorët. Prandaj ngjan pak e çuditshme që autori i të *parit fjalor rimar të botuar në gjuhën shqipe, Fjalorit rimor të Dritëro Agollit*, në një intervistë të botuar menjëherë pas daljes së librit nga shtypi, pohon se deri atë vit nuk kishte pasur dijeni për *Rimarin e Mjedës*. Por dhe të dhënat që përmenden prej tij për përligjjen e mosnjohjes janë më shumë anekdotike, duke përfshirë historira që lexuesit ia ndërlikojnë dhe i mbushin mendjen për pamundësinë e këshillimit të dorëshkrimit (sipas tij, historira të *përmendura në media*, si: *dorëshkrimi u gjet i fshehur në familje poshtë shtratit* etj.). Në fakt, për këtë punë të hershme të Kolë Ashtës dhe dorëshkrimin e tij të ruajtur e të shërbyeshëm lirisht në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë kemi pasur rastin të japim të dhëna të plota për studiuesit qysh në vitin 2007, madje pikërisht në Universitetin *Luigj Gurakuqi* të Shkodrës, në

²² Rreth 280 skema rimore ndeshen në poezinë e Agollit. Vetëm në strofat me gjashtë vargje janë përdorur 49 lloje skemash rimore. Krhs GERO, Mina (2013), *Hyrje e autorit në Fjalori rimor i Dritëro Agollit (morfologjia e rimemave, konkordanca, fjalësi)*, bot. Toena, Tiranë.

²³ SINANI, Shaban (2010), "*Rimari*" i Mjedës në një studim në dorëshkrim të K. Ashtës, në *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, bot. Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, f. 35-40.

²⁴ *Fjalori rimar i gjuhës shqipe* i Alfons Dovanës, në dy vëllime, dorëzuar për shtyp në vitin 1960, u refuzua pa asnjë vërejtje të shprehur me shkrim prej recensuesve, me një shpjegim të pabesueshëm, se ishte vendosur të botoheshin vetëm librat me një numër të kufizuar faqesh. Shih KABASHI, Gëzim (2013), *Alfons Dovana, autori i "Rimarit" të pabotuar, në të përditshmen Shqiptarja*, 17 dhjetor

konferencën shkencore kushtuar 140-vjetorit të lindjes së Ndre Mjedës, më pas botuar në shtypin shkencor, në revistën *Mjedologji* (nr. 1) dhe gjetiu²⁵.

Po le të kthehemi në pohimin e autorit të “*Fjalorit rimor të Dritëro Agollit*”: *Është e vërtetë që ky është një fjalor që botohet për herë të parë në gjuhën shqipe. Por duhet të them që shtegun në këtë rrugë e ka çelur i pari profesor Kol Ashta në Shkodër, i cili që në vitin 1955 kishte mbaruar fjalorin e plotë të veprave të Mjedës, dhe rimarin e Mjedës. Por është e vërtetë që gjithashtu që unë nuk kam qenë në dijeni të kësaj pune. Madje kur e fillova punën për këtë fjalor në Amerikë, mendoja, a është ndonjë tjetër që ka bërë këtë punë. Vonë, kur erdha në Shqipëri, në shkurt të vitit 2013, pasi kisha mbaruar fjalorin, një kolegu im nga Shkodra më njoftoi se profesor Kolë Ashta kishte mbaruar fjalorin e plotë të veprave të Mjedës bashkangjitur dhe me një rimar. Ky dorëshkrim ishte gjetur në shtëpinë e tij poshtë shtratit. Por unë kam punuar në mënyrë të pavarur prej tij, sepse nuk e dija këtë punë. Atëherë vendosa që kur të vija në Shqipëri të shikoja dorëshkrimin e Kolë Ashtës, por libri i tij ende nuk është botuar. Për këtë arsye “Fjalori rimor i Dritëro Agollit” është i pari i botuar deri më sot²⁶. Të dish dhe njëherësh të mos dish ekzistencën e një pune të hershme, të kesh mundësi ta shfrytëzosh atë në një institucion kërkimor dhe ta gjesh fshehur nën shtrat, nuk ngjan aq e mirësjellshme me një autor që nuk pati aq fat sa të ishte i përruar në botimet e mëhershme.*

I së njëjtës kohë me *Rimarin e Mjedës* është dhe një *Fjalor rimar i poezisë shqipe* i hartuar në vitet 1950 nga Alfons Dovana, i përmendur më shumë si *Fjalori i rimave të gjuhës shqipe*. Edhe ky fjalor ka mbetur deri më sot në dorëshkrim, por gjurmët e tij janë në arkivat e disa institucioneve, duke përfshirë atë të ndërmarrjes botuese *Naim Frashëri* dhe të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Dhimitër S. Shuteriqi, në një letër drejtuar shtëpisë botuese, pasi ishte njohur me këtë dorëshkrim, me cilësinë e një recensionuesi, shkruante se *puna e bërë nga Alfons Dovana është një punë e durueshme dhe e zellshme, me kritere të shëndosha shkencore*. Dhe më pas shton: *Ky rimar, i pari në vendin tonë, do të ishte një ndihmë e madhe për studiuesit e gjuhës dhe të poezisë shqiptare, si brenda dhe jashtë shtetit*. I të njëjtit mendim që edhe Androkli Kostallari, i cili, thuajse në të njëjtën kohë (maj 1960),

²⁵ SINANI, Shaban (2010), po aty.

²⁶ Shih GERO, Mina (2013), *Gjuha e poetit Dritëro Agolli në letërsinë artistike, burim i pashtershëm për pasurimin e gjuhës shqipe*, në të përditshmen *Sot*, 13 nëntor.

edhe me cilësinë e dekanit të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, shprehej: *Të bie në sy larmia e rimave, gjë që dëshmon se autori ka hetuar dhe gjurmuar me durim një numër të madh fjalësh nga thesari leksikor i gjuhës sonë. I hartuar në dy vëllime, gjegjësisht me 416 dhe 619 fletë; i organizuar në 75 krerë, Fjalori i rimave të gjuhës shqipe i Alfons Dovanës, që vazhdon të ruhet në dorëshkrim nga familjarët e tij, gjithashtu është një fakt i njohur publikisht²⁷.*

Duke i shpjeguar lexuesit se botimi *Fjalori rimor i Dritëro Agollit* nuk ka ndonjë lidhje me përvoja të mëhershme të studimeve të këtij lloji, autori përmend edhe një fjalor të tretë *rimar*, të cilin gjithashtu nuk e ka njohur, për shkak të ruajtjes nga familja: *Më pas, nga media, kam marrë vesh që një durrsak, Shefqet Karaj, pas vdekjes kishte lënë një dorëshkrim, një fjalor të rimave të gjuhës shqipe. Dhe thuhet që ky fjalor ka rreth 5 mijë fjalë, por dhe ky fjalor s'e ka parë dritën e botimit. Për këtë arsye "Fjalori rimor i Dritëro Agollit" është i pari i botuar deri më sot²⁸.*

Sa i takon *Fjalorit të rimave të gjuhës shqipe*, me 25 mijë fjalë-rima, të hartuar nga Shefqet Karaja (jo Karaj), ai është më shumë një *manual vjershërimi*, që përmban rimat e gatshme të ofruara nga gjuha shqipe, kryesisht rimat foljore, jo pasuri rimash të dëshmuara prej poezisë shqipe*. I tillë është dhe fjalori dygjuhësh i rimave në gjuhën shqipe i hartuar nga Leka Bezhani, me titull *Albanian Rhyming Dictionary*, mbi 31500 fjalë-rima, mbështetur në *Fjalorin drejtshkrimor të shqipes* (1981), gjithashtu është i të njëjtës tipologji, manual pajtimesh eufonike ndërmjet fjalëve, çifte fjalësh që pajtohen prej njëjtësisë tingullore prej rrokjes së fundme me theks²⁹, ndaj nuk mund të shërbejë për krahasime të mjeshtërisë rimëformuese të Mjedës me autorë të tjerë.

²⁷ PRIKU, Mimoza (2014), *One approach for the role of rhyming dictionaries in developing children's language proficiency and the multimedia technologies*, in *European Scientific Journal*, vol. 10 (May), nr. 14, p. 30; KABASHI, Gëzim (2013), *Alfons Dovana, autori i "Rimarit" të pabotuar, në të përditshmen Shqiptarja*, 17 dhjetor.

²⁸ GERO, Mina (2013), *Gjuha e poetit Dritëro Agolli në letërsinë artistike, burim i pashtershëm për pasurimin e gjuhës shqipe*, në të përditshmen *Sot*, 13 nëntor.

* Shefqet Karaja (jo Karaj), autori i kësaj vepre në dorëshkrim, me titull *Fjalori i rimave të gjuhës shqipe*, me 25 mijë fjalë-rima, është romancier, autor kujtimesh; veprimtar i njohur në fushën e kulturës; ka kryer disa detyra në këtë fushë, si kryeredaktor i gazetës *Adriatiku*, përgjegjës i redaksisë së kulturës pranë TVSH. Shih dhe *Një jetë mes rimash: ndahet nga jeta autori i "Fjalorit të parë shqiptar të rimave"* Shefqet Karaja, në të përditshmen *Shqip*, nr. 3380, 10 korrik 2011.

²⁹ BEZHANI, Leka (2010), *Albanian Rhyming Dictionary*, edit. of author, 2010, pa vend botimi, përmban, siç pohohet në parathënie, *more than 31500 words* dhe

V.

Ndre Mjeda është një prej të paktëve poetë që *rendin e vet poetik e vuri në një shkallë hierarkie më të lartë se rendi gjuhësor*, të cilin ai e njihte në rrënjë e në gjendje. Ai bën pjesë tek ata mjeshtër që e detyrojnë gjuhën t'i nënshtrohet kërkesave të një ligjërimi që mund ta ketë për virtyt vetë krijuesi. Mjeda e bëri shqipen të flasë me 11-rrokëshin e *Komedisë hyjnore*; me *katrena* dhe *tercina*; me përfundimin e fjalisë dhe mbylljen e mendimit në mes të vargut; me prishjen e pavarësisë kuptimore të çdo vargu më vete; me *kantilenën* e brendshme të vargut dhe strofës. Pushteti i rendit poetik mbi rendin gramatikor tek Mjeda shfaqet në mjaft raste edhe në formën e shmangies prej trajtave të rregullta të eptimit të fjalës, për efekte eufonie dhe tingëllimi. Mjeda e krijon formën e re jo në mënyrë arbitrare, por me një referencë në rendin e brendshëm të gjuhës. Mbështetur tek *analogjia*, ai formon trajtën joekzistuese *balkue* për *ballkon*, një huazim i vonët i shqipes, formë që përligjet prej të njëjtit eptim tek fjalët *krue* - *kroni*, *përrue* - *përroni*, *ftue* - *ftoni* etj. *Trajtëformimi* në poezitë e Mjedës, për rëndësinë që ka në rendin e tij poetik, meriton të studiohet më vete prej *fjalëformimit*.

Kujdesi për eufoninë, qëkurse Mjeda zgjodhi të shkruajë tingëllima, ka qenë qëllim parësor. *Soneti* është i vetmi nënlloj i poezisë që ka simetri të plotë edhe terminologjike e burimore me një nënlloj të muzikës, *sonatën*.

Po le të kthehemi tek rimat e Mjedës. Në poezinë e tij ka 2040 fjalë të rimuara³⁰. Fjalët e rimuara foljore dhe prejfoljore zënë diçka më shumë se një të katërtën si numër fjalësh, por jo dhe aq si rima, sepse shumë rima formohen me një përbërëse jofoljore (emra dhe përemra që përmbyllen në grupin *-ue*). Në shifra absolute më shumë rimëformime foljore Mjeda ka në zanoren *o* (afërsisht një e treta në përqindje); pastaj në zanoren *u* (në përqindje diçka më shumë se gjysma) dhe së fundmi në zanoren *i* (në përqindje vetëm një e pesta).

është hartuar *based on the Albanian dictionary of standard language*: “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe” (1981).

³⁰ Sot për sot i vetmi krahasim i mundshëm i *Rimarit të Mjedës* është ai me *Rimarin e Dritëro Agollit*, për të cilin ekziston një fjalor, autori i të cilit vëren: *Në poezinë e Dritëro Agollit janë numëruar 7700 fjalë rimëformuese. Fjalori i rimemave*, që përbën pjesën e parë të librit, me titullin *Morfologjia e rimevave*, sipas konstatimit të autorit, *përmban rreth 9000 mijë rimema*, Shih GERO, Mina (2013), *Hyrje e autorit në Fjalori rimor i Dritëro Agollit (morfologjia e rimemave, konkordanca, fjalësi)*, bot. Toena, Tiranë.

Rimat në **a** dhe **y** thuhetse nuk kanë ndonjë peshë. Ndërsa rima në zanoren **ë** nuk ka asnjë.

Ndarë sipas zanoreve rimëformuese rezulton kjo renditje:

Nr.	Rimat në poezinë e Mjedës	Rima foljore ose prejfoljore
1.	Fjalë të rimuara në zanoren a : 307	30
2.	Fjalë të rimuara në zanoren e : 339	76
3.	Fjalë të rimuara në zanoren i : 620	132
4.	Fjalë të rimuara në zanoren o : 468	156
5.	Fjalë të rimuara në zanoren u : 245	146
6.	Fjalë të rimuara në zanoren y : 61	15
7.	Fjalë të rimuara në zanoren ë : 0	0
	<i>Rimari i poezisë së Mjedës</i>	Gjithsej rima të formuara prej
	Gjithsej fjalë të rimuara 2040	eptimit 555
	Në përqindje	27 për qind

Çfarë përfaqësojnë fjalët rimëformuese foljore dhe prejfoljore në poezinë e Mjedës? Rimat në zanoren **a** janë kryesisht folje njërrrokëshe në formën pjesore të pastër ose të parafjalësuar (me, pa): *dā, pā, kjā, ndā, lā*. Rimat foljore në **e** janë më të rralla. Rimat në **o** janë kryesisht folje të vetës së tretë (*gjimon, vajton*). Rimat në **u** janë me peshën më të madhe statistikore në gjithë raportet midis fjalëve rimëformuese, dhe kjo për shkak të grupit **-ue**, që del në formëformim (foljet) dhe në fjalëformim (mbiemrat prejfoljorë me vlerë aspektive të së kryerës dhe emrat e veprimt).

Rimat prej eptimit foljor dhe prejfoljor në grupin **-ue** kanë një traditë relativisht më të hershme në poezinë e Pjetër Budit (në grupin **-uo**)³¹. Poezitë

³¹ Duke qenë se shfaqja e rimës së eptimit në grupin **ue** paraprihet prej rastit të vjershërisë së Pjetër Budit, në vijim sillen tri strofa nga tri poezi të tij. Shih ISMAJLI, Rexhep (1986), *Pjetër Budi: poezi (1618-1621) - parathënia, tejshkrimi, komentet*, bot. Rilindja, Prishtinë, f. 114-115.

*Aty s'prunë madhështii,
As dinje me ligjëruom,
As vertyt as trimëni,
As vetiu me ndihuom.*

*Ku janë ata zotëninj,
që dojin me zotënuom
ndë sqimë e ndë madhështi,
këte jatë tue shkuom?*

*E si zogzitë ndë pyyllt,
Zoti im me të lëvduom,
ndjerë vetë nata mbyyllt,
me një zaa t'amblëtuom.*

(O i pa fat njeri)

(Ku janë ata pleq bujarë)

(I madhi Zot, qofsh lëvduom)

e Pjetër Bogdanit ose ato që iu kushtuan atij, të botuara në *Cuneus prophetarum*, janë më larg kësaj tradite. Në vjershat-kushtime në hyrje të këtij libri rimat janë kryesisht në fjalë emërore. Kurse përkthimet e vetë P. Bogdanit (të *Sibillave* dhe poezia kozmogonike kushtuar lindjes së rruzullimit) janë në 16-rrokësh të parimuar. Tek poezitë e P. Budit për herë të parë rima, kryesisht ajo e alternuar, shfaqet si *baza e eufonisë* dhe *kushti parësor i isostrofës*. Në letërsinë që u krijua me alfabetë orientale, me sa duket, rima erdhi bashkë me gjedhet poetike të vjershërimit klasik pers, madje dhe me leksikun me burim gjuhët e Orientit: osmanisht, arabisht e persisht. Për dallim nga shqipja, rimat e gatshme këto gjuhë i ofrojnë më shumë prej sistemit emëror³².

Rimat në y tek Mjeda janë shumë pak dhe ato prejfoljore thuajse zero.

Rende fjalësh rimëformuese sipas rendit zanor:

Në zanoren **a**: *lā, bâ, dà, kjà, pā, ra, dalë, falë, ndalë, dhânë, ngrânë, thanë**.

Në zanoren **e**: *rreh, shkreh, dëfrehej, ngrehej, thehej, zhgrehej, kthehet, mshehet, njehun, prehun, hjekë, prekë, rrekë, mëjun, ndëjun, dekun, hjekun, ngelë, shkelë, epet, zhgjeshtë, zdeshë, gjetë, mbetë, pvetë**.

Në zanoren **i**: *ndi, ngri, përtri, përzi, pri, shtri, ikë, fikë; goditë, kositë, mbërritë, merahitë, mërzitë, ngritë, qitë, soditë; përsjellët, pshtjellët, njëfët, shifët, ndihet, ngrihet, pihet, shkrihet, shtrihet; fshine, ngrine, përtrine, shkrine; përshndrisin, qendisin, qisin, rrisin, stolisin, shetisin, shndrisin; armatosun, nisun, terrtisun; ngriti, priti, qiti, rriti, shndriti, valviti; flitë, goditë, përsritë, përshndritë, pritë, rritë, rrshitë, thrritë**.

³² Krhs ELSIE, Robert (2001), *Literatura shqipe në traditën islame - Gjuha shqipe me germa arabe gjatë shekullit të 18-të dhe të 19-të*, Kuala Lumpur, f. 5: *Shumica e formave dhe rimave persiane dhe turke zunë vend edhe në literaturën shqipe. Këtë e gjejmë në poezi apo nëpër divane si: murabba (versete), ilahitë (këngë fetare), kasidetë (poezi në stil arab) dhe në gazele (poezi të shkurtra, zakonisht lirika dashurie të pëlqyeshme prej turqve dhe persianëve.*

* Format foljore rimëformuese janë kryesisht të pjesores dhe thuajse vetëm të foljeve njërrrokëshe. Por gjejmë dhe ndonjë formë të së pakryerës (*hapte, kapte*).

* Në rimat në zanoren *e* format e foljeve rimëformuese, siç vërehet, janë kryesisht të diatezës pësore. Rastet e tjera nuk referohen në ndonjë rregull.

* Kryesisht forma të pjesores (ose pjesore në format analitike të kohëve dhe mënyrave), të së pakryerës dhe të pësores në të tashmen. Për rastet e tjera nuk ka rregullsi.

- Në zanoren **o**: *galdon, gjimon, kushton, loton, mugullon, ngushllon, shûjton, vendon, veton, vron; flutro, gjimo, hijesho, lakmo, shpejto, vajto, vendo; farkote, gazmote, mbretnote, mprote, pritote, urdhnote, ushtote; flutroni, kallxoni, kujtoni, lëshoni, shpejtoni, dëgjoni; droshin, gëzoshin, gjimoshin, lotoshin, rrethoshin, xhixhillojshin; farmakove, gazmove, mundove, ndigiove, rrmove, shenjove, zgjove**.
- Në zanoren **u**: *blerue, dertue, farue, idhnue, shugurue, true, vrue; mujtë, ruejtë, shuejtë; flutruene, lëshuene, luftuene, e amshueme, e bekueme, e drueme, e madhnueme, e salikueme, e trueme, e shemptueme; të mallkuemit, të shuemit; këputun, lutun**.
- Në zanoren **y**: *kthye, shfrye, ndrye, shklye, thye, rrfyene, shpërthyene, lypë, hypë, mbytë, ndryni, shtyni*.

Mjeda nuk ka asnjë rimë në zanoren **ë**, por nuk ka ndonjë arsye për t'u çuditur. Kjo ka lidhje me rolin historikisht të rrudhur të kësaj zanorje në gegërisht, jo vetëm për shkak të ndërrimit historik në **a**, por edhe prej kthimit të saj kryesisht në një grafemë njoftuese për gjatësi zanorje. Gjergj Fishta i shkruante redaktorit të veprës së tij, Viktor Volaj, se *bashkë me këngën po të dërgoj edhe një thes me "ë", me i vue aty ku duhen*, ndërsa Konica përqeshte si *kursimin e tepruar të gegëve në përdorimin e kësaj zanorje, ashtu dhe teprimin e marrë të toskëve në zgjerimin e formave të fjalëve me të*.

Nxitur prej këtij konstatimi, e pamë të nevojshme të bënim një kërkim për rimat në **ë** në vjershërimin në dialektin e toskërishtes dhe të dhënat na çuan në përfundimin se kjo zanore përgjithësisht nuk ka ndonjë rol rimëformues në shqip. Por më mirë le të shohim disa të dhëna statistikore, në të cilën krahasohet numri i vargjeve të verifikuara në tërësi dhe numri i vargjeve me rimim në zanoren **ë**:

* Kryesisht folje pavetore (formalisht vetë e tretë); forma të së pakryerës të foljeve të zgjedhimit të rregullt, forma të urdhërores në vetën e tretë; forma të së kryerës së thjeshtë. Në trajtat rimëformuese në këtë zanore ka më shumë prani të rimës prej eptimit. Ndërkaq, duhet vërejtur se këto trajta rimëformuese janë kryesisht në vjershat për fëmijë.

* Trajta foljore në pjesore dhe në të kryerën e thjeshtë, si dhe mbiemra prejfoljorë me kuptimin aspektiv të së kryerës. Në një shumicë rastesh rimat nuk janë formuar folje me folje, por folje me emër (*krue, balkue, prrue* etj.).

Nr.	Autori	Vepra e këshilluar	Fjalë të rimuara	Rima në zanoren ë
1.	Naim Frashëri	<i>Bagëti e Bujqësia</i>	454	18
2.	Naim Frashëri	<i>Istori e Skënderbeut</i>	2426	26
3.	Andon Çajupi	Z. <i>Baba Musa lakuriq</i>	554	12

Duhet shtuar se, siç rezultoi nga analiza një për një e rasteve të rimave në *ë*, pjesa më e madhe e tyre nuk janë zanafillëse, në trup të fjalës së gjuhës shqipe, por shmangie formale prej saj, për shkak të një ekspansioni të lehtë të kësaj foneme në raste të veçuara, siç paraqiten më poshtë:

Naim Frashëri
Bagëti e Bujqësia

Miqt' e ti shqeratë janë, kecërit, dhitë, **dhëntë**,
Cjeptë, ziletë, këmborët, deshtë e më tepër **qëntë**.
Sindëkur çel trëndafilë, e i fal bilbilit **zënë**,
Ashtu na bije nga qielli një gas në zëmërt **tënë**.
Bujku mundohet në verë, po në dimër rri e **prëhet**,
Sheh shtëpizënë më kamje, edhe zëmëra i **bëhet**.

Naim Frashëri

*Istori e
Skënderbeut*

Nuk' e do kombinë **tënë**,
Punët tona s'i pëlqejnë,
Një tjtatër' udhë ka **zënë**,
Si na thon' e na rrëfejnë.

Andon Z. Çajupi
Baba Musa lakuriq

Po Abraami, plak me **mënd**,
s'pëlqen nuse nga ky **vënd**.
Nga të mirat që ka **bërë**
e nderon bota e **tërë**.

Rimari i Mjedës është një prej dëshmimeve parësore si poet i ditur, si poet-filolog. Me shumë interes është konstatimi i studiuesve se poemat sonetike të Mjedës paraqesin shembuj të rrallë të përdorimit të rimës vetëm me fjalë të gjinisë femërore. Në poemën *Lirija* me 64 vargje vetëm dy fjalë

rimëformuese janë gjuhësisht mashkullore. Në dy poemat e tjera, *Lisus* dhe *Scodra*, që kanë gjegjësisht 168 dhe 154 vargje, nuk gjendet *asnjë fjalë rimëformuese e gjinisë mashkullore*³³.

Arsyet që e shtynë Mjedën për të mbajtur një qendrim përjashtues ndaj fjalëve rimëformuese në gjini mashkullore janë për t'u shpjeguar më në thellësi, por një gjë është e sigurt: Ky raport ndërgjinor i fjalëve rimuese, me *mbisundim absolut të atyre të gjinisë femërore*, është i vetëdijshëm dhe nuk mund të jetë kurrsesi rastësor. Po aq i vetëdijshëm ka qenë poeti kur zgjodhi që në poemat-tingëllima fjalët rimëformuese të jenë kryesisht ose, në strofa të tëra, krejtësisht *emërore*³⁴. Ky raport, siç vërehet prej tabelës sinoptike, në poezitë e tjera, sidomos në ato për fëmijë, nuk është absolut, por në asnjë rast rimat foljore nuk e kalojnë një të katërtën.

Prirja e Mjedës për t'u shprehur poetikisht me sa më pak fjalë foljore provohet jo vetëm prej atyre rimëformuese, por edhe prej gjithë leksikut aktiv të veprës së tij. Këtu bëhet fjalë për një vërtetim statistikor, që është realizuar prej studiuesve përmes verifikimit të fjalëve-çelësa sipas dendurisë së përdorimit. Fjalë-çelësa me denduri përdorimi 10 herë e më shumë në 100 poezi të Mjedës, duke përfshirë veprat më të rëndësishme (*Vaji i bylbylit, I tretuni, Andrra e jetës, Gjuha shqype, Liria, Scodra, I mbetuni, Mikut tem Pal Moretti-t*) dëshmohen 160³⁵. Kemi veçuar prej tyre fjalët-çelësa foljore e prejfoljore dhe vërehet ky raport:

Nr.	Fjalë-çelësa gjithsej	Fjalë-çelësa foljore e prejfoljore ³⁶
1.	Janë 160 fjalë-çelësa, në 100 poezi, me denduri më shumë se 10 herë.	Nga këto, 53 janë fjalë-çelësa foljore e prejfoljore.
2.	Nga këto, 66 janë fjalë-çelësa me denduri përdorimi nga 72 herë në 20 herë ³⁷ .	Vetëm 28 prej tyre janë fjalë-çelësa foljore dhe prejfoljore.

³³ KRASNIQI, Milazim, vep. cit., f. 107.

³⁴ KRASNIQI, Milazim, vep. cit., f. 108.

³⁵ CAKA, Nebi; CAKA, Ali (2007), *Konkordancat dhe fjalët-çelës të poezisë së Ndre Mjedës*, botuar në *Aktet e takimit vjetor të IASH*, f. 132-134.

³⁶ Edhe në poezinë e Dritëro Agollit në krye të pjesëve të ligjëratës qëndrojnë emrat. Krhs GERO, Mina (2013), *Hyrje e autorit në Fjalori rimor i Dritëro Agollit (morfologjia e rimemave, konkordanca, fjalësi)*, bot. Toena, Tiranë.

³⁷ Ndër 50 fjalët më të përdorura në poezinë e Dritëro Agollit vendin e parë e zë një përemër, fjala *unë* (780 herë). Shih GERO, Mina (2013), *Hyrje e autorit në Fjalori rimor i Dritëro Agollit (morfologjia e rimemave, konkordanca, fjalësi)*, bot. Toena, Tiranë.

3. Nga këto, 194 janë fjalë-çelësa me denduri përdorimi nga 20 deri në 10 herë. Vetëm 25 prej tyre janë fjalë-çelësa foljore e prejfoljore.
4. Fjalët-çelësa emërore me dendurinë më të madhe të përdorimit: *mal, shpi, zemër, fushë, nanë, ditë, Shqypni, atdhe, fëmijë, lule, qiell, vend.* Fjalët-çelësa foljore me dendurinë më të madhe të përdorimit: *shkoj, dal, shof, lëshoj, me thanë, me bâ, gëzoj, ndrron, gjimon, me këqyrë, me ndie.*

VI.

Në këtë mënyrë, raporti tipologjik i fjalëve rimëformuese (emra dhe folje, bashkë me nënkategoritë e tyre); raporti i trajtave të eptimit të tyre; si dhe raporti i frekuencave të fjalë-çelësave me denduri më të madhe, provojnë të njëjtën gjë: ikjen prej rimës gramatikore, ikjen prej eufonisë që krijon eptimi vetë, ikjen prej rendit sintaksor dhe ritmit gjuhësor, ikjen prej asaj që është e gatshme, në fund të fundit, ikjen prej metrikës dhe prozodisë së rapsodisë, ose më saktë të rapsodisë në gjendjen e rënies së saj, pas prishjes së marrëdhënies trekëndore që kishin përkufizuar Milman Parry e Albert Lord. Nëse do të bënim një kronologji të modeleve të vjershërimit tradicional shqip, që është e domosdoshme për të kuptuar raportin e Mjedës me traditën dhe me modernitetin, pasqyra do të ishte kjo:

Nr.	Tipologjia e vjershërimit	Koha e shfaqjes
1.	Epika heroike legjendare e veriut: varg pa rimë, polimetrik dhe heterometrik në lexim, dhjetërrokësh misionar në të kënduarit me lahutë.	Nga fillimet deri në shek. XVII.
2.1.	Poezia popullore arbëreshe: varg pa rimë; melodik dhe tonik, por me rend theksash dhe ritmesh poetikë që nuk i binden rendit gjuhësor.	Nga fillimet deri në kohët e sotme.
2.2.	Poezia romantike arbëreshe: varg pa rime; melodik dhe tonik, por me rend theksash dhe ritmesh poetikë që nuk i binden rendit gjuhësor.	Nga fillimet deri në shek. XX, me poezitë e botuara nën titullin <i>Liriche sparse</i> dhe me poemën <i>Mino</i> të Giuseppe Schirò-it (dukuri e veçuar, që rishfaqet edhe tek disa poetë arbëreshë të gjysmës së dytë të shek. XX).

3. Poezia popullore tradicionale në toskërisht: tetë-rrokësh, i rimuar, herë pas here me determinim të rimës prej eptimit (grupi *-uar*). Edhe para shek. XVIII.
4. Epika heroike legjendare e veriut, pas prishjes së marrëdhënies trekëndore dhe hyrjes së një instrumenti të ri (*sharki, çifteli*): varg tetërrrokësh, që u shoqërua me cenim të isoritmisë dhe isometrisë, me shfaqjen e rimës, me sundim të grupit *-ue*. Shekulli XVIII e më pas.
- 5.1. **Shekulli i rapsodisë** (këngët historike të Veriut dhe një pjesë e eposit heroik legjendar kënduar me instrumentet e vona, *sharki e çifteli*). Shekulli XIX e vijim.
- 5.2. Ekspansioni dhe ekstensioni i rimës gramatikore në poezinë romantike dhe postromantike (rimat në grupin *ue* në poezinë e Hilë Mosit, Àt Gjergj Fishtës, Giuseppe Schirò-it etj.). Shekulli XX, por dhe më vonë.
6. Ikja prej rimës së eptimit gjuhësor, ikja prej rimës gramatikore, ikja prej rimës së vijueshme, ikja prej rimës foljore, ikja prej grupit *-ue*. Ndre Mjeda, Migjeni.

Të dhënat e mësipërme na lejojnë të konkludojmë se Ndre Mjeda, duke refuzuar rimën e eptimit gramatikor, sidomos të eptimit foljor, në pikëpamje të teknikës së vjershërimit dëshmoi ndarjen me romantizmin, ndarjen me rapsodinë, ndarjen me një traditë relativisht të re, që kishte zëvendësuar një sistem shumë të lashtë vjershërimi, të cilësuar herë si gnomik-topik, herë si varg i lashtë indoeuropian. Në fund të fundit, në këtë risi qendron virtyti poetik i Mjedës, kjo është shprehja e mjeshtërisë së autorit.

* * *

Kërkimi ynë pati një qëllim: të provojë se, me ikjen nga rimëformimi prej eptimit formal gramatikor, Ndre Mjeda synoi t'i largohet rapsodisë, e cila kishte trashëguar një mit të fuqishëm prej shekullit të romantizmit dhe

më tej në postromantizëm, duke përfshirë postromantizmin e shekullit XX, dhe kështu përfundimisht arriti të deestetizonte një prej përbërëseve themelore të rrjedhës letrare paraardhëse, të vjershërimit romantik. Me këtë hap, pavarësisht se në rrafshin tematologjik ai mund të jetë më pranë paraardhësve romantikë, në rrafshin e poetikës ishte krejt në mospajtim me ta dhe më i afërt me Migjenin.

Ndre Mjeda është i pari poet i dy shkollave letrare shkodrane (në kuptimin që i jepte këtij termi Ernest Koliqi, duke parë në brendinë e tij *rrymbën*, *rrymën*, *rrjedhën letrare*), që ndryshoi skemën tradicionale të receptimit të letërsisë. Ai kërkoi lexues dhe jo dëgues, dhe pikërisht ky qëllim e çoi tek prishja e rendit gjuhësor dhe krijimi i një rendi poetik në hierarki më të lartë krahasuar me të, që e ndante në koncept prej rapsodisë.

BIBLIOGRAFI

- ALTIMARI, Francesco (2005), *Introduzione, La metrica*, në *Girolamo de Rada, Omera omnia*, vol. VI, *Skanderbeg sventurato* (a cura di Vincenzo Belmonte), ediz. *Rubbettino Editore*.
- ASHTA, Kolë (pa vit), *Fjalori i plotë i nxjerrun nga shkrimet e Mjedës dhe rimari*, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Dosja nr. 54, nr. i inventarit 273 (por para vitit 1965).
- BEZHANI, Leka (2010), *Albanian Rhyming Dictionary*, edit. of author, 2010, pa vend botimi, me mbi 31 mijë fjalë-rima.
- CAKA, Nebi; CAKA, Ali (2007), *Konkordancat dhe fjalët-çelës të poezisë së Ndre Mjedës*, Aktet e takimit vjetor të IASH; ribotuar në *Malësia*, nr. 3, Podgoricë 2008.
- DOVANA, Alfons (1960), *Fjalori i rimave në gjuhën shqipe*, në dy vëllime, mbi 1100 fl., dorëshkrim, ruhet nga trashëgimtarët i familjes, Durrës.
- ELSIE, Robert (2001), *Literatura shqipe në traditën islame - Gjuha shqipe me germa arabe gjatë shekullit të 18-të dhe të 19-të*, Kuala Lumpur.
- FISHTA, Àt Gjergj (1937), *Ded Gjo Lulin*, në *Lahuta e Malcís*, Shkodër.
- GASSISI, Sofronio (1917), *Contributo alla storia del rito greco in Italia*, ediz. di tip. italo-orientale S. Nilo, Grottaferrata.
- GERO, Mina (2013), *Fjalori rimor i Dritëro Agollit*, bot. Toena, Tiranë.
- GERO, Mina (2013), *Gjuha e poetit Dritëro Agolli në letërsinë artistike, burim i pashtershëm për pasurimin e gjuhës shqipe*, në të përditshmen *Sot*, 13 nëntor.
- GRUDA, Lekë (pa vit, por 1906), *Vargënimi n'gjuhë shcype me gni fjalorth shcyp-frángjisht n'marim*, bot. Tocco e Salviatti, Napoli.

- ISMAJLI, Rexhep (1986), *Pjetër Budi: poezi (1618-1621), tejskrimi, redaktimi, parathënia, komentet*; bot. Rilindja, Prishtinë.
- ISMAJLI, Rexhep (1990), *Poezia e sotme arbëreshe*, bot. Rilindja, Prishtinë.
- KABASHI, Gëzim (2013), *Alfons Dovana, autori i "Rimarit" të pabotuar, në të përditshmen Shqiptarja*, 17 dhjetor.
- KARAJA, Shefqet, *Fjalori i rimave të gjuhës shqipe*, dorëshkrim, me 25 mijë fjalë-rima, ruhet nga trashëgimtarët, Durrës.
- KRASNIQI, Milazim (2005), *Soneti në poezinë shqipe*, bot. Pen Center - Kosovë, Prishtinë.
- LORD, Albert (2000), *Performace and Training*, në *Singer of Tales*, second edition (Stephen Mitchell and Gregory Nagy editors), Harvard University Press, Cambridge-Massachusetts-London.
- MANDALÀ, Matteo (2015), *Mbi formimin rinor të Jeronim De Radës (1822-1837)*, në *Hylli i Dritës*, nr. 1-2.
- MARCO, Costantino (2003), *Cenni sulla metrica del De Rada*, në *Omaggio a Girolamo De Rada (a cura di Italo C. Fortino)*, Microprovincia, Napoli.
- MOSI, Hilë (1989), *Vepra*, vëll. 1, bot. Rilindja, Prishtinë.
- PA AUTOR (2011), *Një jetë mes rimash: ndahet nga jeta autori i "Fjalorit të parë shqiptar të rimave"* Shefqet Karaja, në të përditshmen *Shqip*, nr. 3380, 10 korrik.
- PALAJ, Bernardin; KURTI, Donat (1937), *Visaret e Kombit, Kângë kreshnikësh dhe legenda*, vëllimi II, Tiranë.
- PIPA, Arshi (1978), *Albanian Folk Verse: Structure and Gendre*, në *Albanische Forschungen*, Bild nr. 17, edit. R. Trofenik, Muenchen; bot. shqip me titullin *Vargu folklorik shqip*, bot. Princi, Tiranë 2013.
- PIPA, Arshi (1978), *Hieronymus de Rada*, në *Albanische Forschungen*, Bild 18, edit. R. Trofenik, Muenchen.
- PRIKU, Mimoza (2014), *One approach for the role of rhyming dictionaries in developing children's language proficiency and the multimedia technologies*, in *European Scientific Journal*, vol. 10 (May), nr. 14.
- QERIQI, Ahmet (2003), *Milush Kopiliqi, serb apo shqiptar*, Prishtinë.
- SAWICKA, Irena (2015), *Struktura e rrokjes arbëreshe*, në Bardhyl Demiraj, Matteo Mandalà, Shaban Sinani (përg.), *Edhe njëqind! - Studime në nderim të prof. Francesco Altimarit me rastin e 60-vjetorit të lindjes / Studi in onore del prof. Francesco Altimari in occasione del 60° compleanno*, Tiranë 2015.
- SCALDAFERRI, Nicola (2008), *Appunti per un'analisi della versificazione tradizionale arbëreshe*, në *Omaggio a Girolamo De Rada. Atti del V seminario internazionale di studi italo-albanesi e altri contributi albanologici*, a cura di Francesco Altimari e Emilia Conforti, Università della Calabria, ediz. Rende.

- SCALDAFERRI, Nicola (2014), *Strutture ritmiche nella versificazione tradizionale arbëreshe: una proposta di analisi*, kumtesë e paraqitur në konferencën *Letërsia dhe kultura arbëreshe: Jeronim de Rada në 200-vjetorin e lindjes*, organizuar nga Universiteti Aleksandër Xhuvani dhe mbajtur në Elbasan më 4-5 qershor 2014.
- SCHIRÒ, Giuseppe (1997), *Kënka të përshpyrtëshme*, në *Opere*, vol. VI, a cura di Matteo Mandalà, ediz. *Rubbettino*, Pianna degli Albanesi.
- SCHIRÒ, Giuseppe (1997), *Kryengritja shqiptare*, vjershë e të quajturave *Liriche sparse*, botuar në *Opere*, vol. VII, a cura di Matteo Mandalà, ediz. *Rubbettino*, Pianna degli Albanesi.
- SINANI, Shaban (2010), “*Rimari*” i Mjedës në një studim në dorëshkrim të K. Ashtës, në *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, bot. Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë.
- SINANI, Shaban (2010), *Etnos në epos*, bot. *Naimi*, Tiranë.
- SINANI, Shaban (2004), *Himara, identiteti i bashkësisë dhe etnotipi*, në *Himara në shekuj*, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë.
- TEMALAJ, Lira (1984), *Kultura shqiptare në mërgim*, në *Koha e jonë*, nr. 12.

Nysret KRASNIQI

NDRE MJEDJA: FIGURA SI SHENJË E IDEVE

I. ARGUMENT

Në këtë tezë do të analizohet, në një rrjedhshmëri sistematike, korpusi letrar i Ndre Mjedjes me përqendrim në “ishullimin” e tij në raport me autorët e tjerë të klasikës apo traditës letrare shqiptare. Kjo intencë nuk e nënkupton mohimin e ndikimit, por sforcon fokusimin në veçantinë së tij krijuese në përjasje me autorë të tjerë shqiptarë.

Në kuadër të këtij konceptimi do të hetohet vetëdija klasike letrare e Ndre Mjedjes, e sforcuar në jetësimin e figurës letrare si imenencë artistike, qoftë edhe si ngulmim në *mbretërinë e metaforës* (Riker). Kjo çon drejt një analize *hermeneutike*, e cila nënkupton një dialogim *dekonstruktues* nga i cili rrjedhin komunikimet e përhershme letrare me tekstin e tij.

Kur dihet se, përveç të tjerash, figura letrare është *shenjë e idesë* dhe se Ndre Mjedja kishte konceptim filozofik-klasik për natyrën e saj, hetimi ynë do të lidhet me *poetikën e figurës*, mbi parimin se ajo, e konceptuar intencionalisht nga autori, buron nga idetë dhe kthehet te sforcimi i tyre nëpërmjet verbit e formës letrare.

Kjo pikëpamje na shtyn të diskutojmë edhe për *fenomenin e klasikut*, të cilin tashmë Ndre Mjedja e zotëron në kuadër të *kanonit letrar shqiptar*.

II. MJEDJA: SUBLIMJA - ARTISTIKJA

Mbi parimin neoaristotelian, por joretorik për metaforën si figurë e mendimit, larg të pranuarit të saj si ornament për verbin letrar, Ndre Mjedja shkroi me ngulm poemat themelore të tij. Pra, metafora e

tij nuk është *fusha e lojës*, por *fusha e meditimit dhe mendimit estetik*, madje e transponimit të konceptimit metafizik për metaforën si *gjuhë e shenjave të Zotit* në vargun e krijuar, i cili duhet të dalë si shëmbëllim i vullnetit të Tij krijimtar apo të themi si *sublimacion* i harmonisë! Sepse, siç tha Longini: *sublimja është imazhi i madhështisë së mendjes*. Por, për të arritur te kjo filozofi, qoftë edhe si devocion për të bukurën, duhet *madhështia e mendjes* për t'i harmonizuar parimet e sublimes: fuqia e mendimit, fuqia e emocionit, përdorimi adekuat i figurave, fisnikëria e ligjëratës e dinjiteti i kompozicionit.¹ Kur ri-lexova poezinë e Ndre Mjedjes te veprat *Juvenilia e vjersha të tjera*, *Liria*, *Lissus*, *Scodra*, hetova parimet e sipërtheksuara, të cilat duke u ndërlidhur me 'temat' e këngëtimit dëshmojnë gradacionin e menduar të tyre në secilën formë të shprehjes. Dhe kur dihet ndikimi i fuqishëm i filozofisë longinase në shkrimin neo-klasik, por edhe në konceptimin romantik të njeriut me natyrën, figurën e idesë, pa dyshim se te Ndre Mjedja ynë gjejmë *harmoninë e sublimes në arte*. Në këtë udhë nuk bën përjashtim as koncepti i tij për krijimin artistik, i shprehur mbi pikëpamjet e Horacit. Por, duhet të theksojmë se Longini dhe Horaci gjenin pajtim në filozofemën se stili poetik dhe përmbajtja poetike janë përbashkim i së bukurës së dobishme. Pra, Mjedja thotë: *Poeti prei sëndesh qi shef naltohet edhe ai në parime të shkoquna e i parason me atë shëmbull bukurije qi ká vetë në mënd, e me ndimë të hollësis së mëndes e së fantazis perbân një perftesë teknike; por mbasandej e shfaq si gjâ me korp...*² Kështu që, në këtë harmoni konceptimesh nuk ka dilemë se botëkuptimi i Mjedjes për *poiesisin* është klasik, që do të thotë *kanonizues dhe i tejkohshëm*. Ne edhe sot mund të kemi koncepte të tilla, pra klasike, sepse të jesh apo të synosh klasikën do të thotë që epitetet e të ashtuquajturave rryma stilistike të shkrimit vlejné më pak, madje bëhën pak të dobishme për *ta hetuar* në kuptimin shenaugustinian (jo kuptuar) bërthamën e metaforës si mbretëreshë e realizimit poetik. Klasikja është *dje si sot e këtu*, ngjashëm siç është poezia e Ndre Mjedjes.

¹ Këto janë parimet themelore të Longinit për të arritur *sublimen*, të cilat shpërfaqen me detajishtësi te libri i tij *Peri Hypsous* i shkruar rreth shekujve I-III të Erës Sonë, por e gjetur në shekullin XVI dhe e botuar në vitin 1554 nga kritiku letrar italian, Robortello.

² Ndre Mjedja: *Përmbi poezi përgjithësisht* në Ndre Mjedja, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 130.

III. MJEDJA: METAFORA – METAFIZIKA

Mbas leximit sistematik të poemave *Vaji i bylbylit*, *I tretuni*, që janë bosht i veprës *Juvenilia* si dhe poemës *Andrra e jetës*, *I mbetuni* dhe *Shtegtari*, të cilat janë bosht i veprës *Andrra e jetës*³ konstatimi nistor për to rrjedh si fakt themelor se intenca e tyre, madje autoriale, është *bukuria artistike e pësimit njerëzor*, madje vetmia esenciale krijimtare e poetit. Kjo vërejtje, si konstatim, vetëm sa e forcon bindjen se Ndre Mjedja nuk posedon asnjë ndjeshmëri sa i përket ideologjisë së majtë, e cila, nëpërmjet kritikës së saj, kësaj vepre i atribuonte sipertheksimin e elementit të natyrës apo qoftë të sociale të themi migjeniane. Konceptet horaciane tërësisht klasike, të cilat shënjojnë edhe titullin e librit, pastaj shtresat e kulturës filozofike-letrare jezuite, të cilat e synojnë universalitetin e *andrrës së jetës* në këtë botë dhe *jetën e jetës* në botën e përtejme, nuk mund të justifikojnë rrëshqitje në *poezinë e vobektësisë*, madje qoftë ajo e pranishme edhe si reflektim i madh i dhembjes shpirtërore të autorit. Pra, poezia është *bukuri e meditimit metafizik*. Në kuadër të meditimit metafizik, siç thotë Mjedja, *të naltimit*, zgjidhet *bylbyli*, si alter-ego e autorit, por kemi *vajin*, i cili nuk është lotim për fizikën, por për pasigurinë e vet *qenies njerëzore*. Pra, te poema *Vaji i bylbylit*, hetojmë *thirrjen për lirinë* (ikjen nga kafazi), pastaj *dëshminë e robnisë* (pësimin) dhe *idealitetin e lumturisë* (përhershmërinë e kërkesës për gëzim). Mirëpo, ky meditim, i realizuar nëpërmjet kompozicionit dramatik klasik, nuk ikën nga ideja se çlirimi shpirtëror nuk gjendet e as që duhet të kërkohet në jetën reale. Në figurën e përgjithshme, në simbolin e krijuar të *vajit të bylbylit*, Mjedja realizon meditimin për *paplotninë e jetës*, pësimin e vazhdueshëm në udhën drejt çlirimit shpirtëror. Por, jeta e parë si vuajtje nuk ka të bëjë me socialen, por me *ndjenjën e vetmisë*, e cila siç ndjehet e ka shoqëruar këtë autor në vijimësi, qoftë edhe kur ky autor e ka krijuar aureolën e njeriut publik! Vetmia krijimtare e Mjedjes nuk mund të përcaktohet as nga mërgimet e tij shkollore, as nga të qenit veprimtar i kulturës nacionale, as i legjislaturës politike. Autori ynë vetminë e tij e ka dëshmuar në verbin letrar, sepse pikërisht aty e ka parë mundësinë e çlirimit shpirtëror qoftë edhe si një vetëmashtrim të ekzistencës gnoseologjike personale. Kjo vetmi esenciale hetohet edhe te poema vijuese *I tretuni*, e cila duke figuruar idenë e mërgimtarit, pra të njeriut që detyrohet të largohet nga vendi i vet për një kauzë, qoftë ajo edhe

³ Të gjitha citimet e mëposhtme do të merren nga botimi: Ndre Mjedja, *Vepra 1-3*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

dijatare, prapë kridhet në një meditacion të fuqishëm që lidhet me *neurozën krijimtare*. Simboli poetik, *i tretuni*, larg atdheut nuk *korit vendin e vet* Shqypninë, mallin e ka vetëm tek *nëna*, e cila e do më mirë të vdekur në vendin e vet sesa të gjallë jashtë e larg tij, por ideali i vetmisë diturore e krijimtare, pra universale, dominon përgjithnjë në shpirtin artistik të Ndre Mjedjes.

Dikush mund të habitet nga këto konstatime, të cilat u japin përparësi interpretimeve më *arkipsikologjike* të tekstit, apo pretendojnë t'i afrohen një qëndrimi psikanalitik ndaj tekstit letrar. Por, a nuk thamë që në fillim se synimi i klasikut është *naltimi estetik*, i cili, si i tillë, duke synuar universalitetin, në këto poezi, dhembjen nacionale vetëm sa e *përfton* si njërën nga dhembjet krijimtare të autorit Mjedja, qoftë duke e menduar si element themelor, por megjithatë shtesë në botën metafizike të meditimit poetik. Madje, kjo filozofi krijuese më së miri hetohet te poema kult e letërsisë shqipe, krijimi *autotelik* i këtij autori, *Andrra e jetës*, e cila tashmë qëndron si monument i letërsisë shqipe, por edhe i kulturës shqiptare në përgjithësi. Për ta nderuar këtë monument letrar, por edhe për të komunikuar me të, qoftë edhe si tendencë e këtij interpretimi, ne do të huazojmë *modelin leksematik* të Rolan Bartit, që do të thotë se për qëllime të analizës strukturale do ta interpretojmë pjesën e parë të poemës, e titulluar *Trina*, për të dialoguar me intencat e Ndre Mjedjes.

Leksema 1. Andrra e jetës

Titulli *Andrra e jetës* si sugjerim, mirazh apo thirrje, por edhe si indicie për temën e tekstit, sipas një interpretimi metaforik-ikonik, sugjeron jo jetën, por ëndrrën e saj, pra mashtrimin nga i cili përher-shëm buron dhembja njerëzore. Pra, pikëpyetja esenciale bëhet nëse ekziston në të vërtetë jeta apo njeriu vetëm sa jeton në ëndërrimin e saj, ndërsa në esencë botën e dominon vdekja! Titulli i poemës mjedjane kap meditimin për trishtimin, pra lidhet me krizat mendimtare të tipit: *çka jemi, pse jemi, ku jemi dhe ku do të vemi*, gjithnjë si pikëpyetje gnoseologjike metafizike.

Leksema 2. Trina

T r i n a

I.

*Molla t'kputuna nji deget,
Dý qershija lidhë n'nji rrfanë,*

*Kû fillojnë kufijt e Geget,
Rrijnë dy çika me një nanë.*

*Kreskë e bré perzie me lisa
Rriten rrotull me çetinë,
Plepa t'but' e qeparisa
Mbëlojnë e veshin at ledinë.*

*S'ushton mali prej baktijet,
S'fryn murrilani me duhië;
Paq i kthëlltë prej Perendijet,
Paq prej nierit e qetië.*

*Gurra e lugut veç ushtote
Si lahutë me kângë kreshnike;
E ndër pëmë bylbyli këndote
Valle darsmet e fisnike.*

*Ngreh, bylbyl, n'at hije valle,
Ushtë, gurrë trimneshë, n'shkambije;
Bulk i natës, kungallë, qi talle
Neper gëmba e per lamije,*

*Këndoni, këndonin veç prej stanit,
T'ardhmen Trina mbrámje n'shpië,
Tui blegrue një kîj mbas zânit
T'deles nanë keni me ndie.*

*Veç prei plehit gjel kokoti,
Me njat zâ që s'ndrron kurr-herë,
Ká m'u gjegjë se â tui ndërrue moti,
Se â tui çue një tjetër ërë.⁴*

Pjesa e parë, me simbol *Trinën*, duke respektuar në tërësi mësimet klasike për harmoninë, madje raportin e ndërliqshëm me poetizimin e natyrës, tablonë e saj të rikrijuar në vargun e matur, jep *gjeografinë e jetës* për ta krijuar *poetikën e hapësirës* (Bashlar) e cila s'është asgjë tjetër veçse krijimi i *butësisë* së ambientit për ta krijuar amalgamin e *mendimit* dhe *emocionit autorial* në vargun poetik. Mirëpo, në kuadër të poetikës së hapësirës hetohet dimensionin asociativ, i cili lidhet qoftë me kulturën shqiptare, qoftë me kulturën

⁴ Po aty, ff. 33-34.

religjioze. Në vijë kronologjike, nëse kemi: *Molla t'kputuna një deget,/Dý qershija lidhë n'nji rrfanë*, - që konotojnë trashëgimi e ngjashmëri, kemi edhe *Kû fillojnë kufijt e Geget,/Rrijnë dý çika me një nanë*, Veri të viseve shqiptare dhe veçanti shqiptare brenda llojit, për t'u përmbyllur strofa si njësi kuptimore poetike me *trininë* e andrrës së jetës *dý çika* e *nji nanë*.

Të gjitha strofat e mëposhtme japin ambientin, i cili fiton qetësi nga natyra, qoftë si indicie për bukurinë e rrejshme të jetës, qoftë si parapërgatitje për thyerjen intencionale të po kësaj qetësie, me vetëdijen e plotë se gjithçka është vullnet metafizik, i cili shprehet me vargun *Paq i khëlltë prej Perendijet*. Pra, vullneti metafizik *paqton* natyrën dhe i jep hijeshi jetës. Mirëpo, në strofën parafundore dhe fundore të pjesës së parë të poemës, hetojmë ardhjen e Trines nga natyra e qetë në shtëpi, por edhe indicien për *ndryshimin e motit*, prishjen e harmonisë, e cila esencializohet nëpërmjet *gjel kokotit* (lajmëtar), shenjës themelore të fillimit të krizës, e cila figurohet me vargun *Se â tui çue një tjetrë ërë*.

Mbi këtë logjikë, përshkrimi simbolist i natyrës nuk ka fort lidhje me esencializimin e paraqitjes romantike të saj, sepse qëllimi themelor i Ndre Mjedjes është hartimi i pjesës së parë kompozicionale nëpërmjet së cilës synon *figurën e idesë* se nga jeta ecën drejt të panjohurës, drejt një pritjeje, e cila në rrafsh gradativ duhet të sjellë një *kthesë*, të mos themi një *tronditje*.

Të shohim edhe disa nga *punktumet* e esencave të shkallorës poetike të poemës, të pjesa e dytë, por njëkohësisht të lexojmë duke e cituar tekstin e Mjedjes:

II.

*U ndie një zâ te shtegu;
Cicé! del se erdh murgjina,
E mbrapa po vjen Trina
Me'j qingj te sykes ngryk.*

*E duel me mjelcë te burgu
Lokja, xuer viçin jashtë,
E shega, e létë, si kashtë,
Tui kcyemun u berlyk.*

*Ju suell oborrit rrotull
T'u u hjedhë me bisht perpjetë;
Deri sá plaka vetë
Rrshanë tu murgjina e çoj.*

Moli, tui këndue, lopen,
Tui pritun viçin prórë;
E tambli, bardh si bórë,
Permbërënda mjelcës ngufoj.

Mandej muer kijen pezull
E u vû me syken n'sanë,
Sá çote tamblin anë
Zoga me xé do pak.

Muer edhë krânde e cokla,
E Trinken muer për britë:
Ish lodh: i dhimte nd'ijë,
E kishte mollzat gjak.

Vûni do krânde n'votrë
E fryni n'zjerm qi ish ndalë;
Thej pshesh me tambel valë,
E mbushi kupet plot.

Pshesha me kollomoqe,
T'mirë edhë për zotnië,
Kúr don per rob e shpië
Me i fal' i madhi Zot.

E hangri Zoga shiëshëm,
Por Trina s'hangri gjâ,
As lokja, qi ishte vrâ
Mbas çikës, nuk hangri dot.

Por tírte ndëjë te votra,
Tui kqyrë me zëmër t'plasun;
Tui nduk'at shllungë te rrasun
Ju mbushshin sýt me lot.

Kúr një mbas një pranë zjermit
U lodhne gjumit fëmija,
U çue, e t'dy, si kija,
Mbî t'shtruemen i vëndoj.

E tírte prep te votra;
Pëj tírte per xhubleta;

*E i dukej se tu kënetë,
Se n'shpëlla me drangoj,*

*Tirshin dhe shtojzavallet
Tui luejtë pá mêjun gíshtat;
Siellshin me pleq ferishtat,
Ndoshta edhe fëmiën e vet?*

*E shloj me paë, tui pritun
Driten e pishës me dorë:
Ngrykas, si dy qellorë,
Me krahë pá pupla i gjet.*

Të gjashtë strofat e para, ku secila nga to shënjon nga një *sekuencë* të ardhjes së Trinës në shtëpi, por edhe ardhjen e mbrëmjes, duke krijuar toposin rustik të ardhjes së bagëtisë nga kullosa, pastaj kohën e mjeljes si shenjë për mënyrën e jetesës e pse jo edhe *vijën e qumështit*, shënjojnë edhe *mbrëmjen e Trinkes*, e cila kulmon në strofën e shtatë, që jep indicien e kthyer në shenjë: *sëmundjen* me vargjet: *Ish lodh: i dhimte nd'ijë,/ E kishte mollzat gjak*. Lodhja e trupit konsiderohet si shenjë e lodhjes së shpirtit. Por, paradoksi simbolik i Ndre Mjedjes lodhjen e shpirtit e shquan dhe e veneron në trupin e njomë të vajzës, pra në *korpin* e ri në të cilin ai (shpirti) ende nuk ka zënë vend për t'u mësuar në *burgimin e tij* (koncepti filozofik i burgosjes së shpirtit në trupin njerëzor) në *andrrën e jetës* së kalueshme!

Ndërkaq, strofat e tjera, duke u koncentruar në paraqitjen e brendshme të shtëpisë fshatare, lidhin nyje situatat e rënda të përjetimit të mbrëmjes së Trines. Janë vargjet e strofës dalluese të gjendjeve fizike e shpirtërore të tria simboleve të familjes vetmitare: *E hangri Zoga shishëm*, - shenjën e shëndetit, *Por Tringa s'hangri gja*, - shenjën e sëmundjes *as lokja, qi ishte vra/mbas çikës, nuk hangri dot* - shenjën e mërziës. Në vijimësinë e mërziës, Lokja tjerr, por në esencë tjerr mendimet, qoftë edhe si parandjenjë e *këputjes së njërës mollë*. Lidhur me këtë parandjenjë duhet të shënjojmë këtu vargjet të cilat figurojnë vegimet e nënës, qoftë edhe si ëndërrim: *Ngrykas, si dy qellorë,/Me krahë pá pupla i gjet*. Mbi parimin se ëndrra apo ëndërrimi është mesazhi metafizik, Lokja parandien zbritjen në tokë të po këtij vullneti metafizik, qoftë edhe për të goditur!

Mbi parimin se Zoti i mbledh njerëzit sikur lulet në kopshtin e vet, Ndre Mjedja nuk lamenton, por me dhembje “pranon” vullnetin

metafizik, i cili papandehur e kërkon udhën e largimit të Trinës nga kjo botë, nga *andrra e jetës!*

III

*Cicé, shka ká sot Trinka
Qí po priton m'u çue?
Zgjoje me dalë me mue,
Me lëshue baktiën e vet.*

*- Bij', mos e prek, se njomja
Tash á tui folë me Zojen;
Lân zan e mos çil gojën
Se e lumja Zojë t'bertet.*

*Qe prifti, nanë, qe dajat
Mbas tij, me qíri n'dorë;
Katundca me malcorë
Sá shpia nuk i xê.*

*- Rri, bij' se sunte Trinka
Po shkon me bûjtë te Zoja;
Merri këto lule e çoja
Së lumës dhuntië për tê.*

Janë këto strofat kulmore të *tronditjes* (të katastrofës) mjedjane, të cilat me universalitetin e vet, etablojnë këtë poemë në majat e shkrimit letrar shqiptar, madje e shndërrojnë në monument të kulturës nacionale.

Trinka udhën e saj drejt botës së përtejme e bën natën, por motra e saj, Zoga, duke nisur ligjërimin me thirrje përkdhelëse kërkon që Trina të zgjohet nga gjumi i natës për t'i nisur punët ditore të rritës së saj në mëngjesin që për Trinkën është *vazhdim i gjumit*. Mjedja nuk përmend vdekjen, por lidhet me natën e mbrëmshme, gjumin, për ta vijuar këtë gjendje edhe në *psikenë* e nënës, e cila duke ruajtur dashurinë dhe etikën ekstreme prindërore, me gjithë trishtimin ekstrem, ruan kodin e urtisë duke ligjëruar me përkëdheli: *Bij', mos e prek, se njomja/Tash á tui folë me Zojen;/Lân zan e mos çil gojën/Se e lumja Zojë t'bertet*.

Mbi moton *Ad maiorem Dei gloriam* (Për madhësinë e t'lumit Zot"), Ndre Mjedja nëpërmjet zërit të Lokes pajtohet me vullnetin metafizik. Mirëpo, nëse në jetën tokësore Trina kishte nënë Loken, në

amshim tashmë flet me Zojën, e cila e merr nën kujdesin e vet. Vdekja zbutet, madje pandehet si kalim, qoftë edhe duke “pranuar” vullnesën metafizike, e cila e “thërret” Trinën të shkojë te Nëna tjetër. Madje, kjo udhë vetëm sa rikonfirmohet në vargjet: *Rri, bij’ se sunte Trinka/Po shkon me bûjtë te Zoja*; - qoftë edhe si shenjë se ajo nuk do të mbetet pa kujdesin prindëror!

Kjo filozofi dëshmon se, me gjithë mallin e pashuar për jetën shqiptare, për ambientin e bukur që nganjëherë në poetikën e tij “mashtron” me tone romantike, Ndre Mjedja gjithçka ndërlidh me komunikimin e naltuëm, ndërsa verbi poetik i tij është vetëm mediumi kompozicional i realizimit formal të po këtij komunikimi. Prandaj, në poezinë e Ndre Mjedjes kemi një prani të theksuar të *misterit të vdekjes*, e cila në poezitë e tij gjithnjë del si finalitet apo mesazh përmbyllës i tyre. Poezitë e Mjedjes, të figurimit metafizik, gjithnjë nisen me jetën, por kanë finalitet vdekjen, gjithnjë për të rikujtuar *andrrën e jetës*. Kështu që, titulli i poemës *Andrra e jetës* shndërrohet në figurë metafizike apo të themi metaforë, e cila thërret për lexim kosmogonik.

Në vijimësinë e poezive të Ndre Mjedjes përmendëm edhe vjershat *I mbetuni* dhe *Shtegtari*, të cilat aspak nuk e ndryshojnë bindjen e autorit sa i përket orientimit të tij nistor që të esencializojë komunikimin e tij me trajtat e vdekjes. *I mbetuni* mund të thuhet se është *këngëtim analog* me pjesën e parë Trina, të poemës *Andrra e Jetës*. Duke e nisur ekspozicionin e emocionalitetit për jetimin, Mjedja sjell edhe fundin e tij me vargjet *Afer nanës u shtrive me fjetun, /Afer babës kerkoj pushim; /Kurgjâ t’ngrîtin s’kâ me gjetun, /T’xët e t’fioftë skan me pasë ndrrim*.⁵ Ndërkaq, kjo situatë vetmitare e pikëlluese, e cila e përcjell Mjedjen në vazhdimësi, hetohet edhe te poezia *Shtegtari*, i cili rikthehet në vendlindje, por vetëm për të parë varrimin e të dashurve të vet.

Kështu që, kur lexohet në korpus poezia e Mjedjes e kësaj fryme, të cilën ne e cilësuam metaforike-metafizike, duhet të theksojmë se ekziston një përhershmëri e komunikimit autorial me vdekjen, madje një integrim i temës së saj në letërsinë shqipe, siç vëren edhe studiuesja Dhurata Shehri⁶ kur interpreton paksa emocionalisht poemën *Andrra e jetës*. Ndre Mjedja, me ngulm realizoi

⁵ Po aty, f. 51.

⁶ Dhurata Shehri: “*Të vdesësh, Andrra e Jetës!*”, në *Studime Albanologjike*, Tiranë, 2013, f. 98.

metaforën e vdekjes si figurë të idesë se jeta është vuajtje e kalim drejt lumnisë së menduar të amshimit. A nuk e mendojnë të gjithë pjesëtarët e rendit jezuit jetën si salvim e vdekjen si kalim? Pra, me gjithë tundimet e thella poetike, Ndre Mjedja është vetmitari *filobiblik* (term i Sabri Hamitit) i letërsisë shqipe, i cili nuk largohet për asnjë çast nga doktrina e tij.

Në kuadër të *filobiblikes* së tij, Ndre Mjedja, qoftë edhe kur shkruan poezitë për stinët, siç janë *Préndvéra*, *Véra*, *Vjeshta* e *Dimni*, megjithëse luan me përshkrime ambientale të jetë rustikale, hetohet intenca e *stinëve të jetës*.

IV. MJEDJA: METONIMIA - NACIONI

Janë dy dukuri që, në pika të shkurtra, duhet të përmendën para se të flasim për *metoniminë*⁷ e Mjedjes. E para, ka të bëjë me formimin dijetar e intelektual të autorit, ndërsa, e dyta, ka të bëjë me tematikën nacionale të vjershave, pra *soneteve* të tij.

Formimi i Ndre Mjedës ishte sistematik dhe si i tillë përpiquej edhe me doktrinën apo rendin të cilit i përkiste, nëse mund ta quajmë *jezuitizëm*. Por, kur hulumton sado përciptazi në këtë rend heton se i pari i tyre, Ignatius Loyola, mbrojtës i fuqishëm i *doktrinës kristiane* (të përdorimin një term të Budit) u nis si ushtar e përfundoi si i *shenjtruem* nga Papa. Nëse Loyola mbeti model i fuqishëm i formimit dhe veprimit për universalitetin fetar gjithsesi se edhe pasuesit e tij nuk mund të pandehen njerëz që nuk e pranojnë në asnjë rrethanë veprimin për të mirën e përgjithshme, për humanitetin. I tillë del të jetë edhe veprimi atdhetar i Ndre Mjedës. Nëse duke kundërshtuar frymën osmane e duke kërkuar me ngulm rrënjët e veta identitare Mjedja shënjohej veprimtar nacional, megjithatë në brendi qëndronte fuqishëm një dashurues i konceptit *atme e fe*, koncept të cilin Gjergj Fishta e shndërroi në simbol të krejt veprimtarisë së tij letrare-kulturore, madje e bëri tepër mitopoetik e respublik.

Por, askush këtu nuk duhet të habitet me *dysinë e autorit*, sidomos kur analizojmë format e shprehjes në verbin letrar. Në poezitë e fillimit, pra në poemat me tone elegjiake, Ndre Mjedja shkruante dhembjen e vet, vetminë e tij, duke e sforcuar metaforizimin metafizik,

⁷ *Metoniminë* në këtë rast e përdorim në kuptimin e ndërlidhjes më të afërt të saj me fenomenet e ngjarjet konkrete, pra duke e parë si figurë që është më e afërt për analogji me konkretësinë.

ndërsa kur lidhet për njohurinë identitare shqiptare, gërmimin në trashëgiminë nacionale, qoftë edhe si refuzim i tjetërsimit, Mjedja dialogonte me të vdekurit e tij për lirinë nacionale, e cila bashkohet në synimin human për *lirinë universale*. Madje mund të themi se mbi parimin bazik të nevojës për njohje e dije ngulmuese Ndre Mjedja jeziut kishte *qetësinë e tij shpirtërore* për t'u rebeluar qoftë edhe me rrezikun për t'u parë si liberalizues i rregullave të Shoqërisë Jezuite.⁸ Modeli i tij ishte Gjergj Kastrioti - Scanderbegu, i cili cilësohej si *Atleti i Krishtit*. Pra, qoftë rendi, qoftë tendenca e vazhdueshme për njohje e sforcuan veprimin e heshtur të Mjedjes për kauzën nacionale.

Kjo filozofi, e njohur dhe e pranuar nga autori, kur përkthehet në diskursin poetik duke mos e braktisur metaforën, por duke e zgjeruar apo çliruar shprehësinë e saj, konform kërkesës për më shumë narrativitet poetik, kalon në *metonimi*. Metonimia e Ndre Mjedjes hetohet ndjeshëm te poemat *Lissus*, *Lirija* dhe *Scodra*.

Te sonetet e veprës *Lirija*, i këndohet imanencës njerëzore për të jetuar i lirë. Teksti dykrahësh jep modelin e triumfit të lirisë në tokën amerikane, i cili duhet të shndërrohet në model për lirinë nacionale shqiptare. Mbi modelin e madh kërkohet motivimi për modelin shqiptar, duke e parë Skënderbeun, dhe të parët tanë, pra trashëgiminë, si motiv themelor për kërkimin e lirisë në kohë të re. Duke e ditur saktë se robnia është e kundërta e lirisë, qoftë ajo nacionale apo edhe kërkesë hyjnore, Mjedja pavarësisht sakrificave kërkon udhën drejt lirisë. Është më se i fuqishëm e paradoksal vargu i tij: *Lirin e keni ju; na hekra kemi*,⁹ - duke esencializuar opozitat filozofike ku *lirin-ë* e ka në zemër nacioni, ndërsa *hekrat* i ka me bollëk okupuesi. Ndre Mjedja, duke i kërkuar hallkat identitare, kërkon që megjithë *hekrat*, të ruhet motivi i fortë për lirinë nacionale, pra të përdorim një figurë të tij, të ruhet fuqia nacionale që të *mugullojë lirija*. Poema u shkrua në kohën 1901-1911 dhe bartë edhe shenjat e kohës.

Ndërsa, te sonetet e veprës *Lissus*, duke hyrë edhe më thellë në arkeologji dhe histori nacionale, Ndre Mjedja shkruan *metoniminë e fiksionalizimit historik*, pra hyn në mallin e tij për të hulumtuar në rrënjët etnike-nacionale. Kjo domosdo e shtyn drejt conceptualizimit poetik dhe gjithsesi drejt metonimisë, e cila kapet për shenja identitare duke i parë ato me mallin e autorit. Në kuadër të kërkimit të rrënjëve,

⁸ Përplasje të dijetarëve jezuitë me rregullat e kanonizuara ka pasur në shumë raste të historikut të këtij rendi.

⁹ Poema *Lirija* në Ndre Mjedja: *Vepra I*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 125.

Mjedja ndërlihet me luftërat ilire dhe bukurinë ilire, por kjo ndërlihdje shërben si lidhje hallkash me kohën e lavdit të Skënderbeut, Lezhën që ruan eshtrat e tij si motivim për *me dekë* në kohë të re historike, sepse: *Aj diq, o Zot, per mbas detyrës, por të shkretën/Atme ti rueja, qi dikur pertrîni,/Ti në qiell nder mprojsa të Shqyptaris rreshtojë*.¹⁰ Mbi të njëjtin parim, Ndre Mjedja shkruan edhe *tingëllimat* te vepra *Scodra*, duke hyrë në mitologji, arkeologji e histori, madje duke e parë Taraboshin si simbol të rezistencës dhe të krenarisë ilire-shqiptare, ndërsa Kodrin themeluesin e qytetit të lashtë shqiptar, por edhe kohën e flijimit e cila simbolizohet me vargun *Aferdita per fli Rozafen lypë*,¹¹ qoftë edhe si vijimësi e simbolikave që përbëjnë kulturalitetin arkeo-historik të qytetit, në këtë rast kur Aferdita, perëndesha e bukurisë, kërkon flijimin e bukurisë shkodrane Rozafës.¹²

V. MJEDJA: ALEGORIA – MORALIZATORI

Mbi konceptet autoriale edukative-moralizuese, Ndre Mjedja shkroi edhe një numër të konsiderueshëm të vjershave për lexuesit e rinj duke e ndjerë nevojën për motivimin e tyre për jetë të ndershme, por edhe për t'ua trasuar një rrugë të drejtë në *formimin e personalitetit* njerëzor. Pra, kur kjo intencë është sforcuar deri në kërkesën për të formuar vargjet e tij, Mjedja ka zgjedhur *alegorinë* si dominancë e figurës mbi parimin gjenetik të saj që lidhet me moralizimin, edukatën e mbamendjen. Sipas kësaj logjike, teksti poetik del të jetë i shkurtër dhe sugjeron një mesazh. Në leximin e vjershave të tilla veçojmë kapjen për fenomenet njerëzore siç është alegoria *Guxo*, e cila sugjeron *trimëri e guxim* për sukses, pastaj alegoritë që lidhen me kujdesin në familje, qoftë edhe si kërkesë permanente për dashurinë ndaj prindërve, *Dashtnija ndaj prinden, Nana me buz në gaz*, të cilat sforcjnë respektin për trashëgiminë dhe nderimin për dashurinë e tyre. Mirëpo, nëse alegoria si figurë te vjershat e cituara merr autorësi më të fuqishme, qoftë duke e pasur

¹⁰ Po aty, f. 141.

¹¹ Po aty, f. 159.

¹² Duhet të vërejmë se Ndre Mjedja, mbi parimin e kërkimit poetik në trashëgiminë etnike-nacionale, kishte në plan të shkruante edhe poemat *Dyrrachium* dhe *Apollonia*. Madje poema *Scodra* mbeti e papërfunduar. Kjo vërehet për faktin se leximi i simboleve etnike-nacionale në vijë strukturale kronologjike arrin deri te ndërtimi i Kalasë së Rozafatit. Kjo e dhënë është botuar në *Parathënien* e botimit të parë të veprës: Ndre Mjedja, *Scodra*, Zoja e papërllyeme, Shkodrë, 1939. Shënim sipas botimit: Ndre Mjedja: *Vepra I*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 145.

paramodelin popullor, megjithatë Ndre Mjedja shkruan edhe *Kashë e lasha* dhe *Fjalë të urta*, të cilat jetojnë në botën e njohur të morali-zimit. Një fjalë e urtë e tij thotë: *Nieri i lehtë/Mba kryet përpjetë*.¹³

VI. MJEDJA: KLASIKU

Tashmë duhet të ritheksojmë se Ndre Mjedja është klasiku i letërsisë shqipe. Sipas këtij definimi del se Ndre Mjedja është *autor i pjekur*¹⁴ i letërsisë shqipe, por edhe autor që ka për qëllim *të ilumonojë idenë e traditës*.¹⁵ Janë këto dy koncepte për klasikun, i pari lidhet me mendimet e T. S. Eliotit, ndërsa i dyti me venerimet e Gadamerit. Në të dyja planet Ndre Mjedja del të jetë *klasik i shqipes*. Por, epiteti i tillë vetëm sa e forcon dëshirën për të shprehur aksiomat se si mund të lexohet e interpretohet klasiku ynë sot e kësaj, pra në këtë 150 vjetor.

Duke njohur klasicitetin në krejt madhësinë e tij, themi se *misteri letrar* nuk qëndron në epitetin, qoftë ai edhe i arsyeshem, por në dialogimin permanent të tekstit letrar, në këtë rast, verbit letrar të Ndre Mjedës me kërkesën e vijueshme të qenies njerëzore, me të bukurën si veçanti krijimtare. Kjo bukuri letrare, kur hyn në krahasim me bukuritë e tjera të klasikës shqiptare, gjithsesi se del e veçantë, madje reflekton një vetmi thuajse të pazakontë për autorët e tjerë.

Në përqasje me autorët e *Qarkut Verior* (koncept i Çabejt), Ndre Mjedja sfporcoi vetminë krijuese duke e sprovuar dhe provuar filozofinë e gjuhës shqipe në format e rënda klasike të shkrimit. Metafora, metonimia e alegoria e tij janë dëshmi e vetëdijes për konceptin se verbi letrar duhet të fuzionojë empirinë, traditën dhe filozofinë në një gjuhë të rikrijuar, e cila qoftë me parabazë në metoniminë popullore është e aftë të ridimensionohet në format e ndërliqshme të botës autonome letrare. Kjo aftësi e bëri Ndre Mjedjen autor të veçantë, por të vetmuar. Vetmia e tij, qoftë e parë edhe si “ishullim” u bë më se e natyrshme si pasojë e stilit të lartë të shkrimit të tij. Nuk kërkoi parullën, por kërkoi harmoninë e lartë të emocionit dhe të mendimit në shkrirjen poetike, e cila domosdo kërkon lexuesin e mistereve të letërsisë e jo lexuesin, i cili kërkon mësimin rudimentar nga shkrimi letrar! Kjo shtyu që, meqenëse nuk krijonte ideologema, verbi i tij të interpretohej në mënyrë jovalide, por të keqlexohej

¹³ Ndre Mjedja: *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 46.

¹⁴ T. S. Eliot: *What is a Classic*, (Presidential Address to the Virgil Society, 1944)

¹⁵ Hans-Georg Gadamer: *Truth and Method*, Continuum, London, 2006, ff. XI-XXXI

nëpërmjet atribuideve, të cilat nuk i konotonte ai. Përrjashtim total nga ky keqlexim përben teksti inaugurues i botimit të Ndre Mjedjes në Prishtinë, i vitit 1982, nga Sabri Hamiti, i cili sfidonte fuqishëm poetikën e realizmit socialist të interpretimit, poetikë e cila e kishte “varfëruar” qoftë me vetëdije, qoftë pa vetëdije, botën e mistershme të vetmisë krijuese të autorit! Duke e thyer kritikën e *institucionalizuar*¹⁶ për veprën letrare të Ndre Mjedjes, Sabri Hamiti hapi nyjat për lexim semiotik e semantik të veprës së tij.

Mirëpo, për mendimin tonë, Ndre Mjedja sjell në përshershmëri fuzionimin e metaforës metafizike, metonimisë gnoseologjike nacionale dhe alegorisë moralizuese, në trajtat e formës së lartë kompozicionale poetike, e cila si monument i kulturës identitare shqiptare i sfidon epitetet dhe jeton në botën e leximit dhe të rileximit. Kjo filozofi nuk përjashton trajtat e ndërliqshme të empirisë apo gnosistit autorial, por jeton si dominancë e veprës së tij letrare, qoftë edhe duke e kapur vetëdijshëm hallkën e universalitetit mbi motivacionet dhe motivet e jetës shqiptare. Ndre Mjedja e ka formuar personalitetin tonë nëpërmjet thirrjes latente për ta rilexuar veprën e tij!

LITERATURA

- Dhurata Shehri: “Të vdesësh, Andrra e Jetës!” në Studime Albanologjike, Tiranë, 2013
- Hans-Georg Gadamer: *Truth and Method*, Continnum, London, 2006
- Horaci: *Mbi artin poetik*, Buzuku, Prishtinë, 2000
- Longinus: *On the Sublime*, trans. W. F. Fyfe, Loeb Classical Library, HUP, 1995
- Ndre Mjedja, *Vepra 1-3*, Rilindja, Prishtinë, 1982
- Ndre Mjedja: *Përmbi poezi përgjithësisht* në *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1982
- Paul Ricoeur: *The Rule of Metaphor*, Routledge, London, 2003
- Roland Barthes: *S/Z*, Blacwell, London, 2002
- Sabri Hamiti: “Ndre Mjedja poet”, në Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982
- T. S. Eliot: *What is a Classic?* (Presidential Address to the Virgil Society, 1944)

¹⁶ Sabri Hamiti: “Ndre Mjedja poet”, në Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. VIII.

Gjovalin SHKURTAJ

“SHQYPTARIJA” DHE PËRBASHKËSIA E GJUHËS SI DËSHMI E NJËSISË SË KOMBIT SHQIPTAR NË VEPRAT E NDRE MJEDËS

Përgëzoj organizatorët e dy akademive tona (Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë), që na tubuan sot në këtë konferencë shkencore, e cila, në qoftë se nuk gabohem, është e dyta e tillë mbas asaj që iu kushtua disa vjet më parë shkrimtarit Anton Pashku, në Tiranë; kjo konferencë na mundëson t’i bashkojmë, t’i afrojmë e t’i bashkërendojmë forcat dhe ndihmesat në fushën e studimeve të sotme.

Para se të lexoj ato që i kam shkruar në kumtesën time, më lejoni që të them qysh në fillim se vjersha “Bashkonju” e Ndre Mjedës do të ishte mirë të lexohej së paku një herë në vit nga çdo shqiptar, sidomos nga ata që veprojnë në sferat e epërme të drejtimit të politikës, arsimit e që ideojnë e zbatojnë strategjitë kombëtare të hulumtimeve e të krejt jetës së kombit e popullit shqiptar.

Tema e kumtesës sime është “Shqyptarija” dhe përbashkësia e gjuhës si dëshmi e njësisë së kombit shqiptar në veprat e Ndre Mjedës”, prej së cilës do të lexoj një shkurtore, kurse variantin më të gjatë, ashtu si kolegët e tjerë, do ta dorëzoj për botim në vëllimin përkatës.

Në rreshtat e kumtesës sime, duke iu përmbajtur caqeve nevojisht të përmbledhura për arsye të kohës, do të shpreh (përkant. të ritheksoj e të pasuroj) disa vlerësime që përforcojnë mendimin se Ndre Mjeda, qoftë në vjershat e poemat, qoftë edhe në krejt veprimtarinë e tij shkencore, atdhetare, politike, arsimore etj. mbetet një nga prijatarët dhe luftëtarët më të zjarrtë që *përbashkësia e gjuhës të ishte mjeti kryesor i njësimi e përparimit të kombit shqiptar*¹. Tehun e asaj që

¹ Shih: Kumtesën tonë me titull “Përbashkësia e gjuhës si dëshmi e njësisë së kombit shqiptar në veprat e Mjesës”, Aktet e Konferencës Shkencore, Shkodër, 8 dhjetor 2007 dhe Bushat, 1 gusht, 2012, në “Mjedologji”, 1, 2014, f.101-111.

mund të themi e kemi nyjëtuar në këto tri fjalë çelës: *Shqyptarija*, *lirija* dhe *gjuha shqipe*. Ato ishin, janë dhe mbeten leksemat jo vetëm më të shpeshtat, por edhe më të dashurat, më atdhetaripohueset në veprimtarinë e shkrimtarinë e Ndre Mjedës.

Vjershëria e Ndre Mjedës ka “vulë” të dukshme e të theksuar atdhetarie, duke dalë, ashtu si bashkëkohësi e bashkëvendësi tjetër zadrivor, Atë Fishta, si ideator dhe mëtues i pamposhtur i pohimit:

*“Kjoftë mallkue, kush qet ngatrrime,
Nder kta vllazën shoq me shoq:
kush e dan me fjalë e shkrime,
Ça natyra vetë përpoq!”*²

1. “Shqyptarija” në vjershat dhe në veprimtarinë shoqërore, gjuhësore dhe politike të Ndre Mjedës

“Shqyptarija”, të cilën Mjeda e shkruan gjithmonë me shkronjë të madhe, pa dyshim, i ka kuptimet që jepen për të në *Fjalorin e gjuhës shqipe* 1.shqiptarët, populli shqiptar dhe 2. ndjenja dhe ndërgjegjia kombëtare shqiptare, dashuria e shqiptarëve për atdheun e tyre; shqiptarizëm“(Tiranë 2006, f.1047), por te Mjeda, kjo fjalë është zgjedhur si figurë e gjallë, e shenjtëruar, e shpirtëzuar, sikundër shihet, mbi të gjitha, te soneti “Andërr”, personifikimi me vlerë madhore dhe absolute kombëtare, simbol i devotshmërisë, i përkushtimit dhe virtyteve që përbëjnë idnetitetin shpirtëror të njeriut, të atij që i thotë vetes shqiptar.

“Shqyptarija” ka qenë te Mjeda motërzim i vetë qenies së tij, prandaj, edhe kur botoi “Andërr”, sikundër e përmendi edhe Sabri Hamiti në kumtesën e sotme, ai nënshkroi me pseudonimin “Shqyptari”.³ Vetë Lokja, nëna a tij, e kishte ushqyer që në moshë të njomë duke i thënë:

*”Nji nanë tjetër, thoshte ke,
Bir, n’ket dhe,
Nana jote asht Shqyptarija”.*⁴

² Shih: Ndre Mjeda, *Gjuha shqipe* (Gustav Meyer-it), në “Juvenilia dhe vepra të tjera”, Mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi, N.Sh.Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë, 1964, f.98.

³ Shih: Sinan Gashi, *Pseudonimet e krijuesve tanë dhe karakteri i tyre*, “Rilindja”, Prishtinë, 28 janar, 1981, f.11 (cituar nga M.Quku, *Mjeda 6, Libri I dytë*, f.165).

⁴ Ndre Mjeda, *I tretuni*, në “Juvenilia dhe vepra të tjera”, Mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi, N.Sh.Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë, 1964, f.54.

Vjershat dhe poemat e Ndre Mjedës janë kushtrim për ruajtjen dhe mbrojtjen e tërësisë truallësore të kombit e popullit shqiptar, duke u shprehur qartë e katërcipërisht edhe nëpërmjet toponimisë që përmend e shtie në vargjet e veta, si p.sh.:

*“Prej Tivarit e n’Prevezë,
Nji â giuha e kombi nji,
Ku lëshon dielli njato rreze
Qi veç toka jote i dī”.⁵*

Askush më bukur, po edhe aq me forcë e ndikim në thelb të zemrës së popullit, nuk i ka kënduar njësisë dhe përbashkësisë së dy dialekteve të shqipes, sa Ndre Mjeda, kur thotë:

*“Geg’e Toskë, Malci, jallija,
Jan nji komb, m’u da s’duron;
Fund e maje nji â Shqypnija,
E nji gjithë t’gjith’ na bashkon”.⁶*

Kësaj ideje madhore (të njësisë dhe përbashkësisë së shqiptarëve, të lidhur me një gjuhë “shejte” e të vetme) Mjeda i është qasur e rikthyer disa herë e gjithmonë me theksim e ton kushtrimues, si p.sh. te vjersha “Bashkonju”, ku ai thërret:

*“Mbldhn’ju vllazen, e bashkon’ju
Nen flamur të Shqyptaris:
Prej nji gjaku, nji gjinis
Â shqypтари kand e kand.
Nji gjuhe shejte t’gjith kuvësim
Nji istori, nji atdhe ne kemi,
Geg’e Toskë nji zemre jemi
Me ndjekë Shqype hovin tand.”⁷*

⁵ Shih: Ndre Mjeda, *Gjuha shqype* (Gustav Meyer-it), në “Juvenilia dhe vepra të tjera”, Mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi, N.Sh.Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë, 1964, f.97.

⁶ Ndre Mjeda, *Gjuha shqype* (Gustav Meyer-it), në “Juvenilia dhe vepra të tjera”, Mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi, N.Sh.Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë, 1964, f.98.

⁷ Shih: Ndre Mjeda, *Bashkonju* në “Juvenilia dhe vepra të tjera”, mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi, N.Sh.Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë, 1964, f.123.

2. Edhe “lirija” e “lirimi” i Atdheut janë fjalët në të cilat Mjeda, po të përdorim një shprehje të kohëve të reja, “investon” shumë e me përkushtimin më të madh. “*Për lirimin e atdheut- sikundër thotë Mentor Quku, njëri nga studiuesit më të përkushtuar të Mjedës- ai bëri politikë, mori pjesë në kryengritje popullore, theu disiplinën e shoqërisë, kurse në Manastir qe shpirti i sakrificës dhe negociatori i kompromisit*”⁸. Jemi rritur me tharmin atdhedashës që përmbajnë vargjet e pakundshoqe për “*nanat e Hotit, që ndër djepa rrisin djelmëninë ushtore e hidhnim n’anmikun nëpër gji u qesin*”, prandaj, jam i bindur se secili bir i Malësisë sonë të Madhe “Nderi i Kombit”, është ndier krenar që kemi pasur aso nënash, që kanë lindur “piramida të Shqipërisë etnike, heronj të lirisë e të shqiptarisë”, si Ded Gjon Luli e Prek Cali etj. Bëmat trimërore të burrave të tillë, si dhe ajo dëshirë e përhershme dhe prej mijëra vjetësh e perealizuar e shqiptarëve për liri e lirim ishin për Mjedën te poema “Lirija” si shkëmbinjtë prej graniti në themelet e godinave të patrandshme.

Ai e fillon poemthin “Lirija” me thirrjen drejtuar shqypes e zogjve të maleve: “A shndritë rreze lirije mb’ato maje?”, për të sjellë në strofën e tretë klithmën lirimdashëse të Malcisë:

“Lirim, lirim bërtet gjithkrah Malcija;
A ka lirim ky dhe qi na shklet kamba,
A veç t’mjerin e mblon anë mb’anë robnija?”⁹

Prandaj, edhe I. Kadareja, duke sjellë si shembull poemën “Lirija”, habitet me mendjen e Mjedës, i cili sfidonte modelet e Evropës së plakur, gjysmëmonarkike e gjysmëshoviniste, evokonte për shqiptarët rendin shoqëror amerikan, u fliste atyre për SHBA-në, për Gj. Uashingtonin e Nju Jorkun. Ai sjell si shembull vargun “*Lirinë e keni ju, na hekra kemi*”.¹⁰

Që në fillim të poemës Mjeda vlerëson popujt që luftojnë për liri dhe në mënyrë të veçantë popullin amerikan, që luftoi e hoqi skllavërinë dhe, enkas, i drejtohet së kaluarës shqiptare, figurës së Skënderbeut që “*mbshehtas shetiti,... Frymë të re tui shprazun per gjithkahna,*

⁸ Shih: M.Quku, *Mjeda 3, Libri i parë*, Alfabeti, Ilar, Tiranë, 2007, f.417.

⁹ Shih: Ndre Mjeda, *Lirija* në “Juvenilia dhe vepra të tjera”, mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi, N.Sh.Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë, 1964, f.171.

¹⁰ Shih: *Letërsia, koha, qytetërimi shqiptar*, “Zëri i rinisë”, viti 49, nr.23, f.3-4, Tiranë, 21 mars 1990.

hija e Skanderbegut....”¹¹ Edhe poeti Dritero Agolli, duke e quajtur Mjedën “*shenjtori i madh i Poezisë*”, pikërisht duke u ndalur te poema “*Lirija*” dhe e ka vlerësuar Mjedën si “*një nga poetët më të mëdhenj të Shqipërisë, i cili trajtoi një mori temash për atdheun, shoqërinë, lirinë, natyrën, kulturën dhe të gjitha këto me një mjeshtëri të madhe artistike*”.¹²

3. Ndre Mjeda ideues dorëmbarë i politikës gjuhësore, duke kërkuar: “Të dashunit e gjuhës, por edhe të dalunit zot” asaj.

Shpreh bindjen se te Ndre Mjeda gjejmë edhe baza të politikës gjuhësore kombëtare, të shprehura qartë e theksueshëm në punën, përpjekjet dhe, së mbрами e më për së forti, në kompromisin e tij për zgjidhjen përfundimtare të alfabetit të njësuar e të përbashkët të shqipes në Kongresin e Manastirit (1908), si dhe për krijimin e *frymës përbashkuese* në punën për formimin e një gjuhe letrare kombëtare për të gjithë shqiptarët. Rasti dhe solemniteti i kësaj konference shkencore e lyp ta pohojmë me gojën plot se Ndre Mjeda duhet vlerësuar si shembulli më domethënës i flijimit të “egos” dhe “primatit ditunor”, në të mirë të zgjidhjes së njësimit të alfabetit të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Edhe pse ishte gjuhëtari e filologu më i dalluar i kohës, edhe pse shkencërisht zgjidhja e propozuar prej tij për një *alfabet latin, por pa dyshshkronjësia (bigrame)* do të ishte më e drejtë¹³, në Kongresin e Manastirit, Ndre Mjeda, për hir të njësimit dhe njëjtësimit (unifikimit) pranoi alfabetin e sotëm, duke jetësuar kështu një kompromis historik, një pajtim të të gjithë shqiptarëve, pikërisht në kohën e përpjekjeve dhe frymës përbashkuese që u shtroheshin kombit e popullit shqiptar vetëm katër vjet para shpalljes së Pavarësisë. Më pas, në Komisinë Letrare të Shkodrës, si njëri nga anëtarët më veprues të saj, Mjeda u mor me caktimin e bazës dialektore të gjuhës së shkollës dhe administratës shtetërore shqiptare, për normalizimin e saj dhe për vendosjen e rregullave të drejtshkrimit, krijimin e terminologjisë shkollërore e asaj administrative të njësuar. Në atë komision, Mjeda, duke

¹¹ Shih: Ndre Mjeda, *Juvenilja dhe vepra të tjera*, Mbledhur e redaktuar nga Mark Gurakuqi, Tiranë, 1964, f.175.

¹² Shih: D.Agolli, *Mjeda shenjtor I madh I poezisë*, Figura të shquara të artit shqiptar: Tonin harapi dhe ndre Mjeda, dy lirikët e shquar të Shkodrës, broshurë, Tiranë, 10 dhjetor 2010. (Cituar nga M.Quku, *Mjeda 6, Libri I dytë*, f.25).

¹³ Shih edhe R.Ismajli, *Mjedja për alfabetin e drejtshkrimit në raport me jezuitët* (kumtesë që u lexua në senacën e parë të kësaj konference).

qenë larg çdo qëndrimi të ngushtë vendorist (lokalist), u bë partizan i vënies në bazë të gjuhës së shkrimit të një të folmeje tjetër nga ajo në të cilën shkruante ai vetë dhe luftoi për gjetjen e mbështetjen e formave më të përshtatshme për t'i afruar dialektet e shqipes.¹⁴

Në rastin e Ndre Mjedës, ndoshta edhe më shumë se te cilido nga bashkëkohësit e tij të mëdhenj, si Gj. Fishta, L. Gurakuqi etj., vitet që kalojnë dhe kohët e reja që erdhën mbas tij, kanë qenë të atilla që shkojnë sipas thënies popullore të Jugut: *”vitet tujtje e Ai tëhu”*: janë zgjeruar hapësirat e kundrimeve e kërkimeve rreth jetës e veprimtarive të shumta atdhetare, gjuhësore, muzikore, politike, humane etj.; janë shkruar artikuj, kumtesa e libra monografikë, është ideuar, jetësuar dhe mëkëmbur tashmë edhe një dije e tërë e veçantë e pagëzuar bukuraza “Mjedologji”, në botimet e përfshira në faqet e së cilës Mjedës, atij burri me shtat të shkurtër e fjalëpakët, i janë kushtuar ndihmesa të plota e frymëgjata, i janë blatur fjalë nderuese dhe shqyrtime me rëndësi për historinë e letërsisë shqiptare dhe të albanologjisë në përgjithësi. Vlen të përmendet, këtu, edhe ndihmesa e puna e palodhur e dom Nik Ukgjinit dhe e bashkëpunëtorëve të tij, duke ngritur edhe Qendrën Muzeore “Ndre Mjeda”, si vendtakimi gjithëkombëtar për njohjen dhe nderimin e Poetit e studiuesit tonë të madh.

Mbështes vlerësimin e kolegut e mikut tim, Kolec Topallit, se *“Mjeda është artist i fjalës dhe njohës i mirë i gjuhës, lëvrues i rrallë i saj dhe gjuhëtar me vlera të mëdha”*.¹⁵ si dhe tëhollimet shumë interesante të Mjedës si filolog nga kolegët parafolës (akad. Rexhep Ismajli e prof. Bardhyl Demiraj). Do të shtoja se janë të mirëseardhura vlerësimet e Mjedës si gjuhëtar, sidomos si filolog e si një nga figurat kryesore të Kongresit të Manastirit, bashkë me Gjergj Fishtën, për meritat e punën e tij edhe si hartues fjalorësh dhe si filologu që në shqyrtime rreth veprës së Pjetër Budit, ndërmori edhe një ekspeditë hulumtuese në të folmen e Gurit të Bardhë, për të gjetur burimin e saktë të prurjeve leksikore e frazeologjike të Budit. Këto dhe të tjera, pa dyshim, janë me rëndësi të pasqyrohen edhe më gjerë në Historinë e albanologjisë shqiptare, sidomos sa lidhet me punën për alfabetin e shqipes, për krijimin e njësismin e një gjuhe letrare të përbashkët etj. Mjeda qe gjuhëtar me dije të gjera, por edhe mbrojtës i pakursyer i hireve të shqipes, duke u dalluar edhe për një veprimtari konkrete

¹⁴ SHIH: M.Domit, *Ndre Mjeda si gjuhëtar dhe lëvrues i gjuhës shqipe*, “Drita”, viti 6, nr.47, Tiranë, 20 nëntor 1966, f.2.

¹⁵ Shih: K.Topalli, *Arti i shqipes në veprën e Mjedës*, “Koha jonë”, Tiranë, dhjetor 2007, nr.10.

kundër përdorimit të fjalëve të huaja të panevojshme, prandaj edhe sot, më tepër se kurrë, mendoj se ia vlen të citojmë në këtë konferencë, me solemnitetin që meriton, shembullin e lartë (besoj edhe të parin e të vetmin) që ai, si deputet i Parlamentit të Shqipërisë, në vitet 1920-1924, ka ngritur zërin dhe ka ngulur këmbë për terminologji dhe gjuhë zyrtare të pastër shqipe. P.sh. në vend të termit “Urdhni i ditës” (kalk nga italishtja “ordine del giorno” apo nga frëngjishtja “ordre de jour”) Mjedja kërkonte të përdorej “Rendi i ditës”, si togfjalësh i shqipes. Përveç këtij episodi që e ka shkruar Mark Gurakuqi¹⁶, për qëndrimin e flaktë të Mjedës kundër fjalëve të huaja dhe për pastërtinë e gjuhës shqipe, do t’i referohemi edhe një shembulli tjetër, po ashtu interesant e domethënës, që e ka treguar Gjush Sheldija, mik personal i Mjedës, i cili, shkruan: “Mbasi u kthye në atdhe, Mjeda mori pjesë në grupet për pastrimin e këngëve të ahengut nga shprehjet jo të denja...”¹⁷.

Ndre Mjeda, duke pasur dije të gjera albanologjike dhe mirëfilli gjuhësore për shqipen, e ndiente më mirë e më thellë se të gjithë bashkëkohësit e vet se kishte rëndësi të madhe atdhetare e kombëtare, jo vetëm “të dashunit e gjuhës, por edhe të dalunit zot” asaj me dije e me pohime të mbështetura prej shkencëtarëve të mirënjohur, sikundër ishte, ndër të tjerë, edhe albanologu i shquar Gustav Mayer, të cilin poeti e njihte jo vetëm nga sa kishte gjurmuar e pohuar albanisti i madh për historinë e gjuhës shqipe, po edhe kishte letërkëmbim me të.

Me vargje të një bukurie e hijeshije të pakundshoqe deri atëherë, po edhe mbi shtratin e mbërritjeve e pohimeve të dijetarëve për hershmërinë e shqipes dhe të qenët e saj “pa lidhje birërie me asnjë nga gjuhët e vjetra të Evropës”, poeti përthekon metaforikisht sa vijon:

“Por me gjuhë kaq t’moçme e mjera
Si ‘i bij kje qi pa prind mbet;
Per t’huej t’mbajshin dhenat tjera,
S’t’kishte kush për motrë t’ve’”.¹⁸

Dashuria për gjuhën shqipe dhe ndjenja që ngjall rrethana se “shqypja ndihet” shkon gjithmonë krahas me ndjenjën se “Shqyptarija

¹⁶ Shih: M.Gurakuqi, *Episode dhe kuriozitet*”, “Ylli”, viti 3,nr.7, Tiranë, korrik,1962, f.12.

¹⁷ Shih: *Mjeda intim*, “Mësuesi”viti 3,nr.52, Tiranë,dhjetor 1963, f.3.

¹⁸ Shih: Ndre Mjeda, *Gjuha shqype* (Gustav Meyer-it), në “Juvenilia dhe vepra të tjera”, Mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi, N.Sh.Botimeve “Naim Frashëri”,Tiranë, 1964, f.98.

rron”, dhe ky binom madhështor e drithërues për çdo shqiptar të vërtetë përshkon tejendinë vjersherinë e Mjedës dhe vrujon këndshëm jo vetëm te vjersha “Gjuha shqype”, po edhe gjetiu, ashtu si gurrat freskuese që mbajnë gjallë gjelbërimin e barin e butë të bjeshkëve.

Ndre Mjeda (Mjedia) ishte, pa dyshim, poeti me formim filologjik e gjuhësor dhe me njohjen më të mirë të mbërritjeve të gjuhësisë evropiane të deriatëhershme dhe, mbi atë bazë, si dhe duke qenë në letërkëmbim e bashkëpunim të ngushtë e të përhershëm me figurat më të dalluara të albanologjisë së huaj (G. Majer, H. Pedersen etj), diti të sendërtojë edhe një qëndrim të peshuar e të drejtë larg krahinorizimit dhe ndarjeve territoriale, larg pasioneve të egra për triumfin e njërit apo tjetrit dialekt, njëres apo tjetres preferencë shkronjash. Ai lartëson autorët e vjetër të Veriut dhe punon deri në mbarim të jetës për të gatitur për shtyp veprën e Pjetër Budit, por është po aq i dhënë mbas vlerave të Kristoforidhit, Naim Frashërit, Sami Frashërit, Faik Konicës, Jani Vretos, Gjergj Pekmezit etj. sepse, sipas tij, Gegë e Toskë janë shqiptarë, janë Shqipëria. Dhe, siç shprehej E. Koliqi, *“nji tjetër gjë e bani Mjedën të pavdekshëm; dashunija e stërfuqishme për gjuhën shqipe”*.¹⁹ Jemi vonë, por si thotë fjala e urtë “më mirë vonë se kurrë”, kur flasim për “shqyptarinë” si palca e frymëzimit dhe e gjakimit krijues e veprues të Mjedës si atdhetar, si politikan, si gjuhëtar dhe si poet, na takon t’i referohemi vlerësimit të hershëm, të drejtë e të pakthyeshëm të Ernest Koliqit, i cili *“kishte kuptuar atë që nuk e kuptuan, e harruan ose e neglizhuan ata që erdhën më vonë. Me intuitën dhe syrin e tij vëzhgues, kishte kuptuar se cilat ishin lidhjet shumëplanëshe të Mjedës me gjuhën shqipe. E gjithë qenia e Dom Ndreut ishte e mbrujtur prej një lënde të veçantë, që quhej shqyptari, vlerë absolute nacionale, që gjente shprehje në dashurinë e pakufishme të tij për gjuhën shqipe”*.²⁰ Dhe, pikërisht si dëshmi e asaj ndjenje dhe ideje të pavidrë të Mjedës, edhe në një rast solemn si ky i sotmi, në radhë të parë, na vjen në ndihmë togfjalëshi më i dendur dhe më i adhurueshëm prej tij “gjuha kombëtare”, të cilën ai e quan “detyrë shejte”. Citojmë: *“Asht pra nji detyrë shejte me vu në krye të çdo mësimi tjetër mësimin e gjuhës kombëtare. Nuk asht e vërtetë, djelmoça, shka thotë dikush se gjuha asht vetem nji mjet shkëmbimi mendimesh, një vegël sa me mbarue pun; gjuha...asht*

¹⁹ Shih: E. Koliqi, Mjedja, f.202 dhe M. Quku, Mjeda 3, Libri I parë, f.29.

²⁰ M. Quku, Mjeda 3, Libri I parë, f.29.

stolijs ma e shkëlqyeshme, kunora ma e çmueshme në ballë të nanës së sanë, së mjerës mori Shqypni".²¹

Dhe, për këtë , më mirë sesa të parafranojmë, le të citojmë shpjegimin e saktë e të rëndësishëm të mjedologut të përkushtuar Mentor Quku, që thotë:

"Kërkimet e mia të gjata në këtë fushë do të vërtetonin konkluzionin e Koliqit. Aalfabeti i përbashkët i shqiptarëve, norma letrare kombëtare, si dhe problemet e tjera të rëndësishme të gjuhës shqipe, paskan qenë angazhimi kryesor i Mjedës gjatë tërë jetës së tij. Që këndej paskan buruar gjithë angazhimet e tij të tjera, të shumta: puna me alfabetin e gjuhës shqipe përbënte një korpus unik dhe tepër të rëndësishëm të angazhimeve shkencore dhe politike të Dom Ndre Mjedës".²²

Ndre Mjeda, ashtu si miku e bashkëkohësi i tij i Madh, Gjergj Fishta, që vlerësuar e nderuar që në gjallje, duke u quajtur *"apostull i bashkimit të shqiptarëve"*, sikundër pat shkruar Kristo Floqi me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes së poetit, ku shprehte:

"Mjeda po plaket, por është i ri në energji, që shkel gur e curra, prandaj i dërgojmë mirënjohje. Djalëria e sheh si shembull të gjallë. Për nënë Shqipëri, Mjeda nuk vdes kurrë".²³

Dhe, për ta mbyllur: kanë kaluar plot 150 vjet që nga dita kur lindi Ndre(k) Mjeda (Mjedia) dhe, qysh atëherë shumë versnikë e pasardhës të tij kanë ardhur e kanë shkuar, kurse Ai, as në moshën 150-vjeçare, që po ia përkujtojmë sot, nuk na shfaqet si plak i mbetur, i lënë e që mbahet në shkopin e vlerësimeve që i janë blatur pa kursim nga pasardhësit, ashtu si edhe nga kumtuesit e këtij tubimi të rëndësishëm të dy Akademive tona.

Ndre Mjeda është edhe sot, në 150-vjetorin e ditëlindjes së tij, ashtu si jemi mësuar ta shohim në fotografitë e ruajtura nga G. Marubi, në rresht (herë në mes, herë në krah) të burrave të shquar, miqve e bashkëkohësve të tij të mëdhenj, Gjergj Fishta e Luigj Gurakuqi, Luigj Bumçi, Hilë Mosi etj; në letërkëmbim e miqësi me figurat më të shquara të albanologjisë së kohës, si G. Mayer-in, H. Pedersenin, Gj. Pekmezin dhe krejt yjësine e njohur të dashamirëve e lëvruesve të gjuhës shqipe.

²¹ Shih: Mjeda, Vrejtje ...f.30 dhe M.Quku, *Mjeda 3,Libri I parë*, f. 30.

²² Shih: M.Quku, *Mjeda 3,Libri I parë*, f. 30

²³ Shih:Kristo.Floqi,*Mikut të vlerët Dom Ndre Mjedës, mbi shtatëdhjetë vjetorin e tij "Leka"*,viti 8, nr. 12, .Shkodër,dhjetor 1936, f.532.

Besojmë fort, duke pasur parasysh edhe sapo themi sot në kumtesat e kësaj konference, por mbi të gjitha duke u mbështetur në krijimtarinë e Ndre Mjedës e në studimet rreth veprave, vlerave e ndihmesave të tij të vyera e të shumënduershme (atdhetare, letrare, shkencore, politike) nuk gabojmë po të pohojmë se, ai burrë trupvogël e i me mustakë, i veshur me zhgunin e murmë të priftit e pa kurrëfarë kujdesi për pamjen e tij të jashtme, por syshkëndijë e zemërzjarr, do të mbetet i tillë edhe për brezat që vijnë. Natyrisht, koha dhe studimet e shumta që janë bërë për jetën dhe veprat e Ndre Mjedës, kërkojnë që të bëhen edhe përmirësimet e ndreqjet e duhura, si në antologjitë, botimet e teksteve të Historisë së Letërsisë Shqiptare për shkollat e larta e të mesme, patjetër edhe zëri “Ndre Mjeda” në FESH, duke i plotësuar (përkat. freskuar, pasuruar e pastruar).

Pyetja më e rëndësishme që duhet të shtrohet sot e në vitet që vijnë për vlerësimin (përkat. rivlerësimin) e veprave dhe veprimtarive të Ndre Mjedës është: Çfarë kishte mbetur pa u thënë dhe, ndërkaq, në studimet e këtyre njëzet viteve të fundit, është thënë, në studime e përmbledhje studimesh, të atilla si dhjetë vëllimet e “Mjeda” të M. Qukut, në përmbledhjen “Mjedologji” dhe në kumtesa e artikuj të tjerë, sidomos të disa prej njohësve të mirë të krijimtarisë së Mjedës, si K. Petriti, M. Zeqo, M. Elezi etj.

Për mendimin tim, mbas një pune disamujore që m’u desh të bëja për këtë kumtesë modeste, lidhur me krijimtarinë e Mjedës si poet, nuk di se çfarë mund t’i shtohet në vlerësimet që i janë blatur edhe më parë, pa kursim, si poet i frymëzuar, si këngëtar i atdhedashurisë²⁴, si mjeshtër i stilit e mëtues për formë artistike të përpunuar me gjakimin drejt përsosmërisë, cilësi që ia kanë njohur edhe bashkëkohësit e tij të mëdhenj, si Fishta, Koliqi etj. dhe pasardhësit e autorët e monografive e studimeve mbi të, si Dh. Shuteriqi, M. Gurakuqi, R. Idrizi etj.

Natyrisht, në dritën e hulumtimeve të reja, qoftë në komentet, qoftë në antologjitë e ribotimet e vjershave të Mjedës duhen ndrequr edhe disa gabime, qoftë edhe të vogla, si p.sh. shpjegimi i fjalëve *lavruer* dhe *shpuer*²⁵.

Vlerësimet e Mjedës si gjuhëtar, sidomos si filolog e si një nga figurat kryesore të Kongresit të Manastirit, bashkë me Gjergj Fishtën,

²⁴ Shih: A.Varfi, *Këngëtar i atdhedashurisë*, “ZP”, nr.280 (5690), Tiranë,1966. f.3,

²⁵ Shih: M.Quku, *Botimi i veprës së Mjedës dhe ndërhyrja e botuesve.Amatorizëm apo neglizhencë*, në M.Quku, *Mjeda.1*, f.331.

për meritat e punën e tij edhe si hartues fjalorësh dhe si filologu që në shqyrtime të rreth veprës së Pjetër Budit, ndërmori edhe një ekspeditë hulumtuese në të folmen e Gurit të Bardhë, për të gjetur burimin e saktë të prurjeve leksikore e frazeologjike të Budit. Këto dhe të tjera, pa dyshim, janë me rëndësi të pasqyrohen edhe më gjerë në Historinë e albanologjisë shqiptare, sidomos sa lidhet me punën për alfabetin e shqipes, për krijimin e njësimin e një gjuhe letrare të përbashkët etj.

Dora-dorës, duhet ndriçuar më mirë edhe koncepti teorik që kishte Mjeda rreth gjuhës së popullit, gjuhës së letërsisë artistike dhe gjuhës së administratës shtetërore e më gjerë. Me shumë rëndësi na duket ta përmendim këtu sa i shkruante Mjeda Gustav Majerit lidhur me botimin e “Vajit të bylbylit” në “Shahiri Elierz”:

*“...Ky botim është gjymtuar dhe jashtë Shkodre sigurisht nuk njihet. Puristët do të bënin zhurmë, po t’i shikonin mbasi kanë shumë fjalë turke. Po unë i kam bërë për popullin, që flet kështu; dhe në fillim më ishte e nevojshme të veproja në këtë mënyrë për të bërë që të lexoheshin lehtësisht. E pastaj, artikulli juaj: “Shqiptarët” në organin “Arbëri i Ri” më mbron për mrekulli”.*²⁶

Përkundrazi, kur ishte fjala për gjuhën zyrtare, sidomos për gjuhën e administratës së shtetit, Mjedës i takon merita se ka qenë i pari (për fat të keq edhe i vetmi) nga të gjithë deputetët të Parlamentit Shqiptar, i cili e ka ngritur zërin pikërisht për domosdoshmërinë e zbatimit të një politike gjuhësore kundër fjalëve të huaja të panevojshme.

Kjo, natyrisht, duhet bërë jo vetëm për Ndre Mjedën, por edhe për shumë burra të shquar të tjerë të letrave shqipe, me të cilët krenohen dija dhe shkencat albanologjike shqiptare.

Njerëzit e zakonshëm vdesin vetëm një herë, kurse njerëzit e shquar vdesin dy herë: kur ndahen së gjallësh me trup dhe, për herë të dytë, kur harrohen. Dhe kjo, natyrisht, është më e dhimbshmja. Por, ka edhe asish që nuk harrohen kurrë, që mbeten përherë në kujtesën e brezëve të Kombit shqiptar, sepse qenë të prirë nga mëtime e kahe të mbara atdhetarie e liridashëse, siç ishte edhe Ndre Mjeda (Mjedia) diviza e të cilit që “me punue si mos me dekë kurrë”.²⁷

²⁶ Shih: J.Kastrati, *Dymbëdhjetë letra të Ndre Mjedës dërgue albanologut Gustav Meyer-it gjatë viteve 1892-1893*, në “Arsimi popullor”, viti XXII, nr.1.f.10-16, Tiranë, janar-shkurt 1967. Cituar edhe te M.Quku, *Mjeda I*, f.545.

²⁷ Shih: M.Quku, *Me Budin në dorë derisa vdiq*, Milosao, Tiranë, 13 mars 2011 dhe M.Quku, *Mjeda 6, libri I dytë*, Bibliografia, f.715.

Me krenari të ligjshme, edhe si sot 50 vjet, në Akademitë e Shkencave dhe në universitetet shqiptare, kur t'i kremtohet edhe 200-vjetori, me siguri, folës të tjerë, që sot janë krejt të rinj ose ferishte dhe të tjerë që ende nuk kanë lindur, do ta lexojnë, do ta pëlqejnë e do ta lëvdojnë Ndre Mjedën, ashtu si e pat portretizuar më 5 shtator 1937, miku e bashkëkohësi i vet, Ernest Koliqi: *“dijetar i madh, albanolog zëmadh, poet i talentuar, filozof i shquar, atdhetar i zjarhtë, që punoi gjithë jetën për zgjimin e fuqizimin e vetëdijes kombëtare, arsimit e kulturës”*²⁸.

Sa herë të përmendet emri i tij, do të cilësohet si këngëtar i atdhedashurisë²⁹, si vegjëlidashës dhe si deputeti që u shqua për opozitarizimin e tij të ndershëm e në të mirën e popullit të thjeshtë, si flamurtar i lirisë, si kryembrojtës i “Shqyptarisë” dhe i gjuhës shqipe.

²⁸ Shih: E.Koliqi, *Dom Ndre Mjedja*, në “Cirka”, viti 2.nr.28,Shkodër,5 shtator 1937,f.201-203, si dhe te M.Quku, *Mjeda 6,Libri I dytë*, f301-302..

²⁹ Shih: A.Varfi, *Këngëtar i atdhedashurisë*, “ZP”, nr.280 (5690), Tiranë,1966. f.3,

Hysen MATOSHI

VEÇANTI STILISTIKE TË VEPRËS LETRARE TË NDRE MJEDËS

Ndonëse jo një krijimtari vëllimore, letërsia e Ndre Mjedës, si njëra prej veprimtarive të tij, shtrihet në një hark kohor prej 50 vitesh. Janë këto vitet më dinamike të zhvillimit të letërsisë shqipe, të ardhjes së poetikave e të prirjeve të ndryshme stilistike. Rrugëtimi i tij si individualitet letrar, që nis me poemën romantike “Vaji i bylbylit” 1887 e që sos me poemën sonetike “Liria” 1937, pa harruar edhe disa krijime poetike postume, ndërlihdh, në një farë mënyre, “Lulet e verës” me “Vargjet e lira” si fakte të rëndësishme letrare të romantizmit shqiptar nga njëra anë dhe të aspekte të avangardës sonë nga ana tjetër.

Ku qëndron vepra letrare e Ndre Mjedës në këtë pluralitet poetikash e stilesh, gjithnjë duke marrë parasysh këtë evoluim të procesit letrar shqiptar? Që në fillim dua të them se, parë në aspektin e stilit poetik, te Mjeda nuk gjejmë elemente të divergjencave të mëdha, pavarësisht se ka jetuar si krijues letërsie në kontekste të ndryshimeve kaq të mëdha. Dilema, nëse në këtë rast kemi të bëjmë me stilin e krijuesit, apo me veçanti stilistike të veprës letrare si pjesë e një tërësie autoriale, në këtë rast nuk ekziston. Homogjeniteti stilistik i Mjedës si autor është i qartë, pavarësisht nga motivet e ndryshme të veprës së tij dhe pavarësisht nga gjinitë letrare dhe llojet letrare në të cilat merr trajtë ajo.

Për stilin e një autori, në këtë rast të Ndre Mjedës, mund të flitet në rast se konstatojmë disa përbashkësi të opusit të tij, gjithnjë duke nënkuptuar në këtë kontekst tërësinë e veprës së tij letrare. Është punë e një analize të hollësishme e shteruese kritike, jo lehtë të realizueshme, çështja e përcaktimit të unitetit të përbërësve të ndryshëm stilistikë dhe të koherencës së veprës letrare si një strukturë artistike, gjithnjë kur është fjala për opusin tërësor të një autori. Përveçse kërkohet

njohja e plotë e veprës së autorit, individualiteti i tij kundruall traditës dhe bashkëkohësve, është e pashmangshme edhe nevoja për një qasje studimore monografike përmes së cilës dallohen disa nga veçoritë më të rëndësishme karakterizuese dhe njëkohësisht të përsëritshme që ndeshen në veprën e një autori.

Stilin poetik të Ndre Mjedës do të duhej kërkuar si produkt të një ndërveprimi të natyrës së tij të veçantë dhe fakteve letrare e jetësore që mund të shprehen edhe si burime të formimit të tij shumëplanësh. Kur themi formim shumëplanësh kemi parasysh rolin e tij në jetën fetare të kohës si autoritet fetaro-kulturor ndër jezuitët, autor, përkthyes dhe përgatitës tekstesh fetare, dijetar kontribuues në proceset jetike të alfabetizimit të gjuhës shqipe, të studimit dhe të standardizimit të saj, autor tekstesh shkollore, pedagog, politikan etj. Megjithatë, Ndre Mjeda, në rend të parë, mbahet në mend si poet, edhe pse poezia për të ishte më shumë një dashuri pasionale, ishte më shumë një intermexo shpirtërore, një strehë ngushëlluese ku ai gjente prehje në rrugëtimin e vështirë jetësor e profesional.

Nuk mund të quhet një punë e lehtë përfshirja e Ndre Mjedës në kuadër të një formacioni stilistiko-letrar. Ka pasur studiues që, duke u mbështetur në ndjeshmërinë e tij poetike dhe në fillet e krijimtarisë e kanë renditur ndër romantikët, por edhe të tillë që, duke marrë për bazë konceptet letrare, format poetike, tipologjinë e krijimeve, burimet e formimit të tij etj. e rendisin ndër klasicistët. Argumente ka edhe për konstatimet e të parëve, por edhe për ato të të dytëve. Studiuesit e tij, si bashkëkohësit, ashtu edhe të mëvonshmit, kanë dalluar tek ky krijues mjeshtërinë e rrallë të krijimit klasicist. Bie fjala, Ernest Koliqi, në shkrimin “Dom Ndré Mjedja”, më 1937 pohonte: “Vjerrsha për të i shtrohet ligjve t’arkitekturës. Kjo është shëji dallues i klasicitetit. Ka një bazë të fortë mbi të cilën naltohet ndertesa harmonike me shtylla të mirë-rendueme e me trabeacion mirë-përpjestue. Shikoni Odet e Mahmud Pashës dhe të Mustaf Pashës në Juvenilia. Aty përveç shtjelimit pa kurrnji lajthim të landës së përgjithshme, shef të punueme më kujdes të përsosun edhe çdo tubzë e mbrënda tubzave çdo varg. Asnji auktor shqiptar nuk i rreshtoi në varg me përpikni më të madhe fjalët e kësaj gjuhe qi me vishtirsi i u shtrohet ligjve të rythmit e të rimës”.¹ Konceptet klasiciste mbi artin letrar, në rend të parë, kanë të bëjnë me burimet e formimit dhe me shkollimin e tij. Krijimet letrare të Mjedës përgjithësisht mbështeten mbi parime të rregullshmërisë, qoftë ajo e

¹ Ernest Koliqi, *Dom Ndré Mjedja*, “Cirka”, nr. 28-29, Shkodër, 5 Shtatuer 1937, f. 202.

kundruar nga aspekti i metrikës dhe i eufonisë; qoftë nga aspekti i formave poetike. Intenca e tij stilistike nuk është gjurmimi pas shprehjes së re dhe pas mjeteve të reja shprehëse, por përsosuria e atyre ekzistuese, sikundër edhe pohon historiani i letërsisë, Rexhep Qosja: “Ndre Mjedja nuk është aq poet që kërkon trajta të reja po është poet që i përsos trajtat e njohura”.²

Stili poetik i Ndre Mjedjes (me një përqendrim të veçantë te krijimet e botuara gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore) është stil i krijuesit që mbështetet mbi parimet e artit klasikist. Sikundër klasikët e klasicizmit, edhe poeti ynë mbështetet te kulti i antikës, tek adhurimi i pamasë i gjedheve krijuese dhe i kulturës së antikës përgjithësisht, të cilën, sikundër dëshmon më së miri vetë vepra e tij, e njëjtte rrënjësisht. Poemat “Lissus” dhe “Scodra” janë dëshmi e njohurive të thella të kulturës dhe të historisë antikës, të cilat i vë në pah madje që në strukturën e tyre titullore, duke përdorur toponimet e kohës antike. Mirëpo, Mjedën nuk e ndërlihdin vetëm aspektet tematike dhe përmbajtjesore me klasiken, ngase një marrëdhënie e tillë, jo më pak e rëndësishme, hetohet edhe në rrafshin e formave poetike. Ai, duke krijuar tingëllima, përkatësisht poema në tingëllima, dëshmon se për të ishte po aq i rëndësishëm edhe kulti klasikist i përfilljes së rregullave strikte të krijimtarisë pikërisht në formën më identifikuese të klasicizmit, në sonetin. Mjeda mbetet ndër mjeshtrit më të mëdhenj të sonetit në poezinë shqipe përgjithësisht. Sado që nga shumica e studiuesve të veprës së tij poema “Andrra e jetës” është konsideruar kryevepra e tij letrare, ka pasur mendime se e tillë ishte pikërisht poema sonetike “Lissus”: “Lissus njehet kryevepra e tij. Këta dymbëdhjetë tingllime zhdrivillohen me kaqë fuqi plastike saqi duken vepra e një skulptori”.³

Njëri ndër parimet mbi të cilat kodifikohet klasicizmi është, pa dyshim, edhe qartësia e krijimit. Poezia e Ndre Mjedës, përveç në aspektin e gjedheve tipologjike dhe të përsosurisë së formave, edhe në këtë pikëpamje ndjek këtë parim krijues të klasicizmit, duke u bërë model i komunikimit me shtresa të gjera të recipientëve të saj.

Nuk janë temat dhe motivet ato që e karakterizojnë veprën letrare të Ndre Mjedës. Bie fjala, “I mbetuni” i Mjedës mund të ishte një prototip motivues që më vonë shfaqet në “Lagjen e varfun” të

² Rexhep Qosja, **Historia e letërsisë shqipe – romantizmi III** (botim i dytë), “Rilindja”, Prishtinë, 1990, f. 508.

³ Ernest Koliqi, **Dom Ndrë Mjedja**, “Cirka”, nr. 28-29, Shkodër, 5 Shtatuer 1937, f. 203.

Migjenit dhe në këtë pikëpamje paralelet janë më se të kuptueshme. Mirëpo, në rrafshin e përjetimit dhe të mjeteve shprehëse vërejmë se kemi të bëjmë me dy procedime krejtësisht të ndryshme. Zymtësia migjeniane, si ndjesi, e përplotëson varfërinë si realitet, teksa Mjeda mjerimin e të “mbetunit” të tij e jep në një tablo krejtësisht antitetike:

Edhe shtaza po gazmohet,
Edhe bari mungullon;
N’shend natyra gjith po çohet,
Veç ti, i mjeri, po gjimon.

Kangë e valle tui bashkue,
Shend prej gojet gjithkush qet,
Veç i vorfni tui dertue
Porsi i huej â n’gjini t’vet.⁴

Ndonëse është vështirë të definohet saktësisht fakti se çka e përbën stilin poetik, kryesisht për shkak të mundësisë së qasjeve të shumta lidhur me këtë materie, nëse nisemi nga klasifikimi kajzerian⁵, ku përfshihen disa përbërës stilistikë, si ta zëmë: ritmi, tingëllimi, fjala, sintagma, rendi i fjalëve, konstruksioni (ndërtimi) i fjalëve dhe kompozicioni, mund të thuhet se veçantia stilistike Ndre Mjedës do të mund të qëmtohej, ku më shumë e ku më pak, pikërisht në këta përbërës identifikues të veprës së tij.

Mjeda është dëshmia më e mirë se poezia bën jetën e saj të plotë vetëm në gjuhën e krijimit, madje-madje në variantin gjuhësor të autorit të saj. Ndonëse është ndër autorët e parë të përthyer letërsisë shqipe në gjuhë të tjera, kjo poezi është vështirë të lexohet jashtë kontekstit etnokulturor të lindjes së saj. Purizmi mjedan është dëshmi e intencës përjashtimit jo vetëm të fjalëve të huaja, sa herë që është e mundur, por edhe e një përkufizimi të rreptë dialektor edhe në suaza të vetë strukturës dialektore të gjuhës shqipe. Askush nuk ia ka dalë që të ndërtojë me kaq sukses fjalësin poetik tërësisht mbi bazën e fjalësit të zakonshëm të një të folmeje krahinore.

Si një veçori të figuracionit stilistik, do t’i shtonim edhe nuan-cimet kuptimore, herë-herë edhe të përmasës së alegorisë, që i hasim gjithandej veprës letrare të poetit tonë. Krahës figurave të mendimit dhe tropeve, është funksionalizuar mjaft qartë edhe përdorimi i figurave

⁴ Ndre Mjedja, Vepra, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1970, f. 59.

⁵ Wolfgang Kajzer, Jezičko umetničko delo, Beograd, 1973.

të përsëritjes dhe aty-këtu edhe të atyre të konstruksionit. Qartazi në poezinë e Ndre Mjedës bashkëveprojnë njëkohshëm mendimi, shprehja dhe format poetike, pa e cenuar funksionalitetin e secilit prej këtyre përbërësve. Me një fjalë, struktura e saj semantike si domethënie dhe ajo sintaktike si mënyrë organizimi të ligjërimit poetik përbëjnë njërën ndër veçoritë esenciale stilistike të veprës letrare të Mjedës.

Në qoftë se Fishtës iu njoh gjithandej atributi i poetit i kombit, Mjeda nuk identifikohet si i tillë. Ai mbetet poet i lidhur për krahinën e tij, e cila ka ndikuar fuqishëm në personalitetin e tij, veçmas në planin emocional. Këtë ndikim më së miri, përveç fjalësit të kufizuar krahinor, e dëshmon fakti se përgjithësisht, në planin mallit njerëzor, që merr trajtë poetike, Mjeda mbeti i lidhur për Shkodrën. Për të qartësuar sadopak këtë konstatim po përmendim krijimet letrare të këtyre autorëve, pra të Fishtës dhe të Mjedës, me motivin e mallit për vendlindjen, përkatësisht për atdheun, të cilët ata i shkruan në kontekstin jetësor të mërgimit. Lirika e Fishtës “I dëbuemi” vë në pah aspektin autobiografik të përjetimit të ndarjes së autorit të saj nga Atdheu, nga toka arbnore, nga malet e Shqipnisë, ndërsa Ndre Mjeda në poemën “I tretuni” këtë mall e ndërlihd me ambientin e formimit të tij, me vendlindjen:

Lamtumirë, o mori Shkodër!
Lamtumirë, o ti Cukal!
Zhduket Buena nën një kodër,
Zhduket Drini nën një mal.⁶

Edhe te lirika e tij “Malli për Atdhe” gjejmë identifikimin e Atdheut me vendlindjen, përkatësisht me Bunën dhe Maranajn.

Megjithëse motivohet nga ai ambient i formimit të tij, nga Shkodra, vepra letrare e Ndre Mjedës është e përmasës kombëtare, është ndër shenjat më përfaqësuese stilistike të letërsisë sonë.

Puna kreative e Mjedës shëmbëllen me veprën e skulptorit, i cili, në vend të mermerit, kryeveprat e tij i realizon me mjete rrethanore, rrjedhimisht në veprën e tij nuk flet bukuria e luksit të materialit mbi të cilin shkrin mundin e kreativitetin, veçse madhështia e mjeshtërisë së tij.

⁶ Ndre Mjedja, vep. e cit., f. 35.

Dom Nikë UKGJINI

QENDRA MUZEORE NDRE MJEDA VEND TAKIMI GJITHËKOMBËTAR

Mjedja dhe lidhja e tij me Kuklin

Ndre Mjedja si figurë poliedrike, ka ngjallë një interesim të dukshëm tek studiuesit e rinj për ta njohur veprën dhe jetën e poetit dhe gjuhëtarit të shquar shqiptar, i cili tërë jetën ia kushtoi çështjes sonë kombëtare. Ndërkohë që kemi një interesim të konsiderueshëm në studimet mjedologjike, vërehet edhe një prirje për rileximin e veprës së Mjedës, për shkak edhe sepse ky autor punoi sa për shekullin e vet aq edhe për kohët që vijnë. Një nxitje kanë dhënë në këto kushte edhe qendrat e studimeve albanologjike, katedrat universitare si edhe institucionet pedagogjike e shkencore në tërë hapësirën mbarëshqiptare.

Nisur nga këto fakte, që me ardhjen e tij në këtë famulli në vitin 2006, famullitari i Kuklit, Dom Nikë Ukgjini, punoi për disa vite në radhë për kthimin në identitet të botës ndërtimore të Kishës së Shën Shtjefnit si edhe të banesës, (qelës) të projektuara nga dora e poetit, ku edhe jetoi dhe punoi e shërbeu për 30 vite deri në kalimin e tij në amshim, më 1 gusht 1937.

Mjedja erdhi në famullinë e Kuklit në vitin 1906, nga famullia e Dajçit të Zadrimës dhe puna e tij që përqendruar në ndërtimin e shtëpisë, ndërtuar në vitin 1906 dhe të një dhome të shndërruar në Kishë, së cilës ia dha formën e duhur, duke e zgjeruar në vitin 1913.

Që të mos e linte të shuhej një fshat me banorë, Mjedja i dha një hov të madh edhe zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë në fshat dhe zonën e Zadrimës në përgjithësi. Ai punoi kështu tridhjetë vjet për ta transformuar Kuklin, për të krijuar modelin e një fshati modern, të një ekonomie të përparuar, e cila pastaj, të shpërndante përmes saj idetë e tij për transformimin e të gjithë vendit.



Kukli, si qendër - pse për nga numri i banoreve gjithnjë ka qenë i vogël dhe i papërfillshëm - njihej nëpërmjet Mjedës edhe nga shumë personalitete ndërkombëtare. Kështu, edhe austriaku Paul Siebertz, në librin e tij, *Albanie und Albanofen*, dëshmon si dëshmitar okular, se në vitin 1909 Kukli kishte 27 familje,¹ ndërsa Franz Seiner, në statistikën e bëra për popullatën në Shqipëri gjatë viteve 1916-1918, shënon se Kukli dhe Mali i Kuklit, kishte 45 shtëpi, prej të cilave 39 ishin me banim të përhershëm; kishte 302 banorë dhe 12 banorë të tij ishin të besimit mysliman.² Shënime të ngjashme rreth numrit të banorëve gjejmë edhe te At Lorenc Viezzoli, S. J. në vitin 1923, ku del se Kukli kishte 302 banorë.

Në lidhje me Kuklin, Mjeda kishte edhe momente të hidhura. Në vitin 1912 Mjeda u arrestua nga oficerët osmanë të Ali Fehmi Kosturit, të cilët e mbajtën të mbyllur në qelën e Kuklit, ku iu dogjën edhe dorëshkrimet e shumta të punës së tij shumëvjeçare³. Në vitin 1916, në ikje e sipër nga Mirdita, ushtria malazeze u lëshua si e tërbuar në Kukël kundër famullitarit Mjeda, duke e arrestuar me

¹ MENTOR QUKU, *Mjeda*, 7, Ilar, Tiranë, 2005, f. 432.

² FRANZ SEINER, *Schriften der Balkankommission, XIII, Ergebnisse, der Volkszählung in Albanien. 1916-1918. Wien und Leipzig, 1922. f. 30.*

³ *D. Ndre Mjeda*, në Kumbona e së Diellës, nr. 8, Shkodër, 1938, f. 98.

synim eliminimin e tij⁴. Kjo, për fat të mirë, u mbyll me kaq, sepse ushtritë serbe e malazeze u larguan në fillim të vitit 1916, të ndjekur nga ushtria austro-hungareze.

Nga famullia e Kuklit, Mjeda, kryen detyrën e deputetit, politikanit, diplomatit. Po në atë tryezë që sot gjendet në muze, shkroi dhe rishkroi veprat tij krijuese dhe përkthimore, hartoi me qindra faqe tekste shkollore, shkroi me dhjetëra faqe studimore etj.

Famullitarët që erdhën më pas, si: Karlo Prenushi, Zef Gila e Ernest Troshani, (i cili në prag të Krishtlindjes së vitit 1963 u arrestua nga regjimi komunist,⁵) në shenjë respekti ndaj mësuesit të tyre, Ndre Mjedës dhe të kulturës shqiptare, u kujdesuan për ruajtjen e ambienteve dhe të relikteve të poetit që gjendeshin në shtëpi (qelë), si: një pjesë të bibliotekës me disa dorëshkrime, tryezës, pendës, makinës së shkrimit, një kryqi të drunjtë, i dëmtuar nga dhunuesit osmanë, të cilin Mjeda e mbante në tryezën e punës⁶ etj.

Shtëpia muze në kohën e monizmit

Me mbylljen zyrtarisht në vitin 1967 të objekteve fetare në Shqipëri, mbyllje e cila frymëzohej nga *revolucioni kulturor kinez*, do të vazhdonin me intensitet edhe më të madh internimet, burgosjet dhe pushkatimet e klerit katolik, duke iu shtuar këtyre dhe shkatërrimin dhe tjetërsimin e objekteve kishtare.⁷

Edhe objektet në Kukël në vitin 1967 u tjetërsuan: Kisha që shndërruar në depo grumbullimi e më vonë në depo ushtarake, kurse shtëpia e famullisë në shtëpi banimi për banorët dhe një dhomë në vitin 1962 e më vonë në vitin 1982, që ngritur muze me disa relikte të Mjedës.

Pas demokratizimit të Shqipërisë në vitin 1991, u konstatua së të dyja objektet e stilit neoklasik, ishin të dëmtuara rëndë. Dhoma - muze që mbyllur dhe objektet, bashkë më to edhe tryeza e punës, qenë dërguar për ruajtje në Muzeun Historik të Shkodrës.

⁴ MENTOR QUKU, *Mjeda*, 4, Ilar, Tiranë, 2009, f. 186.

⁵ *Jeta e Dom Ernest Troshanit*. 2013, Arkivi i Dioqezës së Shkodrës.

⁶ Nd' Arkidjeqezës të Shkodrës, në Kumbona e së Diellës, (revistë e Arqidioqezës së Shkodrës), nr. 32, Shkodër, 1944, f. 278.

⁷ DOM NIKË UKGJINI, *Kisha Katolike dhe sfidat e saj në Mbretërinë e Zogut dhe sistemit Komunist*: Albanologji, 3, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2013, f. 99.



Rikrijimi dhe kompletimi i Qendrës “Ndre Mjeda”

Me ardhjen e vëllezërve të Nënë Terezës në këtë famulli, më 1991, u ndërmor aksioni për restaurimin e përkohshëm të objekteve në fjalë. Kështu që në vitin 2007 filloi hartimi i planit për organizimin e ndërhyrjes së plotë dhe thelbësore për restaurimin e objekteve dhe risistemimi i ambienteve të kësaj qendre fetare e kulturore.

Idetë e hedhura në letër për riaftësimin dhe plotësimin e Qendrës me objektet përkatëse, për kthimin në identitet të Qendrës dhe përplotësimin e saj, filluan më 19 mars 2011, me ndërhyrje për riaftësimin e objektit të Kishës, e cila kishte gjendje më të ngutshme për shkak të dëmtimit të pësuar.⁸ Punimet e fazës së parë u mbyllën në fund të korrikut, së bashku me oborrin dhe ngritjen e shtatores madhështore të poetit Mjeda. Ceremonia inauguruese u zhvillua më 1 gusht të vitit 2012, në ditën përkujtimore të vdekjes së poetit Mjeda.

Punimet e fazës së dytë filluan me grumbullimin e mjeteve financiare nga Komuniteti Evropian, në muajin maj 2014, ku u përfshi restaurimi i plotë i shtëpisë muze dhe në muajt shtator-tetor të po këtij viti përfunduan punimet në sistemimin e muzeut në katin e parë dhe të dytë. Momenti finalizues i të gjitha punimeve ishte data 18 nëntor

⁸ FATMIRA NIKOLLI, *Ndre Mjeda Arkitekt, si e shpreh çështjen shqiptare*, Gazeta shqiptare, 8 maj, (Tiranë), 2012, f. 18.

2014, kur në praninë e autoriteteve të larta kishtare e shtetërore të kulturës, u zhvillua ceremonia e inaugurimit të kësaj Qendre të rëndësishme gjithëkombëtare.

Me përfundimin e këtyre punimeve, u realizua në tërësi ideja e rikthimit të plotë në identitet të Kishës dhe shtëpisë së Mjedës dhe Qendra “*Ndre Mjeda*” u vu në shërbim të plotë të kulturës shqiptare dhe asaj të huaj.

Duhet theksuar se në qendër të vëmendjes të kësaj Qendre të shpallur Monument Kulture më 16 dhjetor 2011 është tryeza origjinale 100-vjeçare e poetit Mjeda.

Muzeu, i cili gjendet brenda godinës së Qendrës “*Ndre Mjeda*”, me 16.10.2015, u shpall nga Ministria e Kulturës Muze Kombëtar privat, për shkak të vlerave të cilat ky muze i ka.

Qendra merr përmasa gjithëkombëtare

“Ditët e Mjedës” 2011-2013

Bashkë me zhvillimin e punimeve në Qendrën Muzeore “*Ndre Mjeda*”, Dom Nikë Ukgjini, drejtor i saj, mori njëkohësisht përsipër edhe rolin e nxitësit dhe mbështetësit për organizimin e konferencave shkencore të studimeve mjedologjike si dhe takime të vazhdueshme përkujtimore, të quajtura “Ditët e Mjedës”. Për këtë ai ofroi rreth vetes një grup studiuesish të devotshëm, të cilët u morën me kërkime shkencore rreth veprës dhe jetës së Mjedës. Rezultat i këtyre përpjekjeve janë edhe organizimi i veprimtarive përkujtimore kushtuar Ndre Mjedës, çka ka bërë që të rritet interesimi i institucioneve për këtë figurë të ndritur të Rilindjes Kombëtare. Kjo ka bërë që të afrohen në këto veprimtari shkencore-përkujtimore figura të shquara të shkencës shqiptare, por edhe shumë studiues të rinj të talentuar.

Ideja e mbajtjes së takimeve kulturore “Ditët e Mjedës”, gjatë të cilave përkujtohet lindja më 20 nëntor 1866, dhe vdekja e poetit më 1 gusht 1937, është jetësuar nga studiuesit Stefan Çapaliku, Dom Nikë Ukgjini, Mentor Quku e Zef Paci, në ditën përkujtimore të vdekjes së poetit, më 1 gusht 2011, organizuar nga Fondacioni *Ndre Mjeda*, *Komuna e Bushatit* dhe *Qendra e Studimeve Albanologjike* në Tiranë. Në këtë takim ku morën pjesë edhe figurat shtetërore, si: Kryetarja e Parlamentit, Jozefina Topalli; zv. Ministrja e Arsimit Nora Mala dhe diplomatë të huaj, krahas programit kulturor, është bërë edhe ndarja e çmimit *Ndre Mjeda*: medalja e bronzit iu dorëzua mjedologut z. Mentor

Quku, ndërsa diplomat për recituesin më të mirë iu dorëzuan fituesve përkatësisht nga Nora Malaj dhe Ardian Marashi. Në datëlindjen e Mjedës, më 20 nëntor të po këtij viti (2011), Komuna e Bushatit organizoi takimin kulturor me fëmijët e shkollave, ku morën pjesë Ministri i Kulturës Aldo Bumçi si edhe figura të tjera publike lokale.⁹

Për shkak të rëndësisë që ka figura shumëdimensionale e Mjedës, “Ditët e Mjedës” nuk mbeti e mbyllur vetëm brenda kufijve politikë të Shqipërisë, por mori përmasa gjithëkombëtare.

Si ditë e mbarë e një fillimi të ri të takimeve gjithëkombëtarë, ishte 1 gushti, 2012, kur në Bushat u organizua nga tri subjektet e lartpërmendura, Konferenca Shkencore për Mjedën, me pjesëmarrjen e 14 studiuesve nga Shkodra, Tirana, Prishtina, Shkupi dhe Tetova. Përgjatë një paraditeje të plotë, studiuesit e mirënjohur shpalosën arritjet më të reja në fushën studimore për klerikun, poetin dhe gjuhëtarin Ndre Mjeda. Në orët e pasdites, në Qendrën muzeore në Kukël, u mbaj koncerti folkloristik më pjesëmarrje të këngëtarëve nga Shqipëria e Kosova. Çmimi *Ndre Mjeda* këtë vit iu nda skulptorit të mirënjohur z. Sadik Spahija nga Tirana, i cili realizoi shtatoren e Mjedës dhe Fletëlavdërimi iu dha arkitektit Zef Çuni, i cili kishte hartuar punën restauruese të Kishës, e dëmtuar gjatë sistemit komunist. Për punën e bërë në rindërtimin e Qendrës, Dom Nikë Ukgjini u shpall “*Qytetar Nderi*” i Komunës së Bushatit.¹⁰ Një program kulturor u organizua edhe më 20 nëntor 2012, me pjesëmarrjen e Imzot Angelo Massafra, deputetit të zonës, autoriteteve lokale si dhe të ambasadorit të Britanisë së Madhe në Tiranë, z. Nicholas Cannon.¹¹

Viti Jubilar

Viti jubilar, 100-vjetori i ndërtimit të Kishës, realizuar nga poeti Mjeda në vitin 1913, pati aktivitete të ndryshme të organizuara nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Qendra Muzeale *Ndre Mjeda* dhe Komuna e Bushatit.

⁹ *Energji Ashta, një partner kulturor për rajonin e veriut të Shqipërisë*, gazeta: Panorama, 19 nëntor, (Tiranë), 2011, f. 6.

¹⁰ GJERGJ MARKU, *Festë për poetin Mjeda, në Kumbona e se Diellës*, korrik-gusht, 2012, f. 31, (revistë fetare e kulturore e Kryedioqezës, Shkodër-Pult.).

¹¹ *Përkujtohet poeti Ndre Mjeda ne përvjetorin e lindjes*, gazeta, Panorama, 21 nëntor, (Tiranë), 2012, f. 20; *Përkujtohet poeti Mjeda në 100-vjetorin e pavarësisë*, Kumbona e se Diellës, nëntor-dhjetor, Shkodër, 2012, f. 31, (revistë fetare e kulturore e Kryedioqezës, Shkodër-Pult.).

Më 7 prill 2013, u kremtua Mesha e përsëritshme për Ndre Mjedën, udhëhequr nga Dom Anton Kçira prej Detroiti. Pas meshës, u mbajtën ligjëratat për veprimtarinë teologjike të Mjedës. Përveç autoriteteve vendore, të pranishëm ishin edhe zv. ministri i Kulturës Abaz Hado, zv. ministria e Arsimit, Nora Malaj, si dhe mysafirë të tjerë nga Amerika.¹²

Më 11 maj të këtij viti, në ambientet e Kishës u mbajt promovimi i 10 vëllimeve të monografisë seriale *Mjeda*, të autorit Mentor Quku. Në këtë promovim folën shtatë studiues nga Qendra Albanologjike dhe Universiteti i Shkodrës.¹³ Të pranishëm ishin përfaqësues të qeverisë lokale dhe autoritete shtetërore. Puna e palodhur e Mentor Qukut për Mjedën është vlerësuar si kolosale, sepse ai i ka njohur lexuesit me fusha të panjohura deri në sot, me të cilat është marrë poeti Mjeda.

Ditët e Mjedës, më 1 gusht, ishte konceptuar një *Takim Folkloristik Gjithëkombëtar*. Në të morën pjesë përfaqësues nga trevat shqiptare nga Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi. Në fund të takimit folklorik kryetarja e jurisë, Prof. Afërdita Onuzi, shpalli fituesit: vendin e parë e fitoi ansambli *Trepça* nga Mitrovica.¹⁴

Edicioni i katërt *Ditët e Mjedës* në Kukël, u organizua më 23 nëntor 2013. Në këtë takim përkujtimor të datëlindjes, i cili u mbajt në ambientet e Kishës, përveç organizatorëve, morën pjesë edhe zv. ministri i Kulturës, Zef Çuni si edhe homologu i tij nga Kosova, Gjergj Dedaj, ambasadori i OSB-së, Florian Raunig,¹⁵ etj.

Programi u hap me recitime të poezive të Mjedës nga aktorët e teatrit *Migjeni*. Këngët me tekst të Mjedës, u kënduan nga kori polifonik *Preng Jakova*, kantautorja nga Zagrebi, Bernadina Mjeda dhe sopranoja e njohur, Ledi Paparisto. Mbas kësaj u nda edhe çmimi vjetor letrar, medalja e bronzit *Ndre Mjeda* shkoi për studiuesin nga Stubla (Kosovë) Isak Ahmeti.¹⁶ Në fund, nga studiuesi Nexhmi Bushati u

¹² *Kisha e poetit Mjeda: 100 vjet: lutje e reflektim*, Kumbona e së Diellës, mars-prill, Shkodër 2013, f. 31; KLAID KAPINOVA, *Në Kukël u hap viti i 100 vjetorit të Kishës së Mjedës*, gazeta, Dielli, dt. 12 prill, New York, 2013.

¹³ LEONORA LAÇI, *Promovim 10 vëllimesh për poetin Mjeda*, Kumbona e së Diellës, maj-qershor, Shkodër, 2013.

¹⁴ *Ditët e Mjedës, 76 vjetori i vdekjes së poetit*, Kumbona e së Diellës, korrik – gusht, Shkodër, 2013, f. 31. (revistë fetare e kulturore e Kryedioqezës, Shkodër Pult.).

¹⁵ MENTOR QUKU, *Një ceremoni dinjitoze në Kukël*, Kumbona e së Diellës, nëntor-dhjetor, Shkodër, 2013., f. 31.

¹⁶ Po aty. Po aty.

prezantua vëllimi i fundit i kolanës, Mjeda, vepër e autorit Mentor Quku.

Vitit Jubilar solli diçka të veçantë pikërisht në ditën përkujtimore të lindjes së Mjedës. Tryeza 100-vjeçare e poetit Mjeda, u soll për restaurim në IMK, Tiranë, pas 23 viteve shkatërrimi në muzeun e Shkodrës dhe shumë peripecive administrative dhe më 23 nëntor 2013, u rikthye në shtëpinë muze, ku kishte qëndruar më parë për 30 vite më radhë. Kjo gjë u arrit falë përpjekjeve të shumta nga viti 2011 e në vazhdim të Dom Nikë Ukgjinit, dhe së fundi me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, Visar Zhiti dhe më vonë të Mirela Kumbaro.¹⁷

“Ditët e Mjedës” gjatë 2014-2016

“Ditët e Mjedës” me përfshirje gjithëkombëtare, kanë vazhduar të mbahen edhe në vitin 2014 dhe 2015. Më 1 gusht, 2014, u mbajt “Takime Folkloristike Gjithëkombëtare” me pjesëmarrjen e rapsodëve të njohur nga Kosova dhe Shqipëria, i cili përkoi në prag të ardhjes së Papa Françeskut në Shqipëri dhe në datëlindjen e Mjedës.

Më 20 nëntor të po këtij viti, u organizua takimi “Poetët për Poetin” (i cili u mbajt më 23 nëntor, si ditë më e volitshme), ku 35 poetë e shkrimtarë më të njohur nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, shpalosën poezitë e tyre për poetin Ndre Mjeda dhe një pjesë e tyre ligjëruan mbi krijimtarinë e Ndre Mjedës. Po në këtë vit (2014) në muajin prill, Qendra Muzeore “Ndre Mjeda” dhe “Instituti i Studimeve Albanologjike”, nxorën vëllimin e parë të revistës “Mjedologji”, ku u botuan kumtesat e dy Konferencave Shkencore të mbajtura më parë për Mjedën dhe vëllimi 2 në vitin 2015, i cili përmban historikun e famullisë së Kuklit nga shek. XV e deri sot.

Gjithashtu edhe viti 2015 ishte i begatshëm, sepse pos takimeve të rëndomta të 1 gushtit, datëlindja e poetit Mjeda u shënua më 20 nëntor, duke ftuar studiues e poetë të spikatur nga Shqipëria dhe Kosova, të cilët shpalosën krijimtaritë e tyre letrare dhe dhanë vlerësime për veprimtarinë krijuese të poetit Mjeda. Po në këtë vit, pos botimit të revistës, Mjedologji 2, është realizuar filmi dokumentar për historinë ndërtimore të Qendrës Muzeore “Ndre Mjeda”.

¹⁷ FRANO KULLI, *Pelegrinazhe në Kukël të Ndre Mjedës*, gazeta: Shekulli, dt. 3 shkurt, Tiranë, 2014. f. 18-19.

Më 21 gusht, 2016, Qendra pati nderin që të mirëpriste një grup pjesëmarrësish të Seminarit Ndërkombëtar, të mbajtur në Prishtinë, më 15 – 26 gusht 2016.

Qendra Muzeore ka qenë vazhdimisht në vëmendje të vizitorëve të shumtë, nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, nga Shkodra e Tirana, deri tek vizitat e ndryshme të piktorëve, skulptorëve, aktorëve të filmave, studiuesve, diplomatëve të huaj dhe vendas.¹⁸ Qendra kanë qenë vazhdimisht në fokusin e mediave pamore kombëtare dhe medias së shkruar në Shqipëri dhe Kosovë. Qendra është bërë objekt studimi për shumë studentë nga Universitetet shtetërore e private nga Shkodra e Tirana

Kukli, ku poeti kaloi pjesën më të madhe të jetës, nga vend i lënë pas dore, tani është shndërruar në një vend modern dhe vatër e rëndësishme kulturore gjithëkombëtare. Edhe pse poeti Mjeda ende nuk ka një varr, ngritja e kësaj Qendre është një klithmë për strukturat e lidhura me kulturën, shkencën, arsimin, për të qenë sa më të ndërgjegjshëm në përhapjen e kësaj figure të madhe që na nderon para botës së qytetëruar.

¹⁸ BRIKENA SHLLAKU, *Shtëpia e Ndre Mjedës në rrezik shkatërrimi*, Gazeta Shqiptare, dt. 13 prill, Tiranë, 2010, f. 27.

Persida Asllani

SHKRIMI FILOBIBLIK I MJEDJES

I. NDRE MJEDJA PROZATOR¹

Nga mënyra dhe metodologjia e leximit, për pasojë edhe e botimit të veprës së Mjedjes deri më sot, në Historinë e Letërsisë Shqipe kemi trashëguar një Mjedë-Poet, autor të një vëllimthi të shkëlqyer poetik dhe të një grupi poezish e tekstesh shkollorë për fëmijë. Ajo çka kjo metodologji nuk ka lejuar të mbahet parasysh është fakti se Mjedja ka qenë edhe prozator, shkrimtar e përkthyes i një literature religjioze të shumëllojshme. Në një pohim të tillë, përveç të dhënave bibliografike, dëshmime apo dokumenteve arkivore, na vjen në ndihmë edhe një vështrim statistikor në lidhje me vëllimin e shkrimit të Mjedjes në prozë specifikisht me natyrë, tematikë apo dhe frymë religjioze:

“Nëse e vështrojmë veprën totale të Mjedës nga ana sasiore, krijimtaria e tij poetike që nga ana sipërfaqësore nuk duket si fetare përbën 169 faqe, nga totali prej 2065 faqesh të publikuara. Ato përbëjnë vetëm 8% të veprës së përgjithshme”².

Këto të dhëna vijnë nga studimi i gjerë i Markus Peters kushtuar “Shtypshkronjës së Zojës së papërlyeme” në Shkodër gjatë viteve 1870-1945. Po t’u shtonim shifrave të Peters edhe 150 faqet e botimit të bërë në Romë (pranë Propaganda Fides, për pasojë të pa përllogaritura prej tij) të hagiografisë *Jeta e Shejtit Sh’Njon Berkman*s, mund të themi se vëllimi i përgjithshëm i një letërsie religjioze në

¹ Autorja e këtij punimi falenderon Akademik Sabri Hamitin për sugjerimin dhe nxitjen në drejtim të kësaj teme studimi. – (P.A.)

² PETERS, W. E. Markus, *Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën*, Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, Tiranë 2016, f. 472

veprën e Mjedjes shkon rreth 2215 faqe, duke mbizotëruar dukshëm gjatë viteve 1926-1931 me rreth 90% të saj. Duke i zbritur botimet me destinacion të hapur didaktiko-mësimor, një letërsi e mirëfilltë pijore dhe edukative-meditative shtrihet në një vëllim prej rreth 13450 faqesh.³

Sidoqoftë, duhet mbajtur parasysh fakti se ashtu si me poezinë, shtrija kohore e shkrimit, përkthimit dhe botimit të veprave në prozë përkon gjithashtu me fillesat e krijimitarisë së Mjedjes dhe do të vijojë së paku deri më 1931, si vit i botimit të përkthimit të Jean Croiset-së, duke mos llogaritur dëshmitë e tërthorta për përkthim a përpunim të disa Ungjijve deri në ditët e fundit të jetës. Që nga 7 nëntori i viti 1886, kur rezulton se 20 vjeçari Mjeda ka marrë lejen për botim nga Emzot Logoreci (arqipeshkv ndihmës i Shkodrës) të veprës marianiste *T'perghjamt e Zojs Bekueme* (që u botua vetëm më 1892), e deri te botimi i fundit më 1931, lista e botimeve në prozë është mjaft e pasur: libri i parë i botuar rezulton vepra hagiografike e mirëfilltë *Jeta e Sceitit Sc'Gnon Berchmans*, 1888, Romë; vijojnë *T'perghjamt e Zojs Bekueme* (që botohet vetëm më 1892); librat mësimorë *Të mbledhunit e mësimi të kështenë*. Shkalla e parë, (e dytë dhe e tretë) gjatë viteve 1904-1905; 4 ribotime të *Historia Shejte* për fëmijë me plotësime 1907-1928; *T'përgjamt e Zojës së Bekueme*, botim i dytë i përpunuar më 1927; hagiografia *Shë Luigji Gonxaga* më 1927; *Katekizmi i madh* më 1927-1928; *Lumnit e Zojës së Bekueme*, të Shejtit sh'Alfons M. De Liguori, pjesa I- Falemi Rregjinesha, më 1929; *Jeta e së Lumes Virgjin Mri* (Nxjerrun prej veprës *Cuneus Prophetarum* së I'imzot Pjetër Bogdanit) më 1930; *Visari i kongregacionit*, përkthim nga latinishtja prej Jak Junkut S.J., botim i tretë, më 1930, i përkujdesun posaçërisht prej D. Ndre Mjedës; *Gjashtë të dielet e Sh'Luigjit me Ndandcen e Festen e Shejtit* më 1930; *Devocjoni i Zemrës së Jezu Krishtit*, përkthim i veprës së jezuitit Jean Croiset, 1931. Nëse marrim në konsideratë edhe dëshmitë për bashkëpunime serioze të Mjedjes në

³ Ekziston hipoteza edhe për autorërinë e Mjedjes mbi disa poezi të përshpirtshme e fetare të botuara në periudhën 1889-1903 të Elçija: "T'thrrun me hii n'zemër t'Krishtit"; "Zemra e dhimshme e Krishtit"; "Sh'Mihilli"; "Ankim dashtnijet Zëmërs Krishtit"; "Kanga e t'shumve"; "Zois Kshillit t'mir". Kjo autorësi është parashtruar nga Mentor Quku dhe Markus Peters në veprat përkatëse të cituara këtu. Por, në asnjë rast nuk sillen argumnte e të dhëna të bindshme bibliografike e dokumentare mbi vërtetësinë e saj. Për këtë arsye, nuk po i trajtojmë në këtë punim me shpresën se do të mund t'u rikthehemi në një studim tjerër me argumentime më të pasura e bindëse.

përkthimin e disa *Ungjijve*⁴, do ta përkufizonim kontributin e tij në prozë si 50 vjet shkrime, përkthime, shqipërime e rikrijime në zhanre të ndryshme të letërsisë religjioze apo të shkrimit bibliofilik.

Pavarësisht këtyre të dhënave statistikore e jo vetëm, edhe pse bashkëkohësit e kanë çmuar cilësinë e kësaj vepre në prozë, vëmendja reale që ka merituar ka qenë ajo e ndonjë fraze apo paragrafi elozhues e jo më tepër. Kështu: At Fulvio Cordignano në *Epopeja kombëtare e popullit shqiptar* (1925), duke folur mbi librat e këndimit të Mjedës dhe Zanonit shprehet se “Ktu shifet se edhe prozen e D. Mjedës e mlon një fillad fjesht shqyphtar, çka s’mund thohet për të gjith shkrimtarët e soçëm”⁵. Ndërsa Henrik Lacaj, autor i pjesës kushtuar veprës së Mjedjes në *Shkrimtarë shqiptarë* (1941), vlerëson se “Mjeda u nda në shëj edhe si prozator me veprën *Historija Shejte*, shembull i vërtetë i njëj gjuhë së kulluet e popullorë”.⁶ Më pas, do të duhej vëmendja në kuadër të 50-vjetorit të vdekjes së autorit nga ana e Zef Mirditës, që në studimin “Elemente religjioze në poezinë e Ndre Mjedjes” (1987) paraqitur dhe botuar në aktet e Seminarit Albanologjik të Prishtinës, rikthen edhe një herë vëmendjen të krijimtaria dhe kontributi i Mjedjes në prozën shqipe, ndonëse pa e shtjelluar më tutje:

“Në krahasim me shkrimtarë të tjerë të klerit katolik, opusi i shkrimeve religjioze të Dom Ndre Mjedës është i vogël. Mirëpo, për nga subtiliteti, vetitë estetike, porositë humane si edhe për nga bukuria e pastria e gjuhës, ai opus meriton një vlerësim real”.⁷

Ndonëse kjo prozë nuk përbën mirëfilli fokusin e studimit të Zef Mirditës, ai sjell një informacion më të gjerë dhe një përpjekje më

⁴ Mentor Quku sjell një informacion nga redaksia e Revistës *Leka*, Nr. 6-7, 1938, ku pohohet se Mjedja “na mësoi ortografin qi përdorë sot revista jonë, të cillën na e mësoi praktikisht tue qortue, me një punim të gjatë qi vazhdoi deri pak para deke, përkthimin tanë t’Unnjillit të Shë Markut qi asht tash në shtyp”; si edhe faktin se At Giacomo Gardin, në letrat dërguar Mjedës, në vitet 1934-1935, vërteton se Mjedja ka përpunuar përkthimin që ai i bëri “Unjillit të Shën Lukës”, në QUKU, Mentor, *Mjeda*, [monografi eseistike] në 9 vëllime, Shtëpia botuese “Ilar”, Tiranë 2004-2013. Për lehtësi citimi ai do të citohet gjatë këtij studimi si vijon: QUKU, 6/, ff. 169-170.

⁵ CORDIGNANO, Fulvio, *Epopeja kombëtare e popullit shqiptar*, Pjesa I, Shtypshkronja e Zojës s’Paperlyeme, Shkodër 1925, f. 100

⁶ LACAJ, Henrik, *Shkrimtarë shqiptarë II*, Tiranë 1941, f. 122

⁷ MIRDITA, Zef, “Elemente religjioze në poezinë e Ndre Mjedjes”, në *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Nr. 12, Universiteti i Kosovës, Prishtinë, 1987, ff. 107-108.

klasifikuese e më erudite mbi të duke përmendur vepra si: *Jeta e Shejtit Sh'Njon Berkman, T'pergiamit e Zojës Bekueme*, botimin gjatë viteve 1927-1928 në Shkodër të *Katekizmit të madh, Lumnit e zojës së Bekueme* të Sh'Alfonsit, *Sh'Luigj Gonzaga, Historia Shejte*. Madje tërheq vëmendjen edhe për botimin dhe pajisjen me shënime nga ana e Mjedjes më 1930 e pjesës *Jeta e së Lumës Virgjin Mri* nga *Çeta e profetëve* si edhe të pjesëve nga *Pasqyra e të rrëfyemit* më 1932. “Nga titujt e cituar – përmbyll vëzhgimin e Zef Mirdita- shihet se kemi të bëjmë me një hagiografi dhe me trajtime të ngjarjeve biblike dhe doktrinare fetare”⁸. Megjithatë, në studimet e sotme mjedologjike mund të thuhet se të dhëna të pasura bibliografike e dokumentare mbi prozën e Mjedjes na vijnë falë kontributit shembullor të Mentor Qukut, prandaj shumë referenca të natyrës dokumentare edhe në këtë kumtesë do të vijnë prej monografisë së tij.

II. DY TIPARE THEMELORE TË PROZËS SË MJEDJES

Opusi i prozës së Mjedjes është i shumëllojshëm dhe ofron perspektiva të ndryshme studimore. Në pamundësi për ta trajtuar të plotë në kufijtë e një kumtese, kemi evidentuar dy aspekte të rëndësishme që mendojmë se përbëjnë dhe dy tiparet kryesore të tij:

- a) Aspekti i parë trajton lidhjen e veprës në prozë të Mjedjes me korpusin e Qarkut filobiblik si një vijimësi e natyrshme përmes tipareve që e tipizojnë këtë letërsi; por (dhe sidomos) duke e vendosur në një kontekst të ri religjioz-kulturor e politik, me funksione të reja gjithnjë e më letrare, tipar ky i ri, që diktohej nga epoka por edhe nga vetëdija e Mjedjes si autor dhe shkrimtar.
- b) Aspekti i dytë hedh dritë mbi Mjedjen si themeluesin e zhanrit letrar të Hagiografisë së mirëfilltë në gjuhën shqipe, pikërisht me tekstin hagiografik *Jeta e Shejtit Sh'Njon Berkman*, botuar në Romë më 1888; duke vijuar edhe me veprën tjetër hagiografike, shumë të rëndësishme *Sh'Luigj Gonzaga* më 1927 (vepër madje që dyshohet se mund të jetë hartuar e shkruar ndoshta në të njëjtin vit me *Jetën e Shejtit Sh'Njon Berkman* por e botuar rreth 40 vjet më vonë).

⁸ Ibid.

Duhet mbajtur parasysh fakti se pavarësisht se për arsye studimi këto dy aspekte do të shihen të shkëputura nga njëra-tjetra, në thelb ato përbëjnë pamje të së njëjtës dukuri. Vepra në prozë e Mjedjes karakterizohet nga një emancipim i tekstit letrar religjioz (dhe nënzhanreve të tij) jo vetëm si cilësi e vetëdije shkrimore por edhe si një realitet i ri tekstor që vendoset mes autorit dhe lexuesit. Tashmë jo vetëm autori zotëron modalitetet e duhura gjuhësore, letrare e doktrino-re për të përfutur një teksturë të plotë të shkrimit letrar religjioz, por edhe lexuesi pretendohet ose përftohet në një stad të ri, me një gatishmëri të re, shumë më të emancipuar, i përgatitur e i gatshëm për hulumtime të holla spirituale e teologjike, për ngritje të fuqishme shpirtërore që synojnë ta afrojnë me Pasionet e mëdha të besimit (katolik) përmes gjuhës së vet amtare, e jo thjeshtë t'i predikojnë normativat e një dogme fetare (e cila, ndonëse asnjëherë e përjashtuar, nuk përbën synimin kryesor të kësaj proze).

II.a. NJË PROZË FILOBIBLIKE NË NJË KON(TEKST) TË RI

Duke mënjanuar për arsye studimi dy tekstet hagiografike (*Sh'Njon Berkmans* dhe *Sh'Luigj Gonzaga*) të cilat i gjegjen një zhanri të caktuar letraro-religjioz që do ta trajtojmë më tutje, mund të thuhet se grupi i veprave filobiblike që na vijnë nga pena e Mjedjes bartin tiparet e traditës së hershme të autorëve të Veriut në disa pika duke na lejuar ta vendosim në një linjë zhvillimi të natyrshëm të kësaj letërsie që mbërrin tashmë nga viti 1555 me ndryshime të forta në shekullin XX. Ndër veprat më të rëndësishme rendisim:

T'perghjamit e Zojs Bekueme (botohet vetëm më 1892); 4 ribotime të *Historia Shejte* për fëmijë me plotësime nga 1907-1928; *Katekizmi i madh* – 1927-1928; *Lumnit e Zojës së Bekueme*, të Shejtit sh'Alfons M. De Liguori. Falemi Rregjinesha 1929; *Jeta e së Lumes Virgjin Mri* (Nxjerrun prej veprës *Cuneus Prophetarum* së I'imzot Pjetër Bogdanit), 1930; *Visari i kongregacionit*, ripërkthim nga latinishtja nga Jak Junggu S. J. Botim i tretë, Shkodër 1930, i përkujdesun posaçërisht prej D. Ndre Mjedës; *Devocjoni i Zemrës së Jezu Krishtit*, perkthim i veprës së jezuitit Jean Croiset, 1931; si edhe për herë të parë pjesë nga *Pasqyra e të Rrifyemit* të Budit në Revistën *Leka* (botim i ndërprerë në mes).

Duke folur për një “shkollë filobiblike shqipe” Sabri Hamiti e përkufizon atë si një shkollë letrare, me tekst letrar në shqip si

“derivim i tekstit biblik”⁹. Ky filiacion nga *teksti universal* mund të shqyrtohet në disa nivele, që nga retorika e moralitetit kristian, te tematikat, te figura, te trajtat e ligjërimit e deri te evoluimi i dukurisë komplekse të autorësisë¹⁰.

Nga pikëpamja e statusit, teksti filobiblik – sqaron S. Hamiti është përcaktuar nga burimi, që lidhet me doktrinën (mësimin), me besimin e flijimin për të shpëtuar”, duke i dhënë kështu ligjërimit (diskursit) filobiblik një karakter pohues e pranues, i cili shmang karakterin sprovues a dyshues të ligjërimit. Përmes këtij “aderimi” mund të thuhet edhe se “statusi i ligjërimit (diskursit) filobiblik është i përcaktuar nga *bashkërenditja*”¹¹.

Ndërsa për sa i përket statusit të autorit filobiblik, ai përcaktohet nga teknika e *mbishkrimit*, apo tejsishkrimit dhe ky status do të kalojë nëpër disa shkallë: përshtues, përkthyes, kompilator dhe në fund autor.

Kjo letërsi ka zhvilluar përgjithësisht në shqip llojet e saj të shkrimit, ku mbizotëron shkrimi i katekizmit doktrinal për t’u pasuruar më tej me shkrime me natyrë kristologjike e marianiste.

Do të ishte e pafrytshme ta projektonim veprën në prozë të Mjedjes tërësisht e vetëm në kontekstin e traditës së Letërsisë së hershme shqipe. Për shkak të llojit letrar-religjioz në të cilin është shkruar, ajo përbën natyrshëm një përvijim të kësaj tradite si në retorikë e moralitet, në figura personash e karakter të shkrimit në një prozë didaktike-etike. Proza e tij fton, sikundërse letërsia pararendëse, për aderim, pohim, pranim dhe zhvillon vijimësi të qartë tematike.

Këtë rezonim me letërsinë pararendëse e ilustron edhe krahasimi që mund t’i bëhet poezisë së famshme të Budit *Të mbraztit e jetës* [1618] dhe kreut XXIII të *T’perghjamt e Zojs Bekueme* [1892], shqipërim nga Mjedja (prej spanjishtes) qysh më 1886 i veprës *De imitatione Beatis Virginis Marie* të At Francisco Arias (1533- 1605).

⁹ HAMITI, Sabri, *Poetika Shqipe*, Shtëpia botuese “55”, Tiranë 2010, ff. 169-171

¹⁰ Gjithashtu, ligjërimi thuret simbas gjedhes së retorikës e të moralitetit biblik; tematikat zotëruese janë biblike (Besëlidhja e Vjetër e Besëlidhja e Re); figurat (personat) si dhe figurat poetike ndërtohen me parabazë biblike; figura përfaqësuese në poetikë, si edhe çelësi interpretues është po figura *parexcellence* biblike, *alegoria*; format letrare shfaqen në vargje, në trajtën e poezisë së aplikuar e të poezisë së rastit (okazionale), dhe, në prozë, me karakter didaktik e moral. Ndodhë shpesh që “tekstet letrare janë brenda librave doktrinarë të krishterë, duke krijuar një shfaqje tjetër të doktrinës”. Ibid.

¹¹ Ibid.

Lexuesi i sotëm është i familjarizuar me këtë poezi të Budit veçanërisht përmes strofave që lejojnë të lexohet edhe një ndjeshmëri autoriale:

“Ku janë ata pleq bujarë
Qi qenë përpara ne;
E ata trima sqimatarë
Të shpejtë si rrufe?”

“Ku janë ata djelm të ri,
Të bukur, të lulëzuom,
Qi pate pa me sy
Me ta folë e ligjëruom?”

Por si fillon poezia “Të mbraztit e jetës”?

Në strofat hyrëse shpaloset konteksti i qartë teologjik mbi të cilin do të ndërtohet thirrja ndaj besimtarit për aderim shpirtëror, mendor e moral në mësimet e parimet e dogmës. Nuk ka përse të “pritet kohë” për t’u bërë besimtar i mirë, kur dihet se jo vetëm vdekja është një proces i pashmangshëm e madje i domosdoshëm, por se edhe ora e vdekjes mbetet e pazotërueshme për njeriun, i cili, për natyrë, rend mbas gjërash vanitoze e mëkatare. Ndaj sqaron Budi që në hyrje të poezisë: “Këtu duo të thom pak fjalë ncëë përmenduni që mortsë e madhështie e ncë panjofuni cë njerëzet”, për të vijuar me strofat e para:

“O i pafati njeri
Gjithë ndë keq haruom
I dhâani ndë madhështi
Me mkat pshtjellë e ngatërruom”

[...] “Tue vûm re vetë
Sa gjind e trimëni
Njofunë mbi këtë jetë
Dergjenë ndë vorr të zi.”

Pikërisht të njëjtin shqetësim e predikim parashtrojnë Kreu XXIII i *T’perghjamit e Zojs Bekueme* [1892], me titullin “Sa i dobishëm për shpirt asht mendimi i deks”. Përmes një dialogu imagjinar (unë-ti), zëri i Zojës së Bekueme (Shën Mërisë) këshillon e fton besimtarin e çdo moshe për t’u përballur me idenë e vdekjes, për të mos humbur kohë në pajtimin e tij me mësimet e dogmës:

“As êm Bir Jezu Krishti nuk ju shmang kësaj ligjë, por as per tē as per mue deka nuk kje një ndeshkim, por kje tē nisunit per lumni tē Parrizit”; f. 96

“Gjith i cilli ças mundet me kêne i mbrami per ty; e sa do qit ë kujtojsh se je i shëndosht’ e i fort, mundesh m’u gjetë me’j herë në grykë tē vorrit”;

“Gabon me thes në kujtojsh se vetëm pleq janë në rrezik me dekë; edhe tē ritë desin shum herë pa pritë”;

“Mos vano m’u kthye kah i madhi Zot, pse nuk e di a ka me tē lanë kohë deka m’u pendue e m’u rryfe” . f. 98

Ky është vetëm një shembull se si shqipërimi dhe rishkrimi që na vjen prej Mjedjes përfshihet natyrshëm në vijueshmërinë tematike-teologjike të Letërsisë së hershme fetare në shqip, duke siguruar kështu edhe një filiacion të fortë në kontekstin e letërsisë **filobiblike**.

Madje, edhe statusi i tij si autor përcaktohet po nga dukuritë komplekse të autorësisë filobiblike me trajta të *mbishkrimit* apo *tejshkrimit*, status ky që paraqitet i lëvizshëm sipas zhanrit që trajton: përkthyes, përkthyes, kompilator dhe autor.

Por është pikërisht çështja e ndërlikuar e autorësisë, që lejon të shihet përtej traditës dhe të lexohet Mjedja si *autor-shelbyes* i një letërsie filobiblike, e cila rrugëtonte tashmë nëpër një fazë të re.

Nga auctores te vetëdija autoriale e Mjedjes

Të dhënat dokumentare na lejojnë të pohojmë se vetëdija e tij prej poeti lirik, pra prej krijuesi të një arti të pastër, subjektiv e më së shumti laik ka lindur herët te Mjedja, e thujse në të njëjtën kohë me vetëdijen dhe dijen e tij si autor i një proze hagiografike modeluese por edhe tekstesh marianiste të rishkruara përmes shqipërimit. Mes shqipërimeve të hershme nga italishtja dhe atyre në prozë si parabazë për shkrimet e letërsisë fetare në shqip (nga italishtja, latinishtja, spanjishtja) sjellja e Mjedjes është ajo e një krijuesi të vetëdijshëm e që fare pak i le hapësirë rastësisë, aq sa mund të pohohet se “përshtatjet letrare ashtu edhe ato të natyrës fetare u bënë pjesë identifikuese e krijimtarisë” së tij.¹² Ky status specifik autorial mund të zërthehet në

¹² **MACAJ, Edlira**, *Poetika e Mjedjes dhe shkolla jezuite*: disertacion për mbrojtjen e gradës "Doktor", Universiteti i Tiranës. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, 2015. (I depozituar në fondin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë), f. 15

disa aspekte njëheri: autori mes shkrimtarit dhe përkthyesit; autori mes krijuesit dhe gjuhës; autori mes modelit dhe krijimit.

Në një lexim krahasues mes këtyre të shfaqjeve të përkthimi-shqipërimit, Edlira Macaj vëren se përkthimi i Mjedjes mbërthen pandashmërisht dy linja po aq diferencuese nga njëra tjetra: linjën e letraritetit, shpirtit të lirë që i përket poezisë dhe linjën e arsyes, logjikës dhe mendimit për shpëtimin dhe ngushëllimin e tallazeve, brengave të shpirtit¹³. Dy përvojat ndërkëmbejnë dhe pasurojnë njëra-tjetrën, duke lejuar të pohojmë se “përkthimet e teksteve fetare marrin karakteristikat e shkrimeve letrare”¹⁴

Te Mjedja, edhe mëtimi për trajtën e përsosur të tekstit përfaqëson një metodologji autoriale që do të ushtrohet në çdo mundësi të re ribotimi të veprave, qofshin këto poetike apo edhe ato në prozën letrare-religjioze. Siç mund të shihet edhe në fare pak shembujt në vijim, këto ri-shkrime (shpesh edhe rikrijime) e tejkalojnë thjeshtë përkujdesjen për leksik më të pastër në shqip dhe synojnë një përsosje të shumëfishtë që shkon kah forma dhe mendimi. Në poezi ky rikrijim përfton cilësi tingullore më cilësore, bashkëlidhur një nivel më të lartë në përfytyrim përmes ligjërimit të ri metaforik. Në prozë vjen një zhdërvjelltësi sintaksore, përmes së cilës përftohet një shtirje më e gjerë meditative-shpirtërore por edhe teologjike-doktrinale:

Krahaso:

nga *Vaji i bylbylit* (1887/8)

“Neper fush e neper shpija
T’kish kerkue i shkreti fat;
Reth e reth t’kish ardhun fmija,
T’kishin kiaa me gjith takat” f. 7

te *Vaji i bylbylit* (1917)

“Neper fush’e neper shpija,
Me zitië qi s nep afat,

¹³ Gjithashtu: “Me fjalë të tjera, përkthimi do të thotë se është saktësi dhe subjektivitet njëherësh, duke përfituar në rastin e Mjedjes, me të drejtë termin shqipërim. Në këtë kuptim përshtatjet letrare të Mjedjes, realisht bëhen pjesë e rëndësishme e trashëgimisë së tij letrare. Me nivelin e këtyre përkthimeve letrare, Mjedja përligj rivalitetin me poetin e origjinalit duke qenë se ia përshtati *Vllavrasin* botës shqiptare dhe e bëri të ndjeshme poezinë në arealin shqiptar”. Ibid., f.16

¹⁴ Ibid., f. 18

Rreth e reth t'kish ardhun fmija
Kjamun t'kishte i ngriti fat"

Krahaso:

nga "T'perghjiamit e Zojs Bekueme" (1892)

- "Edhe pse s' paç kurr far behane mkatit, dica; pse deka âsht dera kah duhet me hi n'lumni t'Parizit"; f. 88
- "Mos u dispro, o bir, n'at cias beli t'rrept, por eja mrapa mejet". f. 93

te "T'përgiamit e Zojës së Bekueme" (1927)

- "Edhe pse s' paçë kurrnji njollë mkatit, u përshkova neper dekë, qi âsht e vetmja derë me dalë prei këtij shekullit"; f. 96
- "Nuk kam me të lëshue doret, o bir; por më pergiai mue". f. 102

Kalimi nga trajta e thjeshtë deskriptive "vdiqa" e 1892 në trajtën "u përshkova nëpër dekë" të 1927, jo vetëm e bën më elegante këtë frazë por krijon një hapje të re konceptuale, të karakterit doktrinar, siç është ideja e rrugëtimit dhe "të të përshkuarit" nëpër procesin e vdekjes, si vijueshmëri e natyrshme por edhe përvojë e domosdoshme e qenies për të mbërritur te Krijuesi. Gjithashtu, edhe ftesa e drejtpërdrejtë "eja mrapa mejet" (1892) që Shën Mëria i bën besimtarit të ri, zhvillohet në një ftesë-këshillë që fton për një qëndrim aktiv me natyrë tashmë refleksive-meditative të tipit "me i përngja dikujt", domethënë të ndërmarrësh një proces edifikues brenda vetes për t'ia afruar një modeli ideal, dhe jo thjesht "ta ndjekësh" *a priori*.

E njëjta vetëdije e karakterizon Mjedjen edhe në ritrajtimin e teksteve të kthyera së pari shqip nga të tjerë përpara tij. Është i njohur fakti se ai qortonte dhe përmirësonte me shumë bujari sprovat e përkthimeve të të rinjve (Koliqi, Zamputi etj) si nga letërsia artistike, ashtu edhe ungjijtë, fjalorët, gramatikat etj. Shembulli më tipik në tekstet e letërsisë filobiblike është përpunimi i skajshëm e tërësisht rikrijues që Mjedja i bëri më 1930 përkthimit nga latinishtja të *Visarit të Kongragacionit* nga Jak Junggu botuar së pari më 1888 si edhe më 1897 me titullin *Hazna e Kongregazionit t'Zois Bekuume*. Përveç lehtësimit në material tekstor, duke shmangur oficet, psalmet, litanitë etj, ai e "reformon" veprën drejt një përdorimi më të lehtë për meshët e shenjtja. Mjaftojnë pak shembuj krahasues të na shpalosin cilësinë e

jashtëzakonshme të Mjedjes jo vetëm si zotërues i prozës klasike shqipe, gjë që e ka vërtetuar edhe të “Historia shejte”, por edhe si teolog i nuancimeve befasuese konceptuale:

Krahasim i Uratave:

“Per me bâ një dek t’mir” (1897) Jungg vs “Me ju gatue një dekës së mirë” (1930) Mjedja

- Jungg: “Kuur shpirti i êm ka me da prei kso jete e ka me lan korpin e zbet, t’ftofun e t’pajet, bane kabull, o Zot, t’maruemit e jets s’ême, qi une kam bâ n’lavd e n’nner t’madhnis t’hyinushmes s’ate...” f. 35
- Mjedja: “Kur fshahet e mbrame të zëmres kanë me shterngue shpirtin t’êm me dalë prej korpit, pranoi si të bijt e një padurimit shëjt me ardhë te ti...” f. 28

Një “gatim i dekës së mirë” në uratën e ripërkthyer nga Mjedja, kërkon ndërtimin e një harmonie të re mes trupit e shpirtit në kërkim të hyjnore. “T’maruemit e jets” së Junggut shndërrohet në shenjë “padurimi shëjt” te Mjedja, i cili e përkufizon besimtarin në frymën e fundit të jetës si “të dhënë për lexim” përpara Zotit.

Kjo hapje e rrallë konceptuale në prozë përmes krijimit të “variantit të ri” të veprës, e bën Mjedjen një nga autorët më refleksivë e njëkohësisht më krijues brenda letërsisë filobiblike shqipe krahas sprovës mjeshtërore të Pjetër Bogdanit.

Jo rastësisht ai do të bëhet edhe ndër transkriptuesit e botuesit e parë të tij. Me besnikërinë dhe ndjeshmërinë e veçantë jezuite por edhe personale ndaj figurës së “Zojës”, Mjedja do të përzgjedhë pikërisht pjesën *Jeta e së Lumes Virgjin Mri*¹⁵ nga *Cuneus Prophetarum* për ta botuar më 1930 përmes Shoqërisë letrare të Shën Jeronimit, themeluar po prej tij. Përveç kërkimit të rrugëve të moderuara për njësimin e gjuhës shqipe përmes shembujve nga autorët e vjetër, në tekstet e të cilave dallimet mes dialekteve shfaqeshin më të buta, ai përmes fragmenteve mariologjike e kristologjike e vendos lexuesin përballë një teksti teologjik, duke e përfshirë sa në terminologjinë teologjike shqipe aq edhe në dogmën e besimit. Me shijen e hollë dhe vetëdijen e një

¹⁵ “Jeta e së Lumes Virgjin Mri” (Nxjerrun prej veprës “Cuneus Prophetarum” së l’imzot Pjetër Bogdanit, Argjipeshkvit së Shkupësë. Përshkrue e botue prej D. Ndre Mjedës). Shkodër: Ndre Mjeda, Shoqënia Letrare e Shën Jeronimit, Shtypshkronja e Zojës së Papërlyeme, Shkodër, 1930.

shkrimtari të pjekur, ai ka përzgjedhur për lexuesin tashmë “të shkolluar” e “të formuar” të viteve ‘30 një prej shprehjeve më të shkëlqyer tekstuale të shqipes teologjike, refleksive e letrare. Në parathënien e librit, duke folur për zgjedhjen e kësaj pjese për botim, ai shënon: “Më thotë mendja se edhe me kaq mundet m’u njoftë dija, giuha e zotsija e njati shkrimtarit, qi, deri sod, çohet si shqype madhshtore në qiell të letratyrës së sanë”.¹⁶

Në prozën mjedjane ndjehet parapëlqimi për letërsinë marianiste. Ajo mbizotëron në raport me atë kristologjike, si dhe në një grup tekstesh me natyrë katekistike. Kështu, veç dy botimeve të sipërpërmendura të *T’perghjamit e Zojs Bekueme* më 1892 dhe 1927, ai shfaqet si bashkautor i Shën Alfons Liguorit në veprën *Lumnit e Zojës së Bekueme*¹⁷, pjesa I, Falemi Rregjinesha, botim po i Shoqërisë letrare të Shën Jeronimit, në Shkodër, 1929, duke e vendosur emrin e tij në krye të ballinës së librit.

Në fakt, të dhënat dokumentare na lejojnë ta lidhim historinë e fillimeve të hartimit të kësaj vepre edhe me përpjekjet e Mjedës për të afirmuar alfabetin e tij. Dihet vetëm se në vitin 1891, Mjedja bëri kërkesën pranë Propaganda Fides për botimin e dy veprave që i kishte gati për botim, *Lumnit e Zojës së Bekueme* dhe *T’pergiamit e Zojës së Bekueme*. Madje, rezulton se Guerini ka dhënë pëlqimin e tij për botimin e “Lumnive” por Propaganda, nga ana e saj, futi në shtyp “T’pergiamit”.¹⁸ Për këtë arsye ne nuk e zotërojmë ende variantin e parë të këtij botimi, i cili ka gjasë të jetë pjesë e arkivave të Propagandës dhe mbetet të zbulohet në kërkime të mëtejshme. Por është më se e qartë se botimi i vitit 1929, si një përkthim i çlirët i *Le glorie di Maria* shkruar më 1750, ka përfutur shumë nga procesi rikrijues i Mjedjes, i cili, i vetëdijshëm për këtë fakt, sillet si bashkautor, e madje, nga dëshmitë e kohës na ka mbërritur pohimi i tij se “e kam përkthye sikur ta kishte shkruar shqip vetë sh’Alfonsi”¹⁹.

Të njëjtin përkufizim do të duhej të kishte merituar edhe shkrimi i *Historisë shejte* nga Mjedja - për shkolla të para të Shqypnis. Së

¹⁶ Ibid., f. 3

¹⁷ “Lumnit e Zojës së Bekueme”, të Shejtit sh’Alfons M. De Liguori. Falemi Rregjinesha. (kthye shqip prej Dom Mjedës). Pjesa e parë, Shtypshkronja e Zojës së Papërlyeme, Shoqëria letrare e Shën Jeronimit ndë Shkodër, 1929. Përkthim nga italishtja.

¹⁸ QUKU, 6/1, f. 129

¹⁹ “E kam përkthye sikur ta kishte shkruar shqip vetë sh’Alfonsi”, sipas QUKU, I, f. 436, dëshmuar në *Kumbona e së diellës*, Viti I, nr. 8, ff. 96-98, Shkodër, gusht, 1938.

paku për këtë prozë ai fitoi lavdet si një krijues që “u ndá në shêj edhe si prozator me veprën *Historija Shejte*, shembull i vërtetë i njëj gjuhë së kulluet e populllore”²⁰. Nga botimi i parë më 1907²¹ në Vjenë, vijuar me ato të viteve 1911 e 1915, e deri te ai më i ploti më 1928²² në Shkodër, *Historia shejte*, përveç se paraqet ndryshime të ortografisë sipas parimeve të Komisies Letrare Shqipe, pasurohet me kapituj të rinj, me intermexo, ilustrime etj. Pavarësisht përmirësimeve të lehta në stil e leksik, mund të thuhet se ky tekst shfaq edhe ndryshimet më të lehta mes pjesëve që rimerren në të katër botimet. Leksiku është mjaft i pastër nga pikëpamja e huazimeve që në botimin I. Mendojmë se kjo “qendrueshmëri” vjen për shkak se teksti është shkruar e përpunuar duke pasur parasysh fëmijët dhe një lloj pedagogjie të leximit e të të nxënit²³.

Ndërsa si një kristologji e mirëfilltë vjen përkthimi nga pena e Mjedjes i veprës së jezuitit Jean Croiset më 1931 *Devocjoni i Zembrës së Jezu Krishtit*²⁴. Ky përkthim nga frëngjishtja është jo vetëm plotësim i bibliotekës së besimtarëve me një nga veprat më të mirënjohura të bashkësisë katolike europiane e veçanërisht jezuite, *La dévotion au Sacré Coeur de Notre Seigneur Jésus-Christ* (Lyon 1689), por shfaq qartë edhe pretendimin për një lexim tashmë cilësor të teksteve të letërsisë fetare në shqip, me një lexues të pavarësuar, të aftë të ndjekë, të shijojë e të frymëzohet nga refleksionet e holla mbi devotshmërinë e besimit përmes shembullit të figurës së tij qendrore, Jezu Krishtit. Në fragmentin e përzgjedhur këtu si shembull mund të lexohet sprovë shpirtërore e «përvujtnisë» së besimtarit, por edhe psikologjia e thellë e njerëzores:

- “Nieri i përvujtë nuk çuditet për faje të tjerve, pse e di mirë sa i lig është ai vetë, e se mund të bijn edhe ai n’ato faje; e shef se është në rrezik m’u rrxue tjetri. Sa më pak qi të flitet për vetë, aq më mirë është për përvujti. Hera herë flasim keq për vetë, si me dashtë me ju dftue tjerve se e bajmë n’asgjë vedin; por disa herë kjo bisedë është shkak me na lavdue gjindja. Në daçim me e dijtë a njimënd jena të përvujtë, të vëmë oroe a i dona më

²⁰ LACAJ, Henrik, vep. cit.

²¹ *Historia Shejte* për shkollë të para të Shqypnjesë. Shtampa e parë [Vjenë, tetor, 1907]

²² *Historia Shejte* për shkollë të para të Shqypnis. Botim i katërt [Shkodër, 1928]

²³ Krahaso: Titulli i kapitullit X, nga “Abrami bân sodaka Isakun” (f. 9 e botimit të 1907-s) bëhet “Abrami bân fli Isakun” (f. 13 e botimit të 1928).

²⁴ *Devocjoni i Zembrës së Jezu Krishtit*, shkruar prej Atit Gjon Croiset së SJ, kthyer shqyp prej D. Ndre Mjedës, Shkodër, 1931, Shtypshkronja e Zojës së Papërllyeme.

gjithë zëmrë njata qi na përbuzin; e kur vjen rasa m'u koritë nuk do t'i ikim; nuk do ta ngushllojmë vedin me do hartime madhështore, me do sênde qi mbajmë uzdajë se kena me bâ mâ vonë, sepse këto na shtijnë në zëmrë një madhshti të hollë; nuk do të flasim kurr per të mira t'ona; nuk do t'ankohena per provë qi na çon i madhi Zot; por as tjerët s'do t'i lâmë me na ankue” (fragment nga kapitulli “Përvujtnia e vërtetë”)²⁵

Nga Mentor Quku vijnë të dhëna edhe për gjurmë dorëshkrimesh të tjera kristologjike të Mjedjes, por që deri tani njoftohen vetëm përmes titullit të tyre në shënimet e autorit. Ato janë: “Zejet e Zemrës së Lumit Jezu Krisht” dhe “Të përshpirtshmet ndaj të shugurueshmen Zemren e Jezu Krishtit”, vepra në dorëshkrim – sqaron Quku, - “për të cilën mësojmë përmes listës së dorëshkrimeve të D. Ndre Mjedës”²⁶. (AQSH, fondi Mjeda).

Proza e Mjedjes dhe faza e re e letërsisë filobiblike shqipe

Pavarësisht filiacionit me autorët dhe veprat e hershme të letërsisë filobiblike shqipe, proza e Mjedjes duhet vendosur në kontekstin e një faze të re të kësaj letërsie. Rrethana të reja gjeopolitike në Ballkan kanë sjellë mundësi të reja si për një formim më të mirë të besimtarëve katolikë shqiptarë në lidhje me dogmën, ashtu edhe shkollimin e të rinjve (kryesisht Shkodër), duke rritur nevojën për një shqipe më cilësore në predikime e meshtari dhe në botime e mësimdhënie. Ja si e dëshmon zhvillimin e ri At Fulvio Cordignano:

“ç’prej asaj kohe kur Seminari kishte marrë titullin *Kolegji Papnuer Shqiptar* kishin kaluem 25 vjetë (1862-1887) [...] Typografia e së Papërlyemes kishte filluem të punojë qysh prej vjetit 1871, por i pari libër shqip prej asaj shtypshkroje qe *Doktrina e Kerscten* e Dom Ëngjël Radojës në vjetin 1876 [...]. Në Marc 1981 u fillue botimi i së përkohshmes *Elçija* ase Lajmtari i Zëmrës së Jezu Krishtit, e cila vijou pa pushuem asnjë herë, kështu që, përveç të tjerave, ká edhe nderin të jët revista mâ e vjetra shqipe”²⁷.

²⁵ Ibid, f. 114

²⁶ QUKU, 6/1, ff. 171-172

²⁷ CORDIGNANO, Fulvio S.J., “Vepra e Etënvët Jezuitë në Shqipnín e veriut 1841-1928”, *Diturija*, Nr. 6, 1928a, f. 221

Ndryshimi tjetër i rëndësishëm lidhet me fazat e modernizimit nëpër të cilat po kalonte vetë Kisha Romane. Ajo po i drejtohej gjithnjë e më tepër individit që lexon dhe jo bashkësisë që dëgjon (e të varur për pasojë nga oraliteti).

Tashmë, edhe letërsia filobiblike shqipe do ta synojë bashkësinë përmes individëve që pavarësohen gjithnjë e më tepër në lexim. Për rrjedhojë synohet një sintaksë e qëndrueshme dhe e rrjedhshme, në përputhje me zhvillimet e shqipes, që lejon përsiatje e refleksion, por edhe një gjuhë që të kuptohet në atypëratyshmërinë e saj e në vetminë e leximit.

Kjo fazë e re gjen shprehjen e vet më të mirë që në nisje me kontributin e Ejëll Radojës, autor i:

Jezu Krishti n' zemer t' meshtarit. Kujtime t' shpirtit ci do t' kët meshtari per gjithcilen dit t'motit", Romë 1862; *Koncilli Dheut Shcypnīs* bāmun n' viet 1703 n' koh t' Paps Shcyptarit, Klementit t'Njimdhetit, Botim i trete i Kuvendit 1706 (ripërkthim i variantit origjinal latinisht): Romë 1872; *Dotrina e Kershten me msime e me spiegime* ci i zgodh e i mlo dh shcyp Dom Enjll Radoja prift i Arcidiocezit Shkodrs, Shkoder 1876 – si katekizmi i parë i kompiluar (me sqarime e shpjegime) dhe e para vepër shqip e botuar në trojet shqiptare.

Në dëshminë që sjell Injac Zamputti në “Kujtime për dom Ndre Mjedjen” rrëfëhet një detaj i rëndësishëm mbi një model të mundshëm letrar të vetë Mjedjes në prozën filobiblike shqipe: “Në lidhje me stilin, sidomos në prozë, na bënte shumë qortime. Një ditë, kur e pyeta cili ishte autori shqiptar tek i cili mund të merrnim shembull për gjuhë e stil, ai u ndal vetëm te shkrimet e Dom Ejell Radojës, autor i shekullit XIX, që ribotoi *Koncilin e Dheut të Shqypnisë*”²⁸.

Bie në sy fakti se nga vepra e Radojës, si shembull i gjuhës e stilit, Mjedja ka përzgjedhur veprën *Koncili i Dheut të Shqypnisë* (1872), i cili është në fakt botimi i tretë dhe përkthimi që vetë Radoja i bënte *Kuvendit të Arbërit* (Romë, 1706).

Mendojmë se arsyet pse Mjedja shkon drejt këtij modeli janë së paku dy: njëra lidhet me rëndësinë specifike të kësaj vepre, tjetra me cilësinë e rrallë të përkthimit rikrijues të Radojës. Me rastin e ribotimit

²⁸ ZAMPUTTI, Injac, “Kujtime për dom Ndre Mjedjen” në *Hylli i Dritës*, nr. 2, 2011, f. 131

të kësaj vepre në Prishtinë dhe mbi rëndësinë kulturore të saj, Engjell Sedaj shkruan: “tekstet e vjetra shqipe nuk janë dokumente të gjuhës shqipe [...] por kujtesë e dokumentuar dhe e pashlyeshme e historisë së popullit shqiptar në dimensionet më të gjera të jetës së tij; ato janë edhe letërsi, kulturë, etnografi, art, filozofi dhe politikë” dhe “kështu mund të lexohet edhe teksti i *Kuvendit të Arbërit*”²⁹.

Në vitet e fundit të jetës, Mjedja e drejton vëmendjen e nxënësve dhe shkrimtarëve të rinj pikërisht te ky monument i kulturës kombëtare. Në të njëjtën periudhë, Zef Valentini, duke folur për Radojën në krestomacinë *Shkrimtarë shqiptarë* (1941) shkruan me admirim:

“Stylin e ka të rrjedhshëm e krejt mbas natyrës së fjeshtë së shqipes popullore; din me ia gja tekstit perkah madhnija e naltsija, por pa ndërlikime e pa ernessi; edhe kur ia shef gjasën me lanë servilitetin e perkthimit për të shti ndonji frazë shqipe të bukur e të gjallë, ase për të skjarue e për të fjeshtue periudhën, nuk priton me e ba; kështu qi perkthimi i tij lexohet me shum andje”³⁰.

Tashmë studimet gjuhësore shqipe e kanë vënë në dukje karakterin e varfër të përkthimit të botimit I, ku siç sqaron Rexhep Ismajli bëhet fjalë për një përkthim “të fjalëpërfjalshëm, madje edhe morfemë për morfemë, duke ruajtur shumë shpesh edhe rendin e fjalëve të gjuhës burim”³¹. Ndërsa puna dhe cilësia e variantit të Ejëll Radojës e vendos atë sot në zanafillën e lindjes së filologjisë shqipe: “Ishte bash ky mund dyfish i priftit shkodran, që na lejon tash të fiksojmë në pendën dhe autoritetin e tij fillimet e punës së mirëfilltë filologjike me tekstet e vjetra shqip”³²- thekson Bardhyl Demiraj.

Por përtej “monumentit”, “filologjisë” dhe “përkthimit krijues” ka edhe një faktor tjetër që e tërheq Mjedjen te Radoja: gjuha shqipe si gjuhë “komunikimi”. Edhe pse vetëdija për gjuhën e sidomos përkujdesja proverbiale e “shkrimtarëve të vjetër” për ruajtjen e saj është tipar përfaqësues i letërsisë filobiblike, botimet e kësaj letërsie përgjatë shekullit XIX e risjellin “çështjen e gjuhës” në një perspektivë

²⁹ SEDAJ, Engjëll, *Papa Shqiptar Klementi XI – Albani & Kuvendi i Arbënit*, Buzuku, Prishtinë, 1998, f.7

³⁰ VALENTINI, Zef, *Shkrimtarë shqiptarë I*, Tiranë, 1941, f. 153

³¹ ISMAJLI, Rexhep, *Gjuha shqipe e Kuvendit t'Arbënit*, Prishtinë, 1985

³² DEMIRAJ, Bardhyl, “Shkodra- një qendër albanologjike në prag të pavarësisë”, *Hylli i dritës*, Nr. 4, 2012, f. 10

tjetër. Sepse e tillë ishte gjendja e re e gjuhës. Dhe këtu duhet të mbajmë parasysh më së shumti gjendjen e “gjuhës së folur” me të cilën do të ngjizej tashmë “gjuha e shkruar”, e cila, në radhë të parë duhet kuptuar në këtë fazë kulturore si “gjuhë e leximit”.

Vetë Radoja, në parathënien e “Koncilit” të vet, që mban datën 10 maj 1867, pohon se:

“gjuha jon tui ken e vorfn, sidomos n’essape t’Fees, e n’pun t’holla, droishe, çì mos t’i trazoi vesht e Shqyphtarve t’mi, t’cillt jan msue hem me knue, hem me shkruie ma shpesh n’giuh t’jabanqivet”.³³

Me qëllimin parësor për të qenë njëkohësisht e saktë por edhe e rrokshme, sprova gjuhësore e Radojës është një sprovë komunikimi gjuhësor, saktësie teologjike dhe performance stilistike:

“Nuk t’thom, de n’ket Libr shkruie mieshtrisht prei Vincez Zmajevičit Arkipeshkvit të Tivarit, knohen fial t’rea, t’moçme, e t’zgiedhuna: besa unë, si flasim Shqipen n’Shkoder, ashtu me t’paken forz temen jam munnue me shkruie, tui cialltis, deri ku kam muit, m’u shporr fjalve t’gjuhve t’huejavet, e t’u baa gairet edhe qi fjal, qi knohen ktu, t’jeen marrun vesht prei shqytarit t’soçëm”.³⁴

Është pikërisht “t’marrunit vesht prej Shqyptarit socm” gjykon B. Demiraj “ai tharm ngjizës dhe motivues që përcolli natyrshëm dhe vetëdijshëm shkëputjen përfundimtare të letërsisë bashkëkohore prej fazës së parë apo të mëhershme të kulturës së shkrimit shqip, të cilën jemi mësuar sot ta quajmë “letërsi e vjetër shqipe”. Jemi bash në gjysmën e dytë të shek. XIX, kur përjetojmë përfitim e një paradigme të re në mënyrën dhe qëllimin e lëvrimit, përkatësisht në kulturën e shkrimit shqip që kishte tashmë si destinacion një rreth shumë më të gjerë lexuesish, përkatësisht shtresa të ndryshme sociale, për të cilat leximi i letrave shqip në atë fazë të zhvillimit të shqipes kishte vërtet kuptim”.³⁵

³³ RADOJA, Ejëll, *Koncili i Dheut të Shqypnisë*, botim i tretë i “Kuvendit të Arbrit” të vitit 1706 (ripërkthim i variantit original latinisht), Romë, 1872, f. V

³⁴ Ibid., f. VI

³⁵ DEMIRAJ, Bardhyl, “At Engjëll Radoja (1828-1880)”, në botimin jubilar kushtuar Prof. Tomor Osmanit (në process botimi).

Kjo paradigmë e re kulturore do të diktojë së paku gjatë shekullit XIX edhe përzgjedhjen gjuhësore sidomos në nivel të leksikut, ndonëse rezulton se ka qenë e “qortueshme” nga bashkëkohës ose pasardhës më “puritanë”, siç është rasti i keqardhjes që shpreh Zef Valentini kur shkruan më 1941 se “mjerisht, si koha, iu duk elegancë me e lulzue shqipen e vet me fjalë turqishte të tingëllueshme”.³⁶

Vetë Radoja, i vetëdijshëm për zgjedhjet dhe procedimet e veta në ripërkthimin (rishkrimin) e Konkilit, mbrohet bindshëm (si një teoricien përkthimi) kundrejt kritikave në vitin 1873, në një letër drejtuar Imzot Pooten-it: “Shkëlqesa e Juej më vëte faj se Konqilin e Arbënit nuk e përktheva *ad litteram*. Përkthimi *ad litteram* për kedo është punë qi s’bahet. Pak libra kanë dalë në gjuhë shqipe [...] asnjë libër nuk ka dalë në dritë shkruar më bukur se përkthimi i im”³⁷.

Pikërisht po kësaj paradigme i është përgjigjur edhe Mjedja në botimet e hershme, si në poezi ashtu edhe në prozë. Vepra synon komunikimin dhe autori i saj receptim e ndikim. Jo rastësisht edhe “dedikimi” i parathënieve mes dy autorëve është i ngjashëm:

“Knuessit mikut t’dashtunit / Jet t’ghiat e scnet prei Zotit!”
dedikon Radoja

“Dielmve t’ri scnnet prei Zotit” dedikon Mjedja te *Jeta e Sh’Gjon Berkman*s,

duke përkufizuar kështu edhe llojin rinor të lexuesit të vet, lexues i ngjashëm e i njëkohshëm (1888) me atë që do të lexonte *Kulshedra e shpirtit sblue t’riive* të Junggut, në të cilën është përfshirë edhe *Shahiri Elierz*, prej nga ku do të lexohej edhe “Vaji i bylbylit”.

Nga letërkëmbimi me Gustav Mayer-in shprehet fare qartë nga ana e Mjedjes vetëdija për zgjedhet gjuhësore. Në lidhje me “Shahirin” ai pohon më 15 janar 1893: “Ky botim është i gjymtuem, dhe jashtë Shkodret ai sigurisht qi nuk është i njoftun. Puristat kanë me bâ zhurmë, kur t’shohin se përmbân shumë fjalë turke. Por unë e kam shkruar atë për popullin, i cili flet pikërisht kështu (...) Vaji i Bylbylit është ba shumë popullor n’Shkoder”³⁸. Të njëjtin qëndrim ai e përforcon edhe në lidhje me *T’përghjamt e Zojës s’bekueme* në një kartolinë të datuar 28 korrik 1892: “Po ju dërgoj një kopje të librecit tim *T’përghjamt e Zojës*” (...). Pranojeni Ju lutem si shenjë nderimi e veneracioni të thellë që ushqej për Zotërinë Tuaj. Libri nuk ka në vetvete ndonjë

³⁶ VALENTINI, Zef, vep. cit., f. 153

³⁷ Cituar sipas Zef Valentinit, vep. cit., f. 154

³⁸ QUKU, I, f. 545 dhe PETERS, M, f. 467

vlerë të madhe: megjithatë të jeni i sigurt se aty keni për të gjetur dialektin shkodran siç flitet në qytet dhe si ma pat mësuar nëna ime".³⁹

Duke mbajtur parasysh këtë lidhje të fortë mes shkruarit dhe lexuesit, mes gjuhës së shkrimit dhe gjuhës së leximit (këndimit), apo më saktë vërshimit të oralitetit në indin e tekstit, edhe këmbëngulja dëshpëruese e Mjedjes së ri për të përshtatur ortografinë e shqipes merr një kuptim të ri, me një thelb të pastër "komunikues", dhe nuk i ngjan më një "individualizmi" karakterial. Ja si shprehet Mjedja-gjuhëtar në letrën e sipërpërmendur drejtuar Mayer-it: "Këto poezi do mundja t'i përshkruaja me ortografinë tuaj, duke treguar kështu me përsosmëri shqiptimin e shkodranishtes, e cila nuk mund të bëhet me ortografinë e Shkodrës"⁴⁰. Mjedja poet i hollë i shkodranishtes por edhe i prozës së saj klasike kërkonte përmes ortografisë së re muzikën e gjuhës së folur në trupin e tekstit të shkruar.

Por do të jetë po Mjedja ai që do ta përmirësojë thellësisht në nivel leksikor veprën e vet. Sipas M. Qukut kjo dëshmohet kryesisht duke filluar nga periudha 1905-1908⁴¹. Dhe kjo sjellje është e njëjtë si për poezinë ashtu edhe për prozën, si për krijimet ashtu edhe për përkthimet, përshtatjet etj. Shpesh këto ndryshime nuk janë vetëm leksikore por i përgjigjën edhe një poetike të brendshme të shkrimit sikundërse edhe prirjes së tij refleksive e meditative.

Nëse në botimin e parë të "Vaji i bylbylit" (1888) gjejmë huazimet orientale të tipit:

Jeshil, zeher, qef, hallk, behar, çehre, medet, shyhret, sahat, raha, katil, belda, kiamet, daulet, evlat, zahmet, hall, derman, haps, tallaz, maraz, takat etj., ato thuajse shmangen tërësisht në botimin e *Juvenilias* (1917). Krahaso:

1887/(8)

"Medet se i dimen tietër
Paske, o bylbyl i shkreti,
Zëmren per mall shyhreti
Askurr nuk ta ngushllon"

f. 2

1917

"Por vaj! Se j'dimen tjerë,
Paske o bylbyl i shkreti;

³⁹ QUKU, 6/1, f. 46

⁴⁰ QUKU, 1, f. 545

⁴¹ Ibid, f. 413

Pa daë ty zëmra t'treti
Mbas vajit qi t'rrethon"

f. 12

Siç shihet, shmangia e leksikut oriental në poezi dikton jo thjeshtë zëvendësime mekanike por ndryshime të forta të poetikës.

Edhe një krahasim i thjeshtë i dy botimeve të veprës marianiste *Të përgiamit e Zojës së Bekueme* [1892 / 1927] paraqet zëvendësime leksikore të tipit: “nasihati-shembulli”, “rahati-qetësi”, rixha-lutje”, “mymqym-mundet”, “tafti-fron”, hatri-vendim”, hyneri-stolija”, “masllahat-tëndejun”, “sabri-durim”, “kyvet-forcë”, “hazna-visari”, “mukajet-kujdes”, “dyreku-shtylla” etj. Nga krahasimi mes dy uratave hyrëse mund të shijohet eleganca e shqipes në variantin e dytë të 40 viteve më pas:

1892 “Po t’falmi nners, o Zoj, qi je tafti e selija e Dijes t’hynushme, pasqyra e nasihati i gjith virtyteve. O Zoj e mëshirshme m’a zir hirin prei s’Tennzot qi t’i marr mrapa nasihatet t’ua, e gnato msime qi ti vet, o Nan e dashtun m’i ke msue. Oh sa fort u gzote zemra e eme ka e nnishe zanin t’ann kur m’thoshe: *Eja mrapa mejet.*”

1927 “Po të falem nderes, o Zojë, froni e selija e Dijes së hyjnueshme, pasqyra e shembulli i gjith vertyteve! O Zoj e mëshirshme, ma xier hirin prei së Tenzot qi t’i marr mbrapa këshillet të tua, e njato mësimë qi ti, o Nan e dashtun, më ke dhanë. Oh sa fort kënaqej zemra e eme kah ndieshe zanin tand kur më thoshe: *Eja mbas mejet!*”

Mbas 55 vjetësh nga botimi i *Koncilit të dheut t’Arbërit*, Ndre Mjedja, nxënësi shpirtëror i Ejëll Radojës, e kishte shpënë letërsinë filobiblike shqipe në Shekullin e ri, si një nga *shelbyesit* e fundëm të saj.

Ajo ka tashmë një publik të gjerë, të pavarësuar e të kultivuar në leximin e shqipes, tek i cili nuk synohet një predikim i thjeshtë, por një refleksion i thellë për doktrinën, pranimin dhe ushtrimin e saj në mënyrë bashkëkohore me direktivat e Selisë së Shenjtë. Refleks të drejtpërdrejtë të kësaj bashkohësie përbëjnë edhe botimet e teksteve katekistike të tij.

Drejt Katekizms si “Summa credenti et agendi”

Edhe pse flitet për tekste dhe botime të “Katekizms”, zanafilla e saj lidhet me oralitetin si trajtë e edukimit (mësimi) me zë të lartë të doktrinës kristiane⁴². Duke e ruajtur këtë gjurmë të oralitetit dhe pedagogjisë formuese, katekizmat vijnë shpesh në trajtë manualesh (doracakë) me përmbajtje dialoguese pyetjesh e përgjigjesh të memorizuara. Të botuara si tërësi e parimeve të doktrinës kristiane ato janë emërtuar shpesh edhe me shkurtimin “Doktrina”.

Përmes zhvillimeve të mëdha në shoqërinë europiane, Kisha Katolike përshtat gradualisht katekezën që i bindej ligjësisë të komunikimit gojor në një katekezë të lidhur me lindjen e shtypshkrimit; katekezën e mjedisit komunitar në një katekezë të edukimit formues përmes katekizmave doktrinale.⁴³

Në traditën e botimeve të hershme shqipe tekstet katekistike përbëjnë korpusin kryesor, duke zënë fill qysh me tekstin meshues liturgjiko-katekistik *Meshari*. Por teksti më i rëndësishëm nga kjo pikëpamje është *Doktrina e krishterë* e Budit, duke qenë se sjell në shqip doktrinën e mirënjohur të Roberto Bellarmino-s, e cila ishte zyrtarizuar nga Vatikani si teksti doktrinal për t’u përkthyer në gjuhë të ndryshme e për t’u përdorur si katekizmi i Kishës Katolike në vende të ndryshme për rreth 3 shekuj. Tashmë gradualisht edhe në botimet shqipe do të pasqyrohen ndryshimet e mëdha që përfshijnë modernizimin e shoqërive europiane mbas daljes nga Mesjeta⁴⁴. Në periudhën moderne (XVI-XIX), e cilësuar si epoka e katekizmit (të mirëfilltë), katekumenati u konsiderua si instrumenti parësor i formimit kristian, i përtëritjes së kishës dhe përgjigjes thuaje ndaj çdo

⁴² lat. *Catechismus*, greqisht *katekhismos* derivat i *katekheo* “të edukosh (të japësh mësim) me zë të lartë, si *kata*, con e *echos*, përmes zërit.

⁴³ *Koncili i Trentit* sanksionoi bindjen se “pa një dije minimale nuk mund të ketë shpëtim” dhe u bë promotor i kompilimit të një katekizmi që iu besua një grupi redaktuesish prej teologësh tomistë, botuar më 1566 nën titullin *Catechismus ex decreto Concilii Tridentini ad Parochos*.

⁴⁴ Periudha e Antikitetit të vonë e Mesjetës (deri shek XV), kanë për bazë të përbashkët përmasën komunitare të iniciacionit në besim e në jetën kristine, përmes oralitetit. Mqse të alfabetizuarit janë të paktë dhe të tjerët përbëjnë rreth 90% të popullatave, mbizotëron një katekizëm i tipit viziv dhe devocionar. Me një rrugëtim të gjatë që dëshmohet qysh në tekstin biblik, shfaqen tipare të ndryshme në prerje të mëdha historike që i përgjigjen edhe llojit të raportit mes Kishës dhe bashkësisë së besimtarëve. Për me tepër rreth dukurisë evolutive të katekumenatit shih LA ROSA, Luigi, *La trasmissione della fede. Percorsi storici* (secc. IV-XV), Itst – Ldc, Messina 2009; Id., *Scenari della catechesi moderna* (secc. XVI-XIX), Itst – Ldc, Messina 2005.

mpakjeje të jetës kristiane, të shkaktuar, sipas bindjes së epokës, nga mosdija e popullit kristian. *Katekizmi Roman* është instrumenti bazë që përshkruan krejt pastoralen e përgjithshme, i përforcuar edhe nga një shumësi katekizmash për fëmijë, të rinj dhe të pagdhendurit.

Tashmë besimtari kristian nxitet të kërkojë Zotin duke ecur në thellësi të shpirtit të vet, ku gjenden edhe shenjat e pranisë së tij (Zotit). Jemi përballë një rrugëtimi të brendshëm, me një ekuilibër në proces, pra të paqendrueshëm, mes subjektivitetit besues dhe objektivitetit të besimit. Ndodh kalimi nga një kristianizëm me karakter kolektiv në një kristianizëm me karakter individual, të bazuar te ndërgjegjja individuale e vetëdijshme mbi besimin e vet, por, në të njëjtën kohë, i inkuadruar në mënyrë të ngurtë e uniforme në strukturën e parapërgatitur nga Kisha. Ligjërimi i katekizmave-formulues bëhet gjithnjë e më teknik e doktrinal për t'u mësuar, fjalë pas fjale, përmendësh, edhe me ndihmën e vargjeve, ritmit të frazës ose këndimit. Ky vullnet nga ana e Kishës për të strukturuar doktrinimin e besimtarit (tashmë individ i lirë) në mënyrë të ngulitur e të saktë nga pikëpamja doktrinale, bëri që në dekadat e fundit të shekullit XIX të formulohet nga ana e Vatikanit (1870) dëshira dhe bindja se duhej tejkaluar shumësia e katekizmave dhe duhej përpunuar një katekizëm unik, i përshtatur për të përcjellë në mënyrë autoritare të vërtetat e besimit katolik.

Pikërisht këtë provë unifikuese e ndërmori Papa Piu X (1905) përmes *Acerbo nimis* që e risjell katekizmin si *Summa credenti et agendi*. **Katekizmi i Piu X** është sintezë e një katekizmi unik të Kongresit Katekistik Kombëtar të zhvilluar në Piacenza më 1889, dhe kur u shpall Papë mbas dy vjetësh, teksti u prezantuar si disiplinë me enciklikën *Acerbo Nimis* e u përhap në gjithë Italinë dhe botën.

Katekizmi i Piu X ka si titull fillestar *Compendio della dottrina cristiana* (Shkurtore e Mësimit të Kështenë) i njohur ndryshe si *Katekizmi i madh* në botimin e 1905 me 993 pyetje e përgjigje, por edhe me botime më të lehtësuara e me ilustrime si ai për fëmijë e të rinj *Primi Elementi della Dottrina Cristiana*.

Është pikërisht ky Katekizëm që Mjedja e sjell në gjuhën shqipe me botimin:

Katekizmi i madh – kthye shqip prej D. Ndre Mjedës, me pesë pjesë, gjatë viteve 1927- 1928, në Shkodër.

Vepër me rëndësi historike për doktrinën kristiane dhe unifikimin e universalizimin e saj, *Katekizmi i Piut X* erdhi në shqip përmes përkthimit mjeshëtor të Mjedjes, i cili ka ditur të sinkretizojë, ashtu si pararendësit e vet të letërsisë filobiblike shqipe, jo vetëm një dije doktrinare, por edhe një dije e përvojë në shqipen doktrinare. Kontributi⁴⁵ i Mjedjes në këtë përkthim shpie natyrshëm në modernizimin e mëtejshëm të ligjëritimit doktrinal në shqip, tashmë në koherencë me modernizimin e përgjithshëm të Kishës Katolike në botë.

Por kjo koherencë e veprës së Mjedjes me frymën e përgjithshme të kulturës së besimit dhe të Kishës katolike del në pah edhe më herët përmes përgatitjes së veprave hagiografike në shqip.

II.b. MJEDJA THEMELUES I HAGJIOGRAFISË SHQIPE

Qysh në fillim të këtij punimi e përkufizua Mjedjen si themeluesin e zhanrit letrar të Hagjiografisë së mirëfilltë në gjuhën shqipe, me tekstet hagiografike *Jeta e Shejtit Sh’Njon Berkman*s, botuar në Romë më 1888, dhe *Shë Luigji Gonzaga* më 1927. Duke çmuar rëndësinë e këtij kontributi të Mjedjes në letërsinë shqipe, por edhe rëndësinë e këtyre të dhënave për historiografinë e letërsisë shqipe, shtyhem i të trajtojmë edhe disa nga aspektet më të rëndësishme të zhanrit hagiografik dhe të zhvillimi i tij historik.

Hagiografia si zhanër specifik i letërsisë filobilike

Hagiografia⁴⁶, si shkrimi i jetës dhe /ose i veprës së shenjtëve prek disa zhanre letrare njëkohësisht. Mes tyre del në plan të parë tregimi biografik i *jetës* së shenjtë, por në ndryshim nga biografia standarde, hagiografia është një zhanër letrar që synon të verë në dukje shenjtërinë e personazhit, jeta e së cilit tregohet.

Është e rëndësishme të mbahet parasysh se në bashkësitë e krishtera dhe qysh prej kohëve të hershme, hagiografia dallohet përgjithësisht nga një tjetër lloj teksti, atij i “librave kanonikë” që përbëjnë në thelb *Shkrimet e shenjta*. Prandaj, për të ruajtur qartësinë e

⁴⁵ Këtij kontributi mund t’i shtohet edhe fakti se është po Mjedja ai që nis punën më 1932 për botimi e *Speculum Confessionis* ose *Pasëqyra e t’rrëfyemit*, të Budit, në Revistën Leka, një përshtatje kjo në shqip nga e *Specchio di Confessione* të Emerio de Bonis, vepër po katekistike, e cilësuar nga Budi si “një lloj bashkëbisedimi shpirtëror fetar shumë i dobishëm për ata që nuk kuptojnë gjuhë tjetër përveç gjuhës amtare shqipe”.

⁴⁶ Nga greqishtja e vjetër ἁγιος / *hágios* « shenjt » et γράφειν / *gráfein* « shkruaj ».

analizës ajo cilësohet shpesh si “hagjiografi e mirëfilltë”, ndryshe nga nuancimet e mëvonshme që ka marrë termi për tekste të tjera filobiblike në raporte të ngushta me të shenjtën.

Nga pikëpamja përmbajtësore, siç shprehet edhe Michel de Certeau, në thelb hagjiografia është një tekst i tipit *Acta, Res gestae. Res, non verba* (shkruante Sulpice Sévère) – gjërat dhe jo fjalët. Por « faktet » janë më së shumti shënjes në shërbim të një të vërtete që ndërton organizimin e tyre duke « edificuar » shfaqjen e saj. *Res* janë (bërë) *verba* me funksion të fortë pedagogjik dhe epifanik.⁴⁷

Me një vetëdije të re autoriale dhe zhanrore përgjatë kundër-reformës (si përgjigje apologetike ndaj akuzave të protestantëve për abuzim me kultin e shenjtëve), hagjiografia hyn në një fazë të re veçanërisht në shekullit XVII. Që nga viti 1643 jezuitët bolandistë (nën modelin e Jean Bolland) do të marrin përsipër të qëmtojnë në mënyrë kritike e të botojnë sipas një sistemi kritik sprovues jetët e shenjtëve në veprën e vëllimshme *Acta sanctorum*. Kontributi i bolandistëve solli përkufizime dhe koncepte më moderne në qasjen ndaj saj.

Siç do ta theksojë edhe më 1905 bollandisti i mirënjohur Ati Delehaye në veprën *Les Légendes hagiographiques*, hagjiografia privilegjon *aktantët e së shenjtës* (shenjtët) dhe synon një proces *edukimi* (si ekzemplaritet): «Për të qenë hagjiografik në kuptim strikt – sqaron ai, - dokumenti duhet të ketë një karakter religjioz dhe të propozojë një synim edificues (edukues). Këtë emërtim duhet t’ua rezervojmë pra të gjitha shkrimeve të frymëzuara prej kultit të shenjtorëve, dhe të destinuara për t’i promovuar ata»⁴⁸. Duke i dhënë rëndësi dallimit zhanror mes hagjiografisë dhe historisë, metodologji tipike bolandiste, sipas së cilës “ka rëndësi të theksohet që në fillim [...] dallimi mes hagjiografisë dhe historisë”, veprës së hagjiografit i njihet liria të “mund të mveshë të gjitha format letrare të përshtatshme për të glorifikuar shenjtët, që nga raportimi i thjeshtë zyrtar [...] deri te kompozicioni poetik më i harlisur dhe realiteti më i skajuar»⁴⁹.

Statusi letrar i tekstit hagjiografik është parë dhe vijon të shihet nga perspektiva të ndryshme, më të njohurat prej të cilave prekin

⁴⁷ DE CERTEAU, Michel, *Dictionnaire des Genres et notions littéraires* – Albin Michel, Paris, 1997 f. 349

⁴⁸ DELEHAYE, Hipolyte, *Les légendes hagiographiques* (1905), (bot. II 1906) Bruksel, f. 2

⁴⁹ Ibid. f.12

çështje të: autorësisë; të një sociologjie të leximit dhe të strukturës së diskursit hagiografik.

Me një autorësi specifike që karakterizon në përgjithësi edhe statusin e teksteve filobiblike, hagiografia zhvendoset nga legjenda e miti kolektiv te redaktimi, te bashkautorësia e intertekstualitete të ndërlikuara tipike për këtë zhanër. Duke e shqyrtuar tekstin hagiografik **nga mënyra se si gjeneron ai**, Ati Delehaye e shihte statusin letrar të hagiografisë si ndërveprim i ndërsjelltë mes këtyre faktorësh autorialë:

“Letërsia hagiografike është ndërtuar nën ndikimin e dy faktorëve të dallueshëm qartë mes tyre, të cilët i ndeshim madje në çfarëdolloj rrjedhe letrare. Së pari është krijuesi anonim, i ashtuquajtur populli [...]. Vepra e tij është ajo e një agjenti misterioz e kolektiv, të çlirët, të shpejtë e të çrregullt siç është imagjinata, gjithnjë në kërkim shpikjesh të reja, por e paaftë t’i fiksojë përmes shkrimit. Krahas këtij agjenti, gjendet redaktori [që i jep...] gjithçkaje që është prodhuar një karakter reflektiv dhe afatgjatë. Që të dy kanë bashkëpunuar në këtë vepër nga më të gjerat që quhet *Jeta e Shenjtëve*, dhe na duhet ta njohim pjesën e secilit në këtë sipërmarrje shekullore që rinovohet papushim.”⁵⁰

Ndërsa i vështuar nga pikëpamja e një **sociologjie leximi** statusi letrar i tekstit hagiografik del në pah i lidhur me rolin dhe me funksionet që një bashkësi i njej ose i mvësh atij. Michel de Certeau thekson disa prej aspekteve dalluese por edhe më emancipuese të hagiografisë në një epokë kur ajo përbënte thuajse një ekskluzivitet leximi:

a) Jeta e shenjtëve përfshihet dhe përshekruhet (inscripta) në jetën e një grupi, Kishës ose bashkësisë. Ajo nënkupton që grupi të ekzistojë tashmë;

b) Jeta e shenjtë i sjell komunitetit një element *festiv*. Ajo gjendet në krah të çlodhjes dhe argëtimit. Korrespondon me “kohën e lirë”, një lloj hapeje “shpirtërore” dhe kontemplative. Ajo nuk gjendet në anën e instruktimit strikt, të normës pedagogjike dhe dogmës. Ajo “zbavit”.⁵¹

Fale qasjes së re kritike⁵², tekstet hagiografike moderne u bënë në përgjithësi më të vëmendshme ndaj së vërtetës historike, dhe

⁵⁰ Ibid. f.13

⁵¹ DE CERTEAU, Michel, vep. cit. ff. 351-352

⁵² Me daljen nga Mesjeta hagiografisë do t’i kërkohet një farë ripërkufizimi zhanror, sidomos në raport me Historinë, duke qenë se në mijëvjeçarën e saj të parë ajo

këmbëngulin më tepër te thellësia spirituale, kurajoja misionare ose bamirëse e personazheve se sa te “e mrekullishmja”. Prandaj gjatë shekullit XIX ajo merr pamje më morale: shijes fillestare të së jashtëzakonshmes, zbehjes kuptimore të hapësirë-kohës, i kundërvihet një rend i lidhur me meritat e punës, dobishmërisë së vlerave liberale, klasifikimit sipas virtyteve familjare.

c) Ajo i referohet gjithashtu një normaliteti *psikologjik* vëren de Certeau: ndërkohë që në një “botë” që ngjan e “sëmurë”, shenjtji duhet të shquhet falë “ekuilibrit” që e karakterizon, shembullor, mbi kodin e përcaktuar nga kleri i ri (më i moderuar).⁵³

Por statusi letrar i tekstit hagiografik del më qartë në pah edhe për nga **struktura e vetë diskursit hagiografik**. *Heroi* në përgjithësi paraqet tipare ose sjellje të përsëritura që janë ngulitur duke u shndërruar në “sfera të veprimit”. De Certeau flet edhe për një aspekt *kompilues* të tekstit: “Individualiteti në hagiografi vlen më pak se personazhi (të njëjtat aspekte, tipare, apo episode kalojnë nga një emër i përveçëm të tjetri). Më shumë se emri i përveçëm vlen modeli që vjen nga ky *brikolazh*; më tepër se njësia biografike vlen *dekupazhi* i një funksioni dhe një lloji që e përfaqëson etj.”⁵⁴. Gjithashtu, nëse biografia rreket të shpalosë një evoluim, pra edhe diferenca, hagiografia postulon se gjithçka është e dhënë që në zanafillë me një “vokacion”, me një “përzgjedhje” ose, si në jetët e Antikitetit, me një *etos* nistor.

Studime të mëvonshme tërheqin vëmendjen edhe për **një stereotipi të zhanrit** si karakterizim zhanror. Pjesa më e madhe e

shërbente edhe si “burim historik” por i besueshëm *a priori* të dhënash. Gjithashtu, në evoluimin e gjatë të këtij zhanri thuhet se dy mijëvjeçar, nga tekst i martirizimit dhe i mrekullive të Antikitetit të vonë dhe Mesjetës, hagiografisë do t’i imponohet një trajtë më *historike* ku erudicioni jo vetëm i atij që shkruan por edhe i atij që “e shqyrton” (certifikon) imponon një përkufizim të ri të asaj çka është “e vërtetë” ose “autentike”.

⁵³ DE CERTEAU, Michel, vep. cit., f. 354

⁵⁴ Gjithashtu parashtrojmë tiparet në vijim: 1. Ndërtimi i figurës realizohet duke nisur nga elemente semantike. Kështu, për të theksuar te heroi burimin hyjnor të veprimeve të veta, jeta e shenjtë i jep shpesh një origjinë fisnike. Gjaku bëhet metaforë e hirit hyjnor. Prej këndeje vjen edhe nevoja e gjenealogjisë; 2. Historia është atëherë epifania progresive e kësaj të dhëne, sikur të qe gjithashtu historia e raporteve mes principit gjenerator të tekstit dhe manifestimeve të tij në sipërfaqe; 3. Fundi përsërit fillimin. Nga shenjtji adult, ngjitemi te fëmijëria e tij (...) Shenjtji është ai që nuk humbet asgjë nga ajo që i është dhënë që në fillim; 4. Koha e sprovës (betejë e vetmuar) / koha e lavdisë (mrekullitë publike): kalim nga privatja te publikja. DE CERTEAU, Michel, *Dictionnaire des Genres et notions littéraires* – Albin Michel, Paris, 1997, ff. 354-355.

stereotipeve të diskursit hagiografik gjenden tashmë qysh në tekstet antike profane, qoftë narrative (biografike) qoftë epidiktike (elozhuere): Shenjti është një qenie e predestinuar; *puer-senex*, ai thuajse nuk i njeh lojërat e fëmijërisë, meqenëse koha e shenjtërisë është pjesë e projektit hyjnor dhe i shmanget linearitetit të kohës njerëzore; triumfon mbi tundimet; shpesh shfaqet si një qenie asociale, i vdekur për botën; ka parandjenjën e vdekjes së vet; lista e virtyteve të tij përkon me ato çka ai kërkon të ketë si virtyte; mënyra se si manifestohen ato është e larmishme mes: bamirësisë, shenjave, *miracula*, *mirabilia* etj⁵⁵.

Si përfundim, është e rëndësishme të mbahet parasysh se tekstet hagiografike në përgjithësi, e sidomos ato të shekullit XIX, përshkohen nga “një rrjet intertekstor tepër i dendur” dhe funksionojnë si “një *locus communis* i bashkësisë, ku e gjithë bashkësia kulturore mblidhet rreth vlerave që ajo ndan”⁵⁶. Zhanër specifik në pikëprerje mes letërsisë, historisë, pedagogjisë dhe dogmës, ajo është në thelb “një ligjërim virtytesh” në të cilin “zbërthehet gjithmonë një thelb teologjik”⁵⁷.

Hagiografisë e Mjedjes

Ndre Mjedja njihet si autor i dy hagiografive në shqip të cilat, ndonëse mendohet se mund të jenë shkruar thuajse në të njëjtën periudhë, rezultojnë të botuara me një largësi prej rreth 40 vjetësh:

- ***Jeta e Sceitit Sc’Gnon Berchmans***, t’scoenis Jezu Krishtit, kthye sccyp prei Nnrek Mjeds gesuitit scodran. N’Rom, me scamp t’kuvennit S.t’Propagands, 1888. Me parathënie “Djemve t’ri shëndet prej Zotit”;
- ***Shë’ Luigi Gonxaga*** - Projtësi i përgjithtë i moshës së re. Jet’ e përmbledhun prej D. Ndre Mjedës, Shtypshkronja e Zojës së Papërlyeme, Shkodër, 1927.

Përveç të përbashkëtave të diktura prej zhanrit hagiografik në përgjithësi - ku vlen të përmendet sidomos karakteri “formues-edukues”; etosi i lartë; bashkësia funksionale; leximi festiv; stereotipitë e

⁵⁵ GOULLET, Monique, *Ecriture et réécriture hagiographiques. Essais sur le réécritures des Vies de saints fans l’Occident latin médiéval*, Turnhout, Brepols, 2005 (coll. Hagiologia); dhe GOULLET, Monique, *De l’usage te l’hagiographie en Histoire médiévale*, në Editions Méneestrel, Médiévistes sur le net: sources, travaux et références en ligne.

⁵⁶ Ibid.

⁵⁷ DE CERTEAU, Michel, vep. cit.

personazhit etj. -, mund të thuhet se këto dy hagiografi janë në një lidhje filiative me njëra-tjetrën, dmth të tipit nënë-bijë, duke qenë se i riu Gjon Berkman, në rrugëtimin e tij shpirtëror drejt shenjtërisë, u frymëzua nga leximi i Jetës së Shenjtë Luigj Gonzaga, edhe ky një i ri i frymëzuar për jetë të devotshme e i përkushtuar ndaj Shën Mërisë e Krishtit. Pra, *Jeta e Sceitit Sc'Gnon Berchmans* nënkupton leximin (edifikues-shembullor) të jetës së *Shë Luigji Gonxaga*. Në dekadat e fundit të shek XIX, një botim i të dyja jetëve së bashku ose shumë pranë njëra-tjetrës, do të ishte diçka krejt e natyrshme. Edhe të dhënat dokumentare nga letërkëmbimet e Mjedjes na e vërtetojnë këtë prirje, pavarësisht se historia e botimit të veprave paraqet një realitet tjetër.

Me shkrimin e jetës së Gjon Berkmanit (e njëkohësisht me planifikimin por me gjasë edhe hartimin e jetës së Shën Luigjit) Mjedja i ri jo vetëm bëhet themeluesi i këtij zhanri në shkrimin shqip dhe letërsinë shqipe⁵⁸ por, edhe për shkak të koherencës së imponuar nga botimet e miratuara të Propagandës, e sjell këtë zhanër për bashkësinë shqiptare në stadin e saj real dhe modern sikundërse zhvillohej në hapësirat e tjera evropiane të besimit katolik. Duke shmangur përsëritjen e pasuksesshme të etapave të mëparshme të zhanrit në një kontekst të ri, vepra *Jeta e Sceitit Sc'Gnon Berchmans* më 1888 (e ndjekur pak më vonë nga *Jeta e Sh'Luigjit Gonzaga – yrnekut e paitori i t'riive* e Jak Junggut më 1890), ngërthen thuajse të gjitha tiparet në sinkretizmin e vet, duke shërbyer si një lexim e shkëmbim alternativ në bashkësinë veçanërisht rinore, si model jete e veprimi, por edhe si model ligjërimi e shkrimi shqip, përtej formave klasike të liturgjisë, doktrinës, katekizmit etj. Tashmë, edhe te besimtarët shqiptarë katolikë ndjehet ose duhet nxitur nevoja për një lexim të ri të së shenjtës, për kërkime subjektive, për përsiatje psikologjike, ndjeshmëri por edhe kuptim real (bashkëkohor) të besimit dhe Kishës. Sado e zbehtë që

⁵⁸ Ndonëse nga Ritualet ortodokse të Jugut të Shqipërisë dhe nga shtypshkronja e Voskopojës trashëgojmë në kulturën shqiptare një sërë “Akoluthish”, të njohura më së shumti me emrin “Akoluthitë e Voskopojës”, sqarojmë se ato janë libra shërbese sipas ditëve të shenjtëve në kalendarin fetar dhe ndonëse mund të përmbajnë edhe pjesë të jetës ose veprave të shenjtit “mrekullibërës”, ato janë të shkruara në greqisht. Përmendim: Shërbesë e atit të shenjtë Klimentos (Klement) Kryepeshkop i Ohrit; Shërbesë për 15 dëshmorët e shenjtë (28 Nëntor); Shërbesë e të shenjtit martir Ioan Vladimirit, mrekullibërësit (22 maj); Shërbesë e të shenjtit Martir Erasmit (2 qershor); Shërbesë e shenjtit Naum mrekullibërësit (20 qershor); Shërbesë e të shenjtit martir Nikodimit (10 korrik); Shërbesa e shtatë shenjtorëve (17 qershor); Shërbesë e të shenjtit martir Ioan Vladimiri mrekullibërësi, Venedik 1858 (riprodhim i veprës botuar po në Venedik 1774) etj.

mund të na dukej sot kjo përpjekje, ajo dëshmon së paku për një trokitje moderne në edukimin e bashkësisë rinore katolike shqiptare.

Të dhënat dokumentare, të shqyrtuara më së shumti nga mjedologu Mentor Kuku, na japin si datë të përfundimit të veprës *Jeta e Sceitit Sc'Gnon Berchmans* vitin 1887. Në letrën për At Dedë Pazin SJ, që mban datën 30 nëntor 1887, Mjedja (tashmë pedagog i muzikës në kolegjin “Da Vida” në Cremona) shkruan: “Në çastet e pakta të lira të ndonjë mbrëmje kam vazhduar këtë libër që e nis të porositur. Me këtë nuk kam pasur tjetër qëllim veç të ndihmoj përshpirtësinë e devocionin e besimtarëve”⁵⁹. Ndërsa në letrën e 24 janarit 1888, ai shkruan rreth vizitës së Provincialit Vioni dhe një pakti të mundshëm mes tyre për botimin e jetës së Gjjon Berkmansit: “Ka një javë që kemi në shtëpi Atë Provincialin. Ai në mënyrë spontane më foli gjatë për drejtshkrimin e tjera gjëra të gjuhës shqipe... Më lejoi edhe të shtyp jetën e Sh. Berkmans (e vetmja që kisha në duar, sepse të tjerat, sado që ju kam pyetur, ju nuk më thonë gjë), për dobi të paqës e ktheva në drejtshkrimin e vjetër”⁶⁰. Në fakt, kjo “dobi për paqe” shpreh një nga problemet më të mprehta të Mjedjes autor, shkrimtar e gjuhëtar në kërkim të përdorimit të një alfabeti të ri, të përshtatur me cilësitë fonetike të shqipes.

Sidoqoftë, edhe pse historia e botimit të veprave në prozë të Mjedjes do të jetë e lidhur ngushtë me “çështjen e alfabetit mjedjan”, arsyet e botimit të tyre me diferencë të madhe nga koha e shkrimit apo përkthimit, gjykojmë se mbeten më komplekse se kaq dhe lidhen qoftë me planet e përgjithshme të Provincës në kontekste të lëvizshme gjeopolitike, qoftë me shtrëngesat financiare, qoftë me marrëdhënien e ndërlikuar të vetë Mjedjes me Shoqërinë Jezuite.

Mbas paktit Vioni-Mjejdja, *Jeta e Sceitit Sc'Gnon Berchmans* merr lejen zyrtare për shtyp nga Arqipeshkvi i Shkodrës, Emzot Guerini, në Shkodër, më 7 korrik 1888 dhe botohet në Romë me alfabetin e autorëve të vjetër. Nga parathënia e autorit, me titull “Djemve t’ri shëndet prej Zotit”, kuptohet lehtë destinimi i veprës, i cili përkon më së miri me vetë zhanrin hagiografik si vepër formuese-edukuese sikundërse ndodh edhe me veprën këshilluese (predikuese) *Kulshedra zblue shpirtit t’rive* e At Junggut, në të cilën u përfshi edhe botimi i *Shahirit* me poezitë e Mjedjes dhe Bytyçit. Jeta dhe njëkohësisht shenjtëria e të riut Gjjon Berkmans i shpaloset në shqip

⁵⁹ QUKU, 6/1, f. 42

⁶⁰ Ibid.

lexuesit të ri shqiptar për të gjetur shembull e frymëzim në vendimet e veprimet që do të marrë në jetë përmes devotshmërisë dhe ruajtjes së pastërtisë së shpirtit. Mentor Quku sheh te kjo jetë shenjtë edhe një paralele me jetën e mikut të dashur e të talentuar (të Mjedjes) që vdiq në moshë fare të re (23 vjeçare), Gjon Shllaku SJ.”⁶¹

Vepra është shkruar duke iu përgjigjur parimit të “pavarësisë në lexim” dhe si e tillë bart në shkrim jo thjeshtë cilësitë e shkruesit por sidomos tiparet e bashkësisë së destinuar për lexim (si dhe frymëzim, ndikim). Gjuha dhe shtjellimi i kësaj proze rrjedhimisht do të duhej të ishin të drejtpërdrejta e të rrokshme: një gjuhë “ashtu siç flitet”, fjali të qarta; pedagogji moshore (dmth rinore) formuese por e thjeshtë, pa stërhollime teologjike por ngritje të lartë morale dhe etos përmes shembullit konkret e frymëzues të shenjtit, i cili, jo rastësisht zgjidhet po aq i ri në moshë sa lexuesit e tij potencialë.

Është interesant fakti se vetë Gjon Berkmani është një i ri i devotshëm i cili përmes leximeve u frymëzua dhe ndikua nga jeta (hagjiografia) e Shën Luigj Gonzagës, i shpallur edhe shenjt mbrojtës i të rinjve. Duket sikur do të që më e natyrshme që kjo sprovë hagjiografike të zinte fill pikërisht me jetën e mjeshtrit dhe jo të nxënësit. Por nëse gjykojmë mbi “modelin-formues” që lexuesit e rinj do të gjenin si frymëzim për jetët e tyre, atëherë na duhet të pranojmë se jo jeta e Shenjtë Luigj Gonzaga, por ajo e “nxënësit” Berkmani është më afër tyre dhe si një *mise en abyme* do të shërbente edhe si pasqyrë ku të rinjtë të portretizonin profilin e një frymëzimi më modern për një jetë të devotshme e të pasur shpirtërore. Ky lloj arsyetimi hipotetik nga ana jonë, përkon edhe me parimet e pedagogjisë modeluese që karakterizon prej shekujsh veprimtarinë jezuite kudo në botë.

Sidoqoftë është fakt se nga pena e Mjedjes, jeta e shenjtë Luigj Gonzaga do të vijë e botuar vetëm mbas 40 vjetësh. Megjithatë, perspektiva ndryshon kur marrim në shqyrtim jo kohën e botimit por atë të shkrimit ose edhe të përgatitjes së veprave. Nga letërkëmbimi dhe shënime të ndryshme mund të hamendësohet se Mjedja i ka punuar ose i planifikon thuajse në të njëjtën kohë të dyja veprat (madje më shumë se dy): kujtojmë se në letërën e 24 janarit 1888 drejtuar Atë Dedë Pazit (rreth vizitës së Provincialit Vioni dhe lejen e botimit të jetës së Gjon Berkmanit), Mjedja riktheqson se ai: “Më lejoi edhe të shtyp jetën e Sh. Berkmanit (e vetmja që kisha në duar,

⁶¹ Ibid. f. 547

sepse të tjerat, sado që ju kam pyetur, ju nuk më thoni gjë)...”; gjithashtu edhe letra e 30 nëntorit 1887 drejtuar po Atë Dedë Pasit mban një shënim protokolli në Shkodër “Me i pa dy jetët”. Sipas M. Qukut: “Me siguri dikush në Shkodër don të shohë dorëshkrimin e Berkmans. Jeta tjetër është ajo e Shën Luigj Gonzaga, për të cilën ne nuk jemi të sigurtë se është shkruar tashmë, apo bëhet fjalë për veprën *Të Përgiamit e Zojës së Bekueme*.”⁶² Ndërsa në një letër tjetër drejtuar At Dedë Pasit më 12 maj 1888 sqarohemi se Mjedja është rrekur t’i marrë miratimin Emzot Logorecit, kushëririt të vet, për ta shkruar jetën e Shën Luigj Gonzagës në alfabetin e tij: “Persa i përket jetës së Sh. Luigjit pritja përgjigje nga Emzot Logoreci, e në qoftë se ai nuk kundërshton drejtshkrimin tim, kisha menduar ta shkruaja sipas këtij sistemi”.⁶³ Pavarësisht mungesës së qartësisë mes “shkrimit” “rishkrimit” apo “hartimit” të këtyrë veprave, i sigurt është fakti se Mjedja i ka shndërruar ato në një objekt të punës dhe planeve të veta të cilat duket se zenë fill në vitin 1886⁶⁴.

Nga ana tjetër duhet mbajtur parasysh fakti se një jetë e Shën Luigjit do të botohet më 1890 pikërisht nën autorësinë e Jak Junggut⁶⁵, me titull Jeta e *Sh’Luigjit Gonzaga – yrneku e paitori i t’riive*, botim i cili në kopertinë mban vitin e botimit 1890, në frontespis mban vitin e botimit 1889; mban lejen nga provincial Guerini më datë 17 shkurt 1890 ndërsa daton “parathënie” e autorit më 21 qershor 1888. Siç mund të kuptohet, Junggu e ka në duar këtë vepër të përfunduar më 1888. Gjithashtu, në veprën e tij të mëparshme *Kulshedra e shpirtit zblue t’rive* 1887/8 gjendet si shembull për të rinjtë edhe një fragment rreth një faqe, me titull “Vakiade” nga “jeta e Sh’ Luigjit në vegjëli”⁶⁶. Ky fragment është relativisht i ngjashëm me të njëjtin episod të rrëfyer të libri kushtuar shenjtë, duke na sugjeruar kështu edhe mbi mundësinë e një pune paralele me tekstet. I porositur ose jo, Shën Luigji i Junggut është i gatshëm për botim dhe merr lejen sipas procedurave. Mjedjes nuk i mbetet veçse ta shtyjë qoftë “hartimin”, qoftë “shkrimin” e aq

⁶² QUKU/ 1, f. 548

⁶³ QUKU, 6/1, f. 119

⁶⁴ “*Të Përgiamit e Zojës së Bekueme*, “*Jeta e Sceitit Sc’Gnon Berchmans*” dhe “*Jeta e Shë Luigji Gonxaga*” ishin tre veprat fetare që Mjeda kishte gadi për botim që në vitin 1886” – del në përfundim Mentor Quku në QUKU, I, f. 447

⁶⁵ JUNG, G. *Jeta e sc’Luigjit Gonzaga – yrneku e patrioti I t’riive/ e citi P.I. Junku i S.J. / n’Rom*, 1889.

⁶⁶ JUNG, G, *Kulshedra e shpirtit zblue t’rive*, Skoder: Sctep. e Zojs zanun pa kurr lece, 1887, ff. 11-12

më tepër botimin e variantit të tij të *Shën Luigj Gonzagës* që do të bëhet realitet vetëm në 240-vjetorin e vdekjes së shenjtit.

Por hagjiografia *Shë Luigji Gonxaga* (Projtesi i përgjithtë i moshës së re. Jet' e përmbledhun prej D. Ndre Mjedës), 1927, vjen në një kontekst të ri të prozës shqipe, ku jo vetëm botimet me karakter religjioz janë të shumta e të larmishme por edhe letërsia laike po hyn në fazat e saj të modernitetit. Megjithatë, Shën Luigji i Mjedjes përbën tashmë një vepër sipërore, një model të prozës klasike shqipe. Mjafton të përqasim mes dy “Luigjëve Gonzaga”, atë të vitit 1889 e atë 1927-s, të njëjtat sekuenca narrative për të kuptuar “revolucionin” mjedjan në këtë tip proze, duke mbajtur parasysh faktin se të dy autorët (Junk e Mjedja) kanë pasur si tekste zanafillore kryesisht shkrimet e Virgilio Cepari SJ:

Sekuenca I

Junk: “Zotnia i ati ishte nder tallaze e nder turbullime m'dy ansh; n'njen ash dashtnia qi kishte kah diali nuk e lete m'u daa, m'tieter an drote edhe shpirtin e nuk dote me i fye Tenzot.”

Mjedja: “N'odë tjetrë, tallaze të pashoqe shkalmoshin zëmren e Markezit: dashtnija e një babës, e dashtnija per të madhin Zot, mbasi me sy çilë s'dote me i kundershutue vullendesës së tij.”

Sekuenca II

Junk: Në letrën dërguar Ipeshkvit Gonzaga, babai (i dorëzuar) shprehet se po i besonte (dorëzonte): “me ja fal djalin e paar, dashamirin e vet, n't'cillin kishte pshtet gjith uzdajën e vet”.

Mjedja: Në letrën dërguar Ipeshkvit Gonzaga, babai (i dorëzuar) shprehet se po i besonte (dorëzonte): “Gjân mâ të dashtun e uzdajen mâ të madhe qi mujte me pasë një babë në ket shekull”.

240-vjetori i vdekjes së shenjtit përbën një moment specifik e kremtues për të gjithë komunitetin katolik. Françeskani Gjergj Fishta do të botonte po atë vit melodramën *Shën Luigji Gonzaga*. Po sjellim këtu mënyrën se si poeti shtjellon tashmë në vargje momentin dramatik të konfliktit at/bir përmes fjalëve të Luigjit të ri:

*“Se e drejta me detyrë hecë s’bashkut njitë
Porsi rrezja me dritë;
E se pa t’drejtë nuk mund t’ngjallisë detyra,
Me sa n’pasqyrë, pa dritë, mund t’shifet fyra”*⁶⁷

Interesant është fakti se për botimin e *Shë Luigj Gonzaga* të Mjedjes më 1927 nuk gjendet një mendim kritik në shtypin e kohës, as në atë katolik në Shkodër. Por gjejmë një kritikë vlerësuese në rubrikën “Bibliografi” të Lumo Skëndo në revistën e tij *Diturija* 1928 në të cilën ai argumenton vlerën e veprës pikërisht duke u bazuar të tiparet e zhanrit hagiografik siç janë moraliteti i lartë, shembullorësia, forca e karakterit të personazhit, kërkimi për të bukurën shpirtërore dhe virtytin:

“Salutojmë veprat e botuara në gjuhët t’ënë për të dhënë një ideal të shkëlqyerë për moralitet, për karakterin. Çdo jetë-shkrim i një njeriu të math – të math me shërbimet që i ka bërë njerëzisë, dhe me forcën e karakterit – i është një mbështetje njeriut për të lartësuar në shkallët e mirësisë, për t’arriturë, ose për t’u afëruarë, një formës së plotë bukurije dhe virtyti.”⁶⁸

Me një logjike etatiste, Mit’hat Frashëri shtjellonte gjithashtu edhe lidhjen e ndërsjelltë mes edukimit të qytetarit, të atdhetarit të emancipuar dhe njeriut të besimit të lulëzuar shpirtërisht duke e vendosur kështu kontributin e Mjedjes me këtë vepër në një kontekst të ri, të një shoqërie moderne, që rreket të harmonizojë faktorë socialë të cilët në format klasike ngjajnë në kontradiktë:

“Duke zgjuarë dhe duke u dhënë shpirt ndjenjave të njerëzisë, të mirësisë, duke shvilluarë virtutet njerëzore dhe karakterin e fortë, kemi shëndoshurë ke Shqiptari edhe patriotizmen, që s’është tjetër veçse sinteza e gjithë këtyre. Duke ngjallurë patriotizmen, i kemi shërbyerë dhe kishës katolike, me qënë se është një e vërtetë e evidente që kisha katolike në Shqipëri vetëm me një Shqipëri independente dhe të fortë moralisht munt të mbahetë. T’i shërbyerë Shqipërisë, shqiptaris nëse, është dhe një shërbim i çmueshëm që munt t’i bëhetë kishës”.

⁶⁷ FISHTA, Gjergj, *Shën Luigji Gonzaga*, Shtypshkronja e Zojës s’Paperlyeme, Shkodër 1927 1927, f. 52

⁶⁸ SKËNDO, Lumo, “Shë Luigj Gonzaga, prej D. Ndre Mjedja: Shkodër, 1927”, *Diturija*, nr. 5, 1928, f. 196

Në thelb, Lumo Skëndo i rikthehej intuitivisht një principi themeltar në veprimtarinë e Mjedjes e të shumë klerikëve të tjerë të Shoqërisë Jezuite në Shqipëri, i rishprehur po atë vit e vetëm një numër më pas, po në revistën *Diturija*, nga At Fulvio Cordignano, në shkrimin “Vepra e Etënvjet Jezuitë në Shqipëri e veriut 1841-1928”:

“Për me kuptuam natyrën dhe frymën e veprës tepër përfshise t’Etënvjet Jezuitë në Shqipëri (si dhe gjithkrah tjetërkund), duhet që lexuesi të niset prej këtij parimi themeltuer, i cili mbas né katholicëve nuk ka vepër kulture, për në qoftë se kjo nuk ká për themel dhe për qëllim të bram trajtimin fetár e moral të njeriut. Për né nuk ká një edukatë thjeshtësisht filozofike dhe aq má pak politike e partije, sikundër edhe me të vërtetë nuk eksiston një moral i pa rrënuem në burim e në fuqin efektive të njëj besimi fetár.”⁶⁹

* * *

Hagiografite e Mjedjes, vepra në prozë e tij, por edhe krijimtaria poetike nga *Shahiri*, te *Juvenilia*, *Lirija*, *Lissus* e *Scodra*, përmes vetëdijes autoriale, filiacionit e thyerjeve moderne, kompetencës së lartë gjuhësore, qasjes meditative sa teologjike aq filozofike dhe një estetike të rrallë të tekstit, janë në thelb pjesë e këtij parimi themeltar kulture, sikundërse autori i tyre, Ndre Mjedja, ishte dhe mbeti pjesë e misionit ndriques të besimit me vetëdijen emancipuese të misionarit dhe atdhetarit që e karakterizonte njëkohësisht deri në ditët e fundit të jetës.

“Si dihet – shkruan Camaj në 1965, tashmë poet-shelbyes ai vetë i poetikës së Mjedjes, - se rruga e artit mjedjan qe shumë e gjatë dhe e qëndrueshme në limimin e landës e të gjuhës, e sidomos të gjuhës që u shkri në një me landë.”⁷⁰

⁶⁹ CORDIGNANO, Fulvio, “Vepra e Etënvjet Jezuitë në Shqipëri e veriut 1841-1928” në *Diturija*, nr. 6, 1928a, f. 218; po aty vijon ai: “Në qoftë se ndonjeni mund të sjellë pyetjen, pse Etënt Jezuitë erdhen në Shqipëri, përgjegjja është shumë e thjeshtë: për me dhënë ndihmën e vet për mbajtjen e fés katolike të trashigueme në ket dhë; me fjalë tjera, për me i rrafshuem rrugën qytetnimit dhe kulturës katolike në këto vise, të cilat janë porta e Lindjes, atë kulturë e at qytetnim për të cilat luftoi Skanderbegu, kreshniku shqiptar.”

⁷⁰ CAMAJ, Martin, “Libra të lexuem”, *Shëjzat*, nr.1-2, janar-shkurt, Romë, 1965, f. 68

Ky përkufizim mbetet ndoshta nga më të thjeshtit e njëkohësisht më të vërtetët për Mjedjen, vepra e të cilit, në poezi e në prozë, shfaq rrugëtimin e mundimshëm por precioz të *gjuhës* amtare që bëhet *landë* kombëtare e thelb universal.

Kujtim M. SHALA

MJEDJA: NORMA E FORMA

I

Formulimi *Mjedja: norma e forma* e shenjon poezinë e Ndje Mjedjes (që do *autentiken*) në raport me *poetikën* (që lakmon *universalen*), të lidhur në diskurs normues, bashkë me *variantet* e shkrimit, të lidhura në vepër letrare që lakon *ndjesitë* e *biografitë* (si fenomenologji), të shënuara në diskurs e të hapura në imagjinime.

Kështu, *vepra* e provon *poetikën*, por më parë e sprovon në konkretësinë e shkrimit që, vërtet, është praktikë e *krijimit*, ndërsa vetë bëhet provë autentike e *poetikës*, e tillë që dëshmon *idealitetin* e *poetikës* e *autenticitetin* e veprës (autoriale).

Norma kodifikon rregullin, por *vepra* letrare gjithnjë vjen para dhe s'e do mësimin, meqë vetë kthehet në mësim letrar autentik, të lidhur në *përgjasime* (figura) e të rritur në *besueshmëri* (motivim).

Poezia është forma më personale e letërsisë, por më universalja, prandaj, kur ndodhemi në cep të përjashtimit të *normës*, kthehemi te universaliteti që tenton ajo. Po, se *norma*, si teoria letrare në përgjithësi, do të jetë universale, edhe kur buron nga një vepër konkrete dhe diskursin e *krijuar* të saj e kthen në *diskursivitet* të universalizuar (të normuar).

Çështja bëhet më e ndërliqshme kur autorët janë edhe vetë mendimtarë e dijetarë që propozojnë dije (të lidhur), e cila kërkon prova e diskursivitet dhe që motivimin letrar e kthen në kategori, klasema e sistematikë diskursive. Në këto raste, *vepra letrare* e shenjon *diskursivitetin letrar* dhe kthehet në faqe që zbulon mendimin, ashtu siç e do letërsia: *vepra* para, *teoritë* prapa.

Por, veprat klasike, si ajo e Mjedjes, na kthejnë tek teoritë klasike, të cilat, si norma të lidhura e të strukturuara, që vijnë para veprës, si trashëgimi e si mësim letrar, bëhen mësim krijimi për autorët.

Të lidhura sistematikisht, diskurset e tilla u kthyen në traktate, tekste rregullash, që kishin model vepra letrare konkrete, të prera për teorinë e të zgjedhura për aksiologjinë, e që ktheheshin në model që duhej të përsëritej pa kufi, për të qenë *autor* e për të shkruar një vepër “për të qenë” (Aristoteli). Kështu, traktatet u kthyen në diskurse të zakonshme dhe krijuan traditën e mendimit klasik, ndërsa letërsisë iu deshën shekuj që të hapej në modernitetin e saj, i cili teorinë s’e njohu si *normë e doktrinë*, por si diskurs asbtragues që buron nga përshkrimi i veprës letrare.

Prova për këto bëhet edhe me veprën e Mjedjes, ashtu siç provohen ndarjet, kështu që çështja bëhet më e ndërliqshme dhe hapet në trajtën:

Si duket Mjedja në këtë prerje?

Çfarë ndodh me estetikën klasike në epokën e në veprën e tij?

Si krijohet vepra e si hapet norma?

Çfarë ndodh kur vepra e shpërthen normën?

Si e pret autentikja universalen?

Të gjitha kthehen në pyetje themelore, kur Mjedja lexohet në prerje të tilla.

II

Estetikat e *librit*, të mësuara e të provuara nga autorët e Shkodrës, në sprovën për historinë e letërsinë shqipe, Ernest Koliqi i *skajoi* në Shkollën letrare të Jezuitvet, kur estetikën e lidhi me tema e me stile të mësuara, pra të kulturës së shkruar. Vetë Koliqi Mjedjen e njihte si kreun e kësaj shkolle, të *skajuar*, më tej, si *rrymbë* të trashëgimisë parnasiste të formës së kërkuar e simboliste të kumbimit të vargut, të figurës e të kuptimeve të thella, të shenjuara si shenja të stilit. Në terma të tillë, Koliqi, vërtet, bënte tipologjinë e kësaj letërsie, përballë Shkollës letrare të Françeskajvet, të rritur në literaturën e në kulturën e vendit, me gjuhë e figura të vendit. Por, në provat që jep Koliqi, për të ilustruar tipologjinë e tij, vërehet se kapërcimet nga njëra shkollë te tjetra bëhen qoftë dhe tek autorë tipikë të njëres apo të tjetres, si dëshmi për diferencat relative.

Mësojmë se, teoria u kthye në *metodë* e *metoda* prodhoi *normën*, e cila, duke u përsëritur, u kthye në shkollë letrare. Kjo metodë u lidh në kërkim të formave letrare, të përpunuar gjatë e me durim, figura të zgjedhura, të kurorëzuara me stil të kërkuar e kuptime të thella, të

gjitha shenja të kulturës letrare të mësuar. Kështu, provën e madhe e dha kreu i shkollës, Mjedja, kur veprat i mbajti në tavolinë krejt jetën. Veprat e tij shenjohen me figurën tipike, stilin, si shenjë identifikimi, e veprën si rrjet kuptimesh që hapen e zgjerohen sa herë që kuptohen.

Në këtë nyjë, Mjedja autentik e sprovon poetikën në vepër konkrete, hapet vetë, për ta hapur atë, ndërsa poetika kryqëzon universaljet me veprën autoriale, sidomos në vepra personale e autobiografike që hapen si vepra krejt universale. Kjo e sprovon *normën*, për ta kthyer nga *mësimi* në *praktikë* e nga *praktika* në *autentikë* të identifikueshme me vepra konkrete, si mësim i ri e i vjetër se veprat shpërthejnë *normën* e kthehen në krijime estetike autentike, të matshme vetëm me veten e me autorin e tyre.

Kështu, vepra e Mjedjes kthehet vetë në *praktikë* që e shenjon *normë* dhe e provon fenomenin universal të letërsisë para mësimi e të mësimi si lexim i poezisë. Estetikat janë *kultura të mësuar*, ndërsa veprat - *praktika* të (pa)ngjashme, të rritura në kulturë e në sensibilitet, pra në jetën (letrare) të autorit. Këtu e kështu Mjedja shpërthen *normën*, për ta kthyer sërish në *metodë*, e gjen *formën*, si kurorë të estetikës e të veprës së tij. Prandaj, vepra e Mjedjes përfundimisht shenjohej si *formë* (krijuar) e jo si *normë* e përsëritur.

Në estetikën e tillë, *forma* provohet si esencë, burim e provë e së bukurës letrare dhe merr shenjat e vargut të matur, ritmit të rrjedhshëm, strofës së mbyllur në rrafshin metrik, edhe kur fraza shtrihet përtej saj, kur vargu nuk mjafton e as strofa s'e mban tërë emocionin apo kuptimin, përfundimisht në harmoninë e matjeve e të prerjeve. Kështu, shtyhem i në rrafsh të racionalitetit e të retorikës klasike të poezisë, të mësimi e të krijimit, të identifikueshme edhe me formën e krijuar ngadalë e me durim. Këtu shenjohej fenomeni e problemi i krijimit përballë mësimi. Sa mëson e si krijon Mjedja? Se është e njohur që *krijimet* jetojnë më gjatë se *mësimet*.

III

Vepra poetike e Mjedjes s'është e gjerë, por e thellë, me burim frymëzimet e rralla e punën e gjatë me tekstin. Një poet që pret e njeh frymëzimin, shenjon trashëgimi romantike, ndërsa një poet që shkruan në tavolinë, në mundin pa fund për format e bukura, është një poet i traditës klasike. Në këta cepa krijoi Mjedja, ndërsa vepra e tij rri aty ku kryqëzohen këto trashëgimi e shpërthen në *autentikë*. Në këtë kuptim, kujtojmë *Juvenilian* (1917) nën shenjë e frymëzimit e, në

cepin tjetër, *Scodrën*, vepër postume, të cilën Mjedja s'e kreu për së gjalli, por e ktheu në një vepër të përkryer, prandaj të kryer.

Mjedja projektoi katër vepra me objekt mitologjinë e historinë e qendrave kryesore të jetës shqiptare ndër shekuj, si një arkeologji nacionale, të kujtuar dhe të krijuar nga fillimi: *Scodra*, *Lissus*, *Durrhachium* e *Apollonia*, nga të cilat *Scodra*, me njëmbëdhjetë sonete, s'u krye, *Lissus*, me dymbëdhjetë, u shkrua e u botua, ndërsa dy të tjerat s'u shkruan kurrë. Sepse Mjedja priste frymëzimin? Bashkë me metodën e punës së gjatë para se vepra të botohej, në trajtën *limae labor* (Horaci), si një klasik. Poemthat *Lissus* e *Scodra* kanë trajtë poetike klasike, objekt identitar të rrënjëve të shqiptarëve, të lidhura në kulturën e rrallë letrare e ditunore të Mjedjes, të provuar me formën e përkryer.

Mjedja është autor klasik i shqipes, i provuar me gjuhën shqipe si zbulim e me trajtat klasike si estetikë e identitet letrar. Vepra e tij zbulon gjuhën si esencë, ashtu siç zbulon Fishta shpirtin shqiptar. Zbulesat e tyre dëshmojnë se, tek i pari gjuha krijon, e, tek i dyti, shqiptari zbulon vetveten, me të gjitha vetitë e kalesës. Mjedja u bë autori më i njohur i Shkollës letrare të Jezuitvet, sepse kaloi nga ajo në rrafshin e gjerë të letërsisë nacionale, si autor i madh shqiptar, ashtu siç Fishta, nga prijës i Shkollës së Françeskânëve, u bë Poet nacional, zbulues e përjetësues i *palcit ethnik* shqiptar (Koliqi), të lidhur në gjuhë, doke, kulturë e jetë autentike.

Duke skajuar më tej dyshen e madhe letrare shkodrane e shqiptare, Mjedja kërkon origjinën shqiptare në mitologji e në histori, ndërsa Fishta të ruajtur e të mbuluar në jetën e gjallë të shqiptarëve, mbyllur në Malësi. I pari në trajta klasike të *librit* (kulturës), i dyti me idiomën e në frazeologjinë idiomatike, si shenja të kulturës e të jetës së vendit dhe si shenjë se autentikja jepet vetëm me anë të shenjave autentike.

Shenjat autentike Mjedja i kërkoi e i krijoi te poemat *Lissus* (1928) e *Scodra* (1939), si vepra të përkryera në rrafsh sensibiliteti, trajte e në kuptime, të lidhura rreth idesë së trashëgimisë ilire të shqiptarëve e të rrënjëve tona në agim të qytetërimit. Në këto trajta e thur Mjedja *këngën imagjinare* të lavdit, me sensibilitet lirik e me argument epik, përballë *rrëfimeve të provës së Lahutës së Malcís* (1937) të Fishtës, me pamje të gjera, situata e *gjuhë mashkull*, të bëra *substancialitet* (Poradeci), pra jetë të kthyer në gjuhë.

Në letërsinë e Mjedjes, gjuha shqipe lidhet në vargun e sonetit, si provë se ajo përballon lartësinë e tij, kërkohet fjalë pas fjale e trajtë pas trajte, skalitet ngadalë e me durim dhe matet me argumente e përftesa të *librit* të madh të kulturës humane që hapet me mitologjinë e prehet me historinë, për t'u kthyer në kulturë. Kështu, Mjedja e

provon shqipen si gjuhë të *librit* e të kulturës, në trajtat më të vështira të krijimit letrar.

Trajtat e matura e të prera të soneteve të lidhura në *poemtha*, vargu 11-rrokësh, ritmi, kumbimi i poezisë së Mjedjes shenjojnë kulturën e mësuar, të provuar me figurën e trashëguar e të krijuar, me shenjat autentike që do t'i uiversalizojë forma.

Por, këtu ka një dramë. Si të shkruhen shpërthimet, kur forma pret? Mjedja klasik e provon vetë se forma është racionalitet i zgjedhur dhe se shpërthimet kthehen në krijime vetëm në trajtat e kulturës. Këtu mësojmë se autentikja e parë, pra sensibiliteti, përherë jeton dramën e takimit me tjetrin (traditë e trashëgimi), duke u endur si shpirt që do një trup apo si shpirt që do ta bëjë trupi.

Sonetet e Mjedjes janë vepra të menduara, tekstualisht e Semantikisht të përqendruar, dhe kapin frazën shqipe në lëvizje, në shtrirje e në prerje metrike, ndjekin ritmin e njohur të formës universale e lidhin kuptimet autentike të figurës e të frazës shqipe. Kështu, ngadalë soneti kthehet në formë të shqipes, jo vetëm si provë për gjuhën e për letërsinë shqipe, por si *vepër* e shqipes.

Lissus e *Scodra*, të lidhura në sensibilitet lirik, nuk kanë personazhe, por shenjojnë figura, nuk shtrihen në rrëfime, por kthehen në përftesa të lehta mësimesh, s'e thonë se e kanë me shqiptarin e kohës, por, kur kujtojnë rrënjët, shenjonë degët.

Në këtë format estetik, forma klasike kthehet në vepër për vete, me synim letrar e me shtrirje kulturore, jo për të normuar mësimin, por për të bërë evidencat e dëshmime të imagjinuara apo të provuara. Prandaj, Mjedja hapet e lexohet i ri edhe sot, sepse mësimet merren e vjetrohen, ndërsa shenjëmet trashëgohen e rinohen.

Scodra

IV

O Tarabosh, diftò smiren e hyjnive të Greqis qi lëshuene dergjë e rrenime mbi nipa të Posejdonit. Kulshedra shperthei prei ferrit, me zjerm e surbull e flakë lugatit.

*I E ti smiren diftò qi t'perzêmruemit
Hyjt e Elades germoi, e jasht' zakonit
Dergj' e rrenime grumbulluen e t'shuemit
E nipave caktuene t'Posejdonit.*

*5 Se kah fundi i peqinave t'Mallkuemit
Shperthei kulsheder neper gryk' t'nji stonit;
E si kokerr rrufejet, prei t'aguemit,
Frombos vetueses ju përqasi fronit.*

*9 T'krokodilit mbas giaset, i flakote
Me nji t'nyjeme gjelbrore e t'vérdh' gjith shtati,
E flak' e kuqe neper sy i vetote.*

*12 Krah i zjarrr' brî sjetullavet i delte,
E surfull terfullote e flak' lugati
Qi prei fushës per gjys' malin e shkelte.¹*

IV

Por, se si shfaqet Mjedja në veprën letrare, faqe pas faqeje, si i lidh sensibilitetet e figurat në tekst, si e kthen jetën në *bibliografi*, në qerthujt e *krijimit* durimtar të universaljeve, përtej normës së imitimit të situatave e të konkretësive, e zbulon në plotëni vepra e tij e kryer.

Juvenilia është vepra e plotë që botoi Mjedja për së gjalli, e mori e mori, e strukturuar tematikisht, me *krijime* e me *shqipërime*. Strukturimi i tillë nuk krijon sistem dhe vepra mbetet një album poetik, themelor për të kuptuar poetikën e Mjedjes, meqë aty janë bashkë veprat e kryera të tij nga fillimi e deri në vitin 1917 dhe dëshmojnë për metodën krijuese, të lidhur e të kurorëzuar në *bibliografi*. Kështu, duke përfshirë edhe shqipërimet, *Juvenilia* kthehet në vepër themelore që provon jetën krijuese të Mjedjes me të gjitha shenjat, si sensibilitet, metodë, tematikë, stil e, përfundimisht, si estetikë autentike.

Juvenilia ka edhe një shenjë strukturimi zhanror, meqë nis me poema, vijon me poezi e mbyllet me shqipërime. Insistimi i fortë i Mjedjes te format duket brenda teksteve të veçanta, meqë strukturimi i kësaj natyre lidh tekstet në një vend e nuk është shenjë për krijime sistemore poetike.

Sistematika e Mjedjes është sistematikë kërkimi e zgjedhjeje që përkthehet në punë me tekstin e që te Mjedja kthehet në metodë letrare, e cila lidh pazgjidhshëm sensibilitetin, e kulturën e mësuar, pra mendimin.

Kjo metodë, edhe temat e vendit i kthen në tema të kulturës e në vepra estetike që s'duan të artikulojnë si mësim, si përjetime të

¹ Ndre Mjedja, *Vepra I*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 151.

pangjashme, me rrënjë në ambient, por me kurorë (estetike) universale. Kjo e bëri Mjedjen poet të madh, pa qenë një Dichter.

Mjedja personal e autentik hapet te poemat autobiografike *Váji i bylbylit* e *I tretuni*, si hapje e vetes në letërsi, në përgjasime e në krijime nga fillimi, dhe këtu norma sprovohet thellë në dramën e artikulimit të autentikes në trajtë *individumi*.

Këto tekste hapin poetikën e zbulojnë *psike*-në e autorit, si dy faqe që shenjojnë poezinë. Në këtë pikë, sa më personal që bëhet teksti, aq më universale bëhet vepra, meqë autentikja, e identifikueshme me *psike*-në, është provë e universalitetit të natyrës humane.

Figurat e kërkuara të kulturës apo figurat e identifikueshme të ambientit shkrihen në diskursin personal të Mjedjes, kur ai flet për tjetrin si për veten e tij apo kur flet për veten krahas tjetrit, pra si për tjetrin. Në këtë raport, identifikimet janë totale dhe kthehen në shenjë identitare të veprës e të autorit, sidomos kur diskursi është personal e autobiografik e kur thuret në sensibilitet e në formën lirike. Këtu *norma* i nënshtrohet *sensibilitetit* e *ky formës*, si esencë e si ekzistencë e veprës. Figura e mësuar matet me figurën e trashëguar (ambient e gjuhë) e, së bashku, shkrihen në figurë të krijuar që është një shkallë e re e diskursit e shenjë e estetikës së veprës, në të cilën treten diferencat e kthehen në *njësi* estetike të identifikueshme me harmoninë, saktësinë e me matjet e prera. Kjo të çon te modeli retorik i tekstit të Mjedjes, për të shenjur edhe këtu e edhe kështu klasicitetin e tij, bazuar në harmoni e në përkryerje të formës. Kështu, poezia e Mjedjes s'është një mësim, por një rrjet shenjimesh letrare, kulturore e personale që hapen sot si dje, në dialogun e gjallë e të përhershëm të tekstit me kohët, si shenjë universaliteti që shfaq poezia.

Ndërsa, ambienti autentik hapet në shenjat e veta të para e të figuruara tek *Ándrra e jetës*, kryevepra e Mjedjes, e lidhur si kurorë e tri vjershave: *Trina*, *Zoga* e *Lokja*, dhe e provuar si vepër e kryer, në rendin klasicist, prandaj e përkryer. Në kryerjen e tillë, pra në përkryerjen e tillë, hapet drama e *normës*, e *formës* dhe e *autentikes*, me shenjat e pajtimit apo të refuzimit. Sepse *norma* është mësim, *forma* - kulturë e mësuar e *autentikja* - krijim, ndërsa vepra njeh të parën, zbulon të dytën (si diskurs) e jeton përherë në të tretën. Kështu, në një rend të përmbysur, figura e mësuar apo e gjetur kryqëzohet me *formën*, njeh *mësimin* e *normës* dhe kthehet në *figurë autentike*, gatuar me sensibilitetin e autorit dhe e praruar në kulturën e tij letrare. Figura e tillë e teksti i mbështjellë me sensibilitet e kthejnë racionalitetin e retorikën klasike në një shenjë të lakueshme në veprën konkrete, për të

provuar *autentiken* e krijimit si *universalitetin* më të thellë. Sepse, estetika (*norma*) mësohet, ndërsa estetikat (*poiesis-i*) krijohen.

Ândrra e jetës është vepra më e njohur e Mjedjes, ndoshta dhe më e keqkuptuara, kështu që i duhet *njohja*. Shpëtimi janë leximet autentike, pa projeksionet e *normës* apo të *ideologjisë*, të lidhura me zbulesat e me habinë e leximit të parë. Ndërsa, leximi i përsëritur s'është prej vetiu dhe leximi më i mirë, meqë përsëritja të kthen në fillim dhe aty i ke të gjitha gjasat, për t'u habitur nga fillimi apo për të keqkuptuar nga fillimi.

Në vjershat e në pjesët e *Ândrrës së jetës* hapet ambienti autentik i Gegnisë, me shenjat e jetës së gjallë, me gjuhën e vendit, më së shumti me *ândrrën e jetës* që përjetohet apo që projektohet. *Ândrra e jetës* është vepra e jetës, e figurës së zgjedhur të Mjedjes, por, paradoksalisht, dhe e mendimit të tij, të lidhur në prova ambientale e të universalizuar në imagjinime letrare.

Mjedja s'e rrëfen jetën, por e thur *ândrrën e jetës* së munguar, kështu që teksti i tij është një *projeksion* e jo një *mimesis*. Saga e tillë përqendrohet në esenca dhe kuptime të mbështjella në sensibilitet, ndërsa mësimi shenjohe pa marrë zë.

Trina shkon, Zoga ëndërron, Lokja tretet e vdes, në këto shenja lidhet *ândrra* e tretet jeta dhe ky është rendi që do leximi, sepse këtë e shenjon shkrimi. Kështu i afrohem i estetikës autentike të Mjedjes, pa stilitë e retorikës e pa mësimin e *normës*, gjithnjë duke ndjekur *sensibilitetin e formën*. Trina shkon pa zë, Zoga s'e thotë ëndrrën e kjo e rrit zjarminë, ndërsa Lokja thërret mortjen si shpëtimin. Kështu, saga është e plotë, e kryer, e praruar në shenja dëshmie e elegjie, e mbyllur në harkun universal të ekzistencës, me jetë, *ândrra* e vdekje.

Zoga

IV

E kândshme âsht hâna

Kûr del me zâna,

E n'tokë me dritë perndaret,

Hyjzit qi shndrisin

E qi shetisin

N'per qiell, janë t'bukur faret.

*Kúr del agimi,
E rruzullimi
Me 'j dritë kuqloshe mbëlohet,
E permbi kashta
Shndritë pika lashta,
Zêmra per máll gazmohet.*

*Âsht i madh shêndi
Kur ndihet shpêndi,
Nder pýje tui pingrue ;
E kënaqshme â 'j lule
Kúr ju perkule,
O fllad i lét, me e lmue.*

*Por s i giet qielli,
Nuk i giet prilli,
As fllad qi shetitë lulet
E me érna veshet,
Foshnjes qi i qeshet
Nanës, kúr mbî 'te perkulet.²*

V

Në estetikën e kërkuar e të (për)kryer të Mjedjes, figura kthehet në esencë të diskursit, si shenjë sensibiliteti, stili e mendimi, e në amzë idesh, meqë figura i prodhon idetë, se ajo s'është (vetëm) stoli, por amzë e kurorë esencash. Kështu, leximi i figurës së Mjedjes kthehet në lexim të tekstit, në rrafshin e estetikës e të semantikës, dhe shkrimin për Mjedjen e kthen në një *figuratikë*, metodë që bën bashkë metodën e krijimit, klasën e figurës e interpretimin e tekstit si interpretim i një rrjeti figurash.

Idiomi është shenjë autentike e vendit, kthyer në shenjë komunikimi e kulture, që në literaturë bëhet dhe shenjë estetike, madje shkolle letrare, si te françeskanët e Shkodrës. Vepra letrare përsërit (imiton) idiomën në frazeologji e në figurë, madje të parën e kthen në figurë. Mjedja ecën kahes tjetër, për t'i lidhur figurat në fraza të figurshme, të krijuara nga fillimi. Po, se Mjedja është kreu i Shkollës letrare të Jezuitvet, përfundimisht e *skajuar* me *poiesis*-in, përballë *mimesis*-it të autentikes së Shkollës së Françeskâjvet.

² D. Ndré Mjedja, *Juvenilia*, Shtyp. "Zoja e Paperlyeme", Shkodër, 1928, ff. 53-54.

Kjo do të thotë se figura e Mjedjes përherë është e kërkuar, pa struktura e figura të skemave idiomatike apo të formulave frazeologjike. Formula është strukturë (skemë) pa një kuptim, ndërsa frazeologjizmat - formula të kthyerë në porosi, e të mbushura kuptim, si retorikë që s'shenjohet me *krijimin*, por me *gjetjen* (*inventio*). Mjedja e lidhi tekstin në fraza, por ato s'u kthyen në formula frazeologjike, sepse nuk krijuan raport kauzal me frazeologjinë idiomatike.

Figura e kërkuar e Mjedjes është e bukur, një përcaktim që lidh estetikën me vlerësimin dhe e kthen atë në vlerë themelore. Kështu, figura kthehet në shenjë poetike e identitare, si shenjë autentike e veprës së Mjedjes. Ndërsa, vepra e tij e provon estetikën si shenjë identitare poetike që, kur lidhet me gjuhën e me kulturën, pra dhe me ambientin, kthehet në shenjë identitare të vendit, siç provohet më poshtë:

Ândrra e jetës

Trina I

*Molla t'kputuna një deget,
Dý qershija lidhë n'nji rrfanë,
Kû fillojnë kufit e Geget,
Rrijnë dý çika me një nanë.*

*Krekcë e bré perzie me lisa
Rriten rrotull me çetinë,
Plepa t'but' e qiparisa
Mbëlojnë e veshin at ledinë.*

*S ushton mali prei baktijet,
S fryn murrani me duhí;
Paq i kthílltë prei Perendijet,
Paq prei nierit e qetí.*

*Gurra e lugut veç ushtote
Si lahutë me kângë kreshnike;
E nder pëmë bylbyli këndote
Valle darsmet fisnike.*

*Ngreh, bylbyl, n'at hije valle,
Ushtë, gurrë trimneshë, n'shkâmbije;*

*Bùlk i nates, kungallë, qi talle
Neper gëmba e per lamije,*

*Këndoni këndonin veç prei stanit,
T' ardhmen Trina mbrámje n 'shpí,
Tui blegrue një kîj mbaj zânit
T'deles nanë keni me ndie.*

*Veç prei plehit gjel kokoti,
Me njat zâ qi s ndrron kurr-herë,
Ká m'u gjegjë se â tui ndërrue moti,
Se â tui çue një tjetrë érë.³*

Kur buron nga emocioni, kur kërkohet e mësohet, më së thelli kur krijohet, figura bëhet *shenjë* e autorit, ashtu që të lidhë estetikën e idetë dhe të marrë në vete shpërthimet e mendimin, të parat si shenjë autentike të emocionalitetit e të dytin si provë për tekstin e shkruar gjatë e me durim pafund. Ndërsa, kërkimi bëhet metodë krijuese e Mjedjes, përkryerja estetike - kurora e saj, vepra - trashëgimi për ne e për të tjerë.

Lissus

III

*Të falemi, o Lesh, i lum për sá Madhnija
Shperndau rreth tëje miradína e hire,
E përdorj me cenë kujdesi e dija
Të sá mjeshtrave lulzuen në ket tok' Ilire.*

*Me rruga të ndrejta hijeshue, me shpija
Të nëlta si sukat qi të shikjojnë me smirë;
Me ndertesa t'ushtrimeve kû fëmija
Vujshin, fatosat e një kohës mâ të vshtirë.*

*E kqyrshë sqelen qi Sirakuzani
Ndertoj, e në dritë të venituna ti njifshë
Fytyren tande me stoli të një mbreti.*

E lundra të hueja mbushë me rob qi bâni

³ Po aty, ff. 39-40.

*Fitues Ilirsi, e, porsì fjetun, shifshe
Ándrra fatosash, tui të perkundun deti.*⁴

Figura e Mjedjes, e gjenezës së emocionit, lidhet në diskurs personal, në një dëshmi të rrallë të jetës, të kthyer në *psikografi* poetike, ndërsa figura e shenjës autentike s'është fytyra mimetike e ambientit, por *përfytyra (gjasa)* e pamjeve tipike të tij. Në fund, e si kurorë, figura e krijuar kap të dy diskurset dhe shpërthen *normën*, hapet në *formë autentike* që ka gjenezë emocionin, jetën e kulturën e autorit përnjëherë. Te kjo figurë dominante shenjohen, maturohen e artikulohen idetë, lidhen në mendim e mbyllen si dëshmi letrare të jetës shqiptare dikur e sot.

Jo për ta mbyllur çështjen, por për ta hapur me provat e para, leximi do duhej të niste këtu, me figurat e Mjedjes, të përfytyruara e të krijuara nga fillimi, edhe kur duken krejt të mësuara nga fillimi, si figura të dhimbjes personale, si shenja të ambientit apo si shenjuese të ideve. Në fund e në fillim, si shenja autentike të veprës, të lidhura në kurorën mbretërore të saj.

⁴ Ndre Mjedja, *Vepra I*, f.131.

Mark MARKU

PËRFAQËSIMI I BOTËS SHQIPTARE NË VEPRËN E MJEDËS

Në korpusin e studimeve për poezinë e Mjedjes, *Vaji i Bylbylit* është marrë shpesh si çelës për analizën e marrëdhënies së poetit shqiptar me botën shqiptare dhe një qasje e tillë s'ka të sharë: poeti-bylbyl që këndon botën përmes vajit. Një poet i vetëdijesuar për aktin e krijimit si Mjedja ta imponon një gjë të tillë, madje ai qysh në poemën e parë të librit të tij të parë dhe të vetëm parasheh edhe marrëdhënien që lexuesi shqiptar do të ketë me botën shqiptare përmes poezisë së tij:

“E kur t’vin zhegu
Kur dielli shkon
Ti ke me këndue
Si ke zakon.
Rreth e rreth gjindja
Me t’ndie rri
Prej aso vendit
Dahen me zi”

Një qasje e tillë ndaj tekstit të Mjedjes, dhe për fat të mirë qasja ndaj poezisë së tij jo rrallë është tekstuale e jo kontekstuale, na jep instrumentat për të kuptuar marrëdhënien mes tekstit dhe kontekstit, mes poetit si krijues i tekstit dhe receptuesve të veprës së tij, mes kodit të veprës dhe kodeve kulturore lokale apo universale. Por ajo që ndoshta nuk është studiuar si duhet në veprën e Mjedjes është pikërisht kompleksiteti i përvojës estetike të veprës së Mjedjes. E thënë ndryshe, ende mbetet për t’u diskutuar enigma e veprës së Mjedjes, magjia e leximit të tij të pakohë, mënyra se si ajo sot e gjithë

ditën e bën lexuesin të ngrihet nga rangu i perceptimit të zakonshëm në perceptimin estetik, që e shtrirë në terma estetikë do të na çonte në dy drejtime:

- a. Në mënyrën se si poezia e Mjedjes e emancipon dhe e rafinon shijen e lexuesit të saj;
- b. Në mënyrën se si perceptimi estetik i veprës së Mjedjes e çon lexuesin drejt një perceptimi të reales, pra të botës përmes veprës së artit.

Para se të parshtrij këtu ndonjë ide për këtë marrëdhënie do të desha të sqaroj se përvoja vetjake e leximit të Mjedjes më sugjeron që ta shikoj veprën e Mjedjes jo thjesht si një tekst poetik që operon përmes fjalës dhe kuptimeve apo asociacioneve që bart ajo, por si një vepër arti që vepron njëherësh përmes fjalës, pamjes dhe tingullit, pra njëherësh si një tekst poetik, viziv, muzikor. Më herët studiues të tjerë e kanë shqyrtuar aftësinë asociative pamore apo tingullore të fjalës së Mjedjes. Sabri Hamiti në ftesën për rilexim që na bën përmes parathënies së botimit të veprës së plotë të Mjedjes në Prishtinë shquan qoftë “aftësinë e tij si portretist” qoftë aftësinë “që përmes portretimit të figurës së jashtme të portretohet emocioni njerëzor”

Duke iu rikthyer idesë së fillimit mendoj se Mjedja si asnjë poet apo artist tjetër në historinë e kulturës dhe të artit shqiptar arrin të ndërmjetësojë përmes tekstit të tij marrëdhënien e lexuesit shqiptar me botën shqiptare. Nga kontakti i lexuesit me poezinë e Mjedjes ngjet një reaksion i shumëfishtë që shkaktohet, që është në thelb një transfuzion perceptimesh, përvoja, përfaqësimesh të përvojës ku marrin pjesë njëherësh ndjesitë, kujtesa dhe imagjinata. Gadamer në librin e tij *E vërteta dhe metoda* thotë se “nuk ka përvojë pa përfaqësim dhe nuk ka përfaqësim pa shenja”¹ Pikërisht falë shenjës dhe organizimit të tyre në kode (gjuhë), një përvojë mund të jetë një përvojë e fituar për atë që e ka përjetuar edhe në rastin kur këtë përvojë nuk mund ta kemi si të tillë.

Duhet Mjedja pra që të lexohet bota shqiptare. “Njeriu i zakonshëm që lëviz mes “gjeneralitetesh dhe simbolesh”, - thotë Bergson, nuk e kap dot as individualitetin e gjërave dhe as të qenieve sa herë që ai është materialisht i padobishëm për t’u kapur”². Vetëm në një rast

¹ Gadamer, G. H. *Verite e Methode*, Ed. Du Seuil, f. 440

² Bergson, H. *Le rire*, Ed. PUF, f. 115

thotë Bergson “natyra e ka shkëputur perceptimin nga nevoja dhe ky është rasti i veprës së artit”³ por është pikërisht kjo shkëputje e perceptimit nga nevoja që përbën edhe dobinë e padobishme të veprës së artit.

Kjo dobi e veprës së artit do të shuhej vetëm nëse të gjithë do të ishim artistë. Mendoni - thotë Odile DyPont, sikur ne të ishim të gjithë artistë dhe artistë në të gjitha artet. Perceptim i gjerë, i thellë. Meqenëse të gjithë njerëzit nuk janë artistë, rrjedhimisht edhe shqiptarët, atëherë nevojitet artisti shqiptar. Dhe Mjedja është artisti par excellence shqiptar. Duhet ai, që njeriu shqiptar ta perceptojë ambientin e tij. Jetën dhe vdekjen, motin me të katër stinët. Duhet vargjet e Mjedjes për ta parë vjeshtën si prelud të dimrit, rritjen si prelud të plakjes, jetën si prelud të vdekjes dhe vdekjen si prelud të jetës.

“U shty vjeshta e krizantemi
Vetun vorreve lulezoi
Landët e pyje gjithë ku kemi
Tui fry veri po i cungon”

Perceptimi i zakonshëm i racës njerëzore është i privuar nga një perceptim i tillë. Është deficienca e perceptimit të zakonshëm të racës njerëzore që i jep sharm tekstit të Mjedjes. Perceptimi i artistit ia bën të mundur perceptimit të zakonshëm praninë e pamundur të botës. Sekreti i kuptimit të Mjedjes mendoj, qëndron më shumë në aftësinë perceptuese të tij ose më saktë në perceptim-përjetimin e tij se sa në kreativitetin apo në virtuozeitetin e vargut të tij.

Mënyra e tij e perceptimit të botës dhe e atribuimit të përmbajtjeve dikton formën e të shkruarit eliptik, të tekstit asociativ, të muzikalitetit të vargut. Ai është eliptik në mënyrë radikale, ndërkohë që si paraardhësit ashtu edhe bashkëkohësit e tij ishin narrativë, ai përdor simbolin dhe metaforën ndërkohë që paraardhësit dhe bashkëkohësit përdornin ende dhe kryesisht epitetin. “Kursimtar në fjalë, i saktë në figurë, mik i pashoq i kuptimeve të plota, Mjedja është poet që në poezi i do njësoj qartësinë dhe saktësinë e formulimit të filozofisë jetësore e artistike”⁴ Me pak figura si Bylbyli, Kafazi, Prendvera, ai shpreh vetminë vetjake dhe universale. *Andrra e jetës*, është një sagë e botës shqiptare, por jo vetëm e botës shqiptare, e jetës

³ Bergson, H. Po aty, f. 116.

⁴ S. Hamiti. Ndre Mjedja poet. Parathënie e botimit Mjedja, Vepra, Rilindja. Prishtinë, 1982.. F.XIV.

universale (Jeta, andrra e jetës, dhimbja e jetës, lindja, rritja, pleqëria). Eliptizmi i tij poetik është edhe një fakt editorial: botoi vetëm një libër, *Juvenilien*. Përveç poezive të këtij libri na kanë mbetur prej tij edhe pak poezi të tjera prej të cilave vetëm dy: *Liria* dhe *Lisus* janë në nivelin e poezive të *Juvenilies*. Ka një korrelacion mes librit që është një, jetës që është një dhe botës që është një.

Në këtë këndvështrim është me interes të shihet edhe mënyra se si Mjedja e shfaq unin poetik. Pozia e Mjedjes është lirike dhe si e tillë do duhej të ishte organizuar rreth un-it poetik. “Karakteristike për këtë lloj poezie - thotë kritiku anglez Nerys Williams, është artikulimi i ndjenjave dhe dëshirave të subjektit dhe ndarja e qartë mes subjektivitetit dhe artikulimit të tij”⁵. Në rastin e Mjedjes uni është i fshehur, aq i fshehur sa duket se nuk ekziston. Uni poetik zhduket nga skena për t’u shndërruar në përvojë gjuhe. Në këtë kuptim poezia e tij nuk duket si përjashtësim i së brendshmes siç ndodh me poezitë lirike ku uni lirik është qartësisht i vendosur në qendër të skenës. Këtu nuk flet uni, si subjekt i revoltuar që dëshiron të afishojë ekzistencën e tij në botë por, njeriu që është njësh me botën dhe që e rrëfen botën me ritmin e botës.

Kjo e bën të ndryshme poezinë e Mjedjes nga pjesa tjetër e lirikës shqipe. Nëse në pjesën tjetër të poezisë shqipe poeti është kryesisht zëri i vetes, ai tashmë synon të bëhet zë i botës. Ky ndryshim i rëndësishëm relacional sjell një ndryshim, po aq të rëndësishëm të tonalitetit të poezisë së tij, të ritmit, të sistemit figurativ, të gjithë poezisë së tij. Pozicionimi i tij autorial është diçka midis, diçka neutrale mes vetes dhe botës. Pikëperceptimi i tij të krijon përshtypjen sikur ai herë i ikën vetes dhe i afrohet botës e herë i ikën botës dhe i afrohet vetes. Në mes botës dhe vetes krijohet një gjendje poetike pezullie apo një fashë neutrale kohore e barazlanguar sa nga dita aq edhe nga nata.

Është qartësisht e dukshme prirja e Mjedjes për ta shprehur totalitetin e botës. Natyrisht një gjë e tillë ka qenë, është dhe do të mbetet ambicia e përgjeshme e poetëve. Lamartini i frymëzuar nga magjia e Napolit pati deklaruar se do të shkruante “një poemë të pamatë si natyra, interesante si zemra njerëzore, e lartë sa qielli”. Poema e Lamartinit mbeti tek kjo deklaratë pa mundur të realizohet kurrë. Malarme e pati gjithashtu një ambicie të tillë teksa ëndërronte

⁵ Nerys Williams, *Contemporary Poetry*, Edinburg Univeristy Press, Edinburg 2011, f.27.

një “libër që të ishte shprehje përsosur dhe e plotë e tërë universit” e po ashtu Hygoi me *Legjendën e Shekujve*, për të mos shkuar në fillimet e letërsisë botërore me Homerin, Hesiodin, apo Lukrecin. Por në ndryshim nga ambiciet e mëparshme ku natyrisht nuk duhen harruar edhe përpjekjet e autorëve shqiptarë si De Rada, Naim Frashëri e Gjergj Fishta, duket se Mjeda ndjek rrugën e kundërt: domethënë nuk i jep përmasa tekstit të tij artistik për të rrokur përmasat e botës, por kondenson universin gjë që i bën më pas të mundur përfaqësimin e tij nëpërmjet tekstit të kursyer të poezisë së tij. Ky zvogëlim bëhet duke nxjerrë thelbin e universit, jetës, botës shqiptare dhe duke e shndërruar më pas këtë thelb në gjuhë. Në njëfarë mënyre ai e rikrijon botën pasi e ka menduar atë.

Vjollca OSJA

POETIKA E MJEDJES NË MES POETIKAVE TË KODIFIKUARA DHE IDIOPOETIKËS

Në punimin “Një odë klasike e Mjedjes”¹, studiuesi K. Ashta, pasi i bën analizë të shtruar poezisë “Mikut tem P. Moreti”, na bën me dije, ndër të tjera, se te ky krijim gjejmë të aplikuara pesë cilësi të teknikës klasike, çka e bën, sipas tij, *të dalë në shesh klasicizmi i Mjedjes*. Ndër cilësitë e renditura si tipare të poetikës klasiciste ai fut *frymëzim, shprehje, ndjesi, fantazi, formë*. Por pyetja që na lind, pasi i kemi selitë disi tiparet e poetikave të njohura, është: A janë këto cilësi vetëm të një poetike? Ose më mirë, a janë *frymëzimi, ndjesia, fantazia* cilësi të poetikës klasiciste? (Romantikët, thonë jo!) Po *shprehja dhe forma*?! (Modernistët, që e ndërtojnë ndryshe konceptin e formës, thonë jo).

A del në shesh klasicizmi i Mjedjes me një poezi periferike, për sa i përket përftesës poetike, në raport me krijimet e tjera? Studiuesi duket se e gjen vetë rrugën për te përgjigja, kur, në punimin mbi poezinë “Vaji i Bylbylit”², pranon se Mjedja “...e provon romanticizmin e kohës”, si dhe e përthellon më tepër deklasifikimin, kur pohon se Mjeda, me ekzigjencat e tij për fjalën dhe për formën, i përkiste një lloji tjetër artisti, i cili “na njofton një trajtë të re arti”³. Ndaj poezia e tij nuk hyri brenda horizontit të pritjes së kohës, ndaj ishte “ma pak i kuptuem, përgjithsishe i shpjeguem ma fort prej atyne qi merren me letërsi”⁴ (duke sugjeruar kështu me termat e sotëm lexuesin semiotik ekojan). Që Mjedja, si autor diktues, provokoi që në krye të herës një

¹ Kolë Ashta, “Nji ode klasike e Mjedjes”, Kumbona e së diellës, v.V, nr.31, 1942, 378

² Kolë Ashta, “Vaji i Bylbylit”, Shkëndija, v. XX, nr.7-8, Tiranë 1942, fq. 274

³ Po aty

⁴ Kolë Ashta, Kumbona e së diellës, v.V, 1942, fq.371

“shkundje” letrare, në të gjitha rrafshet e mundshme, nga ai i modelit të ligjërimit, frymës dhe qëllimtarisë së tekstit, llojit të tematikës, zhvlerësimit të instrumenteve retorike në të mirë të procedimeve stilistike dhe deri të sugjerimit të modelit të lexuesit, duket nga vala ekscentrike e polemikave dhe debateve që ishin hapur në të përkohshmet letrare⁵, polemika të cilat shkonin deri te mohimi i cilësimit lirik të Mjedja dhe pranimi veç *si poet (me pikëpyetëse) epik* e me vlerë *minime të Juveniljes*. Çështja e përcaktimit të poetikës do të përbëjë një nga çështjet objekt të subjekteve shkruese për një periudhë të gjatë kohe. Kështu mendimin kritik për poetikën e Mjedjes, në varësi të konstantes së qëndrimit, mund ta klasifikojmë në tri pjesë:

A) Shohim se mendimet e studiuesve të para vitit 1945 (të zyrtarizuara apo jo), në shkrime të përcipta apo edhe në punime të thelluara do të konvergonin, përgjithësisht, në përcaktimin e poetikës së Mjedjes si klasike e neoklasike⁶. Argumenti mbështetës, përgjithësisht, do të lidhet me perfeksionin formal që shfaqet në poezi të tij, apo, në ndonjë rast, edhe me faktin se vinte nga shkolla të formimit klasik apo ndoqi kurse të letërsisë dhe retorikës klasike. Interesant, në këtë kuadër, na ngjan, qëndrimi i P. Gjeçit i cili në dy punimet mbi poezitë e Mjedjes duket se i shmanget qëllimshëm përcaktimit të metodës. Te punimi i botuar në Romë, “Kuahër letërsie shqiptare”⁷, do të formulonte idenë se Mjedja është poeti që nuk ra kurrë në *sentimentalizëm* e në *manierizëm* (si b.f. Çajupi e më shpesh *Prendushi*), *radhohet ndër të pakët qi ka dijt të mëshefi thellësinë e botës së vet nën perspektivën e kuartit të tejdukshmënin e sendeve*, duke sugjeruar kështu një anë tjetër të poetikës së Mjedjes, ikjen drejt impersonales, siç pat bërë dikur poeti anglez J. Keats.

⁵ Shkrimet e Gj. Karmës *Çashja e Mjedës- lirizma mjediane e bota letrare* tek nr. 8-9 i rev. Shkëndija, 1943 dhe N. Barcollës *Hekuran Lumi nën rrum të kumbonës* te Kumbona e së diellës, 1942, ofrojnë panoramën e polemikave që ishin hapur në qarqet letrare të kohës, në lidhje me receptimin e artit të Mjedës. Nikë Barcolla në sintetizimin që i bën kritikës së nisur te rev. Tomorri e 15 dhe 22 shkurtit të '42 të njëfarë Hekuran Lumit (pseudonim) nxjerr se në shkrimin e tij Mjedja pranohet *si poet (me pikëpyetse)*, *epik*; *Mjeda nuk asht poet lirik, dhe në kjoftë se asht nuk asht si duhet; vlera e Juveniljes asht minime*; *Mjedës mund t'i jepet njëfarë rëndësie jo për vlerën poetike, por për zellin që tregon në kërkim të fjalës dhe të krahasimeve*.

⁶ Nisur më fort prej përpikmërisë teknike të vargjeve e strofave, kritika e viteve 20-'30 konvergonte gati e tëra në pikëpamjen se poezia e Mjedës ishte *klasike(klasiciste, neoklasiciste)*, Ali Xhiku, “Letersia shqipe si polifoni”, Dituria, Tiranë, 2004, në footnote-sat, fq 121.

⁷ Pashko Gjeci, *Kuahër letërsie shqiptare*, XVI, “Aprile”, nr.1, Romë 1940, fq. 60

B) Një referencë tjetër metodologjike marrin studimet e Mjedjes pas vitit '45 (brenda kufijve zyrtarë). Nisur nga parimi se në një periudhë të caktuar një stil artistik konoton një ideologji dhe të orientuar më tepër nga prerje ideo-temore, do të ishte dominues mendimi se poetika e Mjedjes preku dy faza: atë të romantizmit dhe realizmit. Klasicizmi, që sipas parimit të mësipërm njësohej me ideologjinë reaksionare, nuk do të shihej më si prirje mbizotëruese në artin e Mjedjes. Kjo diktoi kundërshtitë që vihen re qartazi në punimet e kohës. Mund të ishte ilustrues shembulli i V. Balës (studiues i njohur i Mjedjes), i cili në diskutimin e bërë në nëntor të vitit 1953 do të ngulte këmbë që Mjedja kaloi nëpër fazën e klasikizmit, ndërsa në tekstin zyrtar të *Historisë së letërsisë shqipe*, pj. II, në zërin për Mjedjen, do t'i duhej të konkludonte se *Thelbin e përbëjnë veprat e romantizmit me elemente kritike realiste, "Juvenilja" dhe "Liria"*.⁸ Pra, kemi një heqje dorë, në mos një mohim të pohimit të mëparshëm.

C) Një nisje të re shënojnë studimet që kapërcejnë kufijtë zyrtarë të vendit. Koliqi na kujton se Mjedja diti "*të pajtojë në shkrim të vetin mënyrat e shprehjet stilistike ma moderne (asokohe çmohej shortja kumbore e lyrikës simbolike me përsosjen e ftofët, por skalitëse të vargut parnasian) me ekzigjencat e veshit shqiptar*".⁹ Gradilone do ta përcaktonte konstanten poetike të Mjedjes: *Një kërkesë purifikimi dhe kthjellimi që e transferon nga sferat e larta të artit në një vetëdije gjithnjë e më të gjallë stilistike*¹⁰. Duke e parë si mjeshtri i teknikës dhe njohësi i përkryer i metrit letrar që ka zotëruar sekretet e fjalës dhe të të gjitha figurave të shënuara nga stilistika antike dhe moderne¹¹, ai do të përfronte stilin e Mjedjes me shkollën poetike parnasiane e në veçanti me poetin e soneteve të përsosura Jose Maria de Heredia. Në këtë premje e shikojnë përgjithësisht studiuesit e Kosovës artin e Mjedjes. Kështu, R. Qosja¹² e hap spektrin e ndikimeve nga neoklasikja e romantikja te poetika parnasiste e simboliste. Një lloj afiniteti me poetikën e fundit (simboliste) duket se mbrojnë të tjerë studiues, kur e shikojnë simbolin¹³ si një nga

⁸ *Historia e Letërsisë Shqipe*, pjesa e II, zëri: *Ndre Mjeda*, Tiranë 1959, fq.393- 430

⁹ Ernest Koliqi. *Shejzat* (le pleiadi), Romë, Itali, nr. 1-2, 1962, fq. 194

¹⁰ G. Gradilone, *Studi di letteratura albanese, La poesia del Mjedja. Svolgimento e modelli letterari*, Romë, 1960, fq. 186

¹¹ *Andrra e Jetës* – sipas Gradilones – paraqet një situatë shpirtërore dhe artistike identike me atë të letërsisë perëndimore (Po aty, fq. 168)

¹² Rexhep Qosja, *Dialogje me shkrimtarë*, Prishtinë, 1979, fq. 124, 130, 131

¹³ Anton Berisha, *Simboli në poezinë e Mjedës*, "Bota e Re", Prishtinë 1985, nr. 9, fq. 16

elementet kryesore të formacionit stilistik të poezisë. K. Shala duke iu referuar shkollës jezuite si *rezultat të përbashkimit të diskursit/ poetikës parnasiste me diskursin/poetikën simboliste*¹⁴, e nënkupton pozicionin e Mjedjes, ndërsa Hamiti, në projektin *Shkollat letrare shqipe*¹⁵, e identifikon poetikën e Mjedjes te shkolla kritike si *shkollë e cila përcaktohet nga përsosja e gjuhës poetike dhe vargimit e forcimi i kulturës letrare të shkrimit*.

Nuk besojmë të ketë në letërsinë tonë një autor të dytë që t'i jetë konsumuar kaq shumë çështja e metodës, madje, jo rrallë, edhe në kurriz të vetë veprës. Sidoqoftë, mospërcaktimi i artit të Mjedjes si pjesë e një poetike të vetme e të njohur (formula e tipizimit të artit të tij: *ai është ..., por është edhe ...*), lidhet më së shumti me natyrën e krijesit të saj, për rrjedhojë, me vetë veprën. Poetika e Mjedjes, nëse do të flisnim me gjuhën e Ekos, *në një farë kuptimi () është një depo shumë e madhe zgjedhjesh të kodifikuara apo edhe jo të kodifikuara*¹⁶. Ai projektoi brenda poetikës së tij edhe ato kode që tradita e poetikave të njohura nuk i katalogonte, pasi konsideroheshin thyerje të konvencave të pranura, duke sugjeruar kështu modelin e një martese të veçantë poetikash, si dhe duke materializuar një sintezë të re ndërmjet të kodifikuara dhe idiopoetikës. *Vaji i bylbylit, Mustafa Pasha në Babunë dhe Andrra e Jetës* përbëhen nga një seri shkeljesh të konvencioneve letrare, të cilat e drejtojnë vëmendjen tonë te forma me të cilën organizohet materiali poetik. Nëse do të perifrazonim Shklovskij-n, vetëdija e formës përbën çështjen subjekt të poemave të mësipërme të Mjedjes. Krijimet që botoi te “Juvenilja” dhe ato çka vetëdijshëm la jashtë saj, provojnë intencën e autorit për një estetikë të poezisë së pastër. Procedimet me fjalën: nga gjurmimi te pastrimi i fjalës/ tekstit poetik nga amplifikimet oratorike dhe retorike (procede i njohur, gati redundant, i romantizmit shqiptar të kohës), përpunimi i mekanizmave gjuhësorë brenda vargut dhe strofës të dëshmuara *në variantet e shumta e ripunimet e shpeshta që u bënë poezive të veçanta*, shënojnë këtë intencë. “Si dihet rruga e artit Mjedjan, *thotë Camaj*, qe shumë e gjatë dhe e qindrueshme në limimin e landës e të gjuhës, e sidomos të gjuhës ...”¹⁷. Në poetikën e tij Mjedja mënjanon,

¹⁴ Kujtim Shala, *Expo, letërsia shqipe në katër pamje*, “Buzuku” Prishtinë, 2007, fq.50

¹⁵ Sabri Hamiti, “Faik Konica” Prishtinë, 2004, fq.16

¹⁶ Umberto Eko, *Struktura e papranishme*, Pejë, 1996, fq. 94

¹⁷ Martin Camaj, *Libra të lexuem, Ndre Mjedja; Juvenilja e vepra të tjera*, në Shejzat, v. IX, nr. 1-2, Romë, 1965, fq.68

pothuaj, tërësisht parimin e dekorumit në të mirë të lirshmërisë së strukturës, përmbajtjes dhe fjalës.

Me Mjedjen, siç edhe është konstatuar, fillon thyerja e modeleve në poezinë shqipe. E këtu mendojmë të prekim vetëm disa pika, nga ata që ne mendojmë se veçansojnë poetikën e tij. Kështu, ia vlen të përmendim:

1. Në rrafshin e ligjërimit, poezia (arti) e Mjedjes sugjeron vlerën që zotëron fjala poetike apo përftesa poetike¹⁸, nëse flasim me termat e vetë Mjedjes, vlerë e cila e çon në shtigje të reja përzgjedh-jesh stilistike. Një tip i ri shprehjesh metaforike është evident në poezinë e tij. Meraku për të gjetur fjalë më përshkënditëse (një kërkesë, sipas Koliqit, edhe e shkollës jezuite ku përfshihet Mjedja), të cilat në mënyrë zinxhiore sugjerojnë dhe diktojnë praninë dhe organizimin e fjalëve të tjera, te Mjedja është më e fortë sesa prirja për të *përkthyer një mendim në vargje apo të ndreqë një protokoll të moçëm*. (që, sipas R. Barthes-it, qarkojnë funksionin e poetik klasik.) Për ilustrim mund të shërbenin njësi të tilla: *Kreckë e brë përzie me lisa/rriten rrotull me çetinë*;¹⁹ *E djerr â toka:kreut nder livadhe/ shkon kau e avllin që del prej arve/ erton e nepet për stinë të madhe/ përreth kularve*²⁰. *E /u kënaqshin hyjit që tinëzisht veshtoshin/ ndër heshtime t'pamatuna t'ethirit*;(Scodra, I); *e surfull turfullonte e flak' lugati...*; Në këto shembuj vërehet një kërkesë tjetër e Mjedjes, në raport me vlerën muzikale të fjalës, duke e vlerësuar si një dimension tjetër të gjuhës poetike, jo më pak të rëndësishëm se dimensionin sintaktik dhe atë semantik.

2. Ndër zgjedhjet stilistike të Mjedjes është elipsa, përkundër perifrazës që gjallonte, pothuaj, te të gjithë autorët e Rilindjes²¹. Po

¹⁸ *Natyra e poezisë*, eseja e Mjedjes *Permbi Poezi Përgjithsisht*, te Ndre Mjedja, vep let.2, Tiranë, 1988

¹⁹ Ndrë Mjedja, *Juvenilia*, shtyp. “Zoja e paperlyeme” në Shkodrë, 1928, fq. 39

²⁰ Po aty fq.76

²¹ Mjafton të krahasojmë se si shprehet, nëpërmjet vargjeve te Mjedja dhe te Naimi, malli dhe ngazëllimi për vendlindjen. Mjedja realizon në dy vargje atë atmosferë për të cilën Naimi i duhen më shumë se tetë. Nga poezia “Malli për atdhë” i Mjedjes: “Njatjë kúr mëndja lëshon ndo’j here vrapin/ shëndi I pertrihet” dhe nga “Bagëti e bujqësi” e Naimit: “Mëndje, merr fushat e malet, jashtë, jashtë nga qyteti/ nga brenga, nga thashethemet, nga rrëmuja nga rrëmeti./ Tek këndon thëllëza me gaz edhe zogu me dëshirë,/e qyqeja duke qeshur, bilbili me ëmbëlsirë,/ tek hapetë trëndafil, atje ma ka ënda të jem, /bashkë me shpest’ edhe unë t’ia thërres këngës e t’ia them; të shoh kedhërit e shqerrat, deshtë, cjeptë, dhëntë, dhitë,/qiellin e zbukuruar, dhenë me lul’ e me dritë.”

kështu, për të, është identifikues përdorimi i shpeshtë i hiperbatës. Hiperbata e tij nuk është ajo e thjeshta, klasikja, e zhvendosjes së një gjymtyre morfologjike ndaj një tjetre, por ajo e ndërlikuara, e lëvizjes së një njësie të tërë sintaktike ndaj një tjetre me funksion ngritjen e një atmosfere, jo thjesht mëshimin e një ideje. (*E luftojnë rreptas: nën breshën plumbit/ që karajfilet lëshojn' e bershënat./Turren, o shqype, si rrjedha e lumit/ Trimat si zanat.*) Kështu, Mjedja, zgjedh të kombinojë një sintaksë, që është krejt e dallueshme nga tipat e inversioneve sintaktike të kulturave klasike (me bazë greko-latine), me një fjalor që është tërësisht personal, idiolektal.

3. Përdorimi i dendur i procedesë së mbartjes²², e cila shprish përputhjen e njësisë poetike varg me njësinë gramatikale sintaksë. Funksionet e mbartjes diktojnë çlirimin e marrëdhënieve të mendimit me rregullin (kapërcimi i cakut të vargut a strofës), po kështu edhe në çlirimin e ritmit nga lineariteti i kallëpeve metrike. *Mjedja është mjeshtër i rrallë i bartjeve, të cilat, na thotë mendja, ai i futi me kaq forcë në poezinë tonë*²³, do të cilësonte studiuesi Zheji, duke e parë këtë teknikë të Mjedjes të diktuar edhe te Migjeni.

4. Në formë, sonetet ruajnë strukturën e modelit italian, ndërsa në frymë, sidomos *Scodra* dhe *Lissus*, karakterizohen nga prania e tipareve të tekstit epik (distanca narrative, koha e foljeve, deri te figura tipike e kësaj gjinie hipotipoza - te *Scodra*) dhe një mungesë e dukshme e lirizmit.

5. Modelet strofike dhe metrike, brenda strukturës së një poeme, lëvizin në varësi të ritmit logjik dhe intensitetit të trajtimit të landës. Gradacioni emocional përkëmben gradacionin metrik dhe strofik. Zgjidhet polistrofa/ polimetri përkundër izostrofës dhe izometrit.

²² Këtë teknikë të mbartjes te Mjedja e kemi në tri shfaqje: 1. Mendimi shtrihet në dy a më shumë vargje; 2. nga një strofë kalon në gjysmën e vargut të strofës që e pason dhe 3. nga një strofë kalon në strofat e tjera. (Si ilustruese, mund të shërbente kjo pjesë nga “Andra e Jetës”:

*Rreze, flak'arit. Por rrotull fëtyra /
E fushës kish ndrrue; kish ndrruemun zyra /
E bimës e e pemve; përmbi balkue /
Deri kish ndrrue*

*Erë filzigeni; po i vite j tjetër
Erë: makthit; e rruga e vjetër
Nen shpi, ...)*

²³ Gjergj Zheji, *Vëzhgime metrike*, “Rilindja”, Prishtinë 1981, fq.117

6. Është rasti të pohohet se Mjeda lëvroi mbi 400 e ca skema rimike (sipas studimit “Rimari i Mjedjes”²⁴ të lënë në dorëshkrim të K. Ashtës), një pjesë e të cilave janë ikje nga skema klasike e harmonisë vertikale, duke pamundësuar përpjekjen tonë për t’u veshur teksteve formatet e njohura të rimave klasike. Mjedja shpesh bën kombinime të tilla midis vargut me rimë dhe atij të bardhë, duke krijuar, në saje të figurave tingullore, iluzionin e parë se e gjithë strofa ka rimë të rregullt, kur në fakt vetëm dy vargje mund të rimojnë, si te Mahmud Pasha apo te Andrra e Jetës (Trina) apo, si kjo nga Vaji i Bylbyli: *E tui gjimue/ shkon rreth e rreth/ një prrue që veret/ rrjeth neper gjeth.*

Sado e sido ta vazhdonim qëmtimin e ligjërimit të Mjedjes, një gjë është për të mos u anashkaluar: eleganca dhe thellësia me të cilën Mjedja shënoi ndarjen e epokave letrare në letërsinë tonë.

²⁴ Kolë Ashta, *Rimari i Mjedës*, Arkivi Institutit të Gjuhësisë dhe letërsisë, dosja 54, nr inventari 273

Femi ÇAKOLLI

PSALMIMI NË POEZINË E NDRE MJEDËS

Forma psalmore: tematika dhe karakteri

Në historinë e letërsisë shqipe teksti biblik, ose njohur ndryshe edhe si tema, motivi dhe kodi biblik fillimisht ka hyrë si domosdo fetare, e pastaj imponueshëm si teksti me status sakraliteti, por gradualisht ai fillon që të marrë forma, prirje, kultivim e ndikime të reja deri sot herë si tekst i angazhuar eklesiastik, herë si referencë kulturore a historike, herë si palimpsest, herë me evidenca vetëm mikrostrukturale e herë-herë për funksione tjera çmitizuese e letrare. Dom Ndre Mjedja, siç dihet është formuar si personalitet me dije neoskolastike jo vetëm duke e pasur në zotërim Shkrimin e Shenjtë por edhe shumë dije e përvoja që ndërlidheshin me të, sidomos tek poezia e tij na sjell një përvojë të re duke manualizuar specifikisht strukturën dhe formën psalmike. Përvijime të këtilla shembullore në letërsinë tonë kemi ta zëmë me *Gjahun* e Kristoforidhit, *Lahutën* e Fishtës dhe *Oh-un* e Pashkut.

Psalmi është himni, vjersha, recitimi, didaktika, lirika, celebrimi, hyjnizimi, poema, vajtimi, lutja, galdimi, dhe kënga në tekstin sakral biblik, qoftë judaik e talmudik, qoftë kristian e kishtar dhe qoftë artistik e autorial si prototipe, jo vetëm në jetën glorifikuese, mistifikuese e përdëlluese shpirtërore me karakter universal, por dhe në tekstin letrar me kontekst nacional si një derivim hipertekstual ashtu si e gjejmë në përgjithësi në letërsinë shqiptare në cilindo prej periudhave të saj, e i kultivuar nga autorët më të mëdhenj të letërsisë sonë, duke e përfshirë këtu edhe poetin, shkrimtarin dhe priftin shkodran Ndre Mjedja. Fjala *psalm*, nga greqisht *psalmoi*, do të thotë fjalë që e shoqërojnë muzikën me harpë, dhe prej këtu është ndërtuar kuptimi *lutjet e kënduara*.

Forma letrare qoftë e poezisë ose e prozës, në përgjithësi, në veprën e Mjedjes kur trajtohet dhe zhvillohet sipas këtij arketipi letrar psalmor, këtu po e shënojmë si psalmim, me domethënien: e mënyrës së psalmit, e formës së psalmit, e strukturës së psalmit, e shkrimit psalmues, pse jo edhe psalmia shqipe apo psalmiada shqiptare e karakterit mjedjan përbën objektin tonë studimor.

Pra, psalmimi është mënyra, standardi, metoda, elementet dhe teknikat e bërjes së asaj lloj lirike që përkon me psalmin si modus në disa lloj dimensionesh sikurse struktura, poetika, forma, fryma, mesazhi, stilistika etj. Psalmimi në veprën e Mjedjes merret kryekëput me marrëdhëniet tekstore formale dhe strukturale.

Pluraliteti psalmik dhe normativiteti

Psalmi si lirikë universale paraqet njërin nga problemet më të mëdha poetike dhe teorike në letërsinë botërore në këto 3000 vjetët e fundit, pasi ai përkufizohet diçka mes imitimit dhe frymëzimit, përkatësisht krijimit dhe narrativës biblike si art, histori e teologji. Simbolikisht, por edhe praktikisht, njëra nga çështjet që shtrohet këtu është përkatësia e autorit, me “A” (të madhe – Autori, e që nënkupton Zotin) apo me “a” (të vogël – autori, ose autorët). Psalmi praktikisht është një lloj letërsie me sistem në vete. Psalmi shkruhet prej kohës së Davidit, shek. XI para Krishtit, e deri në shek. V para Krishtit, pra për një gjysmë milenium, kjo na dëshmon se kemi të bëjmë me një formacion letrar dhe jo thjesht me një libër. Autorët e psalmeve janë të shumtë sikurse Mojsiu (Ps. 90) në të vërtetë është një mvëshje autoriale, Solomoni (Ps. 72, 127), bijtë e Koreut (Ps. 84, 85, 87 etj.), Asafi (Ps. 73-83 etj.), Ethanit (Ps. 89), Hemani (88), Shigaioni¹ (Ps. 7) kurse psalmet tjera janë shkruar nga Davidi dhe autorë të tjerë anonimë (Ps. 104-107, 111-126 etj.). Disa psalme janë shkruar për momente, raste e rrethana të caktuara si p.sh. vrasja e birit të Davidit, përurimi i shtëpisë së Davidit, ikja e tij nga mbreti Saul, këngë pas një fitoreje, psalm kur Davidi kishte mëkatuar me Betshebën, psalmet e shtegtimit etj. Disa psalme janë përcaktuar madje se çfarë janë si zhanre, disa se si duhet të këndohen, e disa madje edhe me çfarë veglash muzikore duhet të përcillen: me flaut (Ps. 5), me instrumente me tela (Ps. 4, 6, 55, 61, 67, 76), me gitea (Ps. 8, 81), me harpë (Ps.

¹ Nuk është e sigurt nëse ky emër prezanton një person që mund të ishte ndihmës i Davidit apo ishte një vegël muzikore, pasi Bibla evidenton se Davidi kishte shpikur 200 vegla muzikore, duke përfshirë edhe kitarën.

12), me zë soprano (Ps. 46) kurse për psalmet tjera nuk është përcaktuar se si të këndoheshin. Së bashku këto çështje formësojnë një pikëpamje teorike, kritike dhe teologjike se deri në çfarë shkalle a niveli mund të aplikohen principet se sa psalmet kanë sakralitet dhe profanitet, krijim dhe imitim, normativitet dhe diskripcion, universalitet dhe partikularitet, parimitet dhe alegoritet. Këto në fakt do të ishin edhe termat, kategoritë dhe objektivat letrare që duhen hetuar për një studim më të gjerë edhe në veprën e Mjedjes, pa u kufizuar vetëm me kërkimin “Psalmimi në poezinë e Mjedjes”.

Psalmet në gjuhën shqipe

Në letërsinë shqipe ndoshta nuk mund të gjesh ndonjë libër tjetër që të ketë pasur rreth 100 botime e ribotime dhe mbi 30 përkthime brenda pesë shekujve sikurse Libri i Psalmeve. I pari që e nisi me dorë të mbarë ishte Gjon Buzuku që më 1555. Ai përktheu 28 psalme² nga libri i pestë i psalmeve e që kanë të bëjnë me himne lavdërimi dhe lutje. Është e habitshme se pse Buzuku dy herë e përktheu psalmin 130³, madje as përkthimi nuk është njësoj. Pjetër Bogdani i përktheu 11 psalme, jo të plota. Pas tij këtë veprimtari e vazhduan Gregori i Durrësit (përkthimi humbi), Theodhor Haxhifilipi (përkthimi u fsheh diku dhe kurrë nuk u botua), K. Kristoforidhi (u përkthye dhe shtyp me ndihmën e shoqatës protestante “Shoqëria Biblike Britanike dhe e Huaj”), Xh. N. Serreqi, Naim Frashëri, Gjerasim Qiriazhi, Zef Serembe (i humbi dorëshkrimet në det), Fan Noli, Athanas Sina (misteriozisht edhe ky përkthim humbi), Simon Filipaj (e përktheu Biblën në gegnisht e pastaj punëtorët e Institutit Albanologjik të Prishtinës e përshtaten në shqipen standarde), Steven Etches⁴ dhe shumë përkthyes të tjerë bashkëkohorë. Pse psalmet janë

² Em. Psalmi; psalmat; gjin. e psalmeve, të psalme, të psalmet, psalme; kallëz. psalma; psalterion / psaltirion– vegël muzikore me korda; *këtu sosen të shtatë Psalmat të Peendesëvet; për këta të këndoum të këtyne psalme; ndë psalma e ndë himna* (Thoma Qendro, Fjalor i Shqipes së Gjon Buzukut, Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë, 2013, fq. 354). Ky fjalor përmban mbi 4000 fjalë që janë nxjerrë nga Meshari.

³ Psalmet gegërisht dhe toskërisht, Konstandin Kristoforidhi, SHBNSH, Tiranë, 2015, fq. 8 (parathënia Xhevat Lloshi)

⁴ Stiven Etches është anglez dhe ka jetuar një kohë të gjatë në Vjenë duke punuar për misionin European Christian Mission. Pasi që Shqipëria ishte e mbyllur dhe ateiste ky mision i kishte dhënë detyrë këtij burri që ta përkthente tërë Biblën në gjuhën shqipe, dhe këtë punë e nisi në fund të viteve ’70-ta kurse punën e mbaroi

kaq të pranishme në literaturën shqipe kur dihet se përkthimi i tyre është më i komplikuar se proza e Biblës? Sigurisht, sepse është lirika e Biblës⁵; sepse është kënga, muzika, vegla e Biblës dhe e kishës e po ashtu edhe për komunikim dhe spiritualitet. Listova këtu gjithë këta përkthyes të psalmeve për të prezantuar një problem të padiskutuar deri tani për psalmet në shqip. Buzuku dhe Simon Filipaj⁶ kanë provuar që të bëjnë atë që thuajse nuk bëhet. Këta lirikën dhe teknikën psalmore si vjershëri e kanë konvertuar në lirikë dhe teknikë europiane të vjershërimit. Diku-diku edhe Kristoforidhi merret me këtë qasje andaj për këtë pati debate e fërkime me Gjerasim Qiriazin i cili hetonte se lirizimi evropian i psalmeve (ose lirizimi grek, i tipit *septuagininik* ose atij romak të tipit *vulgatit*) po mërgonte kuptimin origjinal, ose kuptimin e synuar të autorit. Mendoj se këto eksperiencia i ka paramenduar ose i ka njohur Mjedja, dhe si autor, për të cilin thuhet se ai i ka thurë vargjet e tij me limë, prandaj po me këtë ndorje⁷ ai qëllimisht ose përshkak të brymosjes së tij fetare, shpirtërore, kulturore e intelektuale nga ajo që Kuteli e quan *magjia e lashtë* në vjershat e tij e pasoi bukur në shumë raste anën formale dhe strukturale të psalmeve. Me këtë po them se Mjedja duke shmangur përmbajtjen e Psalmeve në poezinë e tij, dhe duke u marrë vetëm me strukturën dhe anën formale dëshmoi urtësi e përvojë si autor dhe krijues.

Poetika psalmore

Deri në shek. IV pas Krishtit, në Europë poezia nuk kishte rimë, ashtu sikurse as psalmet edhe pse poezi nuk kanë fare rimë, së këndejmi bazuar në këtë fakt lidhur me poezinë botërore mund të njohim poezinë jorimuese dhe poezia rimuese. Kështu ne kemi

diku për dhjetë vjet ndërsa botimi i parë i plotë doli në vitin 1993. Ky përkthim është shumë i veçantë sepse ka një përkthim dinamik, perifrazik dhe jokishtar, pastaj ndjek kanonin hebre dhe jo grek të renditjeve dhe gjinive të librave. Steven Etches është i vetmi autor i huaj që ka përkthyer tërë Biblën shqip.

⁵ Më shumë për këtë shih burimin: Femi Cakolli, Hiperteksti biblik në letërsinë e Kosovës, Tenda, Prishtinë, 2006 (fq.37-50).

⁶ Në shqip janë vetëm këta dy autorë katolikë që kanë përkthyer pjesë të Biblës, përkatësisht tërë Biblën, në krahasim me të tjerët që janë të gjithë protestantë. Dallimet e këtyre përkthimeve janë të shumta por dy janë kryesoret: katolikët ndjekin kanonin e Biblës katolike e që ka 73 libra, kurse protestantët ndjekin kanonin e Biblës protestante me 66 libra; përkthyesit katolikë bazohen në tekstin latinisht të Nova Vulgata, kurse përkthyesit protestantë bazohen në tekstin *masoretik* hebraik të Dhiatës së Vjetër dhe në tekstin greqisht *koine* të Dhiatës së Re.

⁷ Ndorje: fjalë shqipe në kuptimin visare, depozitë, mjeshtërim

përballë poezinë jorimuese biblike të Davidit dhe poezinë rimuese artistike të Mjedjes. A është tërë një kontrast, bashkërendim apo asimilim? Psalmet në kuadër të Shkrimit të Shenjtë hyjnë në grupin e librave poetike së bashku me librin e Jobit, Fjalët e urta, Kënga e këngëve dhe Predikuesi. Këta libra janë shkruar në vargje por kur përkthehen zakonisht përshtaten në prozë por tashmë përmendëm rastin e Buzukut dhe Simon Filipaj, që janë përpjekur për modelim në vargje. Kjo metodë ka sjellë disa vështirësi. E para, lirika e psalmeve si poezi hebreje pothuajse me asnjë element metrik, silabik, stilistik nuk përkon me lirikën greke apo europiane. E dyta, lirimzi hebraik tek psalmet shprehet përmes përsëritjes, ritmit dhe paralelizmit⁸ kryesisht sintetik, kurse vjersha e Mjedjes paraprakisht është tingëllimë edhe pse e gjejmë shpesh tipin e apostrofuar përsëritor por edhe tipin e paralelizmit sinonimik dhe antitetik. E treta, poetët biblikë psalmorë kanë zgjedhur më përpara intensifikimin strukturor sesa të bëjnë një psalm të gjatë. A thua pse është zgjedhur kjo mënyrë formale te librat poetikë të Biblës? Jo për tjetër sesa për shkak të karakterit didaktik të psalmeve, prandaj shumica prej tyre janë të shkurtra në mënyrë që të mësoheshin përmendsh, prandaj kështu e shoh edhe funksionin e poezisë së Mjedjes. Didaktizmit psalmor i ka ndihmuar edhe ritmi ideor ose i mendimeve, diku i njohur edhe si ritmi semantik, prandaj shumë prej psalmeve kanë vetëm nga 22 vargje, si rezultat me numrin shkronjave të alfabetit hebraik. Rrjedhimisht këto psalme janë shkruar me anë të një stil akrostik.

Ritmi i mendimeve tek psalmet dhe Mjedja

Tekstit të Biblës i ka ndodhur që fillimisht të jetë në prozë dhe shumë më vonë të ketë edhe tekst lirik, por si ka ndodhur kjo? Lirizimin e prozës biblike e kanë sjell strukturat paralele biblike. Pra, këto struktura paralele e sollën tekstin prej prozës kah lirika përmes paralelizmit të kuptimit.⁹

⁸ Më shumë për problemin e përsëritjes dhe paralelizmit shih tek: Femi Cakolli, Hiperteksti biblik në letërsinë e Kosovës, Tenda, Prishtinë, 2006 (fq.59-68)

⁹ Robert Alter, *The Art of Biblical Poetry*, Basic Books, Inc. Publishers, New York, USA, 1985, fq.7. Shënim për këtë autor: Ky studiues hebre është shumë i njohur si profesor i letërsisë hebreje dhe komperative në Universitetin e Kalifornisë, dhe veprat e tij më të njohura janë: *Motives for fictions, The Art of Biblical Narrative, Fielding and the Nature of the Novel, After the Tradition, Defenses of the Imagination*.

Të shohim fillimisht psalmin e parë, rreshtin e parë për të ilustruar këtë teori dhe për të shijuar dhe kuptuar formën e lirikës psalmore:

Lum njeriu që nuk ecën sipas këshillës së të **pabesëve**,
Që nuk ndalet në rrugën e **mëkatarëve**,
Dhe nuk ulet bashkë me **tallësit**!¹⁰

Elokuencat: nuk ecën, nuk ndalet, nuk ulet kanë të njëjtin kuptim dhe janë përsëritje, kurse emërzimet: **të pabesëve**, **mëkatarët**, **tallësit** po ashtu kanë të njëjtin kuptim, por janë paralelizma. Këtu ka përsëritje, që zakonisht janë foljet ose veprimet dhe ka paralelizma e që zakonisht janë emrat, mbiemrat, përemrat etj., gjithmonë në funksionin e poezisë hebreje, përkatësisht këtu na del në sipërfaqe argumenti ose të menduarit ciklik lindor për dallim prej të menduarit linear perëndimor. Pra duke u manifestuar përsëritja dhe paralelizmi në poezinë të lindjes, ose në këtë rast lirikën biblike, përfitohet ritmi i mendimeve ose i ideve, “daullja”, dhe kjo është rregulla themelore si dallohet dhe si diferencohet poezia biblike nga proza biblike. Të ekzaminojmë tani poezinë e Mjedjes nën këto dy kategori psalmimi apo këtë që quhet ritmi i ideve.

Këtu kemi dy strofa të vjershës **Vorri i Skanderbegut**:

Diq i Madhi: askund **n’ushtri**
Se shef ma jo kurr mizori
Rrebtë si paras s shndrit, **Shqipni**
Njajo shpatë qi sa herë xori
Frikë e mnerë kurrkund s na mbeti
Qysh se ne na u rrxue **qyteti**
E gjith **fisin** e rrënoji.

Ritmi i mendimeve ose ideve për vdekjen e Skënderbeut nyjëtohet përmes këtyre përsëritjeve sintetike: diq, se shef, rrxue, rrënoje. Po ashtu i vëreni edhe përsëritjet e tipit sinonimik e që këtu kanë edhe funksionin e paralelizmave: **ushtri**, **Shqipni**, **qyteti**, **fisi**. Kjo skemë formale përsëritet edhe më shumë në strofën e dytë:

¹⁰ Biblia e Studimit, Shoqëria Biblike Shqiptare, Tiranë, 2009 (përkthimi Diodati), fq. 658

Diq: vorfnisht n'njat vorr à mbëlue
Pa lumni ma i madhi **luftari**;
Fisi jonë me te u rrenue
 Me të diq për luftë **Shqiptari**,
 Bashkë n'at vorr à mbëlue **Shqipnija**
 Deri sa ta thrراسi **mnija**
 Me e tha dorën qi e turpnoi¹¹.

Përsëritjet sintetike foljore janë: diq, vorr, à mbëlue, pa lumni, u rrenue, turpnoi, kurse paralelizmat me funksion të përsëritjeve antitetike janë: **fisi**, **shqiptari**, **Shqipnija**, **mnija**.

Në këtë vjershë ja si e gjejmë ritmin e mendimeve ose ideve të paralelizmit:

varri i Skënderbeut – varri i Krishtit;

lufta heroike e Skënderbeut – lufta heroike e Davidit.

Numracioni po ashtu bëhet edhe mesazhi se si përforcohet ideja biblike. Strofata në këtë vjershë kanë nga shtatë vargje, e jashtëzakonshme kjo jo vetëm tek poezia e Mjedjes por në përgjithësi në letërsinë shqipe. Numri shtatë përfaqëson ditët e javës, ditët e krijimit, ditët e rrëfimit, dhe po ashtu biblikisht ky numër është edhe numri i shenjtë i Perëndisë. Poeti ka lidhur strofat shtatëvargëshe rregullisht me anë të rimimit të shenjë së fundit në varg me sistemin dy nga dy. Pra:

E gjith **fisin** e rrënoi / Me e tha dorën qi e turpnoi.

Ose strofa 3 me strofën 4:

Merrshin hovin për at vend. / Tym e flakë lypshin me shend.

Lidhja e strofave dy e dy simbolizon dërgimin e dy e dy dishepujve prej Krishtit në mision. Vjersha ka 70 vargje, dhe normal që Mjedja ishte qëllimor në këtë numër duke identifikuar 70 dishepujt e Krishtit kur i dërgoi për dëshmin. Cili është interpretimi skematik, mesazhi, porosia e poetit rilindës e ndërtuar mbi këtë model biblik: varri i Skënderbeut është i shenjtë, gjithë ata që e duan Skënderbeun duhet të jenë të lidhur e bashkuar dhe të ndjehen sikur të dërguar ose misionarë që të dëshmojnë për të në mënyrë që Shqipëria të përtërihet. Me anë të glorifikimit psalmor njësoj është shkruar edhe poezia **Gjuha shqipe** etj.

¹¹ Ndre Mjedja, Andrra e jetës – vjersha dhe poema, Naim Frashëri, Tiranë, 1953 (përgatiti Mark Ndoja), fq. 93

Tek vjersha **Vaji i bylbylit** forma psalmore është shumë prezente me anë të përsëritjes dhe paralelizmit po ashtu. Tek pjesa e katërt, e që ka 13 strofa katërvargëshe vlen të përmendet vetëm vargu i fundit e që është i njëjtë tek gjithë këto strofa:

*Fillo me gëzue*¹²

Forma të këtilla nëpër psalme ka kudo por më tipiku është Ps. 136 ku pjesa *dhe mirësia e tij vazhdon përjetë* përsëritet plot 26 herë, pra dyfish më shumë sesa rasti i Mjedjes *fillo me gëzue* që si shprehje në fakt na kujton Letrën e Filipianëve, kap.4:4 e që thuhet:

*Gëzohuni gjithnjë në Zotin; po jua them përsëri: Gëzohuni*¹³.

Aplikim të ngjashëm kemi edhe tek vjershat **Dimni** (*struku struku i shkreti plak*), **I tretuni** (*o lejlek, o shpend i shkretë*) **Zoga** (e kandshme asht hana / kur del me zana), **Mustafë Pasha** (trimat si zana), **Malli për atdhe** (rrij tuj gjimue) etj.

Një tip tjetër i psalmimit në poezinë e Mjedjes është kur ai përsërit një strofë ose edhe dy strofa, një apo më shumë herë, sikurse rasti në vjershën **Vaji i bylbylit**, pjesa e parë. Ky lloj ritmi i mendimeve është përsëritje refrenale:

Po shkrihet bora,
Dimni po shkon
Bylbyl i vorfën
Pse po gjimon¹⁴

A çilë kafazi
Bylbyl, fluturo
Ndër pyje e ograja
Bylbyl, shpejto.

Në këtë përsëritje refrenale sistemi mjedjan sëndërtohet edhe më tej duke aplikuar përsëritjen sintetike e grupit A: fushët, blerimi, livadhi, lulzoi; dhe të grupit B: dhe **malet e pema**. Refrenia tek psalmet quhet *selah*, dhe është vetëm e regjistrit vokal, pra kur këndohej psalmi dhe nuk kishte regjistër skriptal. Fjala *selah* nuk është e qartë saktësisht se çfarë do të thotë edhe pse përmendet 73 herë tek psalmet dhe 3 herë tjera tek libri i Habakukut, por besohet se kuptimi i saj është *të lavdërosh, lavde të ngritura, përsëritje ose refren, pauzë etj.* Ky është teksti i psalmit nr. 3:

¹ *O Zot, sa të shumtë janë armiqtë e mi! Shumë ngrihen kundër meje.*

¹² Ndre Mjedja, Andrra e jetës – vjersha dhe poema, Naim Frashëri, Tiranë, 1953 (përgatiti Mark Ndoja), fq. 48-50

¹³ Bibla e Studimit, Shoqëria Biblike Shqiptare, Tiranë, 2009 (përkthimi Diodati), fq.1364

¹⁴ Ndre Mjedja, Andrra e jetës – vjersha dhe poema, Naim Frashëri, Tiranë, 1953 (përgatiti Mark Ndoja), fq. 39-41

² *Shumë thonë për mua: "Nuk ka shpëtim për të pranë Perëndisë".*
(Sela)

³ *Por ti, o Zot, je një mburoje rreth meje; ti je lavdia ime dhe ai më lartoi kokën.*

⁴ *Me zërin tim i thirra Zotit dhe ai më'u përgjigj nga mali i tij i shenjtë.*
(Sela)

⁵ *Unë rashë e fjeta; pastaj u zgjova, sepse Zoti më përkrah.*

⁶ *Unë do të kem frikë nga mizëri njerëzish që kanë fushuar rreth e qark kundër meje.*

⁷ *Çohu, o Zot, më shpëto, o Perëndia im; sepse ti i ke goditur tërë armiqtë e mi në nofull; u ke thyer dhëmbët të pabesëve.*

⁸ *Shpëtimi i përket Zotit, bekimi yt qoftë mbi popullin tënd. (Sela)*¹⁵

Nëse dom Ndre Mjedja, si një psaltës specifik, ka zbuluar çështjen e refrenit nga psalmet, ose cilido tjetër poet, dhe nëse vjersha shqipe, përkatësisht kënga shqipe ka marrë nga psalmet refrenin si teknikë atëherë ne po flasim në të vërtetë për një ndikim ekzemplariteti të padëshmuar deri tani. Na bën sigurisht përshtypje se në këngët e kreshnikëve përsëritja e të gjitha tipave si dhe paralelizmi janë shumë të pranishme por jo edhe refreni, dhe për mua kjo do të thotë se kënga tek shqiptarët nuk ka ardhur nga lindja, por ata kanë kënduar vetë. Dhe teoria e dytë vërteton se këngët e kreshnikëve ose janë para psalmeve, përkatësisht para kohës kur kanë filluar që të këndoheshin psalmet me anë të selah-ve, pra të refreneve, ose atyre u është ndërprerë dikur procesi lirizues.

Përfundimisht mendoj se nuk ka cilësim më të mirë për tërë veprën e Mjedjes sesa kur ajo shihet si poezia psalmike shqipe duke i mishëruar në strukturën dhe formën e saj tri elementet bazë të poetikës biblike psalmore: përsërtjen, paralelizmin dhe ritmin e mendimeve.

¹⁵ Bibla e Studimit, Shoqëria Biblike Shqiptare, Tiranë, 2009 (përkthimi Diodati), fq. 658

LITERATURA

1. Bibla (Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re), Shoqëria Biblike, Tiranë, 1993 (përkthimi Steven Etches)
2. Bibla (Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re), Drita, Ferizaj, 1994 (përkthimi dom Simon Filipaj)
3. Bibla e Studimit, Shoqëria Biblike Shqiptare, Tiranë, 2009 (përkthimi Diodati)
4. Derek Kinder, Tyndale Old Testament Commentaries Psalms I:1-72; II-73-150, Inter-Varsity Press Leicester, England Downers Grove, Illinois, USA, 1973
5. Gjon Buzuku, Meshari, Rilindja, Prishtinë, 1987 (vëllimi I,II), (hyrja nga Eqrem Cabej)
6. Femi Cakolli, Hiperteksti biblik në letërsinë e Kosovës, Tenda, Prishtinë, 2006
7. Femi Cakolli, Kodi biblik në letërsinë shqiptare, Tenda, Prishtinë, 2003
8. James L. Kugel, The Idea of Biblical Poetry Parallelism and it's History, The Johns Hopkins University Press, Baltimore and London, edition of 1998
9. Jeff Reed, Interpretimi i Fjalës I – parime dhe procedura, BILD International & Tenda, Ames – Prishtinë, 2015
10. Michael Wilcock, The message of Psalms I:1-72; II-73-150, Inter-Varsity Press Leicester, England Downers Grove, Illinois, USA, 2001 (reprinted)
11. Ndre Mjedja, Andrra e jetës – vjersha dhe poema, Naim Frashëri, Tiranë, 1953 (përgatiti Mark Ndoja)
12. Ndre Mjedja, Vepra 1-4, Rilindja, Prishtinë, 1982 (përgatiti Sabri Hamiti)
13. Northrop Fraj, Anatomia e kritikës, Rilindja, Prishtinë, 1990
14. Psalmet gegërisht dhe toskërisht, Konstandin Kristoforidhi, SHBNSH, Tiranë, 2015 (parathënia Xhevat Lloshi)
15. Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi III, Rilindja, Prishtinë, 1990 (botimi i dytë).
16. Robert Alter, The Art of Biblical Narrative, Basic Books, Inc., Publishers, New Work, 1981
17. Sabri Hamiti, Vetëdija letrare, Rilindja, Prishtinë, 1990
18. Thoma Qendro, Fjalor i Shqipes së Gjon Buzukut, Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë, 2013
19. Thoma Qendro, Të Shkrumitë Shenjtë, Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë, 2010

Edlira MACAJ

SHKOLLA JEZUITE DHE VENDI I MJEDJES NË TË

Abstrakt

Qëllimi dhe objekti: *Shkolla jezuite dhe Mjedja në të* kërkon më së pari disa qartësime lidhur me misionin e së parës dhe interesin e të dytit për të përcaktuar dinamikën e bashkëpunimit profesional, raportin formal e njerëzor mes tyre dhe më pas diskutimin mbi shkollën jezuite në raport me letërsinë. Kjo qasje lidhet domosdoshmërisht me gjetjen e përgjigjeve të pyetjeve kërkimore: Si modelohet Mjedja në këtë shkollë? A është shkolla jezuite një shkollë letrare, pasi identifikimi i saj si e tillë implikon gjithnjë referencë kryesore, Mjedjen.

Metoda: Diskutimi mbi dinamikën e bashkëpunimit të poetit me jezuitët në raportin e luhatshëm mes tyre si edhe tezat e rimarra pro dhe kundra shkollës jezuite-si shkollë letrare do të shqyrtohen përmes analizës vlerësuese si edhe kërkimit, gjykimit, interpretimit në shtratin teorik me qëllim stabilizimin e tyre. Kjo metodologji zgjidhet për të saktësuar rolin e jezuitëve në krijimin e një shkolle të rëndësishme për studimin e disiplinave të ndryshme (retorika, filozofia, muzika, etj.) në nivel krahasues me atë europian, ndikimin e këtyre disiplinave tek vetëdija krijuese e poetit dhe së dyti për ta kuptuar shkollën drejt në raport me konceptin e shkollës letrare.

Përfundime: Kërkimi ndihmon në kuptimin e rolit të Mjedjes si promovues i vlerave të shkollës jezuite dhe kthyes i këtyre vlerave mësimore në parime artistike, në një poetikë autoriale. Nga ana tjetër përpjekja për ta konsideruar shkollën jezuite si shkollë letrare në bazë të kritereve teorike nuk përligjet. Identifikimi i saj me Mjedjen shtron çështje të tjera për diskutim.

Fjalë çelës: Mjedja, Shkolla jezuite, jezuitët, shkolla letrare, poetika.

1. SHKOLLA JEZUITE DHE MJEDJA – DINAMIKA E BASHKËPUNIT

Jezuitët të cilët në vitin 1859 hapën Kolegjin Papnore Shqiptare e në 1877-ën Kolegjin Saverjan, erdhën në Shqipëri me misionin e **mbrojtjes dhe të përhapjes së katolicizmit**, e më vonë shtuan qëllime të tjera edukative dhe kulturore, tërësisht në një linjë apolitike.¹ Si qendër fetare instituti jezuit pati ndikim pozitiv falë rolit që luajti **elementi katolik**² në Shqipëri jo vetëm në këtë periudhë, por duke nisur edhe më herët, e jo vetëm në Shkodër, edhe pse kryesisht, por edhe përtej saj, deri në Kosovë. Kjo vijimësi e elementit katolik me rol pozitiv në kulturën shqiptare evidentohet edhe në botimet e kohës, ku ndër kontribues të përcaktuar spikat edhe Mjedja.³ Shkolla **si qendër edukative** me lëndë për fenë, filozofinë, artin e kulturën hodhi themele kulturore dhe shkencore në nivel të krahasueshëm me atë europian.⁴ Fusha arsimore njohu mjeshtrat: At Anton Xanoni, Matí Logoreci; u shquan poetët: Mjedja, L. Gurakuqi; kritiku Konica etj. Aty u përveçuan individë të cilët më pas trokitën fort në kulturën shqiptare të kohës duke sjellë vlera të reja, ndër ta edhe Ndre Mjedja i cili studioi në Shqipëri dhe jashtë saj (Francë, Spanjë, Kroaci, Itali, Poloni etj.) për rreth 20 vjet. Pas rikthimit në atdhe ai bashkëpunoi me ta në revistën *Leka* dhe ligjëroi lëndë të ndryshme në kolegji.

¹ Fulvio Cordignano. *Kush janë jezuitët?* Shkodër: Shtypshkronja, Zoja e Papërlyeme, 1933, f. 49 *Malcori e din fort mirë, mbas një përvoje të gjatë, se misjonari jezuit nuk përzihet në kurrfarë partije politike, prandaj nuk i siellet kurr për çashtje të tilla*

² Marin Sirdani. *Kontributi i elementit katolik shqiptar në lamë t'atdhetaris që prej kohve të vjetra deri në kohën e turqve të ri*, në rev. *Hylli i dritës*, vjeti IX, korrik gusht, Shkodër, Shtyp. Franceskane, 1933, nr.7-8, f. 328-351, f. 350. Sirdani na lë të kuptojmë se kleri katolik është një faktor i rëndësishëm i historisë së kulturës shqipe, duke nisur që nga vitet e hershme të futjes së besimit katolik në Shqipëri. Ai mjaftohet të citojë burime historike që datojnë që nga viti 344 në Amantia deri në vitin 1933. Sipas Sirdanit përmes fakteve dhe shtjellimeve argumentuese historike e eseistike veçohet roli sidomos i disa figurave të njohura duke i dhënë rëndësi të madhe kulturës, e në veçanti edhe gjuhës shqipe.

³ Po aty, f. 350. Sipas M. Sirdanit shihet specifikisht roli dhe vlerat që sollën figura të veçanta të dala prej tyre: *Ndër ma të mbarmët për kohë, por ma të gjallët për ndiesi komtare njifen P. Gjergj Fishta, Don Ndre Mjedja, P. Vincenc Prennushi, e P. Shtjefën Gjeçovi, të cilët me vepra të veta i dhanë një shkas të madh lavrimit të gjuhës shqipe, e trajtuen një numër të madh të pionerve t'indipendencës kombtare.*

⁴ Zef Valentini. *Kontributi i misionarëve italianë në zhvillimin e kulturës shqiptare në: Shejzat*, vjeti XIV, nr. 10, Romë, 1970, f. 316-326

Marrëdhënia që ndërtoi Mjedja me jezuitët ishte e “ndryshueshme” e parë si mundësi për ngritje profesionale, por kuptuar edhe si kushtëzim formal lidhur me institucionin. Bashkëpunimi apo moskuptimi mes tyre në interpretimet e rastit nuk saktësohet, por paragjykohet, njëanësohet, deformohet. Sipas R. Idrizit jezuitët **nuk e lanë Mjedën për shumë kohë në një vend**.⁵ Zheji shpjegon se **Mjeda u hoq nga urdhri i jezuitëve**, e flet për ekzagjerime, por nuk sqaron se cilat janë këto ekzagjerime duke gjykuar ideologjikisht jezuitët.⁶ Dalja nga ky urdhër nuk mund të shihet si kundërshti, por si kufizues në disa momente jetësore të poetit. Për sa kohë Mjedja është larg Shqipërisë është i zënë me studime. Sa më afër vjen ai drejt Shqipërisë, aq më me problematike bëhet marrëdhënia e tij me jezuitët. Dëshmi të ndryshme të lidhura me figurën e tij dhe raportin me jezuitët e pasqyrojnë edhe bashkëkohës së tij që nënvizojnë karakterin e pavarur të poetit dhe pabindshmërinë e tij ndaj tyre⁷. Ky konstatim lidhet me qëndrimin e I. Zamputit kur flet për autonominë vetiake të poetit, (në veshje, liri-dalje) pa u bërë pjesëtar efektiv i këtij urdhri, pra me disa përjashtime nga rregullat strikte të jezuitëve⁸; Quku thekson krenarinë dhe tradicionalitetin⁹ në qëndrimin e tij mbi vlerësimin e këtij raporti, ndërsa R. Elsie për këtë raport flet për përfshirjen e Mjedjes në një konflikt.¹⁰ Pjesa e qartësisë lidhet me diferencimet e qëndrimeve të deklaruara prej tyre rreth çështjeve të caktuara që lidhen me: **Çështjen**

⁵ Ndre Mjedja. Tiranë, 8 nëntori, 1980, f. 18 ...E tillë ishte taktika e tyre. Ata kërkonin te formonin tek ai një kozmopolit të ftohtë si vetë jeta e tyre

⁶ Mentor Quku. *Mjeda 4: Identitet*, Tiranë, Ilar, 2009, f. 313 ...por pa tjetër jo për shkak se botëkuptimi i tij ishte në kundërshtim me atë të jezuitëve të tjerë; këtu duhen kërkuar shkaqe të tjera. Mbase Mjeda që mbeti i ndershëm e konsequent në idetë e veta gjatë tërë jetës, nuk ka duruar dot mënyrën shekullore të **veprimeve dinake të jezuitëve** që “ekzagjeronin” e mbase mund të kenë ndodhur rivalitete të brendshme të urdhrit që s’kanë të bëjnë fare me sferën e botëkuptimit.

⁷ Mentor Quku. *Mjeda 7*. Tiranë, Ilar, 2005, f. 81 ...Donte me kenë i lirë, prandaj edhe u prish me jezuitët.

⁸ Injac Zamputi, *Kujtime për Dom Ndre Mjedjen* në rev.: Hylli i dritës, nr 2 (269), Shkodër, 2011, f.123

⁹ Mentor Quku. *Mjeda 7*. Tiranë, Ilar, 2005, f. 170 Jezuitët shquheshin për disiplinë të fortë e përkundër tyre vë Mjedën si malësor të lirë, i lidhur me familjen, krenar për atdheun. Jezuitët brumosin kuptimin e qytetarit botëror e Mjeda shfaqet si një shqiptar tradicional.

¹⁰ Robert Elsie, *Histori e letësisë shqiptare*, Pejë, Dukagjini, 2001, f. 261 më 1898, në gjirin e jezuitëve të Krajlevicës shpërtheu një konflikt, me sa duket për lidhjet e tyre me Austro-Hungarinë dhe me Vatikanin. Hollësitë e skandalit nuk dihen me saktësi, por **Mjeda u përfshi në njëfarësoj në këtë konflikt** dhe menjëherë u përjashtua apo dha dorëheqjen atë vit nga urdhri jezuit.

e alfabetit, karakterin, aktivitetin e poetit. Mjedja shpeshherë kishte qëndrime të pavarura, besnik ndaj të cilave qëndronte deri në fund, siç ishte këmbëngulja për alfabetin e tij. Tipare karakteriale të poetit dhe domosdoshmëria për të patur liri veprimi, sipas bashkëkohësve të tij ia kushtëzonin edhe më raportin me jezuitët.¹¹ Edhe I. Zamputi¹² e pohon natyrën impulsive të Mjedjes. Karakterin e tij të vështirë, impulsiv e zemërak e pohojnë bashkëkohësit e tij në shumë raste.¹³ Për këtë aspekt nuk duhet dyshuar pasi të gjithë bashkëkohësit e njohin atë pothuaj në të njëjtën mënyrë, gjë që do të thotë se kjo vështirësi e zotërimit të emocioneve prej tij ishte pjesë e vetë karakterit të tij rrëmbyes, zemërak, tipike e një poeti. Jezuitët karakterizoheshin nga një diskrecion i theksuar, por sjellje të përfolura të poetit janë diskutuar mes fretërve. Bëhet fjalë për seancat ezoterike që konsideroheshin aktivitet në kundërshtim me rregullat e urdhrit jezuit, të cilat i përmend edhe Quku¹⁴, e për të cilat Mjedja tregonte interes dhe thuhej se merrte pjesë rregullisht. Nga ana tjetër diskrecioni i jezuitëve mbi këtë temë bëhet edhe më dyshues. Në këtë dinamikë marrëdhëniesh formale dhe njerëzore Mjedja arrin të kryejë një sërë funksionesh zyrtare dhe të bëjë letërsi përgjatë një jetë të tërë. Në kontekstin e një shkolle fetare Mjedja e kryen më së miri edhe rolin e tij ndihmues me krijimin e veprave fetare dhe përkthimeve të kësaj natyre. Falë jezuitëve Mjedja përfiton **edukim dhe formim shkencor**, pasi që nga origjina e saj pedagogjia injaciane ka qenë eklektike në zgjedhjen e metodave të mësimdhënies e të përvetësimit.¹⁵ Në këtë kuptim Mjedja ka fatin të studiojë si i barabartë me çdo student të kohës së tij në kolegjet jezuite. Disiplina studimore si retorika, filozofia, teologjia, linguistika etj. e përgatisin Mjedjen intelektualisht me një vetëdije

¹¹ Mentor Quku, *Mjeda 7: bashkëkohësit*, Tiranë, Ilar, 2007, f. 159 Jezuitët e kanë trajtue mirë. Mirëpo ai binte shpesh në kundërshtim me ta. E, kur binte në kundërshtim, nuk pyeste a ishte rektori, a i pari i jezuitëve..., **ka dashtë me kenë i lirë**.

¹² Injac Zamputi, *Kujtime për Dom Ndre Mjedjen* në rev.: *Hylli i dritës*, nr 2 (269), Shkodër, 2011, f. 123

¹³ Zef Mirdita. *Dom Ndre Mjedja*. Me rastin e 140 vjetorit të lindjes, në: *Urtia*, nr 2 (20), Shkup-Prizren, 2006, f. 435 *Shpesh konsiderohej si njeri kokëfortë me një karakter jo fort të përshtatshëm për jetën rregulltare në bashkësi*.

¹⁴ Mentor Quku, *Mjeda 3*, libri 2: *Liria*, Tiranë, Ilar, 2008, f. 579

¹⁵ *Vetë Injaci ka përshtatur "modus parisiensis", metodën pedagogjike të përdorur në kohët e tij në universitetin e Parisit, duke e integruar atë me shumë parime metodologjike që kishte fituar nga Ushtrimet Shpirtërore zhvilluar paraprakisht në Jezuitët e shekullit të XVI, shkëputur nga: Pedagogjia Injaciane, hyrje në praktikë, Shkodër, shk. Pjetër Meshkalla, 1996, f. 5*

estetike krijuese. Falë kësaj aftësie të mishëruar në tërë poetikën e tij ai bëhet një nga figurat më të spikatura të kësaj shkolle, aq sa me të, shpeshherë, ose përmes tij ligjërohet ekzistenca e shkollës jezuite si shkollë letrare, e ai përfaqësues i saj.

2. SHKOLLA JEZUITE, SHKOLLË LETRARE?!

Mjedja shërben si referencë kryesore për identifikimin e shkollës jezuite si shkollë letrare. Me Ernest Koliqin i cili e përdor për herë të parë termin e shkollës letrare për të identifikuar dy shkollat shkodrane jezuitët dhe franceskanët, mendim që ndikoi edhe të tjerë pas tij, fillon edhe kurthi terminologjik. Ndër të parët që përdorën për jezuitët dhe franceskanët termin shkollë letrare qenë F.Cordignano dhe A. Arapi.¹⁶ Mbi shkollën franceskane kanë folur A. Harapi, Cordignano, Resuli, F. Fishta, S. Mann, G. Schiro etj. R. Elsie përdor termin institucione shkollore katolike franceskane e jezuite të Shkodrës.¹⁷ E. Çabej i vuri të dyja tek qarku katolik i shqipërisë veriore, duke u njohur kështu si qark i veçuar kombëtar.¹⁸ Z. Pllumi i përcaktoi si shkolla letrare e klerit katolik. S. Hamiti pranon termin shkollë kritike. Ai e sheh Mjedjen tek shkolla kritike që mishëron disa tipare si: stil individual, përsosje e gjuhës poetike, formim i madh kulturor e letrar i autorëve, gjykim kritik etj.¹⁹ M. Marku identifikon

¹⁶ Kastriot Marku, *Shkolla letrare françeskane e Shkodrës*, Hylli i dritës, Vjeti XXXI (Tetor-Nandor-Dhjetor 2012, Nr. 4 (271), f. 4, 41, 43, 46, 56.

¹⁷ Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare: Poetë të periudhës kalimtare: A.Z, Çajupi, Ndre Mjeda dhe Asdreni, Pejë, DUKAGJINI, 2001, f. 256*

¹⁸ Eqrem Çabej. *Studime gjuhësore*. Prishtinë, Rilindja, 1975, f. 135. Qarqet sipas tij, vijnë si pasqyrë letrare ku shihen fuqitë dalluese të historisë shqiptare dhe derdhen në letërsinë e shek. XIX-të secili me elementët e tyre të veçantë; Kjo e bën procesin letrar si konvergim të trajtave të ndryshme, në të cilin komponentja fisore e regjionale dhe komponentja fetare me gjithë jetën kulturore sociale përkatëse japin rezultatën nacionale.

¹⁹ Sabri Hamiti, *Poetika shqipe*. Tiranë, “55”, 2010, f. 149, citojmë: *nis të shfaqet diversiteti i stileve individuale e i ligjërimeve. Përsoset gjuha poetike dhe vargërimi, forcohet kultura letrare e shkrimit. Sado ruhen ende tematikat nacionale, edhe brenda vetë autorëve forcohen tendencat kah temat sociale, duke u bërë më kritike. Dalin në skenën letrare autorë me formim të madh kulturor e letrar, duke njohur veçanërisht traditat letrare të Perëndimit. Ndonëse ka ende autorë që donë ta kurorëzojnë mallin për epopenë nacionale, format letrare janë të shumëllojshme, duke përfshirë lirikën, epikën, dramën, format elementare e të zhvilluara në prozë, dhe, për herë të parë, shfaqet gjykimi për letërsinë aktuale në trajtë të kritikës. Mjedja si përfaqësues i kësaj shkolle vjen si: mjeshtri i madh i vargut, i cili me veprën “Andrra e Jetës” (1917) nuk krijon himn, por dëshmi të*

franceskanët si grup kulturor duke i evidentuar tre tipare dalluese ndër grupet e tjera kulturore: elitizmin, koherencën, lëvrimin kulturor përtej atij fetar; A. Tufa flet për traditën kulturore franceskane (nuk përdor termin shkollë), si traditë paradigmatiche²⁰ etj, ndërsa K. Shala e K. Marku mbeten në linjën e trajtimit të shkollës jezuite si shkollë letrare.

Nëse ndalemi tek qëndrimet pro shkollës jezuite si shkollë letrare vemë re se:

1. **Ernest Koliqi** i cili përdor për herë të parë termin e shkollës letrare sheh përfaqësues tipik Mjedjen tek jezuitët e Fishtës tek franceskanët. Lidhur me këtë mund të shtojmë se: termi “shkollë” që përdor Koliqi, duhet kuptuar më tepër si term pune, sesa si mishërim i termit si përkufizim teorik që i njihen asaj. Ai unifikon termin rrymë me shkollë. Njësimi shkollë-rrymë nuk ndihmon ligjësinë e shkollës. Nga ana tjetër sipas tij rrymat kanë teori të përcaktuar, por në shqyrtimin e tij shkollat shkodrane kanë dallime relative, kanë lidhje të papreme, konsiderata që nuk përcaktojnë qartas as ndarjen as lidhjen e tyre..... Sipas tij relativiteti humb kufirin e dallimit mes shkollave²¹. Po ashtu dihet se qëndrimi i Koliqit mbi Shqipërinë dhe çështjet kulturore të saj, specifikisht ato të letërsisë, shprehin edhe konsiderata emocionale. Gjatë viteve të tij të ekzilit në Itali, Koliqi e humb koherencën që pati kur ishte ende në Shqipëri.²² Arsytimi i tij ka përcaktime objektive lidhur me disa tipare që ai vëren tek këto grupime e tek disa autorë në veçanti, por i mungon arsyetimi se çfarë i mban ata të qëndrueshëm në dinamikën e tyre. Shtojmë se

jetës shqiptare, duke i zhvilluar edhe temat e mëdha metafizike në një copë trualli konkret e duke njohur jetën e gjallë. Mjeshtër i madh i tingëllimit, Lissus (1928).

²⁰ Agron Tufa. *Përshpirtje për traditën kulturore Franceskane* në: *Iliriada portal* aksesuar në: <http://iliriada.createmyboard.com/t1757-pershspirtje-per-traditen-letrare-franceskane>

²¹ Ernest Koliqi, f. 22 Franceskanët me përfaqësuesit e tyre L.De Martin, Sh. Gjeçovi, Pashko Bardhi, Fishta, etj. kontribuan në **frazologji**. Ata ndjekin, zbulojnë traditën, mbindërtojnë mbi të, duke patur përfaqësuesin më tipik, Fishtës. Arsytimi i Koliqit mbi shkollat letrare ndërtohet duke patur parasysh kontributin e tyre në gjuhësi. Të dy shkollat-rrymat sipas tij janë marrë me gjuhën dhe letërsinë secili në mënyrën e tyre studimore. **Qëllimi i tyre primar ishte fetar e më pas asnjans e më vonë sollën kontribut historik e etnologjik**

²² Dhurata Shehri. *Statusi i kritikës*, (Ernest Koliqi, shkrimtar i ekzilit), Tiranë, Albas, 2013, f. 99-103

tipare të shkollës jezuite si: fetaria, asnjënjësia (politike) apo historia e etnologjia janë ende larg parimeve të ndërtimit të një shkolle letrare apo vetë thelbit të shkollës letrare si e tillë.

2. Studiuesi K. Shala mendon se teorikisht *një shkollë letrare*²³ *paraqet modele që zbatojnë programe, baza e të cilave janë doktrinat*. (pra shkolla letrare ka program që bazohet në doktrina) Sipas tij letërsia shqipe nuk njeh doktrina letrare të afishuara, por vetëm programet personale të autorëve të caktuar. Nga ana tjetër sipas tij nuk do të thotë se kur mungojnë doktrinat letrare kjo domosdoshmërisht tregon edhe mungesë shkolle. Kjo për shkak se duke qenë se shkollat moderne veçohen nga moduset, atëherë përafria mes tyre e drejton gjykimin në prezencën e shkollave. Kështu K. Shala është një nga mbështetësit e idesë së shkollave letrare, asaj jezuite me Mjedjen dhe asaj franceskane me përfaqësues Fishtë. Sipas Shalës urdhri bëhet ndikim kulturor, ndërsa stili dhe tema esencë letrare.²⁴ Por minimalizmi i rëndësisë së doktrinës nuk ndihmon në faktimin e shkollës jezuite si shkollë letrare.
3. K. Marku²⁵ e zgjeron më tej këtë tezë. Sipas tij ekziston pa asnjë dyshim shkolla letrare e franceskanëve dhe përkrah saj ajo e jezuitëve dhe kundërshton shkrirjen mes tyre.²⁶ Për çështjen e doktrinës si bazë për një shkollë letrare ai sheh *shënimet estetike* të Gj. Fishtës, botuar në vitin 1933, ndaj si kohë veprimi të kësaj shkolle sheh periudhën 1881-1944, boshti kulturor i së cilës ishte nën moton e binomit fe-atdhe, megjithëse ndër të tjera ai pranon se kjo nuk u konstitua si shkollë që në fillim, intuitivisht megjithatë u pranua se

²³ Kujtim Shala. *Expo. Letërsia shqipe në katër pamje*. Prishtinë, Gjon Buzuku 2007, f. 49-52

²⁴ Kujtim Shala. *Shkolla letrare e franceskanëve*, në rev.: *biblioletra*, nr. 1, 2009, f.6, dhe në: *Shkolla letrare e françeskanëve*. (Konstanta, autorë dhe vepra)”. Në: Studime albanologjike, Viti XIII/2008, f. 47-52.

²⁵ Kastriot Marku. *Shkolla letrare françeskane e Shkodrës*, Hylli i dritës, Vjeti XXXI (Tetor-Nandor-Dhjetor 2012, Nr. 4 (271), f. 40-51

²⁶ Kastriot Marku. *Shkolla letrare franceskane e Shkodrës* (distertacion) Tiranë, QSA, 2012, f. 5... *Paraqitja në ndonjë rast e të dy shkollave bashkarisht në një të vetme, nuk nënkupton thjesht një bashkim artificial, sepse funksionimi i tyre nuk ishte një organizim i detyruar, por ato janë parë si një prirje e brendshme që i bashkon përfaqësuesit e tyre në format, strukturat dhe mjetet poetike dhe mbi të gjitha sepse janë sendërtuar në një segment të përbashkët kulturologjik*

përbënte rrymë. Pas kësaj K. Marku pohon se *shkolla ra*²⁷ se nuk pati vazhdimësi. Ndjekësit iu larguan burimit folklorik, romantizmit dhe ardhja në fuqi e sistemit të ri solli shkatërrim të institucioneve dhe asgjësim fizik të përfaqësuesve. Kjo derivoi në moskomunikim të veprës me lexuesin. Mirëpo edhe pse nuk e studion shkollën jezuite si shkollë letrare ai e merr atë si të mirëqenë e ky nuk mund të jetë gjykim objektiv.

Përsa parashtruar më sipër kujtojmë se në kuptimin terminologjik,²⁸ shkolla shenjon: një grup të organizuar, parime të shpallura, ndikim, risi. (Ku i shohim këto cilësi tek jezuitët?) Në kuptimin estetik²⁹ shkollat i identifikon mënyra e krijimit sipas të njëjtit stil e teknikë. Pra ato karakterizohen nga afërsia tematike, përdallim i stilit, dimension i afërt estetik. (Nëse i referohemi Mjedjes cili është i ngjajshmi i tij?) Sipas studiuesit Hamiti shkollat letrare janë ato që njëjtësohen mbi veçantitë e cilësitë e tekstit letrar në strukturat e ligjërit, kodet tematike, format letrare, funksionin e statusin e tekstit letrar; nga autorët që mishërojnë karakteristika të shkollës; nga figurat retorike e poetike, që cilëson një tip shkrimi që mund të jetë identifikimi i tij³⁰. (teksti, forma, kodi, etj) Edhe në aspektin kritik,

²⁷ Kastriot Marku. *Shkolla letrare franceskane e Shkodrës* (distertacion) Tiranë, QSA, 2012, f. 53 **Pra:** K.Marku i pranon dy shkollat shkodrane si shkolla letrare. Argumenton për franceskanët si doktrinë letrare mendimet estetike të Fishtës, ndërsa nuk ndalet gjatë tek jezuitët, duke pranuar mëvetësi të seicilës, jo shkrimje të tyre, por edhe duke pranuar se kjo shkollë nuk pati vijimësi. Në tezën e tij K. Marku nuk i ka objekt studimi jezuitët por merr de facto ekzistencën e një shkolle letrare jezuite përballë asaj franceskane. Sipas tij “shkolla ra”, pa u ndërtuar mirë, pra nuk pati vijimësi

²⁸ Ferdinand Leka. *Fjalori i termave të letërsisë*. Tiranë, Albas, 2013, f. 382... *shkolla letrare shënon një grup shkrimtarësh që puqen mes tyre, sepse kanë pranuar disa parime themelore mbi të cilat mbështeten. Ato parime mund të shpallen edhe në një formë manifesti. Nga shkolla mund të dalë një lëvizje ose një rrymë që përhapet më gjerë në disa vende. Shkollat letrare, zakonisht nuk e kanë jetën e gjatë, por ato mund të ushtrojnë ndikim të frytshëm, kur vërtet sjellin gjëra të reja në art.*

²⁹ Tefik Çausi. *Fjalori i estetikës*. Botim i riparë dhe i plotësuar. Tiranë, OMBRA GVG, 2005, f. 426... *shkollat letrare, jemi mësuar t'i identifikojmë në letërsi me zhvendosjen metonimike të fjalës “shkollë” (si institucion edukimi) në kuptimin e talentit, të mjeshtërisë së fituar, falë punës dhe një formimi të sukseshëm.*

³⁰ Sabri Hamiti. *Poetika shqipe*, Tiranë, “55”, 2010, f. 143-158. Këto përcaktime në letërsinë shqipe Hamiti i sheh të mishëruara në këto shkolla: Shkolla filobiblike (Budi, Bogdani, Variboba), Shkolla romantike (De Rada, Serembe, N. Frashëri), Shkolla kritike (Mjedja, Çajupi, Fishta, Skiroi, Konica, Noli), Shkolla

L.Turco mendon se ndryshimi revolucionar në letërsi, në mos gjithmonë është zakonisht i shkaktuar nga përpjekjet e një shkrimtari ose grup shkrimtarësh për t'i imponuar audiencës, pra marrësit konvencione të reja dhe një nga arsyt themelore të kritikizmit është t'ia shpjegojë këto ndryshime audiencës që mund t'i pranojë ose refuzojë ato.³¹ Ndaj duke zhvlerësuar apo minimizuar rëndësinë e disa kritereve të domosdoshme për të patur një shkollë letrare si: doktrina, programet, vijimësia apo transformimi i modelit në një tjetër pas tij përmes një lidhjeje kronologjike humbet edhe kuptimi i shkollës si e tillë. Ky kolazh qëndrimesh të studiuesve të ndryshëm rreth jezuitëve (e franceskanëve) lidhur me konsiderimin dhe me pranimin e tyre si shkollë letrare, në përgjithësi nuk niset nga i njëjti kanon vlerësimi. Shkolla jezuite nuk përmbush kritere të një shkolle letrare siç i njohim shkollat e tilla në botë. Por nga ana tjetër nuk duhet harruar se shkollës jezuite i duhet njohur merita e koherencës me simotrat e saj në europë e më gjerë për programet studimore që lidhen me lëndët bazë si retorika, filozofia, teologjia, muzika etj., të cilat ndërtojnë marrëdhënie të ngushtë me letërsinë.

Tek Mjedja shfaqet një vetëdije mbi procesin e krijimit, sidomos për poezinë tek përsiatjet e tij estetike.³² Nëse i referohemi estetizmit *si një hetim filozofik në natyrën dhe perceptimin e së bukurës sidomos në art, duke e parë si teori të artit ose shijes artistike*³³ kuptojmë aftësi artistike të tij përftuar falë studimit rrënjësor të retorikës, filozofisë, muzikës, teologjisë, gjuhësisë etj. falë të cilave krijon një poetikë të ndërtuar me disa konstante të qëndrueshme. Mjedja në bashkëpunimin e tij me jezuitët bëhet **promovues i vlerave të tyre mësimore (fetare, edukuese, kulturore, shkencore) dhe kthyes i këtyre vlerave në një poetikë autoriale.**

moderne (Poradeci, **Koliqi**, Kuteli, Migjeni), Shkolla socrealiste (Hivzi Sulejmani, P. Marko J. Xoxa, I. Kadare, D.Agolli), Shkolla disidente (Kasem Trebeshina, B. Xhaferri, Z. Zorba) Shkolla moderne në Kosovë (Camaj, A. Pashku, A. Shkreli, Ali Podrimja, B. Musliu, Z. Rrahmani).

³¹ Lewis Turco. *The Book of Literary Terms: The Genres of Fiction, Drama, Nonfiction, Literary Criticism, and Scholarship*, Hanover, University Press Of New England, 1999 , f. 148

³² N.Mjedja: *Përmbi poezi përgjithsisht*. Poeti e sheh poezinë si proces krijimi ku ndërthuren disa elementë thelbësorë në të cilin vend zënë edhe përfytyrimi e fantazia. Ai shqyrton, analizon dhe vlerëson si duhet të jetë ky proces.

³³ Chris Baldick. 3-rd ed. *The Oxford dictionary of literary terms*. Oxford, Oxford University Press, 2008, f. 5

PËRFUNDIME

Jezuitët erdhën në Shqipëri fillimisht me misionin e përhapjes së fesë. Shkolla u hap nga mësues të huaj, detyrë emergjente e të cilëve ishte mësimi i gjuhës së vendit. Organizimi i saj dhe programi pedagogjik patën profil perëndimor. Kjo e bëri cilësinë e mësimdhënies në nivel të krahasueshëm me simotrat nëpër Europë dhe si e tillë ajo pati rol pozitiv në zhvillimin kulturor të vendit. Mjedja studioi pranë tyre në Shqipëri e jashtë saj e më pas u rikthye sërish në atdhe. Me ta ai pati një bashkëpunim të gjatë dhe të luhatshëm herë pas here. Vendosija e marrëdhënieve institucionale (formale) dhe njerëzore pati ulje e ngritje si për arsye të qarta (refuzimi i alfabetit jezuit, qëndrime të pavarura për çështje të ndryshme gjuhësore, kulturore e politike, qëndrime të pavarura dhe angazhim politik pa miratimin e urdhrit, etj.) ashtu edhe të paqarta ose të paprovuara (seancat ezoterike a ndonjë pakënaqësi tjetër nga ana e jezuitëve). Fakt është që Mjedja përfitoi e u rrit intelektualisht falë studimit në shkollën jezuite, po ashtu është e vërtetë që qëndroi si meshtar i lirë brenda këtij udhri. Nga ana tjetër ai ishte një aset i vyer për ta, boshti rreth të cilit ndëtohet teza e shkollës jezuite si një shkollë letrare.

Në thelb lindja e një shkolle letrare përgatit teoricienë, kritikë që me qëndrimin e tyre krijojnë doktrinë, program, përfaqësues, vijimësi, risi. Në krye të saj qëndron zakonisht një mjeshtër ose përfaqësues dhe me të nis krijohet një traditë. Përfaqësuesit duhet të kenë tematikë, stil dhe estetikë të njëjtë. Në botë shkollat janë identifikuar me mendimin teorik apo kritik të tyre. Në rastin e letërsisë shqipe shkollat shkodrane i ndajnë studiuesit në mbrojtës ose jo të idesë se ato janë edhe shkolla letrare. Fakt është se nuk ka studim të mirëfilltë rreth kësaj çështjeje, sidomos për jezuitët. Studiuesit shqiptarë shpesh janë mjaftuar duke e marrë të mirëqenë këtë fakt, nisur edhe nga termi i Koliqit, (*Dy shkollat letrare shkodrane*) që objektivisht duhet parë më tepër si term pune, sesa si përfaqësuese esencial i termit. Autorë të tjerë që janë shprehur mbi këtë çështje, arsyetojnë jo mbi të njëjtin kanon vlerësimi. (K. Shala e pranon si shkollë por nuk i njeh asaj doktrinë; K. Marku pranon ekzistencën e saj de facto pa e analizuar atë, pasi merret vetëm me franceskanët, M. Marku i sheh franceskanët si grup kulturor, Hamiti e sheh Mjedjen tek shkolla kritike, etj.)

Vijimi logjik mbi këtë çështje shkon me idenë se shkolla jezuite nuk qëndron nëse duhet t'i referohemi përkufizimit shpjegues teorik mbi të, asaj që përlligj ekzistencën e një shkolle letrare. Nuk vihet re ndonjë konstante e qëndrueshme në poetët më të shquar të kësaj shkolle që shkruan para ose në bashkëkohësi me Mjedjen, por nga ana tjetër ka një vend për diskutim në rimarrjen tjetër gjeneruese të kësaj teze duke e kthyer në çështje ndikimi poetikash. Deri tek Mjedja duhet konsideruar mendimi i tipit se jezuitët patën rëndësi të madhe për kohën kur ushtruan aktivitetin e tyre, pasi përgatitën personalitete të rëndësishme gjurmëlënëse në kulturën shqipe në mesin e të cilëve ishte edhe Mjedja i cili pati aftësinë të krijojë një poetikë origjinale. Ndaj duket se në të gjithë optikat Mjedja shërben si konstante e palëvizshme vlerësimi, sigurisht për shkak të cilësisë së tij si mjeshtër i vargut. Ndërkohë lidhur me çështjen e hapur për diskutim Shkolla jezuite dhe Mjedja në të, mbetemi në mendimin se mes tyre pati një bashkëpunim frytdhënës. Mjedja përvetësoi vlerat e tyre edukuese dhe i ktheu ato në një poetikë individuale e u kthye në një model të paarritshëm edhe për poetë të mëvonshëm. Studime të mtejshme e të përimta mbi shkollën jezuite do të ndihmonin në dritësimin të tezave të mësipërme dhe të gjenerimeve të kuptimeve që vijnë nga rimarrjet e tyre.

REFERENCA

- Baldick, Chris. *The Oxford dictionary of literary terms*. 3-rd ed, Oxford, Oxford University Press, 2008
- Cordignano, Fulvio. *Kush janë jezuitët?* Shkodër: Shtypshkronja, Zoja e Papërlyeme, 1933
- Çabej, Eqrem. *Studime gjuhësore*. Prishtinë, Rilindja, 1975
- Çausi, Tefik. *Fjalori i estetikës*. Botim i riparë dhe i plotësuar. Tiranë, OMBRA GVG, 2005
- Elsie, Robert. *Histori e letërsisë shqiptare*. Pejë, DUKAGJINI, 2001
- Hamiti, Sabri. *Poetika shqipe*, Tiranë, “55”, 2010
- Koliqi, Ernest. *Vepra 5*, Prishtinë, FAIK KONICA, 2003
- Leka, Ferdinand. *Fjalori i termave të letërsisë*. Tiranë, Albas, 2013
- Marku, Kastriot. *Shkolla letrare franceskane e Shkodrës* (distertacion) Tiranë, QSA, 2012
- Ndre Mjedja*. Tiranë, 8 nëntori, 1980
- Pedagogjia Injaciane*, hyrje në praktikë, Shkodër, shk. Pjetër Meshkalla, 1996

Quku, Mentor *Mjeda 3/ libri 1: Alfabeti*, Tiranë, Ilar, 2007

Quku, Mentor. *Mjeda 4: Identitet*, Tiranë, Ilar, 2009

Quku, Mentor. *Mjeda 7*. Tiranë, Ilar, 2005

Shala, Kujtim. *Expo. Letërsia shqipe në katër pamje*. Prishtinë, Gjon Buzuku, 2007

Shala, Kujtim. *Shkolla letrare e franceskanëve*, në rev.: *biblioetra*, nr. 1, 2009

Shehri, Dhurata. *Statusi i kritikës*, (Ernest Koliqi, shkrimtar i ekzilit), Tiranë, Albas, 2013

Tufa, Agron. *Përshpirtje për traditën kulturore Franceskane* në: *Iliriada portal* aksesuar në: [http:// iliriada.createmyboard.com/t1757-pershspirtje-per-traditen-letrare-franceskane](http://iliriada.createmyboard.com/t1757-pershspirtje-per-traditen-letrare-franceskane)

Turco, Lewis. *The Book of Literary Terms: The Genres of Fiction, Drama, Nonfiction, Literary Criticism, and Scholarship*, Hanover, University Press Of New England, 1999

REVISTA

Hylli i dritës, nr 2 (269), Shkodër, 2011

Hylli i dritës, vjeti IX, korrik gusht , Shkodër, Shtyp. Franceskane, 1933, nr.7-8

Hylli i dritës, vjeti XXXI (Tetor-Nandor-Dhjetor 2012, Nr. 4 (271)

Shejzat, vjeti XIV, nr. 10, Romë, 1970, f. 316-326 *Urtia*, nr 2 (20), Shkup-Prizren, 2006

PËRMBAJTJA

Sabri HAMITI

NDRE MJEDJA: LIRIKU KLASIK5

Kolec TOPALLI

NDRE MJEDA SI GJUHËTAR.....35

Floresha DADO

MJEDJA – TRI POETIKA NË NJË!47

Rexhep ISMAJLI

MJEDJA PËR ALFABETIN NË RAPORT ME JEZUITËT
E TË TJERËT59

Dhurata SHEHRI

STINËT E MJEDJES67

Bardhyl DEMIRAJ

Ilir. Bassania75

Ali ALIU

LEXIMI DHE RILEXIMI I MJEDJES99

Shaban SINANI

IKJA PREJ RIMËS GRAMATIKORE SI IKJE PREJ
RAPSODISË103

Nysret KRASNIQI

NDRE MJEDJA: FIGURA SI SHENJË E IDEVE127

Gjovalin SHKURTAJ

“SHQYPTARIJA” DHE PËRBASHKËSIA E GJUHËS SI
DËSHMI E NJËSISË SË KOMBIT SHQIPTAR NË
VEPRAT E NDRE MJEDËS143

Hysen MATOSHI

VEÇANTI STILISTIKE TË VEPRËS LETRARE TË
NDRE MJEDËS155

Dom Nikë UKGJINI

QENDRA MUZEORE NDRE MJEDA VEND TAKIMI
GJITHËKOMBËTAR161

Persida Asllani

SHKRIMI FILOBIBLIK I MJEDJES171

Kujtim M. SHALA

MJEDJA: NORMA E FORMA.....207

Mark MARKU

PËRFAQËSIMI I BOTËS SHQIPTARE NË
VEPRËN E MJEDËS219

Vjollca OSJA

POETIKA E MJEDJES NË MES POETIKAVE TË
KODIFIKUARA DHE IDIOPOETIKËS225

Femi ÇAKOLLI

PSALMIMI NË POEZINË E NDRE MJEDËS233

Edlira MACAJ

SHKOLLA JEZUITE DHE VENDI I MJEDJES NË TË243

NDRE MJEDJA - 150 VJETORI I LINDJES
Konferencë Shkencore, 15 shtator 2016
2016

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 16.5 tabakë shtypi
Tirazhi: 200 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18.09
929(496.51) Mjedja, Ndre

Ndre Mjedja 150 vjetori i lindjes: Konferencë Shkencore 15 shtator 2016 / redaktor Eqrem Basha. – Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë; Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2016. – 256 f.; 24 cm.

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze. – Bibliografi, referenca pas disa punimeve.

1.Basha, Eqrem

ISBN 978-9951-615-65-5